

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik 1953-1961

Juljana Krisafi

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Sociale, me profil **Marrëdhënie Ndërkombëtare**, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. Ksenofon Krisafi**

Numri i fjalëve: 62 820

Tiranë, Korrik 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë Juljana Krisafi deklaroj se studimi është një punë origjinale e imja. Siguroj që nuk kam përdorur asnjë ide, të dhënat ose gjuhën e një subjekti tjetër pa njohjen dhe referencën specifike.

ABSTRAKTI

Stalini, ishte muza politike e Enver Hoxhes. Mbi këtë adhurim Enver Hoxha ndërtoi marrëdhënien me Bashkimin Sovjetik. Pas vdekjes së tij kështjella u trondit, por u shemb vetëm pas disa vitesh në vitin e ftohtë diplomatik 1961. Marrëdhënia e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik nuk ishte një marrëdhënie reciproke. Kontributi i dhënë nga sovjetikët ishte vërtetë shumë i madh. Pas çlirimit Shqipëria ishte një vend i falimentuar, shumë i varfër. Miqësia me jugosllavët nuk mjaftoi për ta ringritur vendin e vogël ballkanik për aq pak sa zgjati. Në 1948-ën kur Bashkimi Sovjetik i mori seriozisht marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë e gjeti atë në një nevojë shumë të madhe për para dhe mbështetje me ekspertë të të gjitha fushave. Faktet tregojnë se Bashkimi Sovjetik ishte ai që i fryu zjarrit të prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ndërkohë që Stalini doli hapur kundër përfshirjes së Shqipërisë në një federatë Ballkanike udhëhequr nga Jugosllavia e Titos. Marrëdhënia e udhëheqjes shqiptare me Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit nuk mundi të gjallohej pasi vetëm dy vjet pas ndarjes nga jeta të udhëheqësit Stalin, u shfaq fantazma e Jugosllavisë. Një fantazëm që do ta përndiqte Enver Hoxhen deri në prishjen e vitit 1961. Destalinizimi dhe rregullimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë ishin dy lëvizjet të cilat turbulluan ujrat e kthejllta të marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike. Sovjetiket dolën hapur disa herë në përpjekjet e tyre për ta përmbysur regjimin e Hoxhës dhe Shehut por nuk ia dolën. Këtë e kuptoi edhe udhëheqja shqiptare. Por Enver Hoxha nuk kishte të ndalur. Kush kërcënonte pushtetin e tij ekzekutohej, internohej, shkatërrohej për jetë. Por a ishin të dobishme për Shqipërinë marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik? Faktet tregojnë që po. Por koha tregoi që Enver Hoxha duhet të ndiqte rrugën e hapjes, liberalizimit. Me pak fjalë lideri komunist shqiptar nuk pranoi kurrë të destalinizohej, gjë që rezultoi fatale si në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe me gjithë vendet e tjera dhe përfundoi në izolimin më të madh të Shqipërisë deri në përmbysjen e regjimit në vitin 1990.

Fjalë kyçe: Shqipëria, Bashkimi Sovjetik, Komunizëm, Jugosllavia

ABSTRACT

Stalin, was the political muse of Enver Hoxha. On this worship Hoxha built the relationship with the Soviet Union. After Stalin's death Hoxha's castle was shaken but collapsed only a few years later, in the cold diplomatic year 1961. Albania's relationship with the Soviet Union was not a mutual relationship. The contribution given by the soviets was indeed very big. After the war, Albania was a bankrupt country, the poorest in the Balkans. The friendship with the yugoslavs was not enough to rebuild this tiny Balkan country. In 1948 , when the Soviet Union built serious diplomatic relations with Albania, found the small country in a urge for money and support with experts. Analysing the facts, the Soviet Union was that, which prompted the split between Albania and Yugoslavia. Stalin came out against the inclusion of Albania in a Balkan federation led by Tito's Yugoslavia. Albanian leadership relations with the Soviet Union after Stalin's death failed to enliven, because only after two years, appeared the ghost of Yugoslavia. A ghost that would persecute Enver Hoxha until the 1961 split with the soviets. De-stalinization and the normalisation of the relations with Yugoslavia were two movements which stirred the clear waters of the albanian - soviet relations. Soviets came out some times in their efforts to overthrow the regime of Hoxha and Shehu but failed. The albanian leadership understood their intentions. In this situation Enver Hoxha never stopped. Who threatened his power was executed, deported, ruined for life. But were they useful for Albania the relations with the Soviet Union? The evidences suggest, yes. The time showed also that Enver Hoxha should follow the liberalization and the openness of the country. Shortly, the albanian communist leader never accepted the de-stalinization, which proved fatal for the relations with the Soviet Union , as well as with all other countries and ended in the greatest isolation af Albania until the overthrow of the communist regime in 1990.

Key words: Albania, Soviet Union, Communism, Yugoslavia

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KREU I. HYRJE DHE BAZA TEORIKE

1.1 Hyrje	10
1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit.....	10
1.2.1. Pyetjet hulumtuese të studimit.....	10
1.2.2. Hipoteza e punimit.....	11
1.3. Metodologjia dhe metodat e punimit shkencor.....	12
1.4. Struktura e punimit.....	15
1.5. Skeleti teorik dhe modeli analitik I temës.....	23
II. Një historik i shkurtër i marrëdhënieve shqiptaro - ruse deri në vitin 1953	29
III. Vdekja e J.V.Stalin dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së tij (periudha e muajit të mjaltit).....	41
3.1. Hapat e parë të rivendosjes së marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë dhe reagimi i Tiranës zyrtare.....	53
IV. Mosmarrëveshjet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik 1955- 1957.....	62
4.1: Ngjarjet në Hungari dhe turbullimi i marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë dhe qëndrimi i Tiranës zyrtare.....	71
V. 1958 - 1959 vitet e përmirësimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vizita e Nikita Hrushovit në Shqipëri.....	90

5.1: Baza ushtarako – detare e Vlorës.....	100
VI. Ndarja e madhe me Bashkimin Sovjetik.....	108
6.1: Roli i Shqiperise në prishjen sovjeto - kineze	110
VII..Konkluzione.....	164
Bibliografia.....	167

Kapitulli I: HYRJE DHE BAZA TEORIKE

1.1 Hyrje

Ky është një studim doktrature dhe ka për qëllim të hedhë dritë mbi një periudhë mjaft interesante dhe intensive të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Kam zgjedhur të studioj periudhën nga viti 1953, pas vdekjes së Stalinit dhe deri në ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike në vitin 1961. Është një nga periudhat më të dendura në lëvizje diplomatike dhe politike brenda këtyre marrëdhënieve. Ka pasur edhe më herët studime për marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik por meqënëse kohë pas kohe dalin në dritë dokumente të reja dhe fakte të reja rreth çështjes në fjalë atëherë asnjë studim nuk do të ishte i tepërt. Gjithësesi unë do të përpiqem të hedh dritë në bazë të dokumenteve, intervistave, filmimeve, shtypit të shkruar të kohës dhe sigurisht librave të shumtë që janë shkruar rreth Bashkimit Sovjetik dhe sjelljes së tij me satelitët e tjerë të bllokut komunist, në ngjarjet pikante hap pas hapi duke nisur nga vdekja e Stalinit dhe deri tek kalimi përfundimtar i Shqipërisë komuniste në krah të Kinës së largët. Por nuk do të lë pa kërkuar rrënjët e ndarjes dhe gjithë zhvillimeve të tjera të rëndësishme më larg, në vitet e pasluftës së dytë botërore, krijimin e partisë komuniste shqiptare, rolin e Bashkimit Sovjetik në marrëdhënien tonë me Jugosllavinë etj. Në qendër të studimit është mënyra e të bërit politikë të jashtme në diktaturë, me një superfuqi, nga e cila kemi qënë plotësisht të varur. Kjo është edhe tema më e rëndësishme dhe në funksion të së cilës është shkruar ky punim. Por sigurisht që nuk do të jetë e vetmja.

1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e punimit

1.2.1. Pyetjet hulumtuese të studimit

Marrëdhënia e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik ka qënë shumë komplekse. Duke analizuar dokumente që i përkasin periudhës por edhe dëshmi të kohës lindin një sërë pyetjesh kërkimore për të vërtetuar nëse marrëdhënia jonë me këtë superfuqi ka qënë ashtu siç na është paraqitur deri tani, apo gjërat nuk janë ashtu siç duken.

- (i) A ka qënë Shqipëria plotësisht e varur nga Bashkimi Sovjetik?
 - (ii) A ishte vërtetë Shqipëria në qendër të vëmendjes së Bashkimit Sovjetik ashtu siç ishte krijuar idea në vite?
 - (iii) A kishte mundësi të sillej ndryshe Enver Hoxha me Bashkimin Sovjetik dhe cila ka qënë pika më e fortë e Shqipërisë në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik?
 - (iv) A ishte vetëm fasadë fakti që shqiptarët në marrëdhëniet diplomatike me BS-në dukej sikur pajtoheshin, por në fakt kishte një mënyrë unike të Hoxhës të të perceptuarit dhe vepruarit në këtë fushë?
 - (v) A ishte zvarritja e çështjeve që nuk i pëlqenin Hoxhës mënyra më e mirë e zgjedhur prej tij për të refuzuar?
 - (vi) Çfarë fshihej në telegramet, radiogramet, letrat sekrete që shkëmbeheshin mes ambasadorëve, zyrtarëve të delegacioneve e deri tek ato të udhëheqësve të mëdhenj dhe cila ishte gjuha që përdorej prej tyre?
 - (vii) A ka pasur një plan Hrushovi për ta sulmuar Shqipërinë dhe a mund ta bënte këtë duke marrë parasysh edhe pozitën tonë gjeografike?
- Këto dhe të tjera pyetje do të marrin përgjigje në brendësi të këtij punimi.

1.2.2. Hipotezat e punimit

Një element mjaft i rëndësishëm në strukturën e punimit doktorale është hipoteza e studimit, e cila paraqitet në funksion të pyetjeve kërkimore. Ky studim ofron tre hipoteza që shtrojnë problemin kyesor. Në të gjithë paragrafët e tij ky studim përpaket të tregojë vërtetësinë e këtyre hipotezave.

Hipoteza e parë dhe kryesore e punimit është : Bashkimi Sovjetik nuk kishte atë interesin gjeopolitik apo ekonomik për Shqipërinë, siç mendohej në atë kohë. *Afrimi I Bashkimit Sovjetik me Shqipërinë erdhi kryesisht për shkak të prishjes së marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë dhe të Shqipërisë me këtë të fundit.* Pa përkrahje ekonomike dhe

politike, Shqipëria gjeti tek Bashkimi Sovjetik mbështetjen ekonomike dhe politike që I duhej për të plotësuar vakumin e krijuar nga prishja me Jugosllavinë.

Hipoteza e dytë e punimit është : *Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik nuk dolën ndonjëherë nga tutela e varësisë dhe e preferencave*. Edhe pse brenda të njëjtit kontekst ideologjik marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik reflektonin raportet e fuqive dhe për këtë arsye ato përherë u dominuan nga presioni, nga shantazhi nga njëra anë, dhe perkulja e bindja nga ana tjetër.

Hipoteza e tretë: *Në raport me jugosllavët, Shqipëria asnjëherë nuk ka qenë prioritare, për Bashkimin Sovjetik*. Në çdo rast ajo do të duhet të trajtohej në varësi të ulje - ngritjeve të marrëdhënieve BS - Jugosllavi. Kjo nuk ndryshoi si në kohën e Stalinit edhe në atë të Hrushovit.

1.3. Metodologjia dhe metodat e punimit shkencor

Modeli i hulumtimit mbi të cilin mbështetet punimi është ai i rastit studimor, duke u fokusuar tek konteksti i marrëdhënieve ndërkombëtare në një periudhë të caktuar (marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik në periudhën 1953 – 1961).

Strategjia e hulumtimit e kombinuar :

- *Hulumtimi vlerësues* fokusohet në:
 - Vlerësimin e periudhës (1953-1961) nëpërmjet identifikimit të treguesve kryesorë, vlerave të tyre dhe ndikimit në analizën e rastit studimor.
 - Vlerësimin e implikimeve të marrëdhënieve në kontekstin e brendshëm dhe ndërkombëtar nëpërmjet analizimit të sjelljes së aktorëve, ligjërimit të tyre dhe dokumenteve strategjikë.

- Ky model përdoret kryesisht për t'i dhënë përgjigje pyetjeve dhe hipotezës së dytë të punimit.
- *Hulumtimi krahasues*
 - Më ka ndihmuar në dhënien përgjigje për pyetjen dhe hipotezën e parë dhe të tretë të punimit, të cilat lidhen me faktorët që përcaktojnë kontekstin e çështjeve në disa raste dhe në disa raste të tjera jo, pavarësisht problematikave të ngjashme.
 - Hulumtimi krahasues përbëhet prej konstatimit të ngjashmërisë dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme, në këtë rast për të kuptuar dhe interpretuar më mirë sjelljet e shteteve (Shqipëri dhe Bashkimi Sovjetik) dhe politikat e caktuara të tyre, në këtë rast në lidhje me marrëdhëniet mes të dy vendeve. Krahasimet mund të bëhen mes fushave, faktorëve dhe aktorëve të ndryshëm apo edhe ndërmjet shteteve ose organizatave të ndryshme.

Studimi kërkimor politik është ndër – disiplinor, prandaj edhe metodat e përdorura janë të huazuara nga fusha të tjera shkencore. Një metodë të vetme nuk ka, pasi kjo varet nga objekti i studimit, por më duhet të theksoj se një nga metodat e kërkimit më të përhapura në shkencat politike, është metoda krahasuese. *Kjo metodë konsiston në krahasimin e dy apo më shumë objekteve të studimit që në këtë rast janë shtetet dhe sjellja e tyre në arenën ndërkombëtare.* Në aspektin kohor, mund të jenë në kohë të ndryshme, diakron ose sinkron, në të njëjtën kohë. Në sferën hapësinore studimet krahasuese mund të jenë brenda – shtetërore, ndër rajonale apo globale. *Qasja empirike zë një vend të veçantë në metodikën e kërkimit shkencor në shkencat politike. Në këtë rast ajo mundohet që realitetin e politikës ndërkombëtare përgjatë viteve që merren në studim, ta interpretojë në mënyrë sa më objektive nëpërmjet vërtetimeve, përvojave, instrumenteve dhe metodave të caktuara shkencore. Përveç metodës*

krahasuese në studim, unë kam përdorur gjithashtu edhe *metodën cilësore përmes së cilës siguroj kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit nga prizmi historik dhe filozofik, duke grumbulluar të dhëna dhe informacione me qëllim krahasimin e rasteve apo duke u bazuar në një rast të vetëm studimor*. Këtë e kam bërë me anë të shqyrtimit të literaturës si dhe analizimit të dokumenteve arkivorë. Përsa i përket literaturës janë marrë ne shqyrtim vepra të njohura botërore të cilat kanë përshkruar dhe analizuar modelin e diktaturës staliniste në Shqipëri si dhe sjelljen e diktatorit Enver Hoxha në arenën ndërkombëtare. Mund të themi se botimet akademike për këtë temë janë te shumta dhe me material të bollshëm. Një vend të veçantë zënë dokumentet e komitetit qendror të PPSH-së, si dhe veprat e Enver Hoxhës të cilat përfshijnë në vetvete dokumente të vlefshme. Përveç metodës cilësore më ka ndihmuar në këtë punim edhe metoda sasiore. *Për përpunimin e të dhënave sasiore fokusohemi ne totalin e dokumentacionit, treguesit e ndikimit, trendet bashkëkohore të cilat kombinohen dhe me të dhëna të tjera sasiore si treguesit ekonomikë dhe kulturorë, pra mbështetemi tek të dhënat numerike që janë të prezantuar në trajtën e statistikave*. Analizimi i të dhënave sasiore zhvillohet nëpërmjet kombinimit të analizës statistikore dhe qasjes analitike. *Të dhënat cilësore, dokumentet e rëndësishme për këtë punim, variojnë nga dokumentet strategjike të aktorëve kryesorë e deri tek deklaratat e tyre*. *Në themel të punës kërkimore ka qenë hulumtimi dhe studimi i dokumentave, dëshmime të protagonistëve si dhe literaturës vendase e të huaj për problemet që lidhen me bllokun lindor në vitet 1950 - 1961*. *Për shkak edhe të profesionit, intervistimi i protagonistëve të kohës dhe historianëve të ndryshëm ka zënë një vend të veçantë në punim*. *Ata kanë hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të kësaj periudhe, në funksion të vërtetimit të hipotezave që kam ngritur*.

Kufizimet metodologjike të punimit kanë të bëjnë me vështirësinë e balancimit të dokumentacionit që kemi në dispozicion për shkak të këndvështrimit të ndryshëm mes palëve, të dokumentacionit të marrëdhënieve shqiptaro – ruse. Rusia vazhdon të jetë mjaft konservatore në publikimin e dokumentacionit për këtë periudhë. Materialet shqiptare që i kemi në dispozicion dhe i përkasin kësaj periudhe (1953-1961) kanë ngarkesa të theksuara ideologjike dhe propagandistike. Numri voluminoz i dokumentacionit vendas, të dhënave

në dispozicion, vështirësitë në përzgjedhjen e deklaratave apo dokumentave më të përshtatshme është një tjetër kufizim. Gjithashtu vlen për tu theksuar numri i kufizuar i analizave nga palë të treta , për shkak të peshës së vogël të marrëdhënieve Shqipëri – Bashkimi Sovjetik, në marrëdhëniet ndërkombëtar etj. Me qëllim minimizimin e pasojave që vijnë nga kufizime të tilla, punimi fokusohet në përdorimin e analizës në kontekstin e kësaj periudhe si rast studimor, përzgjedhjen e tre niveleve (konteksti-aktorët-rezultatet) për të ndihmuar në vendosjen në një koherencë të brendshme të punimit. Gjithashtu edhe fokusimi tek një numër i përcaktuar treguesish mbi implikimet në marrëdhëniet dy palëshe siç janë ligjërimi i aktorëve dhe dokumentet strategjike kryesore. Vlen për tu theksuar edhe kufizimi kohor për këtë qëllim (1953-1961).

1.4. Struktura e punimit

E kam nisur këtë punim doktoral me një historik të shkurtër të marrëdhënieve mes të dy vendeve. Për tu ndalur më hollesisht në një moment kyç. Vdekja e Stalinit. Punimi është strukturuar në 8 kapituj kryesorë. Secili ka nëndarjet e veta duke trajtuar çështje të rëndësishme të punimit. Prishja e marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë i ka rrënjët në periudhën menjëherë pas vdekjes së Stalinit. Në fakt ajo shpërtheu në qershor të vitit 1960 në mbledhjen e partive komuniste nga e gjithë bota, organizuar në Bukuresht të Rumanisë. Zyrtarisht ky është quajtur si momenti i prishjes nga të dyja palët si nga Hrushovi ashtu edhe nga liderët komunistë shqiptarë. Por në bazë të fakteve dhe dokumenteve por edhe analizave të ndryshme duket se fara e grindjes u hodh që në vitet e para pas luftës së dytë botërore. Atëherë kur Bashkimi Sovjetik dhe politika e tij ishte plotësisht dakort me tutelën jugosllave mbi Shqipërinë e vogël por edhe në një farë mënyre bekoji qëllimet e Jugosllavisë për të futur Shqipërinë brenda një shteti të madh federativ jugosllav. Jugosllavët ishin në një farë mënyre kumbarët e Partisë Komuniste shqiptare në vitin 1941. Që nga kjo kohë influenca e jugosllavëve u rrit dhe Shqipëria e vogël dhe shumë e varfër, nuk kishte fuqi të

luftonte për më shumë pavarësi. Në këtë mënyrë vendi ynë u bë mjaft i varur nga Jugosllavia, si në fushën ekonomike, politike por edhe në atë të sigurisë.

Gjatë viteve të luftës por edhe pas saj kontaktet mes Partisë Komuniste shqiptare dhe asaj sovjetike ishin minimale. Kontaktet e para me sovjetikët ishin në verën e vitit 1944 kur një grup i vogël ushtarakësh sovjetikë mbërritën në Shqipëri. Marrëdhëniet diplomatike mes të dy vendeve u vendosën në vitin 1945, por ishin të vakëta. Ka qënë pranvera e vitit 1948, koha kur sovjetikët vendosën të investonin në Shqipëri seriozisht dhe në të gjitha fushat. Kjo përkon edhe me periudhën kur çarja mes Stalinit dhe Titos arriti kulmin.

Prishja e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë në vitin 1948 do të bënte të mundur që për Shqipërinë të niste një erë e re. Tashmë shqiptarët do të kishin mbi krye një idhull të ri. Dhe ky idhull do të ishte Stalini. Në këtë mënyrë do ta adhuronte atë Enver Hoxha, por do t'ia impononte në këtë mënyrë edhe popullit shqiptar. I madh e i vogël do ta shihte Stalinin si perëndi. Gjithësesi marrëdhënia me Bashkimin Sovjetik ishte një shans i mirë për liderët shqiptarë, ajo u përdor për tu rimëkëmbur ekonomikisht si dhe për të përmirësuar pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare e sidomos brenda bllokut komunist. Ishte kjo koha kur Enver Hoxha nxitoi të demaskonte ata që ai i quajti “Titistët” me në krye Koçi Xoxen dhe mbështetësit e tij. Kjo ishte koha kur bindja ndaj Bashkimit Sovjetik kishte arritur kulmin.

Por në qiellin e kaltër të marrëdhënieve të shkëlqyera mes të dy vendeve vjen si një rrufe vdekja e Stalinit e cila do të përshkruhet me hollësi në brendësi të këtij punimi. Atmosfera e krijuar, komunikimi, përcjellja nga shtypi dhe tronditja e madhe e krijuar do të jetë pjesë e kapitullit të dytë. Këtu liderët shqiptarë nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të përshtateshin me kursin e ri të politikës sovjetike pas marsit të vitit 1953. Duhet nënvizuar dhe pranuar se vdekja e Stalinit e çorientoi busullën e Enver Hoxhes. Ai u përpoq të përshtatej me kursin e ri të Bashkimit Sovjetik por zhvillimet treguan që nuk ia doli.

Kapitulli i radhës, i pesti, do të përshkruajë dhe analizojë një periudhë mjaft të rëndësishme. Periudha kur u bënë të dukshme shenjat e para të ndryshimit të sjelljes së sovjetikëve me Jugosllavinë armike. Kjo është periudha kur u krijua një ndjenjë shqetësimi, ankthi dhe

mosbesimi në kupolën e Partisë Komuniste shqiptare. Deri në këtë kohë shqiptarët ishin mjaft të bindur edhe në interes të ndihmës shumë të madhe ekonomike që i vinte nga BS-ja. Në vitin 1955 ata filluan të mos i bindeshin më verbërisht kursit që ndiqte Bashkimi Sovjetik. Në këtë kohë Hrushovi vizitoi Beogradin. Gjithësesi Enver Hoxha në këtë periudhë u përpoq të ulë tonet kundër Jugosllavisë me kërkesë të Hrushovit, i cili u përpoq ta bindte se bllokut i interesonte ta kishte me vete Jugosllavinë. Hoxha nuk pranoi kurrësesi të rehabilitonte figurën e Koçi Xoxes apo të bënte një lloj destalinizimi të kursit të tij politik ashtu siç po e inkurajonte tashmë Bashkimi Sovjetik.

Një moment mjaft i rëndësishëm është revolucioni hungarez i cili duket se e përmbysi kursin e ngjarjeve dhe Enver Hoxha e Mehmet Shehu u çliruan nga cdo lloj presioni për reforma të brendshme. Pavarësisht çlirimit, pozitat e tyre u rrezikuan seriozisht në 1956-ën e si rrjedhim edhe besimi tek liderët sovjetikë tani ishte dobësuar e kishte pësuar shumë krisje. Faktet tregojnë se në këtë periudhë Shqipëria vuri re interesin e Kinës së largët për Europën lindore dhe në një farë mënyre në fillim në mënyrë të padukshme e më pas hapur ta mbështesë Kinën në avancimin e saj.

Ndërkohë që gjërat shkonin shumë mirë me Bashkimin Sovjetik në vitet e para të miqësisë, shqiptarët i kishin kushtuar pak vëmendje rregjimit komunist të Pekinit i cili u vendos në 1949-ën. Vëmendja e Kinës së largët u drejtua mbi Shqipërinë pas vdekjes së Stalinit. Kina do të përdorej si një prehër i besueshëm nga liderët komunistë shqiptarë. Në 1956-ën pas humbjes së besimit tek Bashkimi Sovjetik udhëheqja shqiptare filloi të shohë më me vëmendje Kinën dhe zhvillimet në të. Lëvizjet u intensifikuan edhe nga vizitat e udhëheqjes shqiptare në Kinë. Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu u impresionuan dukshëm nga kontaktet e para me kinezët në Pekin në tetor të 1956-ës dhe u kthyen në Shqipëri me sigurinë se liderët kinezë e vleresonin pozitën e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë më shumë se sa e vlerësonte Moska. Në vazhdim marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kinës u rritën dhe arritën kulmin në maj të vitit 1958, periudhë kur Kina nisi një fushatë kundër revizionizmit jugosllav. Dhe për Tiranën zyrtare kjo ishte si një dhuratë e bukur, duke marrë parasysh mospërputhjen thuajse të përhershme të Enver Hoxhës me Titon dhe partinë e tij.

Pavarësisht interesit të dukshëm të Hrushovit për të ndryshuar politikën ndaj Jugosllavisë nuk ishte e thjeshtë të binte dakord me Titon. Edhe pse dukej hapur që ky i fundit ishte mjaft i interesuar që ta sillte sërish brenda bllokut Jugosllavinë, përsëri gjërat nuk shkuan ashtu siç duhej. Rekuperimi i marrëdhënies së Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë do të kishte dritëhije dhe ulje ngritje në varësi të ngjarjeve të aktualitetit dhe Shqipëria sigurisht zinte një vend ndikues në marrëdhënien mes tyre. Hija e ndarjes pllakosi sërish në 1957-ën. Ngjarjet në Hungari dhe strehimi i Imre Nagit në ambasadën jugosllave e zemëruan Hrushovin.

Këto zhvillime i hapën rrugën një periudhe të re marrëdhëniesh mjaft të mira mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Kapitulli I gjashtë do të përshkruajë me kujdes dhe hollësi ngjarjet përgjatë viteve 1958 - 1959 kur sovjetikët e forcuan dhe e shtuan pozitën e tyre në Shqipëri, duke shtuar prezencën fizike dhe sulmet ndaj Jugosllavisë. Në këtë periudhë liderët shqiptarë u munduan me cdo kusht ti vërtetonin sovjetikëve se besnikëria dhe vlerësimi ndaj tyre nuk ishte lëkundur kurrë. Do të shohim se si Hrushovi nuk u dorëzua pavarësisht mosmarrëveshjeve me Titon për ta futur sërish këtë të fundit brenda bllokut. Ky lloj merakut dhe dyzimi i tij në sjelljen ndaj Jugosllavisë nuk iu vinte për shtat liderëve shqiptarë. Në njërën anë po të analizosh deklaratat e kohës, Hrushovi dukej sikur e përkrahte vendimin e ndrojtur dhe mosbesues të Shqipërisë për të rehabilituar marrëdhënien me Jugosllavinë dhe në një farë mënyre dukej sikur vetfajësohej kur mendoj se Tito dhe Jugosllavia do të ktheheshin në rrugë të mbarë dhe brenda bllokut. Por veprimet e tjera tregonin se Hrushovi asnjëherë nuk i la përpjekjet për ta afruar Jugosllavinë. Në korrik të 1958-ës, ai bëri thirrje për një ulje të polemikave. Do të thoshte se Hrushovi vazhonte të ishte ambicioz për të rikthyer Titon.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1959, marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dukej se ishin në qiellin e shtatë. Kjo u vu re në pozitat në ngritje të Shqipërisë në çështjet e bllokut. Vizita e Hrushovit në Tiranë më 25 maj 1959 ishte një nga fishekzjarrët e kësaj gjëndje. Hrushovi nisi një vizitë të gjatë në Shqipëri. Më e gjata që ai kishte zhvilluar ndonjëherë në ndonjë nga vendet e bllokut, përveç asaj të Kinës në tetor të 1954-ës. Pas vizitës së fundit të Zhukovit në 1957-ën, kjo ishte vizita e parë e një udhëheqësi të lartë sovjetik në Shqipëri pas një kohe të gjatë. Dukej sikur kjo vizitë u planifikua e tillë, si për tu

mbushur mendjen shqiptarëve se sovjetikët nuk po i linin aspak pas dore. Por në këtë mënyrë Hrushovi do të njihej më mirë me Shqipërinë, me problemet e saj, me njerëzit dhe liderët e saj dhe si rrjedhojë do të përpiqej të fshinte çdo lloj gjurme nga fërkimet e mëparshme. Por vizita ndoshta nuk ishte aq e sukseshme sa u duk në atë kohë. Hrushovi u zhgënjye shumë nga prapambetja dhe ngathtësia e ekonomisë shqiptare. Liderët shqiptarë, ndoshta edhe u bezdisën nga insistimi i vazhdueshëm i Hrushovit që të ulnin rritimin e sulmeve ndaj Jugosllavisë por të merreshin intensivisht me punët e brendshme të vendit që nuk ishte aspak në gjëndje të mirë.

Vera e vitit 1959 nxorri në pah mosmarrëveshjet mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Molla e sherrit mes dy superfuqive ishte strategjia komuniste ndërkombëtare. Në dhjetëvjetorin e rregjimit të Pekinit do të merrnin pjesë edhe liderët më të lartë të Partisë Komuniste shqiptare, ngjarje në të cilën ata do të ndergjegjësoheshin rreth ftohjes mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Ajo që i shqetësonte deri në atë cast liderët shqiptarë ishte sjellja e Hrushovit me Jugosllavinë dhe aspak zgjerimi i strategjisë komuniste ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe marrëdhëniet me fuqitë perëndimore. Por duke ndjekur festimet në Pekin, ata filluan të kapin pozicionet në mbështetje të kinezëve në të dyja fushat si ideologjike, ashtu edhe në çështjet ndërkombëtare. Në mesin e tetorit të vitit 1959 liderët shqiptarë dolën hapur dhe u rreshtuan në krah të Kinës në çështje të ndryshme të cilat kishin hasur në kundërshtimin e Moskes, ngjarje këto që do ti gjejmë të analizuar në kapitullin e fundit të punimit.

Më 15 tetor radio Tirana në një kronikë të saj lavdëronte rajone të ndryshme në Kinë të cilat arritën të transformoheshin nga rajone të varfra në të pasura në një kohë mjaft të shkurtër. Tirana dukej se tashmë ndihej e frikësuar nga tendenca e Hrushovit për tu hapur me perëndimin dhe po dilte hapur kundër uljes së tensionit mes lindjes dhe perëndimit. Ngjarjet që pasuan në kohën kur në Shqipëri festohej 15 vjetori i çlirimit më 28 nëntor i vunë vulën rritjes së tensionit në marrëdhëniet mes Tiranës dhe Moskës si dhe ngrohjes së marrëdhënieve shqiptaro - kineze. Viti 1960 njihet zyrtarisht si viti kur marrëdhëniet shqiptaro - sovjetike do të precipitonin. Me 6 janar 1960, Vukmanoviç Tempo, kryetar i unionit tregëtar dhe një anëtar i byrosë politike jugosllave, lë Beogradin për tre javë pushime në Bashkimin Sovjetik. Dhe kjo ishte vizita e parë e një zyrtari të lartë të Jugosllavisë në Bashkimin Sovjetik që nga

Nëntori i vitit 1957, gjë që pasoi me bisedime të Hrushovit dhe ambasadorit jugosllav në Moskë, si dhe bisedime të Titos dhe ambasadorit sovjetik në Beograd. Megjithëse bisedimet e Vukmanoviçit me Hrushovin dhe liderë të tjerë gjatë qëndrimit në Bashkimin Sovjetik ishin të pafrytshme, ato treguan sërish më së miri dëshirën dhe interesin e Hrushovit për afrim me jugosllavët. Në këtë kohë shqiptarët u vunë në alarm për këto bisedime madje nuk nguruan ti shprehin rezervat e tyre Hrushovit. Një moment kyç në zhvillimet që do të pasonin më tej është edhe mbledhja e Moskës. Liderët e Bllokut komunist u mbledhën në Moskë në vitin 1960 në një takim për bujqësinë por edhe në një mbledhje për organizatën e traktatit të Varshaves. Deri në këtë kohë pak kush e dinte në Shqipëri se çfarë po ndodhte realisht mes të dy vendeve. Por ngjarjet e konferencës së Moskës do të shkonin shumë larg. Në takimin për bujqësinë Enver Hoxha sulmoi praktikat polake në këtë fushë. Por hasi në replikën e egër të Hrushovit i cili i tregoi vendin delegacionit shqiptar, të cilët duhet të shihnin mirë punët e tyre që nuk është se i kishin dhe aq mirë. Në ditët në vazhdim në takimin e traktatit të Varshavës liderët shqiptarë e rigjetën veten në mënyrë indirekte nën sulmet e Hrushovit. Ishte hera e parë që divergjencat mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik u bënë temë kyçe e bisedimeve në një takim të paktit të Varshavës ku merrnin pjesë të gjithë liderët kryesorë të shteteve të bllokut komunist.

Pas kësaj shfaqjeje degjeneruese, Hoxha dhe Shehu u kthyen në Shqipëri më 9 shkurt, të inatosur, të fyer dhe të vendosur për të mbështetur Kinën me çfarë të mundnin. Në 26 maj të vitit 1960 një delegacion shqiptar i kryesuar nga anëtari i byrosë politike Gogo Nushi shkoi në Pekin për të marrë pjesë në takimin e Organizatës Botërore të Tregëtisë dhe në 3 qershor një delegacion i dytë përfshi këtu edhe Haxhi Lleshin dhe Liri Belishovën, të dy anëtarë të byrosë politike nisen për një tur një mujor në Kinë dhe në vendet e tjera të bllokut aziatik. Dy delegacionet shqiptare të nivelit të lartë ndodheshin në Kinë gjatë tre javëve të para të qershorit, kur Pekini ishte duke lobuar mes partive komuniste për mbështetje përballë Moskës.

Kongresi i partive komuniste i mbajtur në qershor të vitit 1960 në Bukuresht të Rumanisë ishte një tjetër ngjarje ku Shqipëria do të mbështeste e vetme Kinën. Në kapitullin e shtatë do të shohim rolin e Shqipërisë së vogël në prishjen e marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik

dhe Kinës por edhe degradimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Liderët më të lartë komunistë shqiptarë Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu ishin të ndërgjegjshëm se nëse do të merrnin pjesë në kongresin e partive komuniste në Rumani në qershor, në të cilën do të merrnin pjesë gjithashtu Hrushovi dhe gjithë liderët e tjerë të partive të bllokut, do të ishin nën një presion shumë të madh për të mbajtur një pozicion prosovjetik ndaj argumenteve që Moska do të sillte në këtë konferencë kundër Pekinit. Duke mos marrë pjesë në këtë konferencë ata mendonin se mund të shmangnin çdo lloj kompromisi me të dyja palët. Hysni Kapo udhëhoqi delegacionin shqiptar dhe ai ishte i treti për nga rëndësia në hierarkinë e shtetit shqiptar. Por rrethanat e detyruan Hysni Kapon të marrë një pozicion pro kinez në konference dhe dy javë më vonë Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë përpiloi një komunikatë mbi konferencën e Bukureshtit duke e bërë plotësisht të qartë pozicionin e liderëve shqiptarë në krah të Kinës. Kjo ishte periudha me më shumë ngjarje në marrëdhëniet mes të dy vendeve.

Udhëheqja shqiptare doli hapur botërisht kundër sovjetikëve dhe ishte radha e liderëve sovjetikë të përgjigjeshin. Dhe ata zgjodhën ta bënin këtë në dy mënyra. E para duke ushqyer lëvizje të brendshme kundër udhëheqjes së shtetit shqiptar si dhe e dyta me anë të një politikani të huaj, në këtë rast liderin e komunistëve francezë i cili kishte një lloj afërsie me Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun. Misioni i tij ishte të bindte liderët komunistë shqiptarë që ta linin me kaq çmendurinë që kishin nisur. Por vizita e tij rezultoi e pasuksesshme.

Pleniumi i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë mori një vendim të rëndësishëm. Më 9 shtator 1960 ata përjashtuan nga organet drejtuese të partisë, dy zyrtarë të vjetër të partisë komuniste shqiptare, Liri Belishova dhe Koço Tashko. Menjëherë më pas edhe bashkëshorti i Belishovës, Maqo Çomo u hoq nga posti që mbante si Ministër i Bujqësisë. Këto zhvillime u shoqëruan edhe me një tërmet në bazë. U bënë arrestime në rrethe dhe u lëkundën pozitat e shumë kryetarëve lokalë të PPSH-së.

Delegacioni shqiptar që do të merrte pjesë në mes të shtatorit në asamblenë e Kombeve të Bashkuara dhe do të kryesohej nga Mehmet Shehu. Në këtë asamble ishte e pashmangshme përballja me Hrushovin dhe liderët e tjerë të vendeve komuniste të bllokut. Mungesa e Enver

Hoxhës ishte një tjetër shenjë e ndarjes mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik dështoi në misionin e tij për ta përmbysur rregjimin me anë të një puçi të brendshëm dhe në këtë mënyrë iu kthye metodave të tjera të cilat do ta vinin në vështirësi Shqipërinë e vogël dhe të varfër. Ata rritën presionin ekonomik, madje bashkë me të edhe satelitët e tjerë të BS-së në bllokun komunist.

Blloku sovjetik hodhi poshtë menjëherë kërkesën e Shqipërisë për 75 mijë ton drithë për të plotësuar nevojat e popullsisë së uritur. Në të njëjtën kohë ata nisën të tërheqin të gjithë specialistët e tyre nga Shqipëria ashtu siç bënë më herët edhe me Kinën. Në këtë kohë Shqipëria gjeti strehë në ndihmën e dhënë nga Kina. Ata dërguan menjëherë një ndihmë prej 45 mijë ton drithë, 9 mijë nga të cilat arritën më 10 tetor. Në sesionin e asamblesë së OKB-së në Nju Jork, Mehmet Shehu u prit mjaft ftohtë nga homologët e tjerë të bllokut. Nga ana e tyre shqiptarët ngritën çështjen e propozimeve për çarmatimin e bllokut dhe menjëherë pas kthimit në Shqipëri, Shehu i sulmoi publikisht këto propozime ashtu si çdo gjë tjetër që tashmë lidhej me politikën e Bashkimit Sovjetik.

Vizita e fundit e Enver Hoxhës dhe e Mehmet Shehut në Moskë në nëntor të vitit 1960, ishte padyshim një nga më të pakëndshmet. Ata do të merrnin pjesë në këtë konferencë me synimin të shprehnin hapur dhe pa rezerva çdo pretendim dhe çdo ankesë që kishin ndaj liderëve sovjetikë. Në fjalën e tij Enver Hoxha përkrahu hapur kinezët dhe sulmoi gjithashtu hapur udhëheqjen sovjetike dhe veçanërisht Hrushovin. Ai e hapi fjalën me një mbrojtje të fortë ndaj Kinës dhe politikës së saj të jashtme dhe çështjet ideologjike dhe me akuzën se Hrushovi e ka manipuluar dhe anashkaluar ideologjinë Leniniste.

Në 23 nëntor në përgjigjen e tij Hrushovi tha se rregjistrimet do të hedhin poshtë çdo pretendim të liderit komunist shqiptar. Por në fund ai shtroi një pyetje për të gjithë pjesëmarrësit : Kush është dakort me Enver Hoxhën? Dhe dukej se asnjë nuk ishte dakort me të në këtë konferencë. Dy ditë më vonë Hoxha dhe Shehu u nisen nga Moska me tren për tu kthyer në shtëpi duke lënë atje Hysni Kapon dhe Ramiz Alinë për të nënshkruar deklaratën e konferencës së shumë partive, e cila do të ishte simbolikisht edhe dokumenti i ndarjes dhe që u nënshkrua në 1 dhjetor të atij viti. Në 27 nëntor, Mao dhe Çu En Lai

zhvilluan një vizitë në ambasadën shqiptare në Pekin për nder të ditës së çlirimit të vendit tonë dhe Partia Komuniste kineze i dërgoi gjithashtu një përshëndetje Partisë Komuniste shqiptare në të cilën thuhej : “... kinezët ishin shumë të lumtur të kishin përkrah shokë kaq besnikë dhe të palëkundur si shokët e Partisë së Punës së Shqipërisë. Populli kinez e vlerëson shumë mbështetjen e madhe të dhënë nga populli shqiptar....” Para se Hrushovi të dilte publikisht dhe të sulmonte liderët shqiptarë dhe të ndërpriste marrëdhëniet diplomatike, lidhjet e fundit me liderët sovjetikë u shkëputën pas nisjes së Hoxhës dhe Shehut në nëntor të 1960-ës nga Moska pas konferencës së Partive Komuniste. Që nga ajo ditë miqësia e vetme e fuqishme e Shqipërisë në bllokun sovjetik ishte Kina. Por edhe kjo nuk zgjati shumë. Izolimi përfundimtar i Shqipërisë erdhi pak vite më vonë.

1.5. Skeleti teorik dhe modeli analitik i temës

Qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet qasjes empirike dhe analizës kritike objektive, të nxjerrë ne pah , dukuritë, fenomenet, aktorët dhe faktorët që përcaktuan tiparet kryesore të marrëdhënieve midis vendit tonë dhe BS-së në periudhën 1953 - 1961. Më tej nëpërmjet qasjes hulumtuese të ofrojë një mënyrë studimi për zhvillimet e kësaj periudhe dhe nëpërmjet metodave të përdorura dhe sugjerimeve të paraqesë një qasje origjinale për studiuesit dhe aktorët politikë në analizën e veprimit në dinamikën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të vendit tonë. Ky qëllim synohet të realizohet duke analizuar:

- (i) Tiparet e marrëdhënieve midis një vendi të vogël e të dobët me një superfuqi.
- (ii) Ndikimin e këtyre marrëdhënieve në kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm të vendit tonë.
- (iii) Divergjencat ideologjike në marrëdhëniet dy-palëshe.
- (iv) “Kultet individuale” të lidhshirimit në të dy vendet në sfondin e ecures së marrëdhënieve midis dy shteteve.
- (v) Dobinë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik në këto vite.
- (vi) Varësinë në marrëdhëniet ekonomike mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

(vii) Arsyet që çuan në prishjen e marrëdhënieve mes të dy vendeve?

(viii) Jugosllavianë si pikë kryesore të ndarjes.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik janë ende të pazbuluara plotësisht për aq kohë sa shumë dokumente të cilat gjenden në arkivat ruse nuk janë të disponueshme për studim. Megjithatë ashtu si çdo studim apo punim të realizuar në periudha të ndryshme edhe ky nuk mund të vendosë gurin e fundit për sa i përket këtyre marrëdhënieve. Ndoshta mund të jetë një përpjekje për të çmitizuar apo një përpjekje për të qartësuar diçka në këtë marrëdhënie e cila ka pasur shume dritëhije. Dokumentet e Arkivit Qëndror të Shtetit (AQSH) shqiptar nuk japin një panoramë të paanshme të situatës pasi janë përpiluar me një frymë të ngarkuar ideologjike. Botimet rreth marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike kanë qënë të shumta në Shqipëri por jo në Rusi. Janë shumë të pakta studimet për këtë pjesë të historisë së Bashkimit Sovjetik. Rusët kanë shkruar mjaft për marrëdhëniet me shume vende të botës (jo vetëm me superfuqi) por ka një mungesë të theksuar të zbardhjes së marrëdhënieve me vendin tonë.

Faktet tregojnë që marrëdhëniet ekonomike ishin shumë të vlefshme. Gjithashtu Shqipëria zuri një vend në arenën ndërkombëtare falë kontributit të Bashkimit Sovjetik. Nuk ka dyshim që pa mbështetjen e tyre, ne ishim një vend i falimentuar ashtu siç dolëm nga miqësia me Jugosllavinë. Perse bëhej e gjithë kjo? Ndoshta për shkak të pozitës gjeografike të Shqipërisë. Ndërtimi i bazës ushtarake - detare të Pashalimanit dhe magjepsja e udhëheqjes sovjetike ndaj gjirit të Vlorës ishte një tregues për këtë. Megjithatë sovjetikët ikën pa shumë zhurmë edhe nga ky vend edhe pse në vite u proklamua në Shqipëri se ne ishim mjaft të lakmuar për sovjetikët për shkak të synimeve gjeostrategjike.

Përsa i përket destalinizimit dhe liberalizimit të vendit pas kongresit të XX-të të Partisë Komuniste të BS-së rrugë e cila iu diktua Hoxhës nga lideri sovjetik, historia ka treguar se Hoxha ruajti me çdo çmim pushtetin personal. Jugosllavia e Titos dhe opinioni që ekzistonte tek ky i fundit për Hoxhën , e kërcenonte hapur Enver Hoxhën dhe pushtetin e tij.

Arsyet e ndarjes janë të shumëfishta. Nga njëra anë Jugosllavia, rikthimi i marrëdhënieve sovieto - jugosllave, që luajti një rol shumë të rëndësishëm në ecurinë e marrëdhënieve mes

Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Por nuk mund të themi me bindje se Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik do ta kishin ruajtur miqësinë nëse këto marrëdhënie nuk do të ishin recuperuar. Apo nëse Shqipëria nuk do të ishte rreshtuar pro Kinës. Por edhe këtë rreshtim në këtë punim unë e kam parë në dritën e rikthimit të marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë. Sepse pikërisht kur u ndje e rrezikuar nga ky rikthim, Shqipëria i hodhi sytë nga Kina dhe anasjelltas, Kina konstatoi se mund të kishte një mbështetje të vogël në lindje të Europës.

Duke marrë parasysh që Enver Hoxha donte të instalonte në vend rregjimin stalinist dhe më pas ta mbante atë në jetë sa më gjatë, për të dalë në konkluzionet e dëshiruara duhet parë me vëmendje kritika botërore mbi stalinizmin. Me anë të teorisë ne arrijmë të bëjmë një studim jo sipërfaqësor, por të bashkojmë pjesët e një pazëlli, duke bashkuar dhe sqaruar episode të ndryshme me një emërues të përbashkët.

Ky punim bazohet në teorinë realiste të Marrëdhënieve Ndërkombëtare sepse realizmi në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare përfshin një shumëllojshmëri të teorive dhe metodave të cilat besojnë se shtetet janë kryesisht të motivuara nga fuqia, dëshira për pushtet ekonomik dhe ushtarak ose për siguri dhe jo idealet apo etika. Mosmarrëveshjet brenda bllokut komunist, si ato mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, apo Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik treguan që mund të ketë divergjencë të mëdha edhe kur vendet ndjekin të njëjtën strategji dhe ideologji. Shkaku i divergjencave në disa raste ka qenë sovraniteti dhe çështje të rëndësishme me karakter kombëtar. Përsa i përket Shqipërisë faktet tregojnë se interesi kombëtar në dukje ushqente egon dhe luftën e Enver Hoxhës për pushtet. Ai thjesht e përdori atë sa për sy e faqe, për të ruajtur pushtetin e tij personal. Teoria gjithashtu na ndihmon në ngritjen e hipotezave. Ky punim bazohet kryesisht në teorinë realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare Realizmi bën disa supozime kryesore. Së pari supozon se shtetet kombe janë unitare dhe janë aktorë gjeografikisht të përcaktuar në një sistem ndërkombëtar anarkik, pa asnjë autoritet, që të jetë I aftë për të rregulluar ndërveprimet mes shteteve pasi nuk ekziston asnjë autoritet që të luajë rolin e një qeverie botërore. Shtyllë kryesore e realizmit politik është koncepti i interesit të përcaktuar në kushtet e fuqisë e cila injekton mënyrën racionale në çështjen e politikës dhe kështu bën teorike të kuptuarit e

politikës. Realizmi politik është në dijeni të rëndësisë morale të veprimit politik. Ai është gjithashtu në dijeni të tensionit midis kërkesës morale dhe kërkesave për veprim politik të suksesshëm. Sipas realizmit është koncepti i interesit të përcaktuar në aspektin e pushtetit që na mbron nga politika.

Qasjet e mësipërme afrohen sepse punimi mbështetet mbi perceptimin e aktorëve, fjalimet dhe dialogjet e tyre dhe dokumentet strategjikë. Gjithashtu hapësira e çështjeve të marrëdhënieve dy-palëshe mund të shihet në këtë kontekst. Si procesi i marrëdhënieve dy e shumë palëshe dhe format e tjera (bisedime, negocime, samite etj) shërbejnë për të kuptuar sjelljen e shteteve në raport me interesat kombëtare dhe ndërkombëtare të vendosura në nivel nacional, rajonal e më gjerë.

Që nga vitet 1940 kanë ndodhur zhvillime të metodologjive dhe teknikave të kërkimit, analizës dhe mësimi të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat kanë kontribuar në rritjen dhe konsolidimin e teorisë. Këto zhvillime sollën dhe “Debatin e madh” midis realistëve dhe kundërshtarëve të tyre. (Doughertz. E. J , Robert L. Pfaltzgraff Jr. 1993 : 9)

Duhet theksuar se me rëndësi në analizimin e sjelljeve të shteteve, janë disa faktorë të tjerë që ndikojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sipas studiuesve këta faktorë janë gjeografia, shpërndarja e burimeve, demografia etj. Citoj këtu Jean Bodin sipas të cilit rrethanat klimatike ndikojnë në karakteristikat kombëtare, si dhe në politikën e jashtme të shteteve. Ai nënvizon se ekstremet e klimave veriore dhe ato të buta ofronin kushte më të favorshme për të ndërtuar një sistem politik të bazuar në ligj dhe drejtësi. Rajonet veriore dhe rajonet malore ishin më të favorshme për të krijuar një disiplinë më të madhe politike se sa jugu, klima e këtyre rajoneve nuk arrin të nxisë iniciativën.

Vlerësoj gjithashtu se disa nga parimet e mësipërme të dhëna nga Hans Morgenthau, Thomas Hobbes, John J. Mearsheimer janë prezente dhe të nevojshme për periudhën që marrim për studim.

Realistët shikojnë interesin kombëtar si qëllimin primar të shteteve. Interesi kombëtar interpretohet ndryshe nga studiues të ndryshëm. Charles Beard p.sh , foli për territorin dhe tregtinë, si dy nga aspektet themelore të shtetit. George dhe Robert Keohane, folen për tre interesa kombëtare të cilat nuk mund ti shmangim: mbijetesën fizike, që do të thotë

mbijetesën e njerëzve, dhe jo domosdoshmërisht ruajtjen e territorit apo sovranitetit; lirinë me të cilën nënkupton aftësinë e banorëve të një vendi për të zgjedhur formën e tyre të qeverisjes dhe për të ushtruar një grup të të drejtave individuale të përcaktuara me ligj dhe të mbrojtura nga shteti; dhe jetesën ekonomike që është maksimizimi i mirëqenies ekonomike. (Olson W.C . 1991 : 37) Hans Morgenthau përcaktoi ndërkohë konceptin e interesit kombëtar si : “mbijetesën e një njësie politike në identitetin e saj, si minimum i pakalueshëm i interesit të një shteti me anë të vis-a-vis me njësi të tjera, duke përfshirë integritetin e territorit të një shteti, institucionet e saj politike, dhe kulturën e saj”. Dhe e ilustron kete me interesin shumëvjeçar të Sheteteve të Bashkuara të Amerikës që të mbeteshin fuqia dominuese në hemisferën perëndimore duke e udhëhequr atë në funksion të balancës me fuqitë evropiane, të cilat mund të kërcënonin hegjemoninë amerikane. (Olson W.C. 1991:37)

P.sh Henry Kissinger është i mendimit se shtetet nuk do të rrezikojnë sigurinë e tyre për asnjë arsye tjetër. Ndërkohë Morgenthau shprehet se “nëse shihni problemin e politikës në përgjithësi, ju e kuptoni se politika është arti i të mundshmes” dhe sipas tij “...ka disa gjëra që ju do të dëshironit të bënit, por nuk mundeni ti bëni, sepse nuk keni mjetet e duhura” (Smith. S, Hadfield. A, Dunne. T, 2012 : 81). Ofrohet kështu një kornizë e përshtatshme analitike, për të shpjeguar implikimet e varësisë, nevojën për diversifikim, përdorimin e diplomacisë dhe marrëdhënieve si instrument në politikën e jashtme, por edhe përdorimin e instrumenteve ekonomikë, politikë dhe ushtarakë për të garantuar plotësimin e interesave. Gjithashtu në këtë punim une jam mbështetur edhe në një tjetër teori të marrëdhënieve ndërkombëtare, që është konstruktivizmi. Parimi kryesor i kësaj teorie është besimi se politika ndërkombëtare është formuar nga idetë bindëse, vlerat kolektive, kulturën dhe identitetet sociale. Sipas konstruktivizmit, realiteti është ndërtuar shoqërisht nga strukturat konjitive që i japin kuptim botës materiale. Ka shumë lloje të konstruktivizmit, por të gjithë kanë tendencën për të mbështetur idenë se bota fizike është shumë më pak e rëndësishme se sa bota sociale dhe se pjesë të rëndësishme të botës fizike janë ndërtuar në të vërtetë nga bota sociale. Konstruktivistët e kuptojnë botën sikur ekziston, e ndërlikuar, e ndërtuar përmes një procesi ndërveprimi midis aktorëve (individë, shtete, jo shtete), dhe strukturave të mjedisit më të gjerë të tyre. Në variantin e vet evropian, konstruktivizmi

shqyrton rolin e gjuhës në ndërmjetësimin dhe ndërtimin e realitetit social. Konstruktivizmi shtron pyetjen “si është e mundur ” , mbi kushtet historike dhe diskutimet shoqërore që mundësojnë ndryshimin

(Smith. S, Hadfield. A, Dunne. T, 2012 : 120). Por si kontribuojne konstruktivistët ne kete rast në analizën e politikës jashtme. Ka disa mënyra, tre prej të cilave janë : veprimtaria e agjencive qeveritare, vendimmarrja dhe format e saj dhe mënyrat e ndikimit të shoqërisë ndërkombëtare në praktikën e politikës jashtme të shteteve. Ministritë e Jashtme, Departamentet e Shtetit, Departamentet e Tregëtisë, Ministritë e Mbrojtjes etj, të gjitha këto njësi luajnë një rol kryesor si agjenci qeveritare. Misioni i tyre është mbrojtja e interesave kombëtare. Konstruktivistët në vend që të supozojnë se një institucion qeveritar ose shtet ka interesa të caktuara, ata shqyrtojnë kryesisht sesi ndërtohen këto interesa, psh : mënyrën sesi aspekti social, normat apo dhe bisedimet mund ti çojnë shtetet në miratimin e interesave. Faktet materiale, financimet, kapacitetet ushtarake kanë ende rëndësi, por për konstruktivistët është kontesti social ai që u jep atyre kuptim. Një shembull i marre prej tyre, është rasti i zotërimit të armëve bërthamore nga Britania e Madhe, por kjo nuk përbën ndonjë problem për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi kjo interpretohet në një kontest social miqësor (Smith S.Hadfeld A. Dunne. T, 2012 : 125). Si përfundim do të thonim që nëse realistët qëllimisht bazohen në atë çka është e vërtetë, konstruktivizmi përballet me realizmin me anë të realitetit .

Kapitulli II: Një historik i shkurtër i marrëdhënieve Shqipëri - Bashkimi Sovjetik deri në vitin 1953

Marrëdhëniet e popullit shqiptar dhe popujve të republikave sovjetike zënë fill me luftën ruso - turke të viteve 1768 - 1774, luftë e cila u nis si pasojë e nxitjes së Francës nga ana e turqve (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. [Historia e marrëdhënieve]. D. B/I-8, fl.11. AMPJ).

Lufta përfundoi me disfatën e turqve. Sipas dokumentave të Arkivit Qëndror të shtetit shqiptar, rezulton se në luftën kundër turqve bashkë me marinarët turq luftuan edhe shumë shqiptarë, që vinin nga trojet shqiptare të cilat në atë kohë ishin nën pushtimin e perandorisë osmane, referuar një dokumenti të vitit 1953 (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, [Historia e marrëdhënieve], D. B/I-8, fl.11, AMPJ).

Kryetari i artilerisë së flotës ruse Ivan Gannibali në shënimet e tij thotë se shumë shqiptarë kanë luftuar me trimëri së bashku me ushtritë ruse kundër turqve. Ai flet në shënimet e tij për një kapiten të quajtur Mark Dika i cili rekrutoi 50 vullnetarë shqiptarë dhe mori pjesë në të gjitha betejat. Gannibali në kujtimet e tij përmend gjithashtu edhe kapitenin Mihal Stamati i cili në krye të 70 vullnetarëve shqiptarë mori pjesë në të gjitha betejat e Oqipellgut. Po ashtu në shënimet e tij Gannibali përmend edhe luftëtarë të tjerë shqiptarë me emrat Argjër Papakristo, Aleksej Karakizi, Dhimitri Kalivani, Anegori Papa, etj. Këta luftëtarë shqiptarë u dekoruan me medalje trimërie për kontributin e dhënë nga shteti rus (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, [Historia e marrëdhënieve], D. B/I-8, fl.11, AMPJ). Sipas dokumenteve të zbuluara në arkiven e shtetit shqiptar del se vullnetarët shqiptarë morën pjesë në shumë beteja në krah të rusëve, kundër turqve. Enver Hoxha në dokumentet e hershme të kohës së komunizmit, e gjen pikerisht në këto kohë brumosjen e miqësisë ruso – shqiptare. (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, [Historia e marrëdhënieve], D.B/I-8, fl.12, AMPJ) Sipas këtyre dokumenteve, gjatë pushtimit osman, shumë shqiptarë duke e pasur të pamundur të jetonin të nënshtruar, emigruan. Disa u

vendosën në Rusi. Disa të tjerë u vendosën në disa fshatra në krahinën e Zaporozhos në Ukrainë. (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik,[Historia e marrëdhënieve],D.B/I-8, fl.12,AMPJ)

Në historiografinë ushtarake ruse shkruhet për një njësi me luftëtarë shqiptarë : " Batalioni grek i Ballakllavit. Në Perandorinë ruse ka qënë njësi luftarake shqiptare, e cila ka marrë pjesë në luftrat ruso - turke në vitet 1768 - 1774 , 1787 - 1792, 1806 - 1812 si dhe në luftën e Krimese (Vukaj, Sh. 18 qershor , gazeta " Dita").

Sipas shumë dokumenteve të arkivave ruse të cilave i referohen studiues rusë që janë marrë me këtë temë, rezulton se këta luftëtarë shqiptarë kanë qënë nga jugu i Shqipërisë, kryesisht nga krahina e Himarës. (Vukaj, Sh. 18 qershor , gazeta " Dita")

Në një nga punimet e tij Shaqir Vukaj ambasador i Shqipërisë në Moskë por edhe historian, shkruan për mitin e Moskovit. Sipas tij edhe pse marrëdhëniet shqiptaro - ruse janë studiuar pak, duket se në shekujt e XV - XVIII edhe në Shqipëri ishte ngritur miti i Moskovit, në radhë të parë si shpëtimtar i të krishterëve që vuanin nën zgjedhën osmane. Disa peshkopë shqiptarë shkonin në Moskë jo vetëm për të kërkuar ndihma humanitare.(Vukaj, Sh. 18 qershor , gazeta " Dita")

Interesat e Rusisë në Ballkan janë të hershme, por ishte Pjetri i madh që me thirrjen e tij të vitit 1711, bëri që Rusia të përfshihej direkt në zhvillimet ballkanike. (Vukaj, Sh. 18 qershor , gazeta " Dita")

Më vonë Lenini në veprën e tij të vitit 1915 me titull " Socializmi dhe lufta " duke kundërshtuar parrullen se lufta nuk bëhej për të grabitur por për të mbrojtur atdheun shkruan ndër të tjera : " Vetëm hipokritët e fshehin këtë. Anglia grabiti kolonitë e Gjermanisë dhe Turqisë, Rusia Galicinë dhe Turqinë, Franca kërkon Alsas Lorrenën dhe bile bregun e majtë të Rinit, me Italinë është përfunduar një traktat mbi ndarjen e plaçkës (të Shqipërisë dhe të Azisë së vogël) .. ç'hyn këtu mbrojtja e atdheut.." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, D. B/I - 8, fl.12, [" Shqipëria e re " botim i Ministrisë së Punëve të Jashtme, R.P.SH. nr.2,15 shkurt 1954], AMPJ).

Ky është një tjetër moment kur udhëheqësi i revolucionit Lenini i del në krah Shqipërisë, goftë edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në këtë rast, duke kundërshtuar pazaret e fuqive të mëdha.

Në Janar 1916, Lenini në artikullin "Oportunizmi dhe dështimi i internacionales së dytë", sulmon politikën agresive të Italisë dhe Austrisë për të sunduar në Shqipëri. Në një tjetër artikull, " Letër për së largu", Lenini flet gjithashtu për këto grabitje siç i quan ai, jo të drejta. Mes tyre edhe aneksimi i Shqipërisë nga Italia. (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, [Historia e marrëdhënieve], D. B/I-8. fl.12, [" Shqipëria e re " botim i MPJ-se, nr. 2, 1954], AMPJ). Në dokumentet arkivore që përkasin me vitet e diktaturës të gjitha këto interpretohen si një përkrahje e hershme e Rusisë ndaj vendit tonë. Në këto dokumente kryesisht të viteve '50, renditen "të mirat" që Bashkimi Sovjetik i ka bërë Shqipërisë. " Udhëheqësit e popullit sovjetik, dhe të mbarë njerëzimit, Lenini dhe Stalini kanë demaskuar vazhdimisht politikën agresive të fuqive imperialiste për copëtimin e botës " (1953. Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S. D. B/I-8. fl.13. AMPJ)

Një nga veprimet e para në favor të vendit tonë ka qënë denoncimi i të gjitha marrëveshjeve të vjetra anti shqiptare të përfunduara me fuqitë e mëdha, siç shkruhet në dokumentet e arkivës shqiptare dhe shpallja e politikës së paqes nga ana e qeverisë së Bashkimit Sovjetik. Një nga marrëveshjet e denoncuar është edhe marrëveshja sekrete e Londrës 1915, që në fakt lidhej direkt me pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë. Siç edhe dihet në fillim të luftës së parë botërore Italia bënte pjesë në aleancën tripaleshe por më pas ajo filloi tratativat sekrete me shtetet e Antantës për të hyrë në luftë në anën e tyre me kusht që ti bëheshin disa kompensime tokësore. Si rezultat i këtyre tratativave u përfundua marrëveshja e fshehtë e Londrës e cila parashikonte ndër të tjera në artikullin 6 të saj se në traktatin e ardhshëm Vlora së bashku me ishullin e Sazanit ti jepeshin Italisë. Përsa i përket pjesës tjetër të Shqipërisë u parashikua që pjesa veriore dhe jugore të ndahej ndërmjet Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Në artikullin shtatë (7) të marrëveshjes së Londrës thuhej se nga pjesa qendrore e saj bashkë me Durrësin të krijohej një shtet sutonom dhe neutral nën protektoratin e Italisë. Në dokumentet arkivore të periudhës së diktaturës denoncimi dhe publikimi i kësaj marrëveshjeje nga ana e Bashkimit Sovjetik shihet si një veprim me rëndësi shumë të madhe

per vendin tonë si një mënyrë për të mbrojtur të drejtën për pavarësi dhe sovranitet të plotë të Shqipërisë (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.13, AMPJ). Në raportin e mbajtur nga Enver Hoxha në kongresin e parë të Partisë së Punës së Shqipërisë thuhet ndër të tjera se revolucioni borgjez i qershorit të vitit 1924, u ndikua tërësisht nga revolucioni i tetorit dhe kjo duket në fjalët e Avni Rustemit. Në fjalën e tij në parlamentin shqiptar të asaj kohe (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 15, AMPJ) Avni Rustemi deklaronte "e dini fare mire zotërinj se qysh Lenini mbrojti principet e larta te njerëzisë . Ai që së pari denoncoi traktatin e fshehtë të 1915-ës që ishte për copëtimin e Shqipërisë (Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Viti i I-re , nr. 1, 1924, seanca e VII, 4.2.1924, ora 15:00).

Influenca e revolucionit të tetorit duket edhe në botimet e asaj kohe. Vdekja e Leninit nuk mungoi edhe në faqet e gazetave shqiptare. Gazeta " Politika" ku ishte redaktor Halim Xhelo, shkruante me rastin e vdekjes së Leninit artikullin me titull " Dy vdekje".

... jo për Leninin si politikan dhe revolucionar si më të madhin e shekullit, por për Leninin se politika e tij i përket Shqipërisë, i përket popullit tonë të vogël e të lodhur në luftrat e tij prej shekujve.... (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B. S, D. B/I-8,fl.15, AMPJ).

....Lenini theu kasat e hekurta të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, botoi dhe traktatet e vjetra në mes të të cilave ishte edhe traktati i fshehtë i Londres i vitit 1915 që coptonte Shqipërinë (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B. S, D. B/I-8,fl.15, AMPJ).

.. keshtu pra themelet e shtetit tonë janë vënë nga Lenini... shkruhej ne faqet e gazetës " Politika"

Ndërkohë në një nga numrat e revistës " Shqiperia e re ", përkatësisht nr.2 i vitit 1954 gjejmë edhe një thënie të Bajram Currit. Revista merr përsipër të citojë fjalët e tij: "Shqipëria dhe Kosova do të fitojne lirinë kur te fitojnë idetë e profetit Lenin" . Këto ishin vitet e arta të miqësisë shqiptaro - sovjetike kur shtypi shqiptar përpiqej me cdo kusht ta bënte këtë miqësi më të thellë e më vjetër. Por e vërtetë është që idetë e revolucionit të tetorit u pasqyruan hapur dhe gjerësisht në faqet e shtypit shqiptar të kohës.

Gazeta "Politika" në numrin e saj të pestë, që mban datën 6 mars 1924 shkruan për formimin e qeverisë së kryesuar nga Shefqet Vërlaci me ironi :

" Kur sheh njeriu një tufë trashëgimtarësh të pashallarëve që formojnë një kabinet , i duket sikur në të vërtetë ndodhet atdheu i fatosave antishqiptarë nën thundrën e baba dovlatit..". (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl 16, AMPJ).

Artikuj të ngjashëm kanë pasur edhe gazeta të tjera të kohës si " Ku vemi" , " Zëri i popullit" apo " Republika".

Qeveria ruse në datën 3 Janar te vitit 1923 i dërgon një letër qeverisë shqiptare, nënshkruar nga komisar i popullit për punët e jashtme Litvinof, duke marrë shkas nga kërkesa e qeverisë shqiptare për të autorizuar Kosta Kollumbin për riatdhësimin e shqiptarëve që banonin në Rusi. Ndër të tjera në letër shkruhet: "Qeveria e republikës ruse e shtyrë nga dëshira për të vendosur marrëdhënie normale dhe miqësore me të gjithë popujt e zhveshur nga pretendime imperialiste, duke uruar popullin shqiptar për luftën e tij trime për pavaresinë e plotë konsideron se ka ardhur momenti për të vendosur marrëdhënie diplomatike midis dy popujve rusë dhe shqiptarë, gjë që do të lejonte zgjidhjen e gjithë çështjeve politike që ekzistojnë midis të dy vendeve...." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.16, AMPJ).

Në këtë kohë Shqipëria udhëhiqej nga Ahmet Zogu. Pas kësaj letre ky i fundit iu drejtua legatës shqiptare në Paris dhe në Londër për tu informuar dhe për ti njoftuar për jehonën që do të kishte vendosja e marrëdhënieve diplomatike me qeverinë sovjetike. Përgjigjia e diplomatëve shqiptare në atë kohë ishte negative dhe sipas tyre do të ishte e rrezikshme për Shqipërinë vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Rusinë sovjetike (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.17, AMPJ).

Si rrjedhim Ministria e Jashtme shqiptare e asaj kohe në emër të qeverisë shqiptare me letrën e datës 17 prill 1923 drejtuar komisarit të popullit për punët e jashtme të Rusisë, i përgjigjet negativisht propozimit të qeverisë sovjetike. Në letër shkuhej ndër të tjera : "Qeveria shqiptare e sheh të nevojshme të shikojë çështjen në lidhje me reperkusionet që një veprim i tillë nga ana e saj mund të ketë në gjëndjen e saj ndërkombëtare. Prandaj ajo është e mendimit

se do të ishte e preferueshme që të lihej për më vonë dërgimi i përfaqësuesve respektivë, meqë qeveria shqiptare nuk mund tu dilte perpara fuqive të mëdha në këtë çështje..." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.17, AMPJ).

Pas revolucionit të qershorit 1924 udhëhequr nga Fan Noli, ndryshon edhe qëndrimi shqiptar ndaj Bashkimit Sovjetik. Kështu me vendimin nr. 277 të datës 28 qershor 1924 këshilli i ministrave vendosi që qeveria shqiptare të hyjë në marrëdhënie diplomatike me qeverinë e Rusisë sovjetike (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.17, AMPJ).

Pas këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Ministria e Punëve të Jashtme e asaj kohe më 4 korrik 1924 i drejtohet Komisarit për Punët e Jashtme të Rusisë sovjetike Çiçerinit, duke i njoftuar dëshirën e qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ky veprim u bë nëpërmjet legatës shqiptare në Romë dhe ambasadës sovjetike në atë vend (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.17, AMPJ). Pas vendosjes së marrëdhënieve nuk mungoi interesimi nga vendet e perëndimit. Menjëherë legata franceze me anë të një letre u interesua nëse ishte i vërtetë lajmi se Shqipëria kishte vendosur marrëdhënie diplomatike me Rusinë sovjetike. Edhe shtypi filloi një fushatë kundër këtij vendimi. Ndërkohë gjendja në vend nuk ishte e mirë. Të gjitha këto e detyruan qeverinë të merrte një tjetër vendim të kundërt me të parin. Ministria e jashtme shqiptare me anë të një telegrami që mban datën 10 dhjetor 1924 njofton legatën tonë në Romë që të njoftojë ambasadën sovjetike atje se " Qeveria shqiptare e njeh qeverinë sovjetike, por për shkak të fushatës elektorale dhe për arsye të tjera që kanë të bëjnë me reaksionin e partive kundërshtarë, nuk do të mund të lidhen në këtë çast marrëdhënie diplomatike" (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 17-18,AMPJ).

Në një shkrim të gazetës " Bashkimi " që mban datën 19 dhjetor 1924 shkruhet për përfaqësuesin diplomatik sovjetik i cili kishte mbërritur në vend për shkak të vendimit të parë.

".... Por sidomos ardhja e bolshevikëve këtu ju bëri përshtypje edhe përfaqësuesve të huaj të cilët kanë protestuar pranë guvernës sonë...." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 17-18,AMPJ).

Revolucioni i qershorit u shtyp dhe në pushtet erdhi Ahmet Zogu. Gjatë kohës së qeverisjes së Zogut ndodhi edhe vrasja e Avni Rustemit, një nga aktivistët më energjikë të kauzës progresiste. Kur në vitin 1924 Noli fluturoi për në perëndim pak nga mbështetësit dhe miqtë e tij të majtë shkuan në Moskë. Ata u bënë atje pjesë e një komiteti (i krijuar më parë në Vjenë) i cili më vonë u lidh me konfederatën e partive komuniste të Ballkanit dhe nëpërmjet tij edhe me Kominternin. Si fillim komiteti u quajt " Konare " , Komiteti Revolucionar Kombëtar. Në 1928 pasi u pastrua nga elementët të cilët akuzoheshin se bashkëpunonin me imperialistët u quajt "Çlirimi Kombëtar", madje botoi edhe një gazetë " Liria Kombëtare" (Griffith, E. W, 1963 :10). Ky komitet kishte në përbërje të tij edhe poetin Sejfulla Malëshova, intelektualin Llazar Fundo si dhe Ali Kelmendin. Në 1930, Kelmendi, i vetmi geg nga të tre, u kthye në Shqipëri dhe filloi organizimin e grupeve komuniste. I detyruar të fluturojë sërish jashtë Shqipërisë si pasojë e rregjimit të Zogut ai luftoi në brigadën ndërkombëtare në Spanjë dhe më pas u vendos në Francë ku u bë një nga figurat kryesore të një grupi të vogël shqiptarësh, midis tyre dhe studenti i ri Enver Hoxha (Griffith, E. W, 1963 :10).

Vitet '30 frymëzuar edhe nga revolucioni i tetorit ishin vite gjatë të cilëve duke ndjerë rrezikun fashist filluan të organizohen grupet e para komuniste. Këto grupe në mënyrë të organizuar filluan të shfaqen në vitin 1930. Përsa i përket marrëdhënieve zyrtare me Bashkimin Sovjetik, këto i gjejmë në vitin 1934 (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 20, AMPJ).

Ambasada sovjetike me rezidencë në Athinë me notën nr. 140 të datës 3 korrik 1935 i përcjell Ministrisë së Jashtme kopjen e letrës me të cilën njoftohet se ministri sovjetik Kozky akreditohet edhe pranë " oborrit mbretëror " (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 20, AMPJ). Pushtimi fashist mbërri edhe në Shqipëri. Aktorët kryesorë të traktatit të fshehtë të Londrës deklarorin se Shqipëria nuk ju interesonte drejtpërdrejtë. Të gjithë u rreshtuan në krah të pushtimit italian. Sipas dokumenteve të kohës, Bashkimi Sovjetik doli kundër pushtimit italian. Dëshmi të këtij reagimi janë artikujt në shtypin e shkruar të asaj kohe si dhe në radion sovjetike. Georgi Dimitrov anëtar i lartë i Sovjetit Suprem, ishte një nga njerëzit që shkruajti në "Pravda" kundër pushtimit fashist të Shqipërisë (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl. 20, AMPJ).

Nuk vonoi shumë dhe Bashkimi Sovjetik hyri në luftë. Faza e parë e një lufte të organizuar e më të gjerë lidhet me operacionet e ushtrisë sovjetike kundër ofensivës së Moskës dhjetor 1941 - janar 1942. Në këtë kohë komisarati për punët e jashtme të Bashkimit Sovjetik më 18 dhjetor 1942 deklaronte : " Në lidhje me kërkesat e ardhura mbi qëndrimin e Qeverisë Sovjetike kundrejt Shqipërisë, Komisarati popullor i punëve të jashtme shpjegon se Bashkimi Sovjetik, i cili simpatizon plotësisht luftën guximtare çlirimtare të patriotëve shqiptarë kundër pushtimit italian, nuk njeh asnjë pretendim të imperializmit italian kundrejt territorit shqiptar dhe dëshiron ta shohë Shqipërinë të çliruar..." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.22, AMPJ)

Por marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik u konkretizuan dhe u vunë në jetë në gusht të vitit 1944 kur në malet e Shqipërisë mbërri misioni ushtarak sovjetik dhe në këtë mënyrë ndihma e Bashkimit Sovjetik u konkretizua (1953,Marrëdhëniet e Shqipërisë me B.S, D. B/I-8, fl.23, AMPJ).

Nga dy ansamble popullore të rëndësishme për kohën, kongresin e Përmetit dhe mbledhjen e këshillit antifashist të Beratit, i dërgohet një telegram Stalinit ku thuhet ndër të tjera : " Për popullin shqiptar Bashkimi Sovjetik, fortesa e pathyeshme e socializmit, atdheu i madh i popujve të vëllazëruar është sot avangarda e luftës së madhe anti-fashiste , është shembulli më i lartë sakrificash dhe heroizimi, është shtylla më e fortë materiale dhe morale për gjithë popujt e robëruar...." (1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B. S, D. B/I-8, fl. 24. AMPJ).

Enver Hoxha çlirimin e Shqipërisë ia dedikonte në radhë të parë luftës së popujve të Bashkimit Sovjetik, ushtrisë sovjetike, dhe partisë bolshevike. Të paktën kështu shprehet në një nga dokumentet e arkivit qëndror të shtetit shqiptar vet udhëheqësi I komunistëve shqipëtarë(1953, Marrëdhëniet e Shqipërisë me B. S, D. B/I-8, fl. 24. AMPJ).

Megjithatë ashtu siç është shkruar mjaftueshëm rreth kësaj teme, edhe sipas studiuesit William Griffith, Hoxha u vendos në krye të komunistëve shqiptarë, në sajë të kontributit jugosllav më 8 Nëntor të vitit 1941. Me ndihmën e britanikëve dhe jugosllavëve , komunistët shqiptarë arritën të çojnë deri në fund një luftë të gjatë dhe të suksesshme partizane. (Griffith, E. W. 1963 : 14)

Pavarësisht se Enver Hoxha në shkrimet e tij përpiqet ta bëjë sa më të thellë dhe të hershme miqësinë me sovjetikët, faktet tregojnë se Shqipëria deri në vitin 1948 mbeti një satelit jugosllav më shumë se sa sovjetik. Ajo nuk merrte pjesë në mbledhjet e Kominternit dhe përfaqësohej në to nga Jugosllavia. Megjithatë ashtu si të gjithë komunistët e ardhur në pushtet me forcat e tyre edhe lidhësi komunist shqiptar ndoqi politikën e majtë ekstreme " staliniste " si brenda dhe jashtë vendit. Por jugosllavët u lejuan të bëjnë tratativa me shqiptarët ndoshta më shumë se sa ishte dëshira e Moskës për këtë. Kujtojmë këtu krijimin e një shteti të madh federal i cili do të përfshinte edhe Shqipërinë, gjë që u kundërshtua nga Stalini (Dedijer. V. 1953 : 272-273, 302-303).

Gjithashtu jugosllavët planifikuan përdorimin e Shqipërisë si një nga bazat për të mbështetur partizanët komunistë greke, një operacion nga i cili në vitin 1948 Stalini i kërkoi Titos të tërhiqet (Djilas. M. 1962 :17).

Që në ditët e para pas çlirimit politika e jashtme e Shqipërisë u orientua drejt vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me vendet të cilat u rreshtuan pro luftës antifashiste kundër bllokut nazi - fashist. Dhe një nga vendet më të cilat u vendosën marrëdhëniet e para diplomatike ishte edhe Bashkimi Sovjetik. Në 10 nëntor 1945 kryetari i misionit ushtarak sovjetik koloneli Sokolov i paraqiti kryeministrit të RPSH-së Enver Hoxhës një notë të qeverisë sovjetike në lidhje me gatishmërinë e saj për njohjen e qeverisë shqiptare pa kushte. Si rrjedhim u mor vendim edhe për shkëmbimin e përfaqësuesve diplomatikë mes të dy vendeve (1953, Marrëdhëniet me B.S, [pas çlirimit], D. B/I-8, fl. 25, AMPJ).

Më 27 prill u thirr një konferencë ndërkombëtare në San Françisko e cila i zhvilloi punimet deri në 26 qershor të po këtij viti dhe pati për qëllim krijimin e një organizate të re ndërkombëtare sipas vendimeve të marra më herët në Jalltë dhe Krime. Më 21 mars 1945 Shqipëria i drejton një notë qeverisë së Bashkimit Sovjetik, SHBA-së dhe Britanisë së madhe me anë të të cilës kërkonte të merrte pjesë në këtë konferencë. Por duket se vetëm Bashkimi Sovjetik iu përgjigj pozitivisht kërkesës së Shqipërisë dhe në mbledhjen plenare Molotovi kërkoi me këmbëngulje ftesën e Shqipërisë në konferencën e San Françiskos (1953, Marrëdhëniet me B.S, [pas çlirimit], D. B/I-8, fl. 26, AMPJ).

Edhe në seancat e ndryshme të këshillit të sigurimit Shqipëria ka pasur një avokat të fortë. Kërkesat e vazhdueshme të vendit tonë për tu bërë anëtare e OKB-së, janë kundërshtuar me veto nga Anglia dhe SHBA-të. P.sh. në 28 gusht 1946, Gromiko i ka bërë një mbrojtje energjike pranimi të Shqipërisë në OKB. Gjithashtu edhe në Konferencën e Paqes në Paris mbajtur më datë 29 korrik të vitit 1946, qeveria shqiptare bëri kërkesë për të qenë pjesë e kësaj konference që kishte për qëllim nënshkrimin e një traktati të paqes me gjithë vendet ish satelite të Gjermanisë naziste. Por edhe kjo pjesëmarrje e Shqipërisë u bë e pamundur për shkak të kundërshtimit të anglezëve dhe amerikanëve duke e zhvlerësuar luftën nacional çlirimtare të popullit shqiptar. Edhe këtu Bashkimi Sovjetik e mbrojti Shqipërinë me anë të përfaqësuesve të tij në konferencë. (1953, Marrëdhëniet me B.S, [pas çlirimit], D. B/I-8, fl. 26, AMPJ)

Në plenumin e 5-të të Partisë Komuniste shqiptare në shkurt të vitit 1946, klani projugosllav me në krye Koçi Xoxen, ia doli të ndikojë tek udhëheqja dhe si pasojë të sjellë përjashtimin e Sejfulla Maleshovës nga byroja politike dhe Komiteti Qëndror për pikëpamje të djathta në politikën e jashtme dhe të brendshme dhe në ekonomi. (1946, 21 shkurt, [Konkluzione dhe vendime nga Plenumi i V i Partisë], fl. 45, 1947, 10 maj [Letër e komitetit qëndror të partisë në lidhje me oportunizmin e Sejfulla Maleshovës dhe denoncimi i tij nga komiteti qëndror i partisë] fl. 50).

Siç duket jugosllavët në atë kohë kishin dorë të lirë në Partinë Komuniste shqiptare. Me anë të ndikimit të Koçi Xoxes, ata arritën edhe përjashtimin e Ymer Dishnicës. Në vitin 1946, Hoxha u përpoq të ndërmerre një kundërsulm ndaj jugosllavëve por u frenua nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Nako Spiru (Griffith. E. W, 1963 : 19).

Viti 1947 ishte një vit i vështirë për luftën e fraksioneve brenda Partisë Komuniste shqiptare. Ajo u bë më komplekse, e dhunshme dhe çoi deri në degradimin e marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Kjo ishte koha kur Xoxe dhe shokët e tij, bënë çdo përpjekje për të bërë Shqipërinë pjesë të Jugosllavisë. Shumica e udhëheqjes komuniste shqiptare e kundërshtoi këtë plan, dhe në veçanti Nako Spiru, vetvrasja e të cilit pak kohë më

vonë i përkeqësoi marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, I cili nuk ishte gjithashtu dakort me planin. (Djilas. M. 1962 :171-186, 1958, 22 qershor " Zëri i Popullit").

Në Janar të vitit 1948 pas vetvrasjes së Nako Spirut , Stalini thirri Milovan Djilasin në Moskë për të diskutuar rreth marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë por në këtë takim ai deklaroi se ishte dakort që Jugosllavia të gëlltiste Shqipërinë (ndoshta me synimin për të mashtruar Titon). (Hamm, H. 1962 : 36, 1958, 22 qershor " Zeri i Popullit")

Ndërkohë që Stalini bënte këto deklarata, nga ana tjetër inkurajonte Hoxhën të vepronte kundër Koçi Xoxes dhe jugosllavëve. Në çdo rast marrëdhëniet sovjeto - jugosllave vazhduan të përkeqësohen. Moska zbuloi planet e Dimitrovit dhe të Titos për Federatën Ballkanike dhe në shkurt Kardeli dhe Bakariç iu bashkuan Djilasit në Moskë, ndërkohë që Stalini denoncoi planet e jugosllavëve për të përdorur Shqipërinë si një bazë në mbështetje të partizanëve komunistë grekë dhe madje denoncoi publikisht planet e Titos dhe Dimitrovit për krijimin e federatës ballkanike në përbërje të së cilës do të ishte Shqipëria dhe Greqia (Dedijer, V. 1953 :152, 168-169, 182-183).

Kriza mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik pati pasojat e saj në Shqipëri. Kjo ishte koha kur Koçi Xoxe ndërmorri një ofensivë për të larguar nga pushteti Enver Hoxhën dhe të krijonte në Shqipëri një lidhshmëri tërësisht nën kontrollin e Jugosllavisë. Hoxha dhe Shehu duket se i kishin ditët të numëruara por ishte Stalini ai që i shpëtoi në momentin e fundit. (Dedijer.V.1953: 273-303)

Pas prishjes sovjeto - jugosllave në Shqipëri nisi spastrimi politik. I pari, Koçi Xoxe, u gjykua dhe u pushkatua në mënyrë të fshehtë në vitin 1949.

Në këtë kohë u rehabilituan sërish figura të Partisë Komuniste shqiptare si Mehmet Shehu, Liri Belishova, Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu të cilët ishin luftuar më herët nga Xoxe. Pas ekzekutimit të këtij të fundit, Mehmet Shehu u ngrit me shpejtësi. Në 1951 ai zëvendësoi Tuk Jakovën si ministër i brendshëm dhe në gusht 1953 pas vdekjes së Stalinit ai u bë zv. kryeministër (1953, 2 gusht, "Zëri i popullit").

Periudha e dominimit ekonomik të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik filloi në shtator të vitit 1948, kur u nënshkrua edhe marrëveshja e parë ekonomike. Ajo u finalizua gjatë vizitës së Enver Hoxhës në Moskë në vitin 1949. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje edhe satelitët e tjerë të BS-së filluan të mbështesin Shqipërinë. (Griffith, E.W. 1963:43)

Nga viti 1949, 38 për qind e të ardhurave të brendshme të shtetit shqiptar vinin nga kreditë dhe grantet e ndihmës nga vendet e bllokut sovjetik. (Griffith, E. W. 1963: 43)

Ndërkohë një program intensiv i zhvillimit ekonomik , veçanërisht në industri dhe miniera , filloi nën udhëheqjen sovjetike. Gjatë viteve 1951-1955 u rrit prodhimi industrial periodik me tre herë më shumë. (Griffith, E. W. 1963: 44)

Por në vitin 1953 vdekja e Stalinit dhe afrimi i Hrushovit në 1955-ën me Beogradin, kercënoi Enver Hoxhën me destalinizimin dhe me daljen në skenë të Jugosllavisë. Kjo çoi edhe në reduktimin e ndihmës ndaj Shqipërisë në periudhën 1953-1955 si në makineri por edhe në investime të tjera. (Griffith, E. W. 1963: 44)

Kapitulli III: Vdekja e J.V.Stalin dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së tij

Vdekja e udhëheqësit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Josif Visarinoviç Stalin, ishte një ngjarje shumë e hidhur për udhëheqësin e Partisë Komuniste shqiptare Enver Hoxha. **"Vdekja e Stalinit i dha fund një epoke"**, deklaroi presidenti amerikan Ajzenhauer , në një fjalim të tij të mbajtur në 16 mars të vitit 1953. (Duroselle. J. Kaspi. A. 2011: 212)

Dhe kështu ndodhi vërtetë. Sidomos për marrëdhënien thuajse perfekte të Shqipërisë së asaj kohe me Bashkimin Sovjetik. Marrëdhënia e Enver Hoxhës me Stalinin edhe pse e kufizuar në pak takime, dukej se ishte besnike. Të paktën nga ana e liderit shqiptar. Enver Hoxha ishte një lider stalinist dhe i tillë mbeti deri në vdekje. Atij i pëlqente të ishte i tillë. Në librin e tij "Perkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare", Spartak Ngjela e përshkruan si dramatike atmosferën pas vdekjes së Stalinit. Si një dëshmitar i asaj kohe ai thotë se për tre ditë rresht, blloku i udhëheqjes, e gjithë shtëpia e madhe e komitetit qendror dukej e tronditur : "Stalinit i kishte rënë damblla; kështu thoshin plakat e atij rrethi" (Ngjela.S. 2011 : 65) . Stalini dukej se kishte qenë një makth edhe për njerëzit të cilët i konsideronte si më besnikët dhe bashkëpunëtorët e tij. Të gjithë prisnin me gjak të ngrirë do të zgjohej ose jo Stalini. Gjithkush për arsyet e veta. Por të shumtë ishin ata që donin të merrnin pushtetin në vend të tij.

Në rastin e Enver Hoxhës gjërat ishin ndryshe. Ai u takua për herë të parë me Stalinin në vitin 1947, e pas kësaj takimet ishin të rralla por besnikeria ndaj tij e shoqëroi Hoxhën deri në vdekje. Takimi i parë mes tyre, një takim formal ndodhi në verën e nxehte të 1947-ës, 16 korrik. Siç tregon në një intervistë për emisionin " Exclusive " te vitit 2014 ne Top Channel, Gjeneral Rrahman Parrllaku i cili ishte një nga anëtarët e delegacionit shqiptar, ku ndër të tjerë bënte pjesë edhe Koçi Xoxe, i njohur në histori si një njeri besnik i jugosllavëve dhe që

sigurisht në këtë takim të parë mes shqiptarëve dhe sovjetikëve ishte syri dhe mendja e jugosllavëve.

Takimi i dytë me Stalinin do të ndodhte në 1949-ën dy vjet më vonë pas prishjes me jugosllavët. Vijuan më pas edhe tre takime të tjerë. I fundit në pranverën e vitit 1951. Dy vjet më vonë Stalini do të ndërronte jetë. Rrahman Parrllaku më tej në rrëfimin e tij tregon se Stalini ishte mjaft i interesuar të dinte rreth Shqipërisë. Madje biseda u përqëndrua më shumë në pyetjet e tij ndaj nesh.

Edhe vetë Enver Hoxha nuk mundi ta mbante fjalimin e tij në gjuhën frënge ashtu siç ishte përgatitur. Stalini këmbënguli se donte të dëgjonte tingëllimin e gjuhës shqipe thotë Parrllaku. Megjithatë në librin e tij me kujtime të titulluar “ Me Stalinin “ botuar në Tiranë në vitin 1979, Enver Hoxha nëpër rreshta konkludon se interesimi i Stalinit në përgjithësi nuk ishte shumë i madh ndaj Shqipërisë. (Hoxha, E. 1979:15) Para prishjes me jugosllavët ishin pikërisht sovjetikët kumbarët e njëfarë shkrirjeje të vendit tonë me Jugosllavinë e asaj kohe, sipas Hoxhës.

Milovan Djilas i dërguar special i jugosllavëve, në librin e tij të titulluar "Biseda me Stalinin" shkruan se Stalini shpesh i kishte lënë të kuptonte se mund ta fusnin Shqipërinë në federatën e tyre. (Djilas, M. 1962:) Por çfarë ndodhi më pas? Çfarë ndodhi që Stalini ndryshoi mendje dhe i lëvizi gurët e shahut në atë mënyrë që çuan në prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë dhe e afruan Enver Hoxhën me Moskën. Historiani Hamit Kaba në një intervistë për emisionin " Exclusive " të vitit 2014 në Top Channel tregon se ishte dëshira e sovjetikëve që ne u prishëm me jugosllavët. Duke filluar nga fundi i 1947-ës dhe fillimi '48-ës marrëdhëniet sovjeta - jugosllave u keqësuan. Si pasojë u zhvilluan disa bisedime për të cilat udhëheqja shqiptare nuk ka qënë e informuar. Shenja e parë e afrimit me Bashkimin Sovjetik ishte pikërisht vizita e Enver Hoxhës në korrik 1947 në Moskë e cila u bë pa dijeninë e Jugosllavisë.

Sipas dëshmive të kohës Jugosllavia u njoftua në fund të përgatitjeve për të shkuar në Moskë, thotë Kaba. Duket se jugosllavët u bënë xhelozë për atë çka u bisedua në Moskë dhe mund ta konsiderojmë këtë periudhë si fillimin e marrëdhënieve të vërteta mes udhëheqjes sovjetike

dhe asaj shqiptare. Nënshkrimi i traktatit të miqësisë dhe ndihmës reciproke mes Shqipërisë dhe Bullgarisë në vitin 1947, është gjithashtu produkt i politikës sovjetike të kohës e cila gjithashtu nuk u prit mirë nga jugosllavët të cilët e konsideronin Shqipërinë në të ardhmen brenda një federate apo një republike të tyre, shpjegon më tej Kaba.

Enver Hoxha e adhuronte Stalinin. Një shtatore e tij ngrihej në sheshin kryesor të kryqzetit shqiptar Tiranë. Dhe shumë nga ndërmarrjet vendase mbanin emrin e tij. Ai e drejtoi Shqipërinë me një stil stalinist nga i cili nuk hoqi dorë kurrë dhe nuk pranoi asnjëherë që Stalini ishte një kriminel i madh, tiran dhe një despot. E vetmja periudhë kur Enver Hoxha kritikoi diçka nga karakteristikat e Stalinit ishte pranvera e vitit 1956. Pasi Hrushovi goditi rëndë figurën e Stalinit në kongresin e vitit 1956, Enver Hoxha në një artikull të botuar në gazetën "Zëri i Popullit" më 14 prill 1956 me titullin "Marksizëm- Leninizmi na meson se populli është krijues i historisë" dhe nënshkruar me emrin e tij, shprehet për Stalinin se ai bëri gabime që i kushtuan shumë popullit sovjetik dhe çështjes së socializmit (1953, 14 prill, " Zëri i Popullit"). Në 5 mars të 1953-it, Stalini vdiq. Statuja e tij në qendër të sheshit Skënderbej u kthye në një vend pelegrinazhi. Të mëdhenj e të vegjël u rreshtuan në atë ditë gri përballë statujes për të nderuar tashmë kujtimin e Stalinit. Enver Hoxha shpalli plot 14

ditë zije dhe me këtë ia kaluam edhe Bashkimit Sovjetik që mbajti zi më pak ditë se ne duke u bazuar në dokumentet e kohës. Në Bashkimin Sovjetik ditët e zisë ishin përkatësisht 1, 8 dhe 9 mars 1953 (1953, 7 mars, "Zëri i Popullit"). Ndërkohë gazeta "Zëri i popullit" njoftonte mitingje zije në të gjitha qytetet shqiptare. Ato do të zhvilloheshin në 9 mars, dita kur edhe u varros Stalini (1953, 8 mars, " Zëri i popullit").

Por vdekja e Stalinit solli me vete edhe dilemën e atij që do të ishte pasardhësi i tij. Molotovi, Malenkovi apo dikush tjetër. Kryetar i komisionit të varrimit ishte caktuar Nikita Sergejeviç Hrushov e bashke me të bëheshin tre, emrat që po lakoheshin se mund të zinin vendin e Stalinit në drejtimin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (Ngjela, S. 2011: 68). Hoxha i përshkruan ata të tre sipas perceptimit të tij në faqet e para të librit të tij Hrushovianët (Hoxha, E. 1980 : 20-21).

Svjettllana Aliljeva, vajza e Stalinit e përshkruan me emocione dhe frikë vdekjen e të atit. Ajo sjell me detaje atmosferën në shtëpi, momentin kur e lajmëruan se babai kishte pësuar hemorragji, njerëzit në shtëpinë e tyre dhe mënyrën se si ata lëviznin apo reagonin. Teksa flet për dhomën ku ndodhej i sëmuri ajo kujton : "Vetëm një njeri ndodhej atje, dhe sillej në një mënyrë gati të shëmtuar: Berja. Ishte tmerrësisht i tronditur . Fytyra e tij e neveritshme edhe në kushtet më të mira , tani dukej e shformuar nga urrejtja , nga smira, nga ashpërsia, nga dinakëria, nga etja për pushtet, dhe diçka më tepër"(Aliljeva, S. 2006: 15).

Më 4 mars 1953 Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë dhe më konkretisht sekretari i përgjithshëm Enver Hoxha i nis një letër të ndjerë Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit të Republikave Sovjetike Socialiste. Ai flet për lajmin e sëmundjes së rëndë të Stalinit dhe ankthin që ka shkaktuar ky i fundit në zemrat e udhëheqjes por edhe të popullit shqiptar (1953, MPKBS, F. 14, D 1/s , fq.4, AQSH).

Një ditë më vonë u shpall vdekja e Stalinit. Në një njoftim të Agjensisë Telegrafike Shqiptare që mban datën 6 mars 1953, thuhet : “TASS-i njofton me dhimbje të thellë se kryetari i keshillit të ministrave të Bashkimit Sovjetik dhe sekretari i Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Josif Visarionoviç Stalin vdiq më 5 mars në orën 09:50 minuta të pasdites pas një sëmundjeje të rëndë” (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq.5, AQSH).

Urgjentisht në orën 6 të mëngjesit të datës 6 mars Enver Hoxha mbledh komitetin qëndror të PPSH-së së bashku me Këshillin e Ministrave për të komunikuar dhe diskutuar ngjarjen e rëndë të vdekjes së Stalinit. Në fjalën e tij ndër të tjera Enver Hoxha nuk mund ta fshehë pasigurinë dhe panikun : " ***Kjo është një humbje e jashtëzakonshme, një grusht i rëndë për ne***"(1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq 11, AQSH).

Në këtë mbledhje Nexhmije Hoxha propozon që Enver Hoxha ti flasë popullit nëpërmjet radios për ti komunikuar këtë humbje të madhe. Dhe kështu u bë. Menjëherë u shpall zija në të gjithë vendin dhe u anuluan të gjitha shfaqjet teatrale, kinematografike, artistike dhe çdo shfaqje tjetër argëtuese deri në një urdhër të dytë, u ngrit flamuri kombëtar në gjysëm shtizë si dhe u ndërpre puna menjëherë në të gjitha zyrat, ndërmarrjet dhe shkollat (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq. 15, AQSH).

Një delegacion i Shqipërisë do të merrte pjesë në funeralin e J.V.Stalin. Delegacioni u kryesua nga Spiro Koleka, zv. kryeministër dhe anëtar i byrosë politike të komitetit qendror të PPSH-së dhe përbëhej nga Beqir Balluku, shef i shtatmadhorisë në ushtrinë popullore e anëtar i byrosë politike, Liri Belishova , anëtare e byrosë politike dhe anetare e presidiumit të kuvendit popullor, Ramiz Alia anëtar i komitetit qendror të PPSH-së dhe sekretar i parë i komitetit qendror të BRPSH-së, Abdyl Këllezi, ministër i financave dhe Vasil Nathanaili i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i R.P. të Shqipërisë në Bashkimin Sovjetik (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fl.20, AQSH).

Ndërkohë sipas Agjensisë telegrafike shqiptare (ATSH) “Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e tij të 7 marsit 1953 për të përjetësuar emrin e udhëheqësit të madh të popullit sovjetik, mësuesit gjenial të gjithë njerëzimit përparimtar, mikut më të shtrenjtë të popullit tonë, J.V. Stalin, vendosi që bulevardi kryesor i Tiranës që fillonte nga pallati i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe mbaronte në rrugën që shkon për në stacionin e trenit të marre emrin “ Bulevardi Stalin” (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq.21, AQSH).Ishte një periudhë e mbushur me telegrame ngushëllimi. Dukej sikur Hoxha kishte filluar tashmë të llogariste se kush do të ishte pasardhësi dhe si do ti kishte punët me të në vijim. Ai nuk u mjaftua me telegrame dhe komunikata ngushëllimi dërguar komitetit qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por nxitoi ti niste një të tillë edhe Malenkovit i cili ishte tashmë kryetar i këshillit të ministrave të B.R.S.S. (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq.28, AQSH).

Në atë kohë , i mbërriti një letër ngushëllimi me firmën e Hoxhës edhe Molotovit (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq.29, AQSH).

Emër ky gjithashtu i përfolur si ai që do të zinte vendin e Stalinit. Me urdhër të Komitetit Qendror të PPSH-së u vendos që të zhvillohen mitingje zije në shumë qytete shqiptare. Në Tiranë, Korçë, Shkodër, Durrës, Gjirokastrë, Vlorë, Elbasan, Peshkopi , Berat, Kukës, Sarandë dhe në qytetin Stalin (Kuçovë) njerëzit u nxorën në sheshe për të qarë Stalinin. Ndërkohë në qytete të tjera dhe në të gjithë fshatrat e Shqipërisë u mbajtën konferenca përkujtimore. (1953, MPKBS, F.14, D.1/s, fq.36, AQSH).

Për shumë ditë me radhë gazeta “Zëri I Popullit” u hap me tituj bombastikë për Stalinin. Gazeta e datës 6 mars, ditë e premte e vitit 1953, hapej me titullin e madh : “Josif Visarionoviç Stalin vdiq” (1953, 6 mars, : " Zëri i Popullit" : 1). Në datën 7 mars ditë e shtunë, gazeta hapet me titullin : “Në shekuj të rrojë lavdia e shokut të madh Stalin” dhe gjithashtu në faqe të parë gjëndet një thirrje e Enver Hoxhës drejtuar popullit shqiptar si dhe telegrami i ngushëllimit dërguar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe këshillit të ministrave gjithashtu (1953. 7 mars. " Zëri i Popullit" : 1). Po kjo gazetë, më datë 8 mars, ditë e diel, shkruan : “Lavdi kujtimit të përjetshëm të Josif Visarionoviç Stalinit” ose “Stalini rron në zemrat tona, mësimet e tij na prijnë për fitore të reja”. (1953, 8 mars, " Zëri i Popullit" : 1)

Por jeta do të vazhdonte edhe pse me peshën e rëndë të kësaj humbje të madhe për komunizmin botëror. Edhe pse me ankthin e vijës ideologjike dhe politike që do të ndiqte Bashkimi Sovjetik në vazhdim, Enver Hoxha do të vazhdonte ti thurte lavde këtij vendi të madh e ta quante atë burim frymëzimi për arritje të mëtejshme. Edhe pse thashethemet e Tiranës nuk e permendën kurrë emrin e tij, ishte pikërisht Nikita Sergejeviç Hrushov ai që pasoi Stalinin. Më vonë në librin e tij Hrushovianët, botuar në Tiranë në vitin 1980, Enver Hoxha shkruan se “... kur vdiq Stalini udhëheqja e lartë sovjetike në ditën e zisë ndante portofolet. Hrushovi ngjiste shkallët e pushtetit. Deziluzion nga takimi i parë me udhëheqësit e rinj sovjetikë në qershor të 1953-it” (Hoxha, E. 1981: 13).

Hoxhës i bënte përshtypje mënyra se si u njoftua vdekja e Stalinit dhe si u organizua ceremonia e varrimit të tij. Atij i ishte krijuar përshtypja, se vdekja e tij pritej me padurim nga shumë anëtarë të presidiumit të komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në faqet e këtij libri Hoxha nuk përmbahet dhe shpreh hamendjen e tij përzier me dëshirën se sekretar i parë i komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik do të zgjidhej Molotovi, bashkëpunëtori më i afërt i Stalinit , “..bolsheviku më i vjetër , më i pjekur , më me eksperiencë dhe më i njohur brenda dhe jashtë Bashkimit Sovjetik” sipas tij. (Hoxha, E. 1980: 16). “Por nuk ndodhi kështu. Malenkovi u vu në krye, Beria iu ngjit pas. Prapa tyre këto ditë , pak si më në hije , qëndronte një panterë që përgatiste të gëlltiste dhe të likuidonte dy të parët, ky ishte Nikita Hrushovi” (Hoxha, E. 1980: 1).

Pas javëve të para të marsit të cilat u shoqëruan me një zi të zgjatur në vendin tonë, shqetësim kryesor do të ishte pasardhësi i Stalinit. Enver Hoxha dhe shumë zyrtarë të lartë, shkonin nëpër mend shumë njerëz por kurrësesi Nikita Hrushovin, më i padukshëm se të tjerët, dhe ndoshta edhe më i heshturi. Në librin e tij "Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare", Spartak Ngjela përshkruan me sytë dhe mendjen e një dëshmitari të gjallë gjithë vitin 1953 dhe ankthin që ishte i pranishëm në vendin tonë pas vdekjes së Stalinit. Ai kujton se gjatë festës së 1 majit ishte bërë zakon shfaqja e nje parrulle gjigande ku shkruhej Enver - Stalin, dilema qëndronte se kush do të ishte emri që do të zëvendësonte Stalinin. Dhe sipas Ngjelës 1 Maji i vitit 1953 do të kishte një parrullë të re, Enver - Malenkov (Ngjela, S. 2011:76). Kjo tregonte në një farë mënyre se udhëheqja e Tiranës kishte besim tek Georgy Malenkov kryeministër i Bashkimit Sovjetik nga viti 1953 - 1955 dhe një nga njerëzit më me influencë në këtë vend. Siç duket Enver Hoxha e shihte me dyshim që në atë kohë figurën e Nikita Hrushovit, dhe u përqëndrua më shume tek Malenkovi dhe konsolidimi i figurës së tij në drejtimin e Bashkimit Sovjetik. Ashtu siç e thekson edhe Ngjela në librin e tij dilema buronte nga fakti se në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk kishte një kryetar, por tre sekretarë të barabarte dhe këta ishin, Malenkovi, Hrushovi dhe Beria (Ngjela, S. 2011: 77).Edhe pas vdekjes së Stalinit udhëheqësit shqiptarë do të vazhdonin të jepnin llogari në takime të herë pas herëshme. Dhe kjo përfshinte mënyrën se si shpenzonin paratë e dërguara nga Bashkimi Sovjetik, se si organizonin punët e tjera të brendshme, se si organizonin ushtrinë, policinë, industrinë, kulturën e çdo gjë tjetër. Në një nga takimet e zakonshme të udhëheqjes shqiptare me atë sovjetike, Lavrentiy Beria nuk hezitonte të vendosë me shpatulla për muri. Dialogu me palën shqiptare duket i tensionuar. Sipas Berias situata në Shqipëri nuk është ashtu siç paraqitet nga shqiptarët, e kënaqshme. Sovjetikët mendonin se nuk ishte kështu. "...Të huajt në Shqipëri nuk janë baza kryesore dhe më e rrezikshme për punën e armikut por armiqtë e jashtëm mbështeten në armiqtë e brendshëm dhe të dhënat që kemi ne na lejojnë të themi se situata e brendshme dhe e jashtme nuk është ashtu si e paraqitni ju..." (1953, MPKBS, F. 14, D.9, fl.34, AQSH).

Beria nuk ndalet me kaq dhe vazhdon më tej me vërejtjet duke theksuar se fshatarët në Shqipëri janë të pakënaqur dhe sipas tij në këtë pakënaqësi mund të mbështetet armiku.

“...Armikun gjithashtu e keni hala brenda ne aparatet e shtetit , në aparatet ekonomike , në pushtet , në ushtri e gjetke dhe në këtë të fundit 30 - 35 % e oficerëve janë mbështetja e armikut" (1953, MPKBS, F. 14, D.9, fl.34, AQSH). Sovjetiket i kritikonin shpesh udhëheqësit shqiptare për fryrje të aparatit shtetëror. Sipas tyre administrata e këtij vendi të varfër dhe të vogël ishte jashtëzakonisht burokratike. Dukej se sovjetiket ishin në krahun e fshatarëve, që sipas tyre dhe jo vetëm, jetonin në mënyrë mjaft mizerabël dhe vuanin për bukën e gojës (1953, MPKBS, F. 14, D.9, fl.3, AQSH).

Thuajse gjatë gjithë viteve të varësisë nga Bashkimi Sovjetik ata i kërkuar vazhdimisht Enver Hoxhës të tregonte kujdes për fshatin dhe bujqësinë pasi kjo ishte fusha më e rëndësishme ku duhej të investonte më shumë Shqipëria.

Por pas prishjes së marrëdhënieve me sovjetikët, Enver Hoxha në librin e tij "Hrushovianët" i ironizon këshillat e tyre. Për Mikojanin thotë se ishte një matrapaz kozmopolit dhe antishqiptar I përhershëm ndërsa ironizon ato që thoshte Hrushovi për ekonominë shqiptare :“...S'ka ç'ju duhet industria e rëndë, naftë dhe metale ju japim ne, për drithërat e bukës mos u bëni merak , bukë ju japim ne sa të doni. Shqipëria të ecë përpara me pambuk, dele , peshk dhe agrume ..."(Hoxha, E. 1980: 59). Në po të njëjtin libër të botuar në Tiranë në vitin 1980 nga shtëpia botuese “8 nëntori” Enver Hoxha risjell në kujtesë bisedën me Berian, Malenkovin dhe Mikojanin në vizitën e tij të qershorit në Moskë. "Ata derdhën një lumë me vërejtje mbi gjëndjen e punët tona. Se nga i kishin këto të dhëna nuk dihej, por fakt është se ekzagjerimet dhe trashjet e gjërave qenë aq të medha sa të çudisnin.." (Hoxha, E. 1980: 65).

Enver Hoxha kujton se i kishte kundërshtuar fort pretendimet për fryrje burokratike të aparatit shtetëror apo për prapambetjen e theksuar të fshatit duke u kujtuar sovjetikëve se gjërat nuk bëhen menjëherë. Edhe vet Bashkimi Sovjetik kishte kaluar nga kjo fazë dikur, gjë që nuk duhet ta harronin (Hoxha, E. 1980: 66) . Në një vizitë të një delegacioni shqiptar në Moskë ne vitin 1953, Spiro Koleka i dërguari shqiptar për të negociuar kredi të tjera e ndihma në të gjithë sektoret e nevojshëm, i shkruan Enver Hoxhës i shqetësuar se sovjetikët ishin mjaft të shqetësuar nëse i kishin plotësuar shqiptarët porositë e dhëna dhe nëse i kishin përdorur ashtu siç duhej paratë e huazuara deri në atë kohë. Madje madje sipas Kolekës ata dolën në

konkluzionin se qeveria shqiptare nuk i kishte përdorur ashtu siç duhej kreditë e vjetra (1953, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 1, AQSH).

Ndër të tjera i dërguari shqiptar shkruan se kishte kërkuar llogari për këtë pikë por sovjetikët e kishin argumentuar me faktin se qeveria shqiptare kishte ndërtuar dy fabrika për zhveshje pambuku ndërkohë që nuk kishte lëndën e parë për ti vënë ato në punë, pra nuk kishte pambuk. Gjithashtu edhe traktorët në bujqësi nuk ishin shfrytëzuar mirë shtu këtu edhe shumë probleme të tjera që kishin të bënin me mirë administrimin e fondeve (1953, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 1, AQSH). Në takimin me Bulganinin, (drejtues i lartë sovjetik dhe ministër i mbrojtjes në atë kohë) dhe me ministrin e jashtëm Kumikin, Koleka vëren se sovjetikët ishin shprehur të çuditur me kërkesat e qeverisë shqiptare : “ ...Ne nuk kuptojmë si ju kërkonin kredi të reja , kur nuk jeni në gjëndje që të paguani ato që keni marrë”(1953, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 1, AQSH).

Pas takimit të qershorit në Moskë, Enver Hoxha i gjykoi të drejta vërejtjet e ngritura nga sovjetikët, ai u premtoi atyre se do të bënte çmos ti vinte në vend të gjitha detyrat që ata i kishin caktuar. Menjëherë Hoxha mori masa për shfryrjen e aparatit shtetëror dhe e pranoi para tyre se ishte e vërtetë që shumë drejtues ishin ngarkuar me shume detyra dhe duheshin shkarkuar nga këto (1953, MPKBS, F. 14,D.10,fl.1, AQSH). Në këtë kohë Enver Hoxha bëri një riformulim të qeverisë : Spiro Koleka do të kishte ministrinë e industri-miniera-ndërtim , Hysni Kapo do të mbante ministrinë e bujqësisë, pyjeve dhe grumbullimit, tregëtinë e brendshme dhe të jashtme dhe komunikacionin do ta drejtonte Gogo Nushi, arsimin, kulturën, sportin dhe shëndetësinë do ta drejtonte Bedri Spahiu, ministër i brendshëm Mehmet Shehu, ministër i mbrojtjes Beqir Balluku, ministër i financave Tuk Jakova dhe ministër i drejtësisë do të ishte Bilbil Klosi.

Do të kishte dy zv. kryeministra dhe këta do të ishin Mehmet Shehu zv. kryeministër i parë dhe Hysni Kapo zv. kryeministër i dytë. Gjithashtu menjëherë Hoxha urdhëroi të mos kishte kryesi të qeverisë dhe qeveria të mblidhej më shpesh. Gjithashtu ai pranoi se do të ngushtonte aparatit shtetëror me 50 % (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 39, AQSH).Këto lëvizje që dukeshin si reflektim ndaj vërejtjeve të sovjetikëve, u shoqëruan edhe me premtimin se do

të ulëshin edhe disa investime të cilat ishin konsideruar të domosdoshme më parë. P.sh siç ishte rasti i fabrikave të letrës , të xhamit, të linit, çelikut dhe bukës. Hoxha vendosi ti lejë këto të fundit për pesëvjeçarin e dytë. Gjithashtu u shty ndërtimi i hidrocentralit mbi Mat deri në 1957-ën, do të shtyhej ndërtimi i hekurudhave, aerodromit, impiantit të bitumit etj. Pavarësisht ktitikave për keqadministrim të fondeve Enver Hoxha nuk harroi të kërkojë ndihmë nga Bashkimi Sovjetik, për bonifikimin e tokave, për makineri të ndryshme, për traktorë, farë, pleh e specialistë, ndihmë teknike, plotësim të ministrive shqiptare me këshilltarë sovjetikë, si dhe kërkoi edhe 50 mijë ton drithë (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 40, AQSH).

Lideri komunist shqiptar mirekuptonte çdo vërejtje të Berias dhe ishte plotësisht dakort me të për ministrinë e punëve të brendshme por nuk ishte dakort se 30 % e oficerëve mund të ishin armiq. Gjithashtu Hoxha kërkoi edhe praninë e 250 oficerëve sovjetikë në ushtri dhe 38 të tjerë në ministrinë e brendshme (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 40, AQSH). Pas kërkesave të Enver Hoxhes përgjigjia nga sovjetikët në përgjithësi ishte pozitive. Ata i vlerësonin masat e marra por u përqëndruan në disa këshilla të tjera : “...Shoku Enver, një të tretën e punës t'ia kushtojë bujqësisë, të shqetësohet për bujqësinë dhe të mos shqetësohet shumë se u realizua ndërtimi i filan fabrike apo jo” (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 43, AQSH).

Madje sovjetikët kërkuan që ti ulen detyrimet fshatarit pasi i gjykonin shumë të rënda. Sipas tyre ishte grabitje ti merrje fshatarit 50 mije ton, në 200 mije ton prodhim vjetor (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 43, AQSH). Në rekomandimet e tyre sovjetikët i mëshonin shumë bujqësisë, madje ata propozonin që ministër i bujqësisë të zgjidhej dhe të emërohej një nga eksponentët më të mirë të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ata premtonin se do të dërgonin kompetentë të fortë në këtë fushë. Përsa i përket politikës së jashtme sovjetikët i vinin theksin bashkëjetesës paqësore. Ata do të shkëmbenin ambasadorë me Jugosllavinë dhe këtë ia këshillonin edhe Tiranës zyrtare. Dhe ky ishte sigurisht momenti kur Jugosllavia u rishfaq si një rrufe në qiellin e pastër të marrëdhënieve tona me Bashkimin Sovjetik.

Përsa I përket ushtrisë këshillohej që të mos përjashtoheshin njerëz që mund të kishin qenë me armikun dikur por që tani ishin rreshtuar në rradhët e komunistëve apo ata që bënë jetë dhe punë të rregullta (1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 43, AQSH).

“ ...Njerëzit nuk lindin komunistë, kanë edhe gabime, edhe të meta në jetë. Një e kaluar e tillë t'iu vihet në dukje zyrtarisht, por njerëzit të maten me punën që bëjnë sot”(1953, MPKBS, F. 14, D. 9, fq. 43, AQSH).

Ndër të tjera sovjetikë nuk linin mënjatë edhe këshillat për një bashkëjetesë të mirë me klerin pasi këto ishin çështje delikate.

Porosi mbi të cilat duket se u ra dakort si fillim, por në fakt nuk u zbatuan kurrë dhe në një farë mënyre u bënë shkak për mosmarrëveshje më të thella.

"....Më 27 maj kryqëzori sovjetik Nahkimov , i ndjekur nga dy destroyer, kaloi mospërmas dardaneleve në drejtim të Durrësit. Kjo ngjarje u interpretua në qarqet diplomatike në Turqi se dërgimi i këtyre luftanijeve në Shqipëri në këtë kohë, ishte një demonstrim i Bashkimit Sovjetik në lidhje me paktin e Ballkanit, ishte një zile alarmi se Bashkimi Sovjetik do ta shfrytëzonte vendin e vogël për qëllimet e veta.." (Pearson, O .2007: 480).

Një vit më vonë një tjetër takim mes shqiptarëve dhe sovjetikëve do të zhvillohej në Moskë. Më 8 qershor 1954 në orën 15:00 Enver Hoxha, Hysni Kapo, Beqir Balluku, Koço Theodhosi dhe Mihal Prifti do të takoheshin me anëtarët e presidiumit të komitetit qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe përkatësisht në takim do të merrnin pjesë, Hrushovi, Malenkovi, Voroshilovi, Mikoiani, Suslovi, Zorini dhe Leviçkini. Në këtë takim Enver Hoxha foli rreth 1 orë me superlativa për gjëndjen në vend dhe mjaft i kënaqur nga rezultati i zgjedhjeve. Hrushovi nuk hezitoi të ndërhyjë në këtë rast, duke e këshilluar Hoxhën se rezultatet e zgjedhjeve nuk duhet ta vinin udhëheqjen shqiptare në gjumë (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 1, AQSH).

Hrushovi nuk nguroi tu kujtonte takimin e fundit një vit më parë kur ai nuk ishte i pranishëm por ishte i pranishëm Lavrentiy Beria, i cili tashmë nuk jetonte më, e për më tepër ishte shpallur element antiparti. Orientimet e dhëna nga Beria rezultuan të gabuara pasi sipas

Hrushovit Beria kishte qenë gjithë kohën një armik I partisë. Sipas udhëheqësit sovjetik, Beria kishte punuar për të ulur dhe dobësuar partinë dhe për ta likujduar atë. Aktivitetin e tij antiparti ai e kishte zhvilluar më shumë pas vdekjes së Stalinit, sipas Hrushovit. (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 1, AQSH).

Në kujtimet e saj një nga eksponentët e PPSH-së Liri Belishova, kujton se pas vdekjes së Stalinit, nisi një frymë liberale në Bashkimin Sovjetik. Nuk u pushkatua askush veç Berias, arrestimet ishin minimale, internimet minimale, u liruan shumë njerëz të dënuar pa të drejtë (Belishova, L. 2010, "Gazeta Shqiptare") gjë që në fakt nuk u reflektua në Shqipëri.

Në drejtim të Enver Hoxhës u adresuan fjalë të mira. Sipas Hrushovit ishte ai që kishte ndihmuar në demaskimin e këtij njeriu antiparti, Berias. Menjëherë pas largimit të shqiptarëve nga Moska një vit më parë u zbulua aktiviteti armik I Berias (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 1, AQSH). Më tej në fjalën e tij Hrushovi u morr me sekretarin e parë të Partisë së Punës së Shqipërisë.

Nëse Enver Hoxha zgjidhte të ishte kryetar i Këshillit të Ministrave ai nuk mund të ishte edhe në drejtimin e partisë. Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij këshilloheshin se partia shqiptare ishte ende e re dhe duhej forcuar. Ajo akoma ishte një kockë e njomë në këndvështrimin e liderit Sovjetik e për këtë duhej forcuar nga lart. Në krye të partisë duhej një dorë e fortë që të merrej vetëm me punët e partisë. Duke aluduar mes rreshtave se njeriu i duhur për këtë punë ishte Enver Hoxha (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 2, AQSH).

Ai i solli Enver Hoxhës mjaft shembuj, kur kishte qenë vet edhe kryeministër edhe sekretar i parë i partisë komuniste ne Ukrainë, i solli shembullin polak por edhe Stalinin. Ai theksoi se sa kohë Stalini kishte qenë sekretar i Komitetit Qëndror ai kishte qenë një njeri i madh. Hrushovi u mundua ta qunte të gjithë këtë thjesht një këshillë dhe opinion personal, të tjerat shqiptarët mund ti vendosnin vet (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 3, AQSH).

Zhvillimi I ekonomisë ishte një pikë shumë e rëndësishme në marrëdhëniet tona me sovjetikët dhe bërja e llogarive me kujdes, maturi e saktësi siç dukej ishte thembra e Akilit. Sipas Hrushovit, Shqipërisë nuk i duhej shfrytëzimi i naftës pasi kjo ishte një gjë pa leverdi pasi

nafta shqiptare kishte mjaft lëndë të tjera dhe nuk e preferonte askush. Siguria e Shqipërisë thoshte Nikita Hrushov varej plotësisht nga Bashkimi Sovjetik. Ndërkohë ai theksonte se duhej investuar fuqishëm në industrinë ushqimore. Duhej zhvilluar industria ushqimore, konservat, peshku, frutat, vajrat etj. Takimi i gjatë por pozitiv pas atij të një viti më parë i cili duhet theksuar se ishte me tone mjaft të ashpra nga ana e sovjetikëve, u mbyll rreth orës 17 : 45 min dhe prej andej delegacioni i ardhur nga Tirana u ftua për drekë në një dajçë jashtë Moskës. Në dollinë e tij Enver Hoxha i quajti fjalët e shokëve të presidiumit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si thesarin më të çmuar që kishte populli shqiptar dhe premtojte se do ta ruante atë si sytë e ballit. (1954, MPKBS, F. 14, D. 1, fq. 5, AQSH).

Kjo ishte klima që mbizotëronte në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik në vitet e para pas vdekjes së Stalinit të paktën deri në vitin 1955.

3.1. Hapat e parë të rivendosjes së marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë dhe reagimi i Tiranës zyrtare

Përsa i përket politikës së jashtme, dukej se Enver Hoxha ishte dakort me lëvizjet e Bashkimit Sovjetik deri në momentin kur Hrushovi e pa me vend ti komunikojë Hoxhës synimet e tij për të rikthyer në gjirin e bllokut Jugosllavinë. Në një komunikim të detajuar më 23 qershor të vitit 1954 me Nikita Hrushovin, ky i fundit e informon Hoxhën se Bashkimi Sovjetik ishte duke ndërmarrë hapa për të rifituar marrëdhëniet normale miqësore me Jugosllavinë (Pearson, O. 2007: 481). Në një letër dërguar Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe Enver Hoxhës, Hrushovi i kërkonte të këshillohej me të për çështjen jugosllave (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 7, AQSH). Sipas llogjikës së sovjetikëve nga gjiri i demokracisë popullore që pas prishjes së marrëdhënieve në vitin 1948, ishte shkëputur një vend me një popullsi 16 milionë banorë dhe me një pozitë strategjike në juglindje të Europës. Marrëdhëniet e ngrira me sovjetikët, kishin bërë që jugosllavët të afrohen me SHBA-të dhe Britaninë e madhe, madje të përfundojnë një marrëveshje ushtarake - politike me Turqinë dhe Greqinë (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 7, AQSH). Duke parë këto zhvillime që cënonin bllokun, Hrushovi i kërkon Enver Hoxhës ndryshimin e politikës së jashtme ndaj

Jugosllavisë.. "Sipas mendimit tonë, partitë tona në politikën e tyre të jashtme me Jugosllavinë duhet ti vënë vetes detyrën që ti prishin këto plane të imperialistëve amerikanë – anglezë dhe të shfrytezojnë të gjitha mundësitë për të përforcuar influencën e tyre mbi popullin jugosllav" (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 8, AQSH).

Në letrën e tij shumëfaqëshe Hrushovi i kujtonte Enver Hoxhës arsyet e prishjes me jugosllavët dhe analizimin e tyre në një dritë tjetër. Madje ai pretendonte se drejtuesit e lartë jugosllavë dhe vet Tito ishte shprehur i gatshëm për afrimin me vendet e demokracisë popullore. Shumë vende të bllokut i kishin përmirësuar marrëdhëniet me Jugosllavinë në atë kohë, duke e lënë kështu topin në fushën e Enver Hoxhës për të dhënë mendimin e tij në lidhje me Jugosllavinë dhe sjelljen ndaj saj (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 7- 8, 9-10,11, AQSH).

Por përgjigjia e Hoxhës ishte e menjëhershme dhe duhet thënë surprizuese.

Me anë të një letre ai i drejtohej komitetit qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe veçanërisht Hrushovit se ai dhe shokët e tjerë të Byrosë Politike morrën dijeni për përmbajtjen e letrës nga Moska dhe konkluduan se: "Rishikimin e çështjes jugosllave dhe zgjidhjen e saj në interesin e lartë të paqes, të kampit të socializmit dhe të popujve të Jugosllavisë që propozon Komiteti Qendror I Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik , ne e gjejmë tërësisht të drejtë dhe solidarizohemi plotësisht me përçapjet dhe me mënyrën që propozohet në letrën tuaj " (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 15, AQSH).

Sovjetikët nuk humbën kohë në bisedimet me palën jugosllave. Ata i nisën Bashkimit të Komunistëve të Jugosllavisë një letër ku i kërkonin rikthimin e Jugosllavisë në grupin e vendeve të demokracisë popullore si dhe sheshimin e mosmarrëveshjeve (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 15, AQSH). Përgjigjia e jugosllavëve ishte aprovuese ndaj propozimeve sovjetike për përmirësimin e marrëdhënieve midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Në letrën e përgjigjes kishin vend edhe një sërë rezervash me të cilat e shoqëronin aprovimin e tyre. Të paktën kështu shprehet Nikita Hrushov në një letër dërguar Enver Hoxhës për këtë çështje në shtator të 1954-ës (1954, MPKBS, f. 14, D. 6, fq. 20, AQSH). Në letrën e dytë dërguar jugosllavëve Hrushovi u kërkon ndërprerjen e veprimtarisë së "Bashkimit të

Patriotëve jugosllavë “ dhe mbylljen e gazetës që nxjerrin ata në territorin e Bashkimit Sovjetik, pasi kjo do të bëhej pengesë për arritjen e qëllimit të caktuar për përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq.21,AQSH). Rreth dy muaj pas letrës së 23 shtatorit që Hrushovi i dërgonte Beogradit zyrtar, më 16 nëntor 1954 Marrëshalli Tito nis përgjigjen e tij. Ai shkruante se letrën e sovjetikëve e kishin shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Qëndror të Bashkimit të Komunistëve jugosllavë dhe kishin dalë në konkluzionin se ishin dakort në shumicën e pikëpamjeve.

“Fakti që përgjigjia jonë i jepet me një vonesë të madhe letres suaj “, shkruan Tito, “nuk duhet interpretuar si një dëshirë nga ana jonë për të vështirësuar punën, por duhet interpretuar si një pasojë e nevojës së normalizimit gradual të marrëdhënieve, sepse në vendin tonë konditat objektive dhe subjektive janë të tilla që ky normalizim nuk mund të zhvillohet ndryshe pa evituar konsekuencat e ndryshme negative”(1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 51, AQSH).

Ndër të tjera Tito i propozonte Hrushovit se kjo punë nuk mund të bëhej me anë të letrave , dhe do të ishte i nevojshëm një takim personal në rrugën shtetërore në nivelin më të lartë. Ai shkruante se bëhej fjalë për probleme të karakterit më të rëndësishëm ekonomik dhe politik dhe sidomos për pikëpamjen e jugosllavëve mbi problemet ndërkombetare dhe jo vetëm për disa divergjenca të thjeshta partie (1954, MPKBS, F. 14, D. 6, fq. 52, AQSH).

Në një komunikim tepër sekret me Enver Hoxhën më datë 17 janar të vitit 1955, Hrushovi shkruante se kohët e fundit organet e zbulimit të shteteve imperialiste dhe veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Anglisë kishin marrë gjithfarë masash në drejtim të përforsimit të veprimtarisë armiqësore kundër vendeve të kampit demokratik. Sipas Hrushovit ata po përpiqeshin të përhapnin agjaturën e tyre për organizime në përpjestime më të gjëra të spiunazhit , diversionit dhe të masave të tjera subversive kundër vendeve të demokracisë popullore dhe Bashkimit Sovjetik. Si pasojë Hoxha këshillohej të merrte masa në mobilizimin e forcave të sigurisë dhe atyre të zbulimit madje Hrushovi shkonte më larg duke propozuar organizimin e një konference të udhëheqësve të organeve të sigurimit të shtetit për këtë qëllim (1955, MPKBS, F. 14, D. 5, fq. 2, AQSH).

Faktet tregojnë se mobilizimi ishte I menjëhershëm. Në 17 shkurt të këtij viti raportohet nga Tirana zyrtare se një baze e re nëndetësesh sovjetike po operonte në ekstremitetin jugor të Shqipërisë në Dhërmi, një fshat i vogël ky, që shtrihet në këmbët e malit të Çikës, rreth 25 milje në veri të Korfuzit. Tre nëndetëse sovjetike thuhej se ishin stacionuar në këtë bazë pak a shumë në mënyrë të përhershme (Pearson, O. 2007: 488).

Më 23 maj Hrushovi i drejton sërish një leter Enver Hoxhës me propozime drejtuar partive komuniste e punëtore pjestare të kominformit në lidhje me abrogimin e rezolucionit të mbledhjes së kominformit në nëntor të 1949-ës dhe botimin në shtyp të kësaj çështjeje mbi rishikimin e rezolucionit të mbledhjes së kominformit në korrik të 1948-ës. Hrushovi kishte për qëllim ti deklaronte këto në bisedimet që do të zhvilloheshin më 24 maj 1955 në Beograd midis delegacionit sovjetik dhe atij jugosllav (1955, MPKBS, F.14, D. 10, fq. 13, AQSH). Pas dy ditësh në 25 maj Enver Hoxha përpilon një letër të cilën ia dorëzon ambasadorit sovjetik në Tiranë, Leviçkin, në të cilën deklarohej qëndrimi mospajtues i byrosë politike të PPSH-së mbi mënyrën se si po vepronte Hrushovi në lidhje me rehabilitimin e plotë të Jugosllavisë (Hoxha, E. 1982 : 539).

Në këtë letër Hoxha shkruan me superlativa për burimin e frymëzimit tek Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, e ndër të tjera : “Partia komuniste e Bashkimit Sovjetik na ka mësuar ta shfaqim mendimin për çdo çështje që ka të bëjë me vijën e partisë haptas dhe sinqerisht , si internacionalistë”(1955, MPKBS, F.14, D. 10, fq.15, AQSH)

Hoxha nuk harron ti kujtojë Hrushovit se PPSH-ja ka qënë gjithmonë dakort me propozimet dhe tezat e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në lidhje me Jugosllavinë. Frika nga Jugosllavia, nuk e frenoi Enver Hoxhën të ishte i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë. Sipas tij kjo letër dhe mendimet që shprehen në të nuk përputhen me ato të komunistëve shqiptarë. Në këtë rast ata nuk mendojnë njëlloj. Ai shkruante se byroja politike shqiptare dhe ai vetë kishin nxjerrë disa vërejtje dhe propozime përse i përket bisedimeve që do të bëheshin me jugosllavët dhe abrogimit të rezolucionit të vitit 1949 (1955, MPKBS, F.14, D. 10, fq.15, AQSH).

Sipas Hoxhës, komunistët shqiptarë mendonin se përveç ndonjë gjëje me rëndësi taktike, vija e përgjithshme, përmbajtja kryesore e rezolucionit të mbledhjes së kominformit në nëntor të vitit 1949 ishte e drejtë dhe përmbajtja e këtij rezolucioni nuk mund të merrej e shkëputur nga rezolucioni i korrikut 1948. Hoxha këmbëngul në përmbajtjen e drejtë të të gjithë rezolucioneve të kominformit për Jugosllavinë dhe thekson se nga eksperiencia e tij me jugosllavët ai është i bindur se ata vazhdonin të ishin në pozita antimarksiste. Ai kundërshtonte me forcë procedurën e zgjedhur për aprovimin e abrogimit të rezolucionit të mbledhjes së kominformit në nëntor të 1949-ës. Koha shumë e shkurtër që iu la partive komuniste dhe punëtore, pjestare të kominformit për të shfaqur mendimin e tyre në lidhje me përmbajtjen e letrës së ardhur nga komiteti qëndror i Bashkimit Sovjetik, i dukej e pamjaftueshme për t'u shprehur për një çështje kaq të rëndësishme siç e quan këtë Enver Hoxha. Duhej një analizë e thellë për këtë vendim, madje Hoxha kundërshton me forcë publikimin e tij dhe nxjerrjen në shtyp pasi kjo do të ishte e parakohshme dhe do të shkaktonte sipas tij dëme serioze në orientimin e përgjithshëm në lidhje me Jugosllavinë, në partitë e interesuara e në mënyrë të veçantë në Partinë e Punës së Shqipërisë (1955, MPKBS, F.14, D. 10, fq. 17, AQSH).

Lideri komunist shqiptar, i kujton Hrushovit në letrën e tij, se Partia e Punës së Shqipërisë kishte plot 7 vjet që luftonte për zbatimin e vijës së saj të përgjithshme në lidhje me Jugosllavinë, të ndërtuara mbi këto rezolucione të kominformit dhe të aprovuara nga kongresi i parë i Partisë së Punës së Shqipërisë. Që të ndryshonte kjo vijë që po ndiqej ndaj Jugosllavisë dhe që e gjykonte të drejtë do të duhej të mblidhej kongresi i Partisë ose të paktën konferenca e Partisë (1955, MPKBS, F. 14, D.10, fq.18, AQSH).

Kjo ishte hera e parë që Enver Hoxha kundërshtonte kërkesat apo propozimet e një lideri të lartë të Bashkimit Sovjetik. Dhe kur bëhej fjalë për Jugosllavinë, ai do të vazhdonte ta bënte këtë deri në vdekje. Në letrën e tij Hoxha i propozonte Hrushovit që të mos merret një vendim i shpejtuar për abrogimin e rezolucionit të nëntorit '49, dhe të mos shpallej asgjë në shtyp për këtë, madje asgjë nga këto të mos deklarohet në bisedimet e Beogradit. Hoxha shkon edhe më tej kur merr guximin ti tregojë Hrushovit se duhet të bisedojë veç për çështje taktike dhe jo për ato parimore që prekin vijën e përgjithshme të partive komuniste (1955, MPKBS,

F.14, D. 10, fq. 18, AQSH). Por kundërshtimi nuk zgjati shumë. Enver Hoxha reflektoi dhe pa kaluar shumë kohë thirri në zyrë ambasadorin sovjetik në Shqipëri, në atë kohë K.D. Leviçkin, të cilit i pranoi se përgjigjia e letrës së Komitetit Qëndror të Bashkimit Sovjetik të datës 23 maj 1955 ishte një gabim i rëndë.

Rezoluta e kominformit e vitit 1948, mënjanoi rreziqet për pushtetin e Enver Hoxhës por edhe për pavaresinë e Shqipërisë. Hedhja poshte e saj ngjallte frikë për rreziqet e mësipërme. Por Shqipëria e cila nuk mund të bënte dot pa ndihmat dhe mbështetjen e Bashkimit Sovjetik nuk mund të kundërshtonte hapur Nikita Hrushovin. Një ditë më pas byroja politike e tërhoqi qëndrimin e saj si më sipër në lidhje me Jugosllavinë, me argumentin se nuk kishin parë interesin e përgjithshëm dhe se ishte vënë në dyshim vija udhëheqëse e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (Lalaj, A. 2009 : 103).

Dhe si për ta theksuar këtë e për tu shfajësuar më tej, ai i shkruan më 26 qershor një letër Nikita Hrushovit, ku ndër të tjera i raporton për ato që ka biseduar me ambasadorin sovjetik por edhe se e gjen të nevojshme ti tregojë arsyet që e shtynë byronë politike të KQ-së së Partisë së Punës së Shqipërisë të bjerë në një gabim të tillë. Çdo fjale e Hrushovit ishte e qartë dhe e drejtë, ashtu siç kishte qënë gjithmonë, për liderin komunist shqiptar. Hoxha pranonte kokëulur se nuk ishte thelluar aq sa duhej për mënyrën se si duhej konkretizuar në praktikë vija e drejtë e partive të demokracisë popullore përballë Jugosllavisë. Gjithashtu ai pohonte se kishte qënë gjithmonë dakort me zgjidhjen në rrugën marksiste - leniniste të mosmarrëveshjeve me Jugosllavinë, por në të njëjtën kohë kishte krijuar bindjen se udhëheqësit jugosllavë nuk do të hiqnin dorë dhe nuk do të njihnin gabimet e tyre të rënda (1955, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 21, AQSH).

Ai pranonte më në fund se ishte treguar subjektiv në gjykimin e çështjes, nisur dhe nga fakti se sa agresivë ishin treguar jugosllavët kundër PPSH-së dhe sovranitetit të Shqipërisë.

Shprehet i keqardhur dhe nuk heziton të pranojë se gjëndet në një situatë jashtëzakonisht të tmerrshme shpirtërore.

"...Por asnjë grimë nuk na u lëkund besimi i pafund që ne kemi për partinë komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kjo na shpëtoi të mos bënim gabime më tutje dhe të gjenim shpejt rrugën e drejtë. Vuanim tmerrësisht se përse të mos ishim dakort me komitetin qëndror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ne kurrë një gjë e tillë s'na kishte ngjarë dhe kurrë nuk do të ngjasë" shkruante Enver Hoxha(1955, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 22, AQSH).

Gjithësesi komiteti qëndror i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik nxitoi që me anë të një tjetër letre, ti bënte të qarta bisedimet sovjeto - jugosllave të 27 majit në Beograd, për shqiptarët. Ato zgjatën 7 ditë dhe në to u arrit një marrëveshje për të zhvilluar një takim të nivelit të lartë. Por cili do të ishte vendi i takimit? Udhëheqësit jugosllavë propozuan për tu takuar ose në Beograd ose në ndonjë vend mbi Danub. Ata ranë dakort që takimi të bëhej në Beograd edhe pse kjo mund të interpretohej si një lëshim nga ana e Bashkimit Sovjetik. Hrushovi nuk e fshehu entuziazmin për këtë takim. Delegacioni i Bashkimit Sovjetik që do të udhëtonte për në Beograd do të lidhej me popullin e këtij vendi, do të manifestonte ndjenjat miqësore të popujve të Bashkimit Sovjetik për ta dhe do të krijonte kushtet më të favorshme paraprake për një këmbim pikëpamjesh të drejtpërdrejta , të sinqerta dhe shoqërore me udhëheqësit jugosllavë (1955, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 37 , AQSH).

Rezultati i bisedimeve sovjeto – jugosllave ishte pozitiv. U bë një kthesë e shpejtë në marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Federale të Jugosllavisë. "...Marrëdhëniet jonormale dhe të sëmura që u krijuan pas vitit 1948, u likuiduan..." (1955, MPKBS, F. 14, D. 10, fq. 37, AQSH).

Enver Hoxhës në këtë rast nuk i mbetej gjë tjetër veçse të pranonte dhe të ndiqte si fillim edhe pse ngadalë kursin e Bashkimit Sovjetik ndaj Jugosllavisë që do të thoshte politikë dhe bashkëjetesë paqësore me Jugosllavinë.

Më 16 qershor 1955 Enver Hoxha merr një ftesë për të shkuar me pushime në Bashkimin Sovjetik bashkë me bashkëshorten Nexhmije Hoxhën. Ai në fillim nuk ishte dakort të shkonte për shkak të rrugës së gjatë por nuk ishte në kushtet kur mund ta refuzonte ftesën. Sapo mbërriti në Moskë ai u ftua nga Mikhail Suslov në ceremoninë e pajtimit me Marrëshallin Tito dhe madje ju kërkua të rehabilitonte shqiptarët të cilët ishin dënuar në kohën e

ndërprerjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë. Gjithashtu Hoxhës iu ushtrua presion nga Anastas Mikoyan që të takohet në Moskë me Svetozar Vukmanoviç Tempon i cili kishte qënë emisari i Titos në Ballkan gjatë luftës, me të cilin edhe kishte bashkëpunuar Koçi Xoxe (Pearson. O.2007: 494). Sovjetikët nuk kishin humbur kohë. Presioni ishte rritur dhe Hoxha tashmë ishte zënë në kurthin e rikthimit të një marrëdhënieje që nuk e donte.

Lëvizjet diplomatike të nëntorit të vitit 1955 i ngjajnë përpjekjeve të një vendi në kërkim të shpresës së humbur. Zv. ministri i jashtëm shqiptar i përcillte në këtë kohë, përfaqësuesit francez në Tiranë, Burdej , zyrtarisht dëshirën që në qoftë se qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe dëshironin, Shqipëria do të ishte gati të shkëmbente përfaqësuesit diplomatikë me këto qeveri (Milo, P. 1996: 8) .

Me uljen e tensionit ndërkombëtar, ishin krijuar kushtet dhe mundësitë që Republika Popullore e Shqipërisë të zgjeronte marrëdhëniet diplomatike. Konferenca e Gjenevës e vitit 1955 zgjoi shpresën për zgjidhjen e problemeve me rrugën e diskutimeve e cila mund të thellonte uljen e tensionit. Paskal Milo në studimet e tij thotë : "... nuk duhet përjashtuar mundësia që Enver Hoxha i pakënaqur nga krushqia që bëri Hrushovi me Titon me vizitën e të parit në Beograd, ka synuar të forcojë pozitat e pushtetit të tij duke i dhënë sinjale të reja përëndimit..."(Milo, P. 1996: 8).

Më 7 dhjetor të vitit 1955 Leviçkin ambasador i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri zhvilloi një bisedë me të dërguarin jugosllav në Shqipëri Ajtiç mbi marrëdhëniet jugosllavo - shqiptare. Nga biseda mes tyre duket se marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik kishin ndryshuar ndjeshëm (Kaba, H, Çeku,E. 2011: 158). Në bisedën me Leviçkin, Ajtiç pranoi se kohët e fundit ato ishin përmirësuar ndjeshëm

Ai vlerësoi në mënyrë të veçantë vizitën e të gjithë udhëheqësve të partisë dhe qeverisë së Shqipërisë në pritjen e dhënë nga misioni jugosllav me rastin e dhjetë vjetorit të shpalljes së republikës së Jugosllavisë. Për Ajtiç, kjo vizitë ishte dëshmi e Shqipërisë për të pasur marrëdhënie miqësore me Jugosllavinë. Për jugosllavët ishte problem që Shqipëria nuk po shprehej ende për periudhën 1944 – ‘48 në marrëdhëniet me Jugosllavinë si dhe Koçi Xoxen të cilin ata (shqiptarët) vazhdonin ta quanin armik të popullit dhe atë periudhë, si periudhën

e ndjekjes së një politike kolonizuese të Jugosllavisë ndaj Shqipërisë. Në këtë bisedë mes ambasadorit sovjetik në atë kohë në Tiranë dhe te dërguarit jugosllav në Shqipëri vihet re një prirje e palës sovjetike për të parë drejt të ardhmes. Në shënimet e tij Leviçkin citon se i tha Ajtiçit që kthimi drejt të shkuarës dhe kujtimi i saj në rastin e dhënë do të na pengojnë të ndërtojmë të ardhmen (Kaba, H. Ceku, E. 2011: 159).

Kapitulli IV: Mosmarrëveshjet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik 1955 – 1957

Viti 1956 nisi me një ngjarje shumë të rëndësishme. Ishte kongresi i XX-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por përpara tij, KQ i PK-së së Bashkimit Sovjetik u mbledh më 13 shkurt 1956 në një takim për të diskutuar raportin që do të mbahej në kongres. Nga dokumentet e hapura tashmë në arkivat ruse duket se përmbajtja e fjalimit të famshëm të Nikita Hrushovit ishte vendosur që më parë në këtë mbledhje të komitetit qendror. Kongresi i XX-të i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik u mbledh më 14 shkurt të 1956-ës dhe zgjati deri më datë 25 të këtij muaji. Ngjarja më e rëndësishme e këtij kongresi ishte destalinizimi i Bashkimit Sovjetik të cilin sekretari i parë i partisë komuniste sovjetike Nikita Hrushov e lajmëroi me anë të një fjalimi të gjatë në të cilin mori në analizë gjithë karrierën politike si udhëheqës të Stalinit. Fjalimi u mbajt në një audiencë të zgjedhur dhe të miratuar nga vetë Hrushovi (Ngjela, S. 2011: 209). Për herë të parë Stalini kritikohet në rrugë zyrtare për kultin e individit dhe fajësohet për pasojat e tij në shoqërinë e Bashkimit Sovjetik (Historia III, 2003: 194). Hrushovi do ta niste fjalimin e tij me fjalët :

“ Të dashur shokë, në raportin e komitetit qendror të partisë për kongresin e XX-të dhe në një numër të konsiderueshëm të fjalimeve të mbajtura nga delegatët edhe gjatë sesioneve plenare të mëparshme, shumë folën për kultin e individit dhe për rrjedhojat e tij të dëmshme”(1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fl.1, AQSH).

Më tej Hrushovi u përpoq të shpjegonte se ky raport nuk kishte për qëllim gjykimin dhe vlerësimin e jetës dhe aktivitetit të Stalinit, ai theksoi se të gjithë botërisht e njohin rolin e Stalinit në zbatimin revolucionit socialist, në luftën civile, dhe përpjekjet e tij për ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik. Sipas Hrushovit komiteti qendror pas vdekjes së Stalinit mori në analizë atë që kishte ndodhur me të. Nuk është në linjën e marksizëm - leninizmit ti veshësh një personi të vetëm aftësi të mbinatyrshme, të padështueshme dhe ta shohësh atë si një zot (www.britannica.com/event/Twentieth-congress-of-the-communist-party-of-Soviet-

Union). “Tani”, tha Hrushovi, “ne na shqetëson një pyetje e cila ka një rëndësi shumë të madhe për të tashmen e partisë dhe të ardhmen e saj – se si kulti i individit Stalin u rrit gradualisht, kulti i cili në një farë shkalle u bë burimi i një serie shtrembërimesh të principeve të partisë, të demokracisë së partisë dhe ligjshmërisë revolucionare “

Hrushovi i kujtoi delegatëve se si klasikët e marksizëm - leninizmit luftuan çdo manifestim sado të vogël të kultit të individit (www.britannica.com/event/Twentieth-congress-of-the-communist-party-of-Soviet-Union). Më tej lideri i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik do ti hidhte sytë tej në luftë. Në mënyrën se si Stalini e menaxhoi luftën dhe ushtrinë. Dhe në këtë fushë Hrushovi gjeti dhe theksoi mjaft të meta. Sipas tij Stalini nuk merrte parasysh informatat që i vinin nga burime mjaft të sigurta për palën kundërshtarë, gjithashtu Stalini nuk armatosi ashtu siç duhet ushtrinë sovjetike. Në qoftë se industria sovjetike do të ishte mobilizuar në kohën e duhur dhe ashtu siç duhet për të siguruar ushtrinë me armatime dhe me pajisjet e nevojshme, ata do të kishin pasur humbje shumë më të pakta në këtë luftë të vështirë, proklamonte Hrushovi në kongresin e XX-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik.

“injorohej gjithçka. Edhe paralajmërimet e komandantëve të ndryshëm ushtarakë, edhe të dhënat e të arratisurve dhe bile edhe veprimet e hapura të armikut . Çfarë largpamësie është kjo nga ana e një udhëheqësi të partisë dhe të vendit në një moment kaq me përgjëgjësi në histori ?”(1956, MPKBS, F. 14, D. 3,fq, AQSH)

Më tej Hrushovi u ndal tek politika e represioneve në shkallë të gjërë kundër kuadrove të ushtrisë që sipas tij pati pasoja të rënda për faktin se minoi bazën e disiplinës ushtarake. Edhe pas fillimit të luftës, nervoziteti dhe histerizmi që tregonte Stalini në ndërhyrjen e vet gjatë operacioneve luftarake i kishin shkaktuar ushtrisë së Bashkimit Sovjetik një dëm kolosal, sipas sekretarit të parë të partisë komuniste Nikita Hrushov. Ai zbrazti një thes me vërejtje për Stalinin dhe mënyrat e tij të gabuara në drejtim. Ai foli hapur për gjakun e derdhur, për dëmet e shkaktuara dhe gjatë fjalës së tij nuk mungoi habia në sallë (1956, MPKBS, F. 14, D. 3, fq, AQSH).

Ky ishte një fjalim bombë. Asnjëherë më parë një drejtues i lartë i Bashkimit Sovjetik nuk kishte folur kundër Stalinit dhe bëmave të tij. Sipas Hrushovit, Stalini e popullarizonte shumë veten si strateg të madh, fuste në ndërgjegjien e njerëzve me gjithëfarë mënyrash versionin se të gjitha fitoret që ka korrur populli sovjetik në luftën e madhe patriotike ishin rezultat i burrërisë, trimërisë, gjenisë së Stalinit dhe të askujt tjetër (1956, MPKBS, F. 14, D. 3, fq. 53, AQSH).

"Në periudhën e pasluftës gjendja u ndërlikua edhe më tepër. Stalini u bë më kapriçioz , më i pezmatuar, brutal, filloi të zhvillohej në mënyrë të veçantë dyshimi" (1956, MPKBS, F. 14, D. 3, fq. 57, AQSH) .

Në fjalimin e tij Hrushovi foli për maninë e madhështisë së Stalinit, e cila çoi edhe në ndarjen me Jugosllavinë. Një nga pikat më të rëndësishme të këtij raporti ishte rikthimi i Jugosllavisë në bllokun e partive komuniste me në krye Bashkimin Sovjetik. Për faj të politikave të gabuara dhe demtuese të Stalinit, Hrushovi e pranoi se në mesin e tyre kishin zënë vend shumë mashtruesë dhe servilë (1956, MPKBS, F.14, D. 3, fq. 61, AQSH).

Hrushovi foli edhe për heqjen e emrit të Stalinit nga fabrikat, uzinat, ndërmarrjet, shkollat pasi edhe në këtë mënyrë shfaqej kulti i individit. Ai parashtroi detyra të rëndësishme, si çrrënjësja në mënyrë bolshevike, e kultit të personit si një shfaqje e huaj për frymën e marksizëm - leninizmit, si dhe duhet të forcoheshin parimet leniniste edhe në kushtetutën e Bashkimit Sovjetik (1956, MPKBS, F. 14, D. 3, fq. 64, AQSH).

Këmbanat e kongresit të XX-të ranë në veshët e liderit shqiptar si një alarm. Menjëherë pas kthimit nga Moska, Enver Hoxha thirri pleniumin e 17- të të PPSH-së në mars të 1956-ës. Ai i informoi anëtarët e pleniumit mbi punimet e kongresit të XX-të dhe i porosi ata që të mos njoftohej partia për kultin e individit të Stalinit të cilin e dënoi fuqishëm Hrushovi në kongresin e XX-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik (Akademia e Shkencave të Shqipërisë , 2009 : 203).

Jehona e kongresit të XX-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik ishte shumë e madhe. Nuk mund të themi se çfarë reagimi personal kishte Enver Hoxha ndaj deklaratave të

Hrushovit, por ajo që bëri publikisht ishte se në fillim nuk hezitoi të dilte kundër kultit të individit të Stalinit. Pak javë pasi Stalini ishte goditur egërsisht dhe në menyrë të argumentuar në kongresin e XX-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik nga pasardhësi i tij Hrushovi, Enver Hoxha nuk hezitoi të jepte mendimin e tij për këtë çështje. Organi zyrtar i partisë së punës së Shqipërisë, “Zëri i Popullit” më 14 prill 1956 u hap me kryartikullin me titull “ Marksizëm – Leninizmi” na mëson se populli është krijues i historisë”. Ky artikull mbante firmën e Enver Hoxhës. Në të ai shprehej :

...“Stalini bëri gabime që i kushtuan popullit sovjetik dhe çështjes së socializmit. Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik e dënoi me të drejtë kultin e individit të krijuar për J.V. Stalin në vitet e fundit të aktivitetit të jetës së tij dhe që i solli kaq dëme Bashkimit Sovjetik. Duhet thënë se J.V. Stalin në një kohë pasi PK-ja e BS-së e populli sovjetik arritën fitore të mëdha që çuan në triumfin e socializmit, filloi ta vinte veten mbi partinë dhe popullin, të largohej nga masat dhe kështu u bënë gabime që i kushtuan shumë popullit sovjetik dhe çështjes së socializmit”(1956, 14 prill, " Zëri i Popullit").

Pra siç vihet re, Enver Hoxha nuk hezitoi ta kritikonte po aq ashpër sa edhe Hrushovi , idhullin e tij. Por kjo ndodhi për pak kohë siç do ta shohim edhe më vonë. Në faqet e "Zërit të Popullit", Enver Hoxha shkruan më tej:

“ Në dënimin që kongresi i XX-të i bëri kultit të individit, në kritikën e hapur dhe të guximshme që u bëri dëmeve të tij , PK-ja e BS-së dhe të gjitha partitë komuniste e punëtore të të gjitha vendeve nxjerrin konkluzione me rëndësi praktike...”(1956, 14 prill, " Zëri i Popullit")

Edhe pse Enver Hoxha u përpoq të ndiqte rrugën e Hrushovit, përsëri shkëndijat e para të mosbesimit dhe të paranojës që sillte rikthimi i miqësisë mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë kishin filluar të shfaqeshin. Efektet e kongresit të XX-të të PK-së së BS-së u ndjenë fuqishëm në konferencën e Tiranës së PPSH-së. Zërat kundër kultit të individit u shtuan dhe pushteti i Enver Hoxhës ishte me I rrezikuar se kurrë. Klima në të gjithë bllokun komunist ishte e tillë. Hoxha ndërpreu pushimet në Vlorë dhe ia behu në konferencën e Tiranës, ku rebelimi ishte i madh më 15 prill 1956. Por ai arriti ta ulë pakënaqësinë dhe ta

përmbysë situatën. Veprimi i radhës ishte arrestimi i palëve. Dhe pikërisht ndërkohë që dilnin nga salla e konferencës. Jo pak, por 44 komunistë u arrestuan dhe u dënuan. Studiuesja Ana Lalaj shkruan se vetë Enver Hoxha iu referua konferencës së Tiranës, duke e cilësuar si një nga çastet më të vështira të Partisë së Punës së Shqipërisë (Lalaj, A. 2007 : 4).

Ditën e fundit të konferencës Hoxha mbledhi byronë politike dhe ju dha te gatshëm zbulimin duke e cilësuar atë "një punë të rrezikshme armiqësore nga elementë kundër partisë dhe demokracisë sonë popullore" (Dyrmishi, D. 2011: 228.)

Paralel me luftën politike dhe eliminimet në radhët e partisë, Hoxha guxoi ta çonte edhe më tej mendimin e tij mbi konferencën e Tiranës. Shumë vite më vonë ai akuzoi edhe pse pas vdekjes, gjithë klanet armiqësore sipas tij tashmë të eliminuara. Ai shkruante : "Në krye të kësaj veprimtarie të fshehtë qëndronte Mehmet Shehu i ndihmuar nga Beqir Balluku , Kadri Hazbiu etj "(Akademia e shkencave të Shqipërisë, 1983: 203).

Konferencën e Tiranës Enver Hoxha e cilësoi si një pjesë të komplotit Tito - Hrushov, për përmbysjen e gjëndjes në vendin tonë (Hoxha , E. 1982: 541).

Situata nuk do të kalonte pa u vënë re nga Hrushovi i cili ndiqte me kujdes zhvillimet në Shqipëri. Në kujtimet e tij botuar në gazetën "Panorama", Agim Popa përkthyesi i Enver Hoxhës, shkruan se Hrushovi e kishte përjetuar keq faktin që Hoxha jo vetëm nuk i liroi ata por madje i pushkatoi (2011, Kujtimet e Agim Popës, " Gazeta Panorama").

Presioni i Hrushovit nuk pati efekt. Hoxha nuk u dorëzua por arrestoi dhe dënoi dy udhëheqës të rëndësishëm, Bedri Spahiun dhe Tuk Jakovën. Në librin e tij "Përkulja dhe rënia tiranisë shqiptare 1957 - 2010", Spartak Ngjela citon kujtimet e babait të tij Kiço Ngjela për reagimin e Bedri Spahiut gjatë pleniumit. Në fund, shkruan Ngjela, ai kishte marrë fjalën dhe me gisht i kishte thënë Enver Hoxhës:

"kush je ti që i ke hipur kalit të partisë e gënjen e akuzon? Sejfullai oportunist, Tuku oportunist, Bedriu i tillë e këtyllë, .. po ti vet kush je? Ta them unë se kush je : ti je njeriu i rrugëve të errëta të Parisit .. ti je një pusht pa princip". Kurrë më nuk u dëgjua një akuzë e tillë kundër Enverit (Ngjela, S. 2011 : 106).

Nën presionin e ngjarjeve të fundit të vendit lider të komunizmit, Bashkimin Sovjetik, po ndodhte një rotacion i shpejtë i udhëheqësve të vendeve komuniste. Ndoshta Enver Hoxha e kishte ndjerë një gjë të tillë. Po ndodhnin shumë gjëra, Hrushovi po afrohej me Titon dhe në vendet e tjera po vinin në pushtet edhe njerëz të dënuar e të burgosur më parë. Gjatë diskutimeve të Enver Hoxhës në konferencën e Tiranës, ai iu kundërvu diskutantëve duke përdorur akuza dhe presione nga më orderet dhe i cilësoi diskutimet si veprimtari armiqësore të nxitura nga agjenturat e huaja gjë që do të thoshte se ai do të hakmerrej kundër të gjithë atyre që guxuan dhe folën në këtë konferencë. Pas analizave të bëra, byroja politike vendosi përjashtimin e 9 anëtarëve të partisë (Dyrmishi, D. 2011: 229). Më vonë për disa u morën masa edhe për dënim me burg e internim. Por grushti më i fortë pas konferencës së Tiranës nuk ishin këto përjashtime e dënime, por ishte forcimi i kultit të individit të Enver Hoxhës, si dhe shtypja e çdo tentative për liberalizim, për mendim dhe fjalë të lirë.

Më 10 dhe 11 maj Enver Hoxha mbledhi Komitetin Qëndror të PPSH-së dhe diskutoi vendimet dhe veprimet e fundit në konferencën e Tiranës. Komiteti qëndror i dha Enver Hoxhës një votëbesim dhe i hapi rrugën kongresit të tretë të Partisë së Punës së Shqipërisë (Pearson, O. 2006: 507). Kongresi i tretë i Partisë së Punës së Shqipërisë kaloi mirë dhe pa incidente. Enver Hoxha u shfaq sërish në Tiranë në krye të Partisë së Punës dhe u rizgjodh unanimisht në krye të saj si sekretar i parë i partisë. Edhe Mehmet Shehu dhe Komiteti Qëndror u rizgjodh unanimisht. Peter Pospyelov një anëtar i sekretariatit të Partisë Komuniste sovjetike, ishte i pranishëm në kongres si delegat nga Bashkimi Sovjetik dhe nuk nguroi të shprehë fjalët më të mira për kongresin dhe për rizgjedhjen e Enver Hoxhës (Pearson, O. 2006: 507).

Hoxha nuk hezitoi aspak të mbështeste çdo veprim dhe vendim të marrë pas konferencës së Tiranës dhe e quajti Tuk Jakovën, Bedri Spahiun dhe Koçi Xoxen elementë revizionistë dhe trockistë (Pearson, O. 2006: 507).

"Koçi Xoxe dhe shokët e tij, krijuan dhe vunë në lëvizje një nga fraksionet më të rrezikshme kundër partisë, një fraksion që kishte për qëllim shpërbërjen e unitetit dhe deri likuidimin e

partisë. Koçi Xoxe mori atë që meritonte” deklaronte Enver Hoxha(Pearson, O. 2006: 507).

Kongresi i Partisë së Punës së Shqipërisë i përfundoi punimet me fjalët aprovuese të të dërguarit sovjetik i cili ndër të tjera u shpreh : " Partia e Punës së Shqipërisë nuk ka bërë asnjë gabim, pasi ajo ka ndjekur gjurmët e lavdishme të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, politika leniniste e të cilës ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë e drejtë"(Pearson, O. 2006: 508)

Më 1 qershor të vitit 1956 një delegacion jugosllav zbarkoi në Moskë. Në krye të tij, Josip Broz Tito, sekretar i përgjithshëm i partisë komuniste jugosllave, Edvard Kardel sekretar i Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste jugosllave, si dhe anëtarët Jakov Blasheviç, Velko Miçunoviç, Koca Popoviç dhe Mijalko Todoroviç si përfaqësues të popullit jugosllav (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 53, AQSH).

Ata u pritën përzierisht nga një delegacion i Bashkimit Sovjetik i kryesuar nga Nikita Sergejeviç Hrushov sekretar i parë i komitetit qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, anëtarët e presidiumit të Komitetit Qëndror të PK të BS-së Bulganini, Voroshilovi, Mikoiani, Molotovi etj. Vizita e jugosllavëve në Moskë zgjati plot 23 ditë, deri më datë 23 qershor dhe përfundoi me një deklaratë të përbashkët mbi marrëdhëniet mes të dy vendeve (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 53, AQSH).

Gjatë këtyre bisedimeve u ra dakort mbi disa çështje të rëndësishme. U vunë në një bazë të shëndoshë marrëdhëniet midis dy vendeve me anë të deklaratës së Beogradit të 2 qershorit 1955. Gjithashtu janë krijuar kushte shumë të mira për bashkëpunimin mes partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Bashkimit të Komunistëve jugosllavë. Në këtë deklaratë u fol për parime e për paqedashje dhe u ra dakort që të dy shtetet do të kontribuonin sinqerisht për këtë (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 56, AQSH).Dhe në këtë klimë të hapur dashamirësie mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë duket se për Enver Hoxhën gjërat nuk shkonin ashtu siç dëshironte. Pas ikjes së K. D. Leviçkin ambasadorit sovjetik nga Tirana në fund të vitit 1955, një tjetër ambasador sovjetik do të vinte në Shqipëri. Në një bisedë të Krillov, ambasadori i ri i Bashkimit Sovjetik në Tiranë, me Enver Hoxhën, mbi marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave

më 9 korrik 1956, ai kujton se Hoxha dëshironte të këshillohej me të se si ti ndërtonin marrëdhëniet me Jugosllavinë.

Krillov dhe Hoxha e zhvilluan këtë takim në ambientet e shtëpisë së liderit komunist shqiptar. Në këtë takim Enver Hoxha i rrëfeu Krillovit se misioni jugosllav në Tiranë si dhe më parë, vazhdonte të bënte një punë, që drejtohej kundër vijës së komitetit qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe kundër qeverisë shqiptare. Sipas Hoxhës punonjësit e misionit jugosllav vazhdonin të ruanin lidhje të forta me qytetarë shqiptarë, veçanërisht me lloj - lloj elementësh të paqëndrueshëm. Gjithashtu sipas tij misioni jugosllav në Tiranë bënte biseda të ngjashme me të gjithë qytetarët shqiptarë që u drejtoheshin për të marrë viza për të shkuar në Jugosllavi. "Janë vënë re një sërë rastesh kur punonjësit e misionit pas marrjes se vizave shkonin në shtëpitë e këtyre qytetarëve duke vazhduar përpunimin e tyre" (Kaba, H. Çeku, E. 2011:160).

Sipas Enver Hoxhës kjo bëhej duke u munduar të manipulonin mendjen e shqiptarëve që kërkonin vizë për në Jugosllavi, duke sharë me çdo mënyrë udhëheqjen e komitetit qendror të PPSH-së dhe qeverinë të cilët sipas jugosllavëve nuk dëshironin miqësi të vërtetë me ta. Në këtë takim Enver Hoxha bisedoi me ambasadorin Krillov një sërë çështjesh që e shqetësonin, që nga çështja e Kosovës e Metohisë (siç e quante ai në atë kohë) e deri tek çështja e 50 emigrantëve që dëshironin të ktheheshin në Jugosllavi. Pas kësaj ai e porositi Krillovin që të diskutonte çështjet shqetësuese me Moskën dhe të këshillohej me ta e ndërkohë ta njoftonin për pikëpamjen e tyre (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 161). Ndër të tjera në këtë bisedë me Krillovin Enver Hoxha i cili kishte mbledhur informacion dhe fakte rreth jugosllavëve në Shqipëri, ai shtroi edhe një çështje tjetër. Atë të Kosovës.

Sipas tij para pak kohësh në Kosovë e Metohi (në atë kohë krahinë jugosllave), ku jetonin 800 mijë shqiptarë filloi një proces i gjerë kundër një grupi shqiptarësh të cilët në vitin 1948 kishin organizuar lëvizjen për bashkimin e kësaj krahine me Shqipërinë. Enver Hoxha pretendonte se shteti shqiptar nuk kishte asnjë lidhje me këtë grup. Dhe shtronte pyetjen se përse duhet të niste tani ky proces. Sipas tij shumë shqiptarë që shkonin herë pas here në Jugosllavi si pasojë e lidhjeve fafëfisnore atje, i nënshtroheshin një lloj përpunimi përkatës

nga ana e organeve Jugosllave dhe ata që bënë rezistencë futeshin në burg (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 161).

Enver Hoxha kishte ndërmend të ftonte së shpejti personalisht, të dërguarin jugosllav Milatoviç në Ministrinë e Jashtme dhe ti percillte atij mendimet që kishte për misionin jugosllav në Tiranë. Nëse ai nuk merrte masa, atëherë punonjësit më të kompromentuar si Vuçiç dhe Xhixha do të dëboheshin nga vendi. Pas bisedës së gjatë, synimi i Hoxhës ishte që çështjet të cilat e shqetësonin ti shkonin në vesh Hrushovit. Ai e porositi Krillovin të këshillohej me Moskën zyrtare e ndërkohë ta njoftonte për pikëpamjen e tyre (Kaba, H. Çeku, E. 2011 : 162).

Më 6 gusht të vitit 1956 Enver Hoxha do të ftonte sërish në zyrën e tij ambasadorin sovjetik në Tiranë Krillov. Kjo ndodhi pas takimit që Hoxha pati me të dërguarin e Republikes Popullore Federative të Jugosllavisë Arso Milatoviç. Sipas bisedës së regjistruar nga vetë Krillovi, Enver Hoxha dhe Milatoviçi kishin biseduar për rreth 1 orë e 15 minuta. Ishte një bisedë e hapur në dukje, ku ishte folur për miqësinë mes Shqipërisë e Jugosllavisë deri në 48-ën, por edhe për shkaqet e prishjes së saj ende të pakuptueshme për jugosllavët (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 166).

Gjithësesi siç pohonte vet Enver Hoxha biseda kishte qenë e sinqertë dhe miqësore. Gjatë kësaj bisede Enver Hoxha i kishte përcjellë Milatoviçit të gjitha ankesat e tij për misionin, çështjen e emigrantëve jugosllavë në vendin tonë apo kosovarëve ndaj të cilëve ishte hapur gjyq në atë kohë në Jugosllavi. Gjithashtu Enver Hoxha në këtë takim kishte shprehur gatishmërinë e tij për përmirësimin e marrëdhënieve, madje i shprehu Milatoviçit edhe besimin që kishte tek Tito dhe madje u dërgoi jugosllavëve edhe të fala miqësore (Kaba, H. Çeku, E. 2011 : 165-166)

4.1. Ngjarjet në Hungari dhe turbullimi i Marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë dhe qëndrimi i Tiranës zyrtare

“ Ç’po ndodh tani në Hungari? Terror si në kohën e Hitlerit dhe demagogji. Propaganda imperialiste e trumbeton këtë si triumfin e demokracisë” (Hoxha, E. 1979 : 72). Kështu shkruante Enver Hoxha në një nga veprat e tij, atë me numrin katër për ngjarjet e 1956-ës në Hungari. Në bazë të këtyre tezave që Hoxha hodhi në kapitullin mbi Hungarinë, u përgatit edhe kryeartikulli që u botua më 5 nëntor 1956 në gazetën “Zëri i Popullit” me titullin “Populli hungarez dërmoi komplotin fashist”. Ngjarjet në Hungari nisën si një përplasje pikëpamjesh demokratike në Budapest në një klub i cili kishte emrin e poetit të madh kombëtar hungarez Shandor Petëf (1956, 5 Nëntor, " Zëri i Popullit").

Ngjarjet në Hungari duket sikur turbulluan ujërat e qeta të marrëdhënieve të përmirësuara dukshëm mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Në disa radiograme të diktuar nga ambasadori i Bashkimit Sovjetik në zyrën e Enver Hoxhës në Nëntor të vitit 1956 flitet për gjëndjen dhe ngjarjet në Hungari. Në atë kohë u zhvillua një mbledhje midis përfaqësuesve të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Bashkimit të Komunistëve Jugosllavë për çështjen e Hungarisë. Dhe madje pati edhe disa letërkëmbime (1956, MPKBS, F.14, D. 19, fq. 57, AQSH).

Në një letër drejtuar Titos, Kardelit dhe Rankoviçit nga Nikita Hrushov ky i fundit shkruante se në Hungari gjithçka po shkonte ashtu siç edhe ishte biseduar. Ai mbështeste qeverinë e Janosh Kadarit e cila sipas tij mbështetej nga populli. Kjo letër dukej si një raportim për ato që ndodhën në Hungari ato ditë të vështira të 1956-ës. Më 4 nëntor të atij viti, në orën 12, kundër revolucionit u shtyp (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 57, AQSH).

Në fund të letrës thuhet: “ Bisedimet tona të fundit mbi çështjen hungareze treguan unitetin e pikëpamjeve të fundit mbi zhvillimin e ngjarjeve në Hungari dhe duhet të merren masat përkatëse” (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 57, AQSH). Në fakt, kundër revolucionit hungarez u shtyp nga tanket sovjetike, në rrugët e Budapestit. Dhe Partia e Punës së

Shqipërisë duket se nxorri mjaft mësim nga ato që ndodhën në Hungari. Ja çfarë thoshte Enver Hoxha në një fjalim të mbajtur në një takim solemn për themelimin e partisë më 8 nëntor '56:

".....Tragjedia e popullit duhet të bëhet mësim për të gjithë popujt e ndershëm të botës, duhet të bëhet mësim për të gjithë ata që flenë mbi dafina, dhe ata të cilët duke dëgjuar sllogane ideologjike nga imperialistët, e ulin vigjilencën e tyre, e zëvendësojnë atë me oportunizëm dhe butësi të rrezikshme...." (Pearson, O. 2006:512).

Në një letër të ambasadorit sovjetik në Beograd, Firjubin, drejtuar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi bisedimet që ky i fundit kishte zhvilluar me Kardelin thuhet se, ky i fundit (Kardeli) i kishte njoftuar se jugosllavët kishin marrë kontakt me Imre Nagin. Ndërkohë që Imre Nagi bashkë me ish grupin e tij qeveritar prej 11 vetësh, pa Kadarin, ndodheshin tashmë në ambasadën jugosllave në Budapest si emigrantë. Firjubini raportonte se sipas jugosllavëve do të ishte mire që të bisedohej me Imre Nagin dhe ti kërkohej që ai të mbështeste qeverinë e Janosh Kadarit. Jugosllavët ishin të mendimit se kjo gjë do ta lehtësonte gjëndjen në Hungari dhe do të ndihmonte në njohjen e qeverisë së Kadarit si një qeveri e ligjshme (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 57, AQSH). Gjithashtu në këto bisedime Kardeli kërkoi të merreshin masa për ruajtjen e ambasadës jugosllave në Budapest sepse duke u ndodhur Imre Nagi në këtë ambasadë ajo mund të sulmohej nga populli.

Bashkimi Sovjetik dhe drejtuesit e tij nuk ishin dakord me këto pikëpamje të jugosllavëve. Në një telegram të Shepillovit drejtuar Beogradit ai sqaronte pikëpamjet e parashtruara nga ana e Kardelit nga ana e komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në këtë telegram thuhej se mund të ishte e nevojshme të bisedohej me Imre Nagin ndërsa në atë kohë një hap i tillë nuk do të ishte i nevojshëm. Sovjetikët ishin të mendimit dhe e konsideronin të nevojshme që Imre Nagi me gjithë grupin e tij prej 11 vetësh t'i dorëzohej autoriteteve ushtarake sovjetike për t'ia dorëzuar më pas qeverisë revolucionare hungareze (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 58, AQSH).

Megjithatë Tito në një letër tjetër dërguar Hrushovit duket se është dakort me shpalljen e qeverisë revolucionare hungareze. Por nuk nguron të përmendë se nga veprimtaria e ushtrisë

sovjetike në Budapest janë ngjallur pakënaqësi në Jugosllavi. Agjensia shtetërore jugosllave e lajmeve TANIUG përcolli në këtë kohë një deklaratë të qeverisë mbi gjëndjen në Hungari dhe mbi pozicionin e saj në këto ngjarje. Dhe sipas Titos kjo kishte ndihmuar që pakënaqësia të ulej.

Gjithashtu Tito përpiqej të bindte Hrushovin për të mirat e strehimit të Imre Nagit në ambasadën jugosllave. Sipas tij do të ishte më keq nëse ata do të strehoeshin në një nga ambasadat e perëndimit. Tito i kërkonte Hrushovit ta kuptonte drejt dhe të ishin dakort me pozitën e palës jugosllave, në lidhje me dërgimin e grupit të Imre Nagit në Jugosllavi me dëshirën e tyre dhe i kujtonte Hrushovit se në këtë grup kishte edhe komunistë të mirë. Pavarësisht se Tito dhe të tijtë shpreheshin të kënaqur me zhvillimin e ngjarjeve në Hungari dhe do të bënin çmos që qeveria e Janosh Kadarit ti kapërcente shpejt vështirësitë, përsëri ata nuk ishin dakort që Imre Nagi dhe grupi i tij të dorëzohej qeverisë revolucionare hungareze. Tito e quante këtë një mosmbajtje të fjalës nga ana e tyre, pra ai nuk pranonte të tradhëtonte besimin e Imre Nagit dhe grupit të tij (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 58, AQSH).

Me 6 nëntor të 1956-ës Hrushovi i përgjigjej Titos se telegrami i fundit i dërguar nga ata mbi pikëpamjet për Imre Nagin i kishte hidheruar. Hrushovi dukej i zhgënjyer dhe i prerë në besë. Siç shkruante edhe vetë, ai kujtonte se kishin gjetur një gjuhë të përbashkët për Imre Nagin dhe për ato që ai kishte bërë dhe i kujton Titos fjalët e tij

“Çfarë komunistësh janë ata që vrasin dhe torturojnë komunistët në Hungari” (1956, MPKBS, D.19, fq.59, AQSH). Hrushovi i shkruante Titos se në këto kushte nuk kishte asnjë garanci për të mbajtur marrëdhëniet me Imre Nagin. Ai shprehej i habitur se përse Imre Nagi duhet të strehohej në ambasadën jugosllave. Madje Hrushovi shkonte edhe më larg kur thoshte se për ta do të ishte më mirë nëse Nagi do të strehohej në ambasadën amerikane.

".... asnjë njeri që respekton qeverinë e vet nuk mund të durojë që Imre Nagi, i cili i hapi rrugën reaksionit në Hungari të dërgohet në një vend mik fqinj. Ky fakt mbulon me mjegull Jugosllavinë dhe do të bëjë që të komplikohet çështja e saj në lidhje me marrëdhëniet jugosllave karshi qeverisë revolucionare hungareze..." (1956, MPKBS, D.19, fq.59, AQSH) Hrushovi e konkludonte me mendimin unanim të presidiumit të komitetit qëndror të partisë

komuniste të Bashkimit Sovjetik se Imre Nagi dhe grupi i tij duhet ti dorëzohej qeverisë revolucionare hungareze dhe paralajmëronte se dërgimi i Nagit në Jugosllavi do të sillte mosmarrëveshje mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 60, AQSH).

8 Nëntori i 1956-ës, Tito i shkruante një letër të gjatë Hrushovit. Në këtë letër Tito shpjegonte arsyet e qëndrimit të Jugosllavisë ndaj ngjarjeve në Hungari dhe përse Nagi u strehua në ambasadën jugosllave. Sipas tij në datën 2 Nëntor, Santos në emrin e të gjithë grupit të Nagit filloi bisedimet për ti lejuar që të hynin në ambasadën jugosllave në Budapest për të shpëtuar nga bandat e kundër revolucionit. Marrëshalli tregonte se ata dhanë pëlqimin e tyre për këtë kërkesë duke pasur parasysh se ata nuk do të vinin menjëherë në ambasadë (1956, MPKBS, F. 14, D. 19. fq. 61, AQSH).

Por pasi në 4 nëntor filluan operacionet e ushtrisë sovjetike në Budapest, Nagi me shokë dhe me familjet e tyre në mëngjes herët u dukën në ambasadën jugosllave duke shfrytëzuar për këtë qëllim fjalën e dhënë më parë. Tito justifikojë me fjalët se ata tashmë ishin në një pozicion mjaft të vështirë që duhej zgjidhur. Ai i kërkonte Hrushovit vëmendje në situatën e tyre. Duke u nisur nga kushtetuta jugosllave dhe nga e drejta ndërkombëtare ai shkruante se nuk mund të mos e mbante fjalën e dhënë dhe tua dorëzonte këta njerëz, pushtetit hungarez.

“.... kjo çështje duhet zgjidhur në mënyrë të tillë që të mos i sjellë dëm as marrëdhënieve tona me vendet e ndryshme as Bashkimit Sovjetik, as zhvillimit të socializmit në Hungari. Ne besojmë se ju do të përpiqeni të gjeni një zgjidhje tjetër të kësaj çështje”(1956, MPKBS, F. 14, D. 19. fq. 61, AQSH).

Në një kohë të shkurtër erdhi përgjigjia e Hrushovit më datë 9 nëntor 1956. Lideri sovjetik i kishte mirëkuptuar argumentet e parashtruara më parë nga Tito. Madje madje ishte dakort edhe të propozonte një plan për rrugëdalje nga kjo situatë. Ai propozonte që Imre Nagi dhe grupi i tij të bënte një deklaratë drejtuar qeverisë së Kadarit për çështjen që ata viheshin në dispozicion të qeverisë dhe të kërkonin prej saj lejen për të shkuar në Rumani dhe të deklaronin se ata nuk do të bënin asgjë të keqe , se nuk do të dëmtonin çështjen e forcimit të qeverisë revolucionare punëtore - fshatare të Hungarisë . Sipas Hrushovit vajtja e Imre Nagit

në Hungari nuk do ti sillte dëme askujt dhe askujt nuk do ti ulte prestigjin. Ai mendonte se qeveria hungareze dhe Kadari do të ishte dakort me këtë. Në këto kushte kjo ishte e vetmja rrugëdalje e mundshme e rëndësishme e cila duhet të realizohej sa më shpejt (1956, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 64, AQSH).

Viti 1956 shënoi një tjetër ftohje të marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Gjë që i interesonte Enver Hoxhës. Në një letër dërguar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik më dt. 3 dhjetor 1956 Josip Broz Tito konstatonte se marrëdhëniet mes partive të të dy vendeve ishin përkeqësuar në një farë mase. Tito në letrën e tij prekte një sërë problemesh dhe ngjarjesh të cilat krijuan një lloj hendeku mes të dy vendeve. Përgjigjia e kësaj letre nga Bashkimi Sovjetik erdhi pak kohë më vonë. Ata binin dakort se marrëdhëniet ishin përkeqësuar dhe madje argumentonin disa momente që kishin ndikuar në këtë përkeqësim (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 23, AQSH).

Marrëshalli Tito në një fjalim të mbajtur në një takim të partisë komuniste jugosllave mbajtur në Pula deklaronte se kishte një divergjencë opinionesh në gjirin e lidërshipt sovjetik mes stalinistëve në njërin anë dhe avokatëve të demokratizimit në krahun tjetër, ndërkohë që mbronte njëkohësisht edhe pozicionin e Jugosllavisë përballë ngjarjeve në Hungari (Pearson, O. 2006: 513).

Ne këtë klimë të trazuar mes Bashkimit Sovjetik dhe Juosllavisë, Enver Hoxha nxiton të botojë një artikull 8 nëntor tek gazeta sovjetike "Pravda" ku sulmonte rëndë Titon duke e quajtur atë injorant, dogmatist dhe oponent të demokracisë. Kjo e acaroi shumë Marrëshallin Tito i cili në përgjigjen ndaj Hoxhës nuk harroi ta quante atë një marksist të ngelur në tentativë, i cili dinte vetëm të thoshte fjalët marksizëm - leninizëm dhe asgjë më shumë se kaq. Ai e quante Enver Hoxhën një stalinist, i cili jo vetëm sulmonte Jugosllavinë, por dilte hapur edhe kundër ideve dhe veprimeve të lidërshipt aktual sovjetik dhe Hrushovit me shokë (Pearson, O. 2006: 513) . Sovjetikët ishin te pakënaqur, se si disa çështje që deri në atë kohë mbaheshin në nivel konfidencial, ishin bërë temë për një fjalim publik madje dhe pozicioni i Bashkimit të Komunistëve Jugosllavë në këtë fjalim binte ndesh sipas sovjetikëve me ato që delegacionet respektive kishin rënë dakort më parë në takimet e tyre. Ajo që i shqetesonte

ata ishte ringritja e çështjeve të cilat kishin marrë zgjidhje, si çështje ende të debatueshme në këtë fjalim të mbajtur nga Tito në Pula e më pas edhe në fjalimin e Kardelit në 7 dhjetor në Skupçino. Për sovjetikët kjo ishte e pajustificueshme. Të indinjuar, këta të fundit, e quanin pa vend që jugosllavët para gjithë botës nisën të diskutonin çështje për të cilat kishin biseduar më parë si një parti komuniste me një parti tjetër komuniste. Sipas sovjetikëve, jugosllavët filluan të shtronin krejt ndryshe çështje për të cilat ishte rënë dakort më parë, siç ishte çështja e ushtrisë sovjetike në Hungari, çështja e mbështetjes së qeverisë revolucionare punëtore e fshatare me Kadarin në krye, çështja e Imre Nagit, etj (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 24, AQSH)

Hrushovi ngrinte dyshime rreth pozicionit të Titos në gjithë ngjarjet e Hungarisë duke e lidhur këtë me këmbënguljen e tij për të mos e dorëzuar Nagin dhe grupin e tij. Përshtypja e udhëheqësit sovjetik ishte, se edhe më parë shtypi jugosllav ndriçonte rendin e brendshëm të Hungarisë në mënyrë që në fakt mblshteste ato forca në Hungari që u bënë më vonë udhëheqësit e reaksionit.

“ I tërë zhvillimi i ngjarjeve hungareze tregoi në mënyrë të qartë se kryengritja e kundër-revolucionit në Hungari nuk ishte tjetër përveç se një orvatje e reaksionit imperialist për të shfrytëzuar situatën e krijuar në këtë vend nga gabimet e rënda të udhëheqjes së mëparshme të Hungarisë, për të realizuar planin minues të menduar dhe të përgatitur me kujdes prej kohësh kundër kampit socialist nën flamurin e të ashtuquajturës çlirimi i “Evropës lindore”(1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 26,AQSH).

Përveç ngjarjeve në Hungari, mosmarrëveshjet e reja mes dy vendeve të kampit socialist u shtrinë edhe më tej. Si për shembull, mbi sistemin socialist sovjetik.

Sipas jugosllavëve ky sistem kishte lindur kultin e individit. Por Hrushovi mendonte se kjo ishte e pavërtetë. Sipas tij kulti i individit ishte në kontradiktë të thellë me natyrën e rendit socialist dhe për këtë Partia Komuniste e BS-së bëri luftë kundër tij duke u mbështetur në bazë të sistemit socialist sovjetik.

Sovjetikët tregoheshin të ashpër në këtë rast edhe kundër kritikës jugosllave kundrejt disa partive komuniste. Në fjalimin e tij në Pula, Tito u bëri kritikë disa anëve të politikës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si dhe të partive të tjera komuniste. Hrushovi gjykonte se këto ishin minuta shumë të këndshme për armiqtë e komunizmit, kur përpara të gjithë botës udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të partive të tjera komuniste u ndanë në “stalinistë” dhe “jo stalinistë” (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 29, AQSH).

Hrushovi ishte i bindur se fjalimi i Titos në Pula i kishte shkaktuar dëm kauzës së socializmit, lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare dhe marrëdhënieve sovieto - jugosllave (1956, MPKBS, F.14, D. 16, fq.31, AQSH).

Por në këto marrëdhënie të trazuara nuk mbetën pa u diskutuar edhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe pozitat e saj. Në një komunikim telegrafik dërguar nga Tito drejt Moskës në 3 dhjetor të vitit 1956 thuhej se ekzistonte një dokument i Partisë së Punës së Shqipërisë me direktiva të tilla, të cilat i dëmtonin marrëdhëniet mes të dy vendeve dhe nuk kontribuonin në përmirësimin e tyre. Hrushovi pranonte se kishte marrë inisiativën që t'ua përcillte këtë vërejtje edhe shqiptarëve. Por në këtë kohë erdhi një reagim nga Enver Hoxha i cili mohonte kategorikisht ekzistencën e një dokumenti të tillë dhe aq më tepër dërgimin e tij në drejtim të Beogradit dhe udhëheqjes së tij. Për më tepër Hoxha deklaronte se ky dokumet ishte i falsifikuar i fabrikuar prej ndonjë armiku të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë. Hrushovi shprehej se asnjëherë nuk e kishte këshilluar Enver Hoxhën (dhe më konkretisht gjatë ndalimit të tij në Moskë pas kthimit nga Kina) apo ti kishte dhënë atij rekomandime që kishin për qëllim përkeqësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë.

Në fund të letrës Hrushovi shkruante : “ Nuk mund të mos më terhiqet vëmendja gjithashtu edhe nga njoftimet e shtypit perëndimor mbi ndihmën ushtarake amerikane që do të vazhdojë për Jugosllavinë...” (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 3, AQSH).

Pas letrës së 10 janarit 1957 dërguar nga Hrushovi, vjen edhe përgjigjia e Bashkimit të Komunistëve Jugosllavë drejtuar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Që në rreshtat e parë shprehet keqardhja për ato që mendonin sovjetikët. Përgjigjia

jugosllave në pjesën më të madhe kishte lidhje me ngjarjet në Hungari, të cilat u bënë sërish shkak për mosmarrëveshjet e reja midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Por përgjigjia jugosllave ishte më e gjatë se kaq dhe më komplekse. Tito pretendonte se ndaj Jugosllavisë po sajoheshin gjëra që nuk qëndronin, madje thksonte se po përdreshin metoda kundër Jugosllavisë si në vitin 1948. Ai përmendte në letër edhe disa ngjarje të ndodhura në Shqipëri. Si p.sh dëbimi i disa nëpunësve dhe pushkatimi i komunistëve si spiunë jugosllavë.

" Pushkatohej njerëz të pafajshëm, të cilet nuk kanë qënë dakort me një politikë të tillë kundërt Jugosllavisë, sikundër politika që po ndjekin udhëheqësit shqiptarë që nga viti 1948, ju kujtojmë se megjithëse ata janë pushkatuar si "spiunë jugosllavë" ne nuk kemi asnjë lidhje me ta" (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 105, AQSH)

Sipas Titos duke filluar nga korriku 1956 kursi në lidhje me Jugosllavinë po ndryshonte dhe pastaj vinin një varg ngjarjesh, të cilat sipas jugosllavëve kishin influencuar mbi sovjetikët në një farë mënyre që ata të ktheheshin në pozitë të vjetra. Tito shkonte edhe më larg kur akuzonte Hrushovin se kishte hequr dorë nga esenca e kongresit të XX-të. Për të ilustruar këtë fakt ai merr si shembull dollinë e Nikita Hrushovit ngritur në pritjen e dhënë në ambasadën e Republikës Popullore të Kinës në Moskë më 17 janar të vitit 1957, në lidhje me 3qëndrimin e Çu En – Laj-it (1956, F. 14, D. 16, fq. 107, AQSH). Ashtu siç Jugosllavia perbente një problem të vjetër në marrëdhëniet me Shqipësinë dhe Bashkimit Sovjetik, edhe Shqipëria ishte herë pas herë molle shërri me Titos dhe Hrushovit. Tito i tërhiqte vëmendjen Hrushovit se qeveria e shqiptare kishte vazhduar veprimtarinë e saj zbuluese kundër Jugosllavisë sikur asgjë të mos kishte ndryshuar që nga viti 1948. Sipas tij kjo veprimtari zhvillohej edhe në ambasadën shqiptare në Beograd. Sipas jugosllavëve vetëm gjatë vitit 1956 organet e tyre kishin zbuluar 20 agjentë të qendrës së zbulimit të ambasadës. Edhe gjatë vitit 1955 u diktuan 6 grupe të hedhura nga Shqipëria në Jugosllavi për veprimtari zbulimi.

" ...Autoritetet shqiptare me vite të tëra përpiqen të ngjallin ndjenja antijugosllave ndërmjet pakicës kombëtare shqiptare në Kosovë e Metohi dhe në Republikën Popullore të Maqedonisë..." (1956, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 111, AQSH).

Sipas Titos në zhvillimin e propagandës kundër Jugosllavisë, Shqipëria zë një vend të veçantë. "Ne na duket", thotë Tito, "se në "Pravda" nuk u botua rastësisht artikulli i Enver Hoxhës dhe nuk është i rastësishëm fakti që Shqipëria luan një rol kaq aktiv si në fushatën e kaluar antijugosllave ashtu edhe në fushatën e tanishme" (1956, MPKBS F. 14, D. 16, fq. 112, AQSH).

Në këtë mënyrë ai aludon se Hoxha merrte bekimin e Moskës për lëvizjet e tij antijugosllave. Në një dokument të gjetur në arkivat shtetërore ruse, janë zbuluar shënime të zëvendës shefit të seksionit të komitetit qendror të partisë komuniste për Ukrainën në komitetin qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, Vinogradov, mbi shkaqet e keqësimit të marrëdhënieve shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në këto shënime përmendet ambasadori i Bashkimit Sovjetik në atë kohë në Tiranë Krillovi i cili i raportonte shokëve sovjetikë se shqiptarët kishin bërë një punë të madhe për demaskimin e pikëpamjeve antimarksiste të udhëheqjes jugosllave. Megjithatë sipas tij kohët e fundit fjalimet e shpeshta të udhëheqësve shqiptarë për çështjen jugosllave kishin marrë një karakter tepër të ashpër dhe përmbanin sulme personale, kundër personaliteteve të rëndësishme jugosllave. Sipas Krrillovit kjo ishte edhe arsyeja e acarimit të marrëdhënieve shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë (Kaba, H. Çeku, R. 2011: 167). Sekretari jugosllav i shtetit Popoviç në fjalimin e botuar në gazetën " Borba" të 27 shkurtit të vitit 1957 deklaronte : "... të krijohet përshtypja se udhëheqja e tanishme shqiptare për shkaqe të veçanta ecën drejt prishjes së marrëdhënieve shtetërore me Jugosllavinë" (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 167). Në dokument thuhet se ambasada sovjetike propozonte një bisedë me përfaqësues të nivelit të lartë të udhëheqjes shqiptare, në lidhje me forcimin e mëtejshëm të polemikës me jugosllavët dhe madje propozonte të këshilloheshin me ta që të tregoheshin të kujdesshëm dhe të duruar për këtë çështje. Në mbledhjen e 4 prillit 1957 në restorantin e hotel "Dajtit" u bë një pritje e madhe e organizuar nga ambasada e Republikës Popullore të Hungarisë, me rastin e festës kombëtare, ditën e çlirimit të Hungarisë nga ushtria sovjetike. Në këtë pritje foli zv.kryeministri i dytë i shtetit shqiptar Hysni Kapo si dhe ambasadori i Hungarisë në Tiranë në atë kohë Zhad Kullak. Në pritje kishte edhe shumë drejtues të tjerë të qeverisë shqiptare dhe Partisë së Punës së Shqipërisë. Në pritje ishin të pranishëm edhe përfaqësues të trupit

diplomatik të vendeve të kampit socialist. Mes tyre edhe përfaqësues të ambasadës jugosllave në Tiranë (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 167).

Në raportin e Enver Hoxhës " Mbi gjëndjen ndërkombëtare dhe detyrat e partisë" mbajtur në pleniumin e III të PPSH-së, më 13 shkurt 1957, shkruhej :

".... Udhëheqësit jugosllavë nuk janë të larë lidhur me kundër-revolucionin hungarez, por përkundrazi kanë përgjegjësi të madhe, për zhvillimin e ngjarjeve në Hungari..." (1957, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 50, AQSH).

Pra Enver Hoxha sulmonte ashpër jugosllavët për ngjarjet e fundit në Hungari. Udhëheqja shqiptare nuk e ulte në asnjë moment gatishmërinë për të kuptuar, nuhatur dhe lexuar mes rreshtave. Në një telegram të Mihal Priftit nga Moska, që mban datën 21 shkurt 1957 flitej për një takim me delegacionin bullgar. Ambasadori bullgar Lisakov kishte lexuar raportin e Hoxhës dhe vazhdimisht qeshte teksa i tregonte Mihalit për të. Kjo gjë nuk i kishte rënë në sy për mirë përfaqësuesit të shteti shqiptar.

"E pyeta çfarë i pëlqen. Nuk mu përgjigj, por duke qeshur thoshte "malladjec Enveri", e përsëriti disa herë këtë shprehje. Unë e pyeta përsëri për domethënien dhe më tha, i ashpër (1957, drejtorja e pare, B.S. D.40, fl. 1, AMPJ). Ndërkohë përgjigjia e Mihal Priftit ndaj reagimit të Lisakovit ishte e prerë. Sic thotë dhe vetë në telegram ai u përgjigj :

" Asgjë të tepërt, dhe të gjitha të vërteta, nuk është kështu ?"(1957, B. S. D. 40, fl.2 , AMPJ)

Raporti i Hoxhës analizonte një sërë çështjesh, ngjarjet kundër revolucionare në Hungari e në Poloni, unitetin e kampit socialist, luftën ideologjike për mbrojtjen e marksizëm – leninizmit etj. Si përfundim, Hoxha ishte i bindur se Jugosllavia abuzonte me tezat e kongresit të XX-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi kultin e individit. Sulmi i udhëheqjes shqiptare nuk i drejtohej vetëm Jugosllavisë, por nëpërmjet saj mbërrinte deri tek Hrushovi.

Në një telegram dërguar Behar Shtyllës ministrit të punëve të jashtme të RPSH-së në atë kohë nga Mihal Prifti ambasadori shqiptar në Moskë që mban datën 22 shkurt 1957 thuhet se ky i

fundit kishte takuar I.K.Zamçevskin, ambasadorin sovjetik ne Jugosllavi në atë kohë dhe kishte biseduar me të rreth pleniumit dhe marrëdhënieve me Jugosllavinë. Sipas Mihal Priftit, Zamçevski ishte shumë i kënaqur nga qëndrimi i PPSH-së ndaj Jugosllavisë. Ndër të tjera Zamçevski kishte thënë : " Ka ardhur koha që në marrëdhëniet tona me Jugosllavinë duhet të mbajmë qëndrime analoge dhe reciproke. Na bëjnë mirë dhe do t'iu bëjnë mirë dhe juve. Në rast se na godasin me njërën dorë nuk duhet ti lejojmë të zgjatin tjetrën. Ne sillemi akoma bujarisht me ta . Po të marrim parasysh se çfarë kanë bërë ata në Hungari dhe çfarë po bëjnë kundër jush e kundër nesh, ata janë armiq të kampit tonë. Prandaj dhe cdo veprimi të tyre duhet tu përgjigjemi" (1957, B.S. D. 41, fl. 3-4 AMPJ)

Ndër të tjera në telegram Prifti theksonte fjalët e Zamçevskit për zhvillimet në Jugosllavi. Sipas tij diplomati sovjetik i kishte thënë se në udhëheqjen jugosllave midis Edvard Kardeljit dhe Aleksandar Rankoviçit kishte filluar një luftë për pushtet. Kohët e fundit Titoja gjithmonë e më tepër me pretekstin se doktorët nuk e lejonin të punonte shumë po largohet nga drejtimi i çështjeve shtetërore. Kardeljin e cilësonte si një person që ishte për bashkëpunimin me social - demokratët e internacionales së dytë, për rivendosjen e kapitalizmit. Rankoviçin si një person që anonte më shumë nga bashkëpunimi me kampin komunist por asgjë konkrete nuk dinte për të (1957, B. S. D. 41, fl. 5, AMPJ).

" Gjithësesi duam që delegacionit tuaj, lidhur edhe me marrëdhëniet me Jugosllavinë t'i bëjmë një nga pritjet më të mira dhe më të ngrohta" e mbyll bisedën me Mihal Priftin ambasadori sovjetik në Jugosllavi. (1957, B.S, D. 41, fl. 7, AMPJ)

Më 6 mars të vitit 1957 Mihal Prifti I shkruan Behar Shtyllës se Mihail Suslovi (anëtar i byrosë politike të PK-së së BS-së), kur e kishte pyetur në një pritje të organizuar nga Andrei Gromiko (anëtar i byrosë politike të PK-së së BS-së) për ministrin e jashtëm polak, ai i kishte thënë se pleniumi nuk kishte shkuar keq me aq sa kishte lexuar të botuar tek "Pravda" (1957, B.S. D. 41, fl. 10-11, AMPJ).

Pas deklaratave të Enver Hoxhës në pleniumin e tretë të PPSH-së, u rikthye tensioni mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe rrjedhimisht edhe mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Në prill të 1957-ës Hrushovi e kritikoi Hoxhën për qëndrimin ndaj Jugosllavisë, pavarësisht

se marrëdhëniet e Moskës zyrtare me Beogradin nuk shkonin dhe aq mirë. Ai i kërkoi Hoxhës të përmirësonte menjëherë marrëdhëniet me Jugosllavinë. Hrushovi madje organizoi në Moskë një takim të Enver Hoxhës me ambasadorin Jugosllav atje Veljko Mićunović, por pa asnjë rezultat sepse marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë vazhduan të përkeqësohen (Akademia e shkencave të Shqipërisë, 2009: 257).

Në pritjen që dha ambasadori hungarez, ku i pranishëm ishte edhe Mihal Prifti, në një takim me Mollotovin në atë kohë zv. kryeministër i BS-së dhe ambasadorë të tjerë, atë të Bullgarisë, Kinës dhe Çekosllovakisë, ky I fundit fliste gjithë pasion për mbërritjen e delegacionit shqiptar në Moskë. Ai duke e ngritur zërin u thoshte të pranishmëve se po përgatiteshin me të gjitha mënyrat të prisnin "bojevju"(luftetar) delegacionin luftëtar shqiptar. "...Përgatituni edhe juve", bërtiste me hare duke iu drejtuar të tjerëve Mollotovi (1957, B.S, D. 41, fl.12, AMPJ).

Spartak Ngjela , kujton se vera e vitit 1957 ishte një vere e nxehtë dhe me shumë zhvillime. Ndër të tjera ai shkruan se gjatë këtij viti Hrushovi e kishte ndryshuar qëndrimin kundrejt Hoxhës. Ngjela rrëfen se në atë kohë si pasojë e ndryshimit të kursit politik të Moskës , ndihej dhe kuptohej një afrim i madh i udhëheqjes shqiptare me vendet e Bashkimit Sovjetik, në një kohë që marrëdhëniet e Kremlinit me Enver Hoxhën ishin gjithnjë e më të ftohta (Ngjela, S. 2011: 209).

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, delegacioni shqiptar vizitoi në prill të 1957-ës disa qytete të Bashkimit Sovjetik, ku u prit me mitingje dhe ku u mbajtën fjalime për luftën, miqësinë mes popujve, mirënjohjen dhe bashkëpunimin brenda kampit socialist (1957, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 1, AQSH).

Në 5 prill, delegacioni i udhëhequr nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, u nis nga porti i Durrësit. Ata ishin ftuar në Moskë nga komiteti qëndror i partisë komuniste sovjetike për të zhvilluar bisedime rreth divergjencave në opinione që kishin pasur mes tyre kohët e fundit. Anëtarët e tjerë të delegacionit ishin : Ramiz Alia, Spiro Koleka, Rita Marko, Gogo Nushi, Behar Shtylla dhe Xhafer Spahiu (Pearson, O. 2006: 523).

Shqetësimi kryesor i Nikita Hrushovit ishte të sillte një erë të re pajtimi në marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë. Mendimet e tij ai i shpalli hapur në një fjalim publik duke u marrë më shumë me qëndrimin e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Duke analizuar fjalimin e Hrushovit në pritjen ndaj delegacionit shqiptar, ambasadori i Britanisë së Madhe në Moskë, Sir Patrick Reilly nënvizonte se kishte një kritikë të nënkuptuar për papajtueshmërinë shqiptare kur Hrushovi nxorri në pah që Shqipëria ishte në kushte më të këqia me Jugosllavinë krahasuar me pozitën e Bashkimit Sovjetik ndaj kësaj të fundit. " Ishte evidente se liderët sovjetikë, nuk ishin aspak në ankth ta identifikonin veten me armiqësinë shqiptare kundër Jugosllavisë. Madje ata mund edhe ti kishin inkurajuar shqiptarët të ishin në një linjë me ta në politikën e ndjekur ndaj Jugosllavisë" (Pearson, O. 2006: 523) Në një nga fjalimet e tij drejtuar Hrushovit, Bullganinit (anetar i byrose politike të PK-së së BS-së) etj, mbajtur në Kremlin në 16 prill 1957, Enver Hoxha i përlur, falënderon vazhdimisht për ndjenjat e kulluara dhe të sinqerta Bashkimit Sovjetik. "Kur të kthehem në Shqipëri ne do t'ua tregojmë të gjithë vëllezërve tanë këtë", vazhdon Hoxha më tej. " Besnikeria ndaj mikut, thotë ai, është një nga parimet më të larta të traditave fisnike që populli ynë ka ruajtur si gjëra të shenjta gjatë shekujve " (1957, B.S, D. 43, fl 48,AMPJ).

Ky ishte dhe fjalimi i fundit i mbajtur në Moskë gjatë vizitës së delegacionit shqiptar pasi kishte ardhur fundi i udhëtimit dhe Enver Hoxha ishte më i lumtur se kurrë nga pritja e bërë. Ndër të tjera në fjalimin e mbajtur në Kremlin, Hoxha nuk harroi të përmendë kongresin e XX-të. Ai tha: "Partia jonë është me këtë kongres, me këtë frymë, me këtë interpretim, dhe do të jetë në kundërshtim të papajtueshëm me antimarksistët, dhe revizionistët, që gjoja me fjalë janë me kongresin e XX-të, por me vepra janë kundër tij"(1957, B.S, D. 43, fl. 69, AMPJ)

Rezultatet e vizitës së prillit të delegacionit shqiptar në Moskë u dukën të kënaqshme. Në një deklaratë të përbashkët sovjeta - shqiptare thuhej se prej datës 1 deri më 17 prill 1957 me ftesën e qeverisë së Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, kishte qenë në Moskë delegacioni qeveritar i Republikës Popullore Shqiptare me të cilin u zhvilluan bisedime në shumë fusha dhe ndër të tjera : “u konstatua se qeveritë e tyre ishin unanime në vlerësimin

e gjendjes ndërkombëtare dhe në kuptimin e rrugëve të forcimit të mëtejshëm të solidaritetit dhe bashkëpunimit midis shteteve socialiste..”(1957, B.S, D. 43, fl. 72 - 73, AMPJ)

Në një intervistë dhënë " Radio Moskës " nga kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë Mehmet Shehu, i pyetur çfarë ishte e domosdoshme sipas mendimit të tij për përmirësimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me fqinjët e saj, Shehu përgjigjej se qeveria shqiptare duke ndjekur politikën e saj konseguente e paqësore i kishte kushtuar një kujdes të veçantë marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë të mbështetura në parimet e barazisë, të respektit dhe të interesit reciprok dhe të mos ndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit.

Ndër të tjera në intervistë Shehu deklaroi kohët e fundit ishin dukur disa shenja të ashpërsimit në marrëdhëniet midis republikës popullore të Shqipërisë dhe republikës federative popullore të Jugosllavisë. “ ..Por qeveria e Shqipërisë kishte bërë dhe do të bënte cdo gjë që varej prej saj në mënyrë që jo vetëm të mos keqësoheshin marrëdhëniet midis të dy vendeve por të përmirësoheshin..” (1957, B.S, D. 43, fl.135,136, AMPJ).

Pavarësisht përpjekjeve të Hrushovit dhe sovjetikëve për të ulur tonet e Enver Hoxhës ndaj Jugosllavisë, përsëri marrëdhëniet, ato pak që ekzistonin, mes Tiranës dhe Beogradit kishin mjaft tension. Kështu në faqet e ditarit të të ngarkuarit me punë të përkohshme të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri Hoshev është gjetur e zbardhur edhe një bisedë e tij me zv.kryetarin e parë të këshillit të ministrave Beqir Ballukun lidhur me veprimtarinë anti-shqiptare të misionit jugosllav në Shqipëri si dhe ftesën e marreshallit Zhukov për të ardhur në Shqipëri. Në këtë bisedë duket se Balluku i ka treguar Hoshevit se pas dëbimit nga vendi të sekretarit të parë të misionit jugosllav Vuçiç , i cili ishte rezidenti kryesor i Jugosllavisë në Shqipëri, këto funksione i kaluan të dërguarit Arso Milatoviç. Sipas Ballukut edhe Milatoviçi u tregua shumë aktiv në punë dhe madje bënte hapur propagandë anti shqiptare. Madje Balluku shkon edhe më tej kur thotë se Milatoviçi takohej shpesh me ambasadorin polak Pshenioslo dhe shfrytëzonte atë gjerësisht si dhe bënte përpjekje për t'i shfrytëzuar çekët për interesat e tij (Kaba, H. Çeku, R. 2011: 169).

I dërguari me punë të përkohshme i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri Hoshevi dhe Beqir Balluku folën në këtë takim edhe për vizitën e marrëshallit Zhukov në Shqipëri. Balluku i propozoi Hoshevit që periudha më e përshtatshme për këtë vizitë do të ishte në pranverë - verën e atij viti shoqëruar me një skuadrije ushtarake sovjetike e cila presupozohej të bënte vizitë miqësore në portet shqiptare (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 169).

Në një telegram dërguar Behar Shtyllës ministrit të punëve të jashtme, nga zyra jonë në Moskë dhe që mban datën 27 qershor 1957, shkruhej se zyrtarët sovjetikë shohin nga ana e jugosllavëve karshi tyre si dhe karshi vendeve të tjera një ndryshim që konsiston në një sjellje të urtë e të mirë të jugosllavëve karshi sovjetikëve qoftë në Beograd dhe në Moskë, në uljen tensionit në shtypin e tyre që u duk sidomos në rastin e përvjetorit të nënshkrimit të materialeve të Moskës. Jugosllavët po përpiqeshin të fitonin sërish zemrat e sovjetikëve, të paktën kështu po mendonin këta të fundit dhe siç dukej nuk donin kurrësesi që të rifillohej një diskutim për çështje ideologjike(1957, B.S. D. 46, fl. 49, 50, AMPJ).

Këto biseda ishin zhvilluar mes Mihal Priftit dhe një zyrtari sovjetik te ministrisë së jashtme të quajtur Dedushkin I cili me vonë shërbeu edhe si ambasador i BS-së në Liban. Ky i fundit i kishte thënë se jugosllavët nga sa duket ishin duke ndryshuar qëndrim karshi kampit dhe duhet të ndryshonin sepse shikonin që nuk ju shkonte ndryshe. Përsa i përket fjalëve të përhapura se do të mund të vinin ushtarakë jugosllavë për të studiuar në Moskë, Dedushkini nuk e konfirmoi këtë gjë (1957, B.S. D. 46, fl. 49, 50, AMPJ).

Më 18 korrik 1958, u njoftua zyrtarisht nga agjensia e lajmeve TASS se dy zv. presidentët dhe dy nga njerëzit më të afërt të Titos, Edvard Kardel dhe Aleksandar Rankoviç, zhvilluan një takim mjaft miqësor me liderët e Shqipërisë dhe Bullgarisë Enver Hoxha dhe Todor Zhivkov, në praninë e Hrushovit dhe anëtarëve të tjerë të presidiumit të partisë komuniste sovjetike në një shtëpi fshati në afërsi të Moskës. Kjo ishte hera e parë pas prishjes së kominformit që zyrtarë kaq të lartë jugosllavë pranonin të kishin kontakte të drejtpërdrejta me Enver Hoxhën. U deklarua se takimi u zhvillua në një klimë mjaft të ngrohtë por koha tregoi se edhe kjo përpjekje e Hrushovit për të pajtuar Enver Hoxhën me jugosllavët nuk doli e suksesshme dhe jetë gjatë (Pearson. O. 2006: 527).

Në një telegram të nisur nga Moska drejt Tiranës, më 18 korrik 1957, Enver Hoxha shkruante se ai, Nexhmija dhe Mihali u ftuan në një darkë nga Hrushovi. Në këtë darkë përveç anëtarëve të presidiumit ishte edhe Zhivkovi me bashkëshorten dhe Kardeli me Rankoviçin me gratë e tyre.

"Në dollitë që ngriti shoku Hrushov", shkruan Hoxha, "për miqësinë mes vendeve tona dhe Jugosllavisë, duhet të forcohet miqësia ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Jugosllavisë dhe midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, Bullgarisë e Jugosllavisë si dhe midis vendeve të tjera socialiste në baza marksiste - leniniste"(1957, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 2, AQSH). Hoxha theksonte fjalët e Hrushovit në këtë darkë se, miqësitë janë prishur, janë ndrequr e prap janë prishur. "...Por tani", thoshte Hrushovi në darkën e organizuar, "janë të gjitha konditat objektive dhe subjektive që të përmirësohen".

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë sipas Hrushovit dhe kësaj të fundit me Bullgarinë nuk ishin përmirësuar. Prandaj ai kishte porositur Kardelin dhe Rankoviçin që jugosllavët të ndalnin ndaj këtyre vendeve veprimtarinë agjenturore e cila nuk ishte e lejueshme midis vendeve socialiste dhe kjo mund të shkaktonte ashpërsimin e marrëdhënieve (1957, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 2, AQSH).

Në këtë takim u pranua se me Jugosllavinë ka akoma mosmarrëveshje që po të vazhdonin mund të krijojnë situata të rënda dhe për këtë do të mjaftonte një shkrepse. (1957, MPKBS, F.14, D. 19, fl. 3, AQSH).

Në telegramin tepër sekret të dërguar nga Moska, Enver Hoxha shkruan se përballë këtyre tezave të Hrushovit dhe thirrjes së tij "Poshtë revizionistët", jugosllavët patën një qëndrim të ftohtë dhe dukeshin të tronditur (1957, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 4, AQSH)

Presidiumi i komitetit qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik vendosi ardhjen e Marrëshallit Zhukov në Shqipëri nga data 17 deri 25 tetor 1957, ndërsa më parë Zhukovi do të kalonte nga Beogradi ku do të zhvillonte gjithashtu një vizitë të gjatë 8 ditore nga data 8 tetor deri më datën 16 të këtij muaji. Në një telegram të ministrit të mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik G.K. Zhukov drejtuar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik

mbi ecurine e vizitës dhe bisedimet me udhëheqësit shqiptarë ndër të tjera ai përshkruante vendet ku Marrëshalli ndaloi, takimet me njerëzit etj. Ndër të tjera në këtë telegram tepër sekret dhe jashtë radhe ka edhe konstatime (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 174).

Sipas ministrit sovjetik të mbrojtjes Partia e Punës së Shqipërisë ishte e lidhur ngushtë me popullin dhe gëzonte autoritet e besim të plotë. Ndër të tjera ai shkruante se partia dhe udhëheqja e saj me në krye Enver Hoxhën e kuptonin drejt rëndësinë e miqësisë së popujve të Bashkimit Sovjetik me Shqipërinë dhe të gjithë kampin socialist. Byroja politike e partisë së punës e vlerësonte domosdoshmërinë e përmirësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 174). Përsa I përket ushtrisë shqiptare, Zhukovi thoshte se ajo ishte e aftë për luftë dhe kishte kuadro nga radhët e oficerëve, 100 për qind e të cilëve ishin anëtarë të Partisë së Punës, shumica e të cilëve kishin ndjekur studimet në Bashkimin Sovjetik. Në telegramin sekret Zhukovi rrëfente se pasi pa me hollësi portin e Vlorës, bazën e nëndetësve që ndërtohej atje dhe vijën e mbrojtjes së bregut të detit Adriatik nga toka dhe deti, arriti në konkluzionin mbi domosdoshmërinë e forcimit serioz të mbrojtjes së bregut dhe bregdetit shqiptar e cila nga pikëpamja strategjike ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për të gjithë kampin socialist (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 174).

Marrëshalli Zhukov paralajmëronte në këtë telegram edhe një takim që do të organizonte të nesërmen më 25 tetor në rezidencën e tij për një bisedë speciale me Enver Hoxhën, Mehmet Shehun dhe Beqir Ballukun të cilët sipas tij iu lutën ti ndante me ta vërejtjet e tij.

Ndërkohë që Zhukovi ndodhej në Shqipëri dhe Jugosllavi, në Moskë u mbajt pleniumi i komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik që shqyrtoi “çështjen e Zhukovit” të fabrikuar gjatë kohës së mungesës së tij në Moskë. G. K. Zhukovin e liruan nga posti i ministrit të mbrojtjes dhe e përjashtuan nga radhët e presidiumit të komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 175).

Marrëshalli i Bashkimit Sovjetik G. k. Zhukov mbërriti në Shqipëri në 17 tetor dhe qëndroi deri më 25 tetor. Ai u shoqërua nga disa personalitete ushtarake sovjetike (1957, B.S. D. 43, fl. 9, AMPJ). Më datë 25 tetor të vitit 1957 në godinën e komitetit qendror të partisë Enver

Hoxha zhvilloi me Marrëshallin Zhukov bisedime me kërkesën e tij personale. Në këtë bisedë ishin të pranishëm nga pala shqiptare Mehmet Shehu, Beqir Balluku dhe Hysni Kapo ndërsa nga pala sovjetike përveç marrëshallit ishte i pranishëm edhe ambasadori i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri Ivanov. Përveç vlerësimit të vizitës së ministrit të mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik në Shqipëri si një ngjarje shumë të rëndësishme, Enver Hoxha u ndal më tej në situatën e brendshme të vendit. Ai tha ndër të tjera se shqiptarët gjithmonë e kishin menduar dhe e mendonin se ndihma e Bashkimit Sovjetik ishte një nga faktorët kryesorë në ndërtimin e socializmit. Në një farë mënyre Hoxha po i bënte premtime Zhukovit se do të plotësonte çdo rekomandim dhe çdo vërejtje të sovjetikëve, madje ai i lutej këtij të fundit që ti transmetonte komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik se do të bënin gjithçka për të kryer detyrat që dilnin nga ndihma e përbashkët (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 177).

Në fund Enver Hoxha do të fliste për ushtrinë dhe mbrojtjen e vendit. Në një çast, mes lumit të fjalëve, ai i kërkoi Zhukovit, që ata do të dëshironin në këtë rreth të ngushtë me porosi të qeverisë dhe komitetit qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë të bënin propozimet mbi bazën ushtarake – detare të Vlorës.

“ KQ i PPSH-së i kërkon KQ të PKBS-së dhe qeverisë sovjetike ta kthejmë bazën luftarake detare të Vlorës, në bazën luftarake – detare më të fuqishme, për veprime kundër forcave ushtarake - detare të NATO-s në detin Mesdhe”(Kaba, H. Çeku, E. 2011: 177).Enver Hoxha i kërkoi Zhukovit që të njoftonte komitetin qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik për këtë çështje. Nga ana e tij, përveç falënderimeve, Zhukovi e këshilloi Enver Hoxhën ta diskutonte këtë çështje personalisht me udhëheqësin e komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik kur të ishte në Moskë për festën e tetorit (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 177).

Pas kthimit në Bashkimin Sovjetik, Zhukovi u thirr menjëherë në një takim me drejtuesit më të lartë ku edhe mori vesh se ishte zhveshur nga të gjitha detyrat e tij dhe si ministër i mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik ishte vendosur Marrëshall Rodin Malinovsky. Nuk u dha asnjë shpjegim për arsyet e kësaj lëvizjeje në kupolën sovjetike. Enver Hoxha në kujtimet e

tij me vonë shkruajti : " ...a ka mundësi që informacioni për pikëpamjet e Zhukovit mbi Jugosllavinë arritën tek Hrushovi para se vet Zhukovi të kthehej në Moskë..?"(Pearson, O. 2006:530)

Ndërkohë nga Jugosllavia vinin zëra të një revolucioni që do të ndodhte në Shqipëri. Një artikull i gazetës jugosllave "Borba" më 29 nëntor të vitit 1957 mbante titullin "Shqipëria në prag të revolucionit". Sipas kësaj gazete qendra të revoltës ishin bërë, Tirana, Durrësi, Shkodra dhe Vlora. Rreth 70 njerëz ishin qëlluar në rrugë, nga këta 30 - 40 në Tiranë, gjatë demonstratave kundër qeverisë dhe pro Jugosllavisë ndërsa frika ishte rikthyer në vend. Gazeta raportonte se burgjet ishin mbushur me njerëz që shpreheshin pro Jugosllavisë dhe njerëzit në veri po merrnin malet drejt arratisjes për të shpëtuar dënimeve radikale (Pearson, O. 2006: 515).

KAPITULLI V: 1958 - 1959 vitet e përmirësimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vizita e Nikita Hrushovit në Shqipëri

Në datën 2 dhe 3 Janar 1958 Radio Moska dha lajmin marrë nga Agjensia Telegrafike Shqiptare se forcat shqiptare ajrore kishin kapur një avion anglez me 6 vetë ekuipazh. Ndërkohë në një telegram të të njëjtës datë nisur nga Moska për ministrinë e punëve të jashtme thuhej se këshilltari i ambasadës jugosllave në mbrëmjen e dates 2 janar në pritjen e sudanezëve uroi shqiptarët që e kapën avionin anglez dhe tha se ishte më mirë që nuk e rrëzuan se do të ngrihej tensioni. Gjithashtu kërkoi ta njoftonin çfare u bë me avionin e parë (1958, B.S, D. 50, fl. 1, AMPJ).

Edhe "Pravda" më datë 4 janar botoi shkrimin e ATSH-së mbi shkeljen nga ana e avionit anglez të hapësirës ajrore të Republikës Popullore të Shqipërisë mbi uljen e detyrueshme të këtij avioni (1958, drejtorja e parë, B.S. D. 50, fl 3, 127/2 AMPJ).

Avioni britanik kishte në bordin e tij 5 burra, pjesëtarë të ekuipazhit dhe një stjuardesë. Ai u ul në Vlorë sapo kishte hyrë viti i ri 1958, nga dy avionë luftarakë shqiptarë. Pjestarët e ekuipazhit u mbajtën nga autoritetet shqiptare deri në një vendim të dytë por vendndodhja e tyre u mbajt sekret (Pearson, O. 2006: 536).

Këto zhvillime rritën ankthin tek italianët rreth sigurisë së detit Adriatik. Sipas disa raportimeve të bëra në Romë natën e incidentit me avionin britanik, sipas tyre deti Adriatik ishte shndërruar në një det sovjetik, gjë e cila përbënte një kërcënim ndaj Italisë. Italianët pretendonin se sovjetikët kishin akses në detin Adriatik përmes Shqipërisë ose "satelitet të kamufluar " të Jugosllavisë. Ata pretendonin se bazat raketore sovjetike ishin vendosur tashmë në Shqipëri (Pearson, O. 2006: 536).

Në prill të vitit 1958 Ramiz Alia dhe Hysni Kapo mbërritën në Moskë. Ata u takuan ndër të tjerë me Susllovin, të cilin e falënderuan për kujdesin dhe mundësitë për të marrë eksperiencën e partisë komuniste sovjetike. Por ndihma më e madhe që merrnin shqiptarët nga sovjetikët ishte ajo ekonomike.

Në një telegram të nisur nga Alia dhe Kapo për Enver Hoxhën që mban datën 4 prill 1958 ata thonë se Susllovi u kishte kërkuar të mos e acarinin gjëndjen me Jugosllavinë. Ishte përgjigjur Hysniu duke thënë se megjithëse ata (jugosllavët) punonin kundër, gjithë kohën, përsëri ata (shqiptarët) nuk i kishin bërë çështje (1958, B.S, D. 49, fl.5 - 6, AMPJ).

Gjithësesi atëherë kur u interesonte duket se sovjetikët i mbeshitesnin sulmet shqiptare kundër jugosllavëve. Keshtu në 4 maj " Zëri i Popullit" botonte një artikull mbi revizionizmin jugosllav, artikull i cili u botua menjëherë edhe nga "Pravda" sovjetike më datë 11 maj (1958, B.S. D. 50, fl. 23, AMPJ). Më 26 korrik 1958 në kuadër të dakortësisë me vendimet dhe veprimet e Bashkimit Sovjetik me anë të një deklarate qeveria shqiptare binte dakort dhe aprovonte traktatin e miqësisë dhe bashkëpunimit mes vendeve të Europës me pjesëmarrjen edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu në këtë deklaratë përmenden vuajtjet e Shqipërisë nga luftrat e krijuara nga imperializmi ndërkohë që nuk harrohet të theksohet se qeveria shqiptare është vendosmërisht kundër politikës së fuqive perëndimore. Ky traktat do të çelte udhën për zgjidhje graduale me anë të bisedimeve te problemeve të ndryshme, argumentonte deklarata aprovimin e këtij traktati (1958, B.S, D. 45, fl. 87- 88, AMPJ).

Marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit asnjëherë nuk mundën të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga marrëdhëniet e Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik. Në një letër dërguar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe konkretisht Nikita Hrushovit më datë 14 prill 1958, Enver Hoxha shkruante i entuziazmuar mbi vendimin e marrë nga komiteti qendror i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik në lidhje me mos dërgimin e delegacionit sovjetik në kongresin e shtatë të lidhjes së komunistëve të Jugosllavisë (1958, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.1, AQSH).

" Komiteti qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë, solidarizohet plotësisht me vendimin tuaj mbi këtë çështje. Dhe është plotësisht dakord me vlerësimin marksist - leninist që i bëni projekt - programit të lidhjes së komunistëve të Jugosllavisë"(1958, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.1, AQSH).

Pas kësaj edhe delegacioni shqiptar e refuzoi ftesën gjë që Enver Hoxha e argumenton në këtë mënyrë. "...teksti i këtij projekt - programi ka teza anti - marksiste, revizioniste dhe likuidatore...." Sipas tij në këtë projekt - program likuidohet roli i partisë, i diktaturës së proletariatit, sulmohet sistemi socialist sovjetik dhe ai në vendet e demokracive popullore, nuk reflektohet kontradikta kryesore midis sistemit socialist dhe atij kapitalist, predikohet shuarja e luftës së klasave në etapen aktuale, zbutet dhe gati zhduket rreziku nga ana e imperialistëve, bëhen përcaktime të papranueshme armiqësore në lidhje me politikën paqësore dhe internacionaliste të kampit socialist me në krye Bashkimin Sovjetik etj (1958, MPKBS, F.14, D.6, fl.2, AQSH).

Por çfarë ishte ky projekt program që hidhëroi Bashkimin Sovjetik dhe bëri që Enver Hoxha të ndihej më komod në raport me ta, tani që marrëdhëniet mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë po përjetonin sërish ditë të acarta. Programi i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë shprehte pikëpamjen në lidhje me disa probleme nga më esencialet e lëvizjes së punëtorëve ndërkombëtarë në zhvillimin e socializmit në mbarë botën thuhej në një artikull për këtë projekt - program të botuar në revistën jugosllave " Komunisti " (1958, MPKBS, F.14, D.6, fl.7, AQSH).

Në projekt - program u përfshinë një sërë tezash të përgjithshme marksiste - leniniste. Sipas artikullit këto teza janë në kundërshtim të hapur me teorine dhe praktikën e marksizëm - leninizmit, me praktikën e lëvizjes komuniste botërore, me çështje të veçanta si p.sh mbi zhvillimin e sotëm ndërkombëtar, mbi dy sistemet botërore, mbi çështjet e ndërtimit socialist në vende të ndryshme, mbi shtetin socialist dhe marrëdhëniet reciproke midis vendeve socialiste (1958, MPKBS, F.14, D.6, fl.7, AQSH). Një vend të veçantë zinte edhe çështja rreth kapitalizmit të asaj kohe dhe rrugëve të kalimit në socializëm. Çështja që u quajt më shumë jo marksiste dhe leniniste ishte idea që krahas me transformimin socialist revolucionar, shoqëria socialiste mund të lindte edhe në rrugën revolucionare: "...kjo ide kishte sjellë me vete një seri gjykimesh antishkencore , jo marksiste jo leniniste mbi fenomenet dhe proceset... (1958, MPKBS, F.14, D.6, fl.7, AQSH).

Pas kapjes, burgosjes dhe ekzekutimit të Hasan Spatës, një oficer shqiptar zbulimi, që përdorej nga qeveria shqiptare për të hyrë dhe dalë në territorin e Jugosllavisë, marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë u tensionuan së tepërmi. Në këto kohë të vështira, lidhshipi shqiptar e quante Titon fashist dhe e akuzonte për genocid ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë (Pearson, O. 2006: 540)

Pavarësisht se marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë u ftohën sërish dhe pavarësisht se Enver Hoxha ndihej më pak i rrezikuar, duket se probleme të cilat rridhnin nën tokën e marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike kishte mjaft. Që nga shfrytëzimi i kredive dhënë nga sovjetikët në mënyrën e duhur, trajtimi i specialistëve sovjetikë të vendosur në vendin tonë, ndonjë batutë aty këtu, por edhe ndonjë pakënaqësi..

Në një letër dërguar komitetit qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë, komiteti qëndror i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik i kërkonte shokëve shqiptarë pakësimin e specialistëve sovjetikë në vend pasi kjo do të pengonte rritjen e kuadrove vendas dhe si rrjedhim ata konsideronin të dobishme të tërhiqnin nga Republika Popullore e Shqipërisë të gjithë këshilltarët sovjetikë dhe së bashku me palën shqiptare të rishikonin çështjen e një pakësimi të konsiderueshëm të mëtejshëm të disa specialistëve sovjetikë që punonin për të dhënë ndihmë teknike qofshin civilë ashtu edhe ushtarakë. ".....kemi parasysh se praktikisht është e pamundur që të mbikqyrim veprimtarinë e çdo specialisti sovjetik që punon në vendin tuaj. Duke qenë kompetent në degën e vet, disa nga specialistët sovjetikë nuk kuptojnë mirë kurdoherë rrethanat politike dhe veçoritë nacionale të vendit tuaj. Si pasojë e kësaj nuk përjashtohen disa moskuptime që s'janë në dobi të marrëdhënieve tona vëllazërore." (1958, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 3, AQSH) . Përgjigjia e kthyer nga pala shqiptare më datë 23 shtator 1958, shprehte dakortësinë për çdo çështje që sovjetikët kërkonin në letrën e tyre, për tërheqjen e specialistëve dhe familjeve të tyre etj. Ndërkohë që theksohej vazhdimisht se marrëdhëniet ishin shumë të mira dhe vëllazërore.

Në një intervistë për emisionin "Exclusive" në Top Channel, Gjeneral Rrahman Parrllaku kujton se marrëdhëniet me specialistët sovjetikë kishin qenë jashtëzakonisht të mira. Në marrëdhënie personale kanë qenë jashtëzakonisht korrektë. Parrllaku kujton se me tre prej

tyre pati edhe marrëdhënie familjare. Gjenerali tregon se pavarësisht se studiuuan në Bashkimin Sovjetik, përsëri kuadrot shqiptare nuk kishin praktikë dhe nga një sektor në tjetrin ndihma e specialistëve sovjetikë ka qënë vendimtare. Ai veçon këshilltarin e fundit që erdhi në priudhën 1960 - '61 kur po prisheshin marrëdhëniet dhe me të cilin i pati shumë të rralla kontaktet sepse ai i shmangej.

Më 16 shkurt të vitit 1959, komiteti qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë merr një letër nga komiteti qëndror i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në kongresin e XXI-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik do të shtohet çështja mbi formulën, që të shprehet më drejt dhe në mënyrë më të plotë karakteri i marrëdhënieve midis partive komuniste.

Për disa vjet rresht ishte krijuar një praktikë që BRSS qëndronte në krye të kampit socialist botëror, ndërsa PK e BS-së ishte forca drejtuese e lëvizjes komuniste. Sovjetikët vunë në dukje se kjo formulë e përdorur kishte dhe anët e saj negative. Ajo shfrytëzohej sipas tyre nga kundërshtarët. Në letër përmendeshin fjalët nënshttrim dhe shërbim ndaj Moskës si fjalët që perdoren më shumë në propagandën antikomuniste (1958, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 8, AQSH).

".... Natyrisht kjo nuk do të thotë se ne u bëjmë thirrje të gjithëve të shpërndahen nëpër "apartamentet " e tyre kombëtare dhe të mbyllet secili në guacken e vet. Njohja e barazisë dhe e pavarësisë së detashmenteve kombëtare të klasës punëtore nevojitet pikërisht për të përforcuar edhe më shumë unitetin dhe besimin midis tyre për të forcuar idetë dhe parimet internacionaliste proletare". Letra perfundonte me mesazhin se "...vetëm kur të gjitha partitë janë të barabarta në të drejta mund të vendosin marrëdhënie besimi dhe të bashkëpunimit vullnetar"(1959, MPKBS, F.14, D.2, fl. 12, AQSH).

Viti 1959 nisi me një ndihmë prej 75 milion dollarësh në formën e kredisë nga qeveria sovjetike për Shqipërinë si një mbështetje për realizimin e planit të ardhshëm 5 vjeçar. Gjithashtu sovjetikët u angazhuan për një hua prej 8,75 milionë dollarësh për zhvillimin e industrisë së naftës në Shqipëri, në të cilën specialistët sovjetikë në nxjerrjen e naftës dhe gjeologjisë punonin vazhdimisht dhe trainojnë kuadrot shqiptarë (Pearson, O.2006 : 550).

Në 3 prill një marrëveshje mes Enver Hoxhës dhe sovjetikëve u përfundua formalisht me anë të të cilës Bashkimi Sovjetik zotohej të ndihmonte Shqipërinë për implementimin e planit të tretë 5 vjeçar 1961-1965, duke i dhënë ndihmë ekonomike dhe asistencë teknike. Gjithashtu marrëveshja u nënshkrua edhe për shkëmbime mallrash mes të dy vendeve (Pearson, O.2006 : 550).

Dy anije transporti mallrash sovjetike më 17 prill 1959 nga flota e Detit të Zi kaluan Dardanelet, detin Egje e më pas u drejtuan për në Shqipëri. Kishte transportues, destroyere, etj. Sic shkruan në librin e tij "Shqipëria në shekullin e XX-të, një histori" , Owen Pearson, sipas shërbimeve sekrete të asaj kohe nuk kishte ditë që të mos kalonte një anije sovjetike apo polake drejt Shqipërisë për tu ankoruar në Durrës nga e cila shkarkoheshin makineri të reja sovjetike. Thuhej se sovjetikët kishin derdhur rreth 600 milionë rubla ose 54 milionë paund sipas kursit të këmbimit të asaj kohe për të përmirësuar industrinë dhe standartin e jetesës në Shqipëri. Ndërkohë që mijëra studentë shqiptarë po studionin në Bashkimin Sovjetik (Pearson, O. 2006: 552).

Kulmi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, nga shumë analistë apo deshmitarë të kohës ishte vizita dy javore që Nikita Hrushovi bëri në Shqipëri. Kjo vizitë zgjati nga 25 maji deri në 4 qershor dhe ishte e para e bërë nga një udhëheqës kaq i lartë sovjetik. Ajo në dukje ishte entuziaste por edhe sfiduese (Duka, V. 2007: 271).

Kryeministri dhe kryetari i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbërriti në Tiranë në maj të vitit 1959 me një shpurë të madhe zyrtarësh sovjetike dhe u prit me entuziazëm nga shqiptarët. Që nga zyrtarët e lartë e deri tek populli i thjeshtë.

Hrushovi u prit në Shqipëri nga një delegacion përbërja e të cilit ishte si më poshtë : Enver Hoxha Sekretar i parë i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Mehmet Shehu kryetar i Këshillit të Ministrave, Hysni Kapo, Sekretar i Komitetit Qëndror të Partisë, Beqir Balluku zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Mbrojtjes Popullore, Gogo Nushi president i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, Spiro Koleka zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave, Liri Belishova sekretare e komitetit qëndror të PPSH-së, Manush Myftiu zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Arsimit dhe Kulturës, Koço

Theodhosi zv. kryetar i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i komisionit të planit, Abdyl Këllezi zv. kryetar i Këshillit të Ministrave, Adil Çarçani ministër i industrisë dhe minierave, Maqo Çomo ministër i Bujqësisë, Behar Shtylla ministër i punëve të jashtme, Nesti Nase ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Moskë (1959, B.S, D.92, fl.40, AMPJ).

Delegacioni sovjetik gjatë qëndrimit në Shqipëri bëri një udhëtim në të gjithë vendin. Vizitoi një varg ndërmarrjesh industriale, kooperativa bujqësore , ndërmarrje bujqësore shtetërore, institucione të kërkimit shkencor dhe mësimor (1959, B.S, D. 92, fl.83, AMPJ). Hrushovi vizitoi thuajse gjithë qytetet e Shqipërisë. Përveç Tiranës , ai shkoi në Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, etj. Spartak Ngjela në librin e tij e kujton kështu atë moment : "..... une kisha dalë vet për ta parë me shkollen, sepse të gjitha shkollat e Tiranës ishin shpërhapur përgjate gjithë rrugës që fillonte nga Zogu i Zi e mbërrinte deri në Pallatin e Brigadave ku ishte edhe rezidenca dy javore e Hrushovit. Një entuziazem frenetik kudo. Të gjithë bërtisnin e çirreshin me thirrjet " Bashkimi Sovjetik" dhe " Enver - Hrushov"(Ngjela, S. 2011: 240).

Në një leter dërguar Nikita Hrushovit pas vizitës së tij në Tiranë, Enver Hoxha i drejtohej me përulje udhëheqësit sovjetik, sërish për ndihmë, kryesisht për bujqësinë, e cila ishte dhe fusha ku Hrushovi bëri më shumë vërejtje dhe dha më shumë këshilla. Ai i kërkonte Bashkimit Sovjetik një numër traktorësh dhe makinerish të tjera bujqësore, të lëvroheshin 700 traktorë fizikë, gjysmën e tyre mundësisht në tremujorin e parë dhe gjysmën tjetër deri në fund të vitit 1960 si dhe një numër makinerish të tjera bujqësore dhe të gjitha këto sipas vlerësimit të Hoxhës kushtonin rreth 23 milionë rubla. Plus edhe blerjen me klering të vajit lubrifikant përkatës që do të duhej për përdorimin e këtyre traktoreve gjatë vitit 1960 (1959, MPKBS, D. 14, D. 12, fl. 2, AQSH) ,

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri Nikita Hrushovi mbajti një fjalim në një miting të madh me punëtorët e kombinatit të tekstileve "Stalin" i cili ishte një dhuratë nga qeveria sovjetike për Shqipërinë. Atje punonin rreth 4600 punonjës dhe çdo njëri nga specialistët dhe drejtuesit e stafit ishte trainuar në Bashkimin Sovjetik. Radio "Moska" raportonte se makina e udhëheqësit sovjetik gjatë rrugës për në kombinat ndalohej here pas here nga punëtorët të

cilët donin të përqaфонin mysafirin e dashur , përfaqësuesin e nje vendi mik, e të takonin duart me të.

Në fjalimin e tij publik në kombinatin "Stalin", Hrushovi kërcënoi se do të ndërtonte në Shqipëri një bazë raketore nëse një e tillë do të ndërtohej në Itali dhe Greqi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tha se Shqipëria ishte ekskluzivisht e përshtatshme për të ndërtuar një bazë raketore (Pearson, O. 2006: 554).

Por vizita e Hrushovit në vitin 1959 në Shqipëri sigurisht nuk shkoi e gjitha vaj. Historianët e kohës dallojnë edhe ato mosmarrëveshjet që ekzistonin pavarësisht nga deklaratat që dukeshin sikur ishin në të njëjtën gjatësi vale. Vetëm një vit më vonë në mbledhjen e Moskës në nëntor të 1960-ës, Hrushovi u habit tepër nga përballja me shqiptarët e inatosur. Pra në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik duhej dalluar shfaqja nga thelbi. Në arkivin qëndror të shtetit shqiptar gjen një sërë dokumentesh tepër sekrete për kohën ku renditen vërejtjet e Nikita Hrushovit gjatë vizitës në Shqipëri.

Për shembull në datën 25 maj '59 Hrushovi ka thënë se në lidhje me ndërtimin e uzinës së vogël metalurgjike duhen bërë më parë llogaritë se sa do të kushtojë një ton metal . Ose për ndërtimin e kombinatit të ri të tekstileve ose shtimin e kapacitetit të kombinatit "Stalin" duhet parë çështja nëse mund të pranojnë vendet e tjera për të marrë pambukun shqiptar që ishte i një cilësie jo të mirë dhe te jepnin në këmbim pambuk të një cilësie të mirë (1959, MPKBS, F. 14, D.23, fl. 1, AQSH). Ajo që vazhdimisht këshillonte Hrushovi ishte të bëheshin mirë llogaritë, fushë në të cilën duket se çalonte pushteti i Enver Hoxhës.

"Ekonomia dhe bujqësia shkojnë mirë dhe njerëzit punojnë. Vendi mund të bëhet shumë i pasur dhe te jetojë pa përkrahje. Shqipëria ka perspektiva të mira zhvillimi sepse ka miniera, tokë e klimë të mirë dhe det. Nuk duhet nisur nga fakti që këtu të rriten të gjitha kulturat për të plotësuar të gjitha nevojat e vendit por të kultivohen ato kultura për të cilat ka më tepër leverdi"(1959, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 2, AQSH).

Më vonë në librin e tij " Hrushovianët " Enver Hoxha i përçmonte këshillat e Hrushovit. Ndër të tjera ai shkruan dhe përsërit vërejtjet e Hrushovit :

"Mos e harxhoni tokën dhe klimën tuaj të mrekullueshme me misër e grurë. Këto nuk ju sjellin të ardhura. Te ju rritet dafina, por a e dini ç'është ajo? Dafina është flori. Mbillni mijëra hektarë me dafinë se jua blejmë ne. Vazhdoi me kikirikët, me çajin dhe agrumet". Hoxha pretendonte që Hrushovi donte që Shqipëria të kthehej në një koloni me një bujqësi frutash, që ti shërbente Bashkimit Sovjetik revizionist ashtu sikurse u shërbejnë Shteteve të Bashkuara të Amerikës kolonitë e plantacioneve të bananeve e frutave në Amerikën Latine. "...Por ne s'do ta lejonim dhe se lejuam kurrë këtë vetvrasje që na këshillonte Hrushovi " (Hoxha , E. 1980: 356).

Sipas udhëheqësit sovjetik çështja e naftës në Shqipëri në atë kohë ishte problem shqetësues sepse ajo duhet të pastrohej dhe kjo gjë kërkonte shumë shpenzime. Ai nuk harronte të këshillonte Enver Hoxhën që të mos bënte investime atje ku nuk kishte leverdi. Për shembull benzina në atë kohë në Shqipëri ishte e një cilësie shumë të ulët dhe nuk mund të konkuronte prodhimet e të tjerëve (1959, MPKBS, F.14, D. 23, fl. 8, AQSH).

Gjithashtu Hrushovi i mëshonte në atë kohë edhe prodhimit të produkteve kimike, si plastmasi por një industri e tillë kërkonte shumë shpenzime. Duheshin ngritur fabrika për prodhimin e artikujve të industrisë kimike të cilat mund të plotësonin nevojat e brendshme, por duheshin menduar mirë nëse kishin leverdi, thoshte vazhdimisht lideri sovjetik (1959, MPKBS, F.14, D. 23, fl.9, AQSH).

"Po të ketë shumë gaz ose naftë ndoshta mund të ndërtohen centrale elektrike me naftë" (1959, MPKBS, F. 14, D. 23, fl.10, AQSH)

Por fusha në të cilën u ndal më gjatë Nikita Hrushovi gjatë vizitës në Shqipëri, ishte bujqësia. Ai mendonte se kjo ishte fusha në të cilën Shqipëria kishte më shumë leverdi dhe i sillte më shumë mirëqënie për popullin. Ai i thoshte vazhdimisht Hoxhës se në vend duhet të mbilleshin ato kultura që jepnin më shumë fitime. Bimë të tilla me leverdi të madhe të mos prodhoheshin vetëm për të plotësuar nevojat e vendit por edhe për tu shitur (1959, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 11, AQSH).

".....Me fletet e dafinave mund të blini në Bashkimin Sovjetik mish dhe bukë sa të doni.."(1959,MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 11, AQSH)

Hrushovi mendonte se edhe kultura e kikirikut duhej llogaritur për tu mbjellë duke parë se sa jep një hektar nga kjo bimë dhe sa jep duke u mbjellë me misër. "Nje hektar me kikirikë do të japë të ardhura shumë më tepër se sa po të mbillet me grurë" (1959, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 12, v. AQSH).

Ndër të tjera Hrushovi konstatonte se ndërtimet në Shqipëri bëheshin me menyrë shumë primitive. Sikur të riorganizohej kalimi i ndërtimeve me blloqe beton arme, ato do të kushtonin më lirë, arsyetonte ai (1959, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 13, AQSH).

"Por Hrushovi ishte një injorant i vërtetë në këto fusha. Ai shihte vetëm leverdinë." shkruante më vonë Enver Hoxha në librin e tij "Hrushovianët" (Hoxha, E. 1980: 356).

Në një telegram dërguar nga Beogradi, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë që mbante datën 24 maj 1959, thuhej se në rrethet politike jugosllave dhe ato diplomatike vizitën e shokut Hrushov në Shqipëri e interpretonin si vijon :

1. Shkon në Shqipëri për të zhvilluar bisedime lidhur me vendosjen e bazave të raketave me qënë se Italia dhe Greqia kishin vendosur ti instalonin ato amerikane (1959, B.S. D. 92, fl.51, 52, AMPJ).
2. Shkon në Shqipëri sepse është gjendja e keqe ekonomike, për t'ju dhënë ndonjë ndihmë (1959, B.S. D. 92, fl.51, 52, AMPJ)
3. Shkon për të biseduar me udhëheqësit shqiptarë për të zbutur sulmet e tyre kundër Jugosllavisë (1959, B.S. D. 92, fl.51, 52, AMPJ).
4. Si dhe shkon në Shqipëri për tu larguar nga Bashkimi Sovjetik për shkak se Hrushovi nuk i vlerësonte bisedimet e Gjenevës (1959, B.S. D. 92, fl.51, 52, AMPJ).

Atasheu i ri ushtarak sovjetik në kontaktet që kishte pasur me ushtarakë jugosllavë, ata i kishin shfaqur habinë duke i thënë se çfarë do të bënte shoku Hrushov 12 ditë në Shqipëri. "...Korrespondentët e huaj, amerikanë, austriakë e të tjerë që erdhën në legatë për të kërkuar

vizë midis të tjerave thanë se vizita e Hrushovit në Shqipëri kishte një rëndësi të madhe ndërkombëtare..”(1959, B.S. D. 92, fl.51, 52, AMPJ).

Pak kohë pas vizitës së Hrushovit në Shqipëri, më 1 gusht 1959, kolegji i ministrisë së punëve të jashtme të Shqipërisë vendosi që nëse sondazhet e qeverisë shqiptare do të priteshin në mënyrë të favorshme nga ana e qeverisë amerikane, menjëherë të bëhej propozimi zyrtar për nisjen e bisedimeve. Nëse përgjigjia e amerikanëve do të ishte pozitive atëherë do të caktohej për ti kryer këto bisedime përfaqësuesi i përhershëm i Shqipërisë në OKB Reis Malile (1959, D. 342,v. 1959, fl. 26,[Vendim i Kolegjiut të MPJ dt. 1.8.1959], AMPJ). Kuptohet që procesi do të ishte tepër i kujdesshëm por megjithëkëtë duket se pala shqiptare e donte mjaftueshëm nisjen e bisedimeve dhe afrimin me SHBA-të në atë kohë. Më 19 gusht 1959, zv.ministri i punëve të jashtme Vasil Nathanaili njoftonte përfaqësitë diplomatike dhe u jepte njëkohësisht udhëzime: " Kohët e fundit ka patur shenja për afrim nga Amerika. Pozita jonë është e fortë. Në rast se i afrohet ndonjë përfaqësues diplomatik, dhe ju bën propozim, i thoni se ia transmetoni qendrës. Inisiativa nga ana juaj të mos ketë."(1959, B.S. D. 339, fl.22, [Telegram i zv. ministrit të punëve të jashtme V.Nathanaili dërguar përfaqësive diplomatike 19.8.1959], AMPJ).

5.1.Baza ushtarako-detare e Vlorës

Gjatë vizitës së majit në Shqipëri, Hrushovi u magjeps nga gjiri i Vlorës. Enver Hoxha e kujton kështu këtë moment :

"Ç'mrekulli është këtu. Mund të ndërtohet një bazë ideale për nëndetëset tona. Të gërmohen e të hidhen në det këto vjetërsira (fjalën e kishin për objektet arkeologjike të Butrintit) ta shpojme këtë mal e të dalim matanë. Do të kemi në dorë bazën më ideale e më të sigurtë në Mesdhe. Që këtë mund të paralizojmë e të sulmojmë gjithçka" (Hoxha, E. 1980: 367).

Baza e Pashalimanit ishte një ëndërr në sirtar për sovjetikët. Më saktë ëndërra e gjithë carëve rusë po realizohej. Flota e tyre do të dilte më në fund në Mesdhe. Dhe kjo do të realizohej nëpërmjet Shqipërisë. Në kujtimet e tij botuar në një nga gazetat e përditshme, " Standart" , Dashamir Ohri, një nga veteranët e Flotës Luftarake Detare të vendit tonë shkruan me detaje si u ndërtua, si erdhën nëndetëset e para, kush i menaxhonte ato dhe gjithë bazën ushtarake që thuhej se ishte shqiptaro – sovjetike, por që në fakt ishte një fasadë. Ohri ka qënë komandanti i bazës së nëndetëseve të Pashalimanit pikërisht në periudhën që lindi dhe u zhvillua konflikti i madh me aleatin e hershëm, Bashkimin Sovjetik. " 21 ditë lundrim u deshën për mbërritjen e nëndetëseve të para sovjetike drejt Vlorës", kujton ai (Ohri, D. 2010 " Standart") .

"....gjithçka ishte në interes të synimit të hershëm sovjetik për dalje të lirë në Mesdhe pasi nëndetësja s'kishte shumë rol në plotësimin e detyrës që kishte ushtria jone si ushtri mbrojtëse. Mirëpo kjo na rëndoi tepër ekonomikisht. Fjala e saktë është që në vend që ti shërbenim mbrojtjes sonë u shërbenim qëllimeve Ruse" (Ohri, D. 2010, " Standart").

Një tjetër personazh dhe dëshmitar i ngjarjeve të Pashalimanit ishte dhe Qemal Hysaj. Ish komandant i Rregjimentit Detar në Vlorë me gradën Kapiten i Rangut të Parë (i barazvlefshëm me gradën e kolonelit), i cili e kujton me nostalgji atë udhëtim, që shënoi veç të tjerash edhe pikënisjen e karrierës së tij ushtarake.

"Ishte qershori i vitit 1958 dhe unë kisha përfunduar studimet për specialitetin e armatimit të anijeve luftarake. Por, pavarësisht kësaj, kërkova që praktikën ta zhvilloja në nëndetëse, gjë që m'u aprovua menjëherë nga komanda", tregon Hysa (2010, 29 korrik, ATSH).

"E morëm vesh lajmin dhe faktin se në kuadrin e një marrëveshjeje me Traktatin e Varshavës, do të krijohet Baza Ushtarake Detare e Pashalimanit. U gëzuam, por u lumturuam edhe më shumë kur mua dhe shokut tim na u aprovua kërkesa tjetër për të lundruar me grupin e nëndetëseve, ndërsa normalisht, duhej të udhëtonim me avion drejt vendit tonë" (2010, 29 Korrik, ATSH) .

Historiani Hamit Kaba në një intervistë dhënë për emisionin "Exclusive" në Top Channel thotë se dokumentet britanike janë shumë interesante. Sipas tyre pas prishjes me Jugosllavinë mendohej që baza do të ndërtohej në Shqipëri. Që në vitin 1952 apo '53 ne gjirin e Vlorës është futur një avion zbulimi britanik me firmën e Çurçillit për të marrë të dhëna nëse po ndërtohej me të vërtetë një bazë nëndetësesh në gjirin e Vlorës... Kaba thekson se nga dokumentacioni që kemi ne nuk është vënë re se ky avion është zbuluar.

Sapo u kthye në Moskë pas vizitës në Shqipëri, Nikita Hrushov, tha në një miting në pallatin e sportit në Moskë se në mënyrë fare të paarsyeshme Italia dhe Greqia kishin nisur ndërtimin e bazave raketore në territorin e tyre. Ndërkohë që as Shqipëria, as Bashkimi Sovjetik dhe as Bullgaria nuk kishin në plan të sulmonin këto vende.

".... natyrisht që ne mund ti arrijmë bazat greke dhe italiane të raketave që nga Bashkimi Sovjetik, por pse duhet ti qellojmë ata nga distanca kaq të gjata, kur mund ti shkatërrojmë bazat e armikut me raketa të vogla nga territori i Shqipërisë dhe Bullgarisë?! " (Pearson, O. 2006: 558)

Baza e Pashalimanit u ndërtua në bazë të një marrëveshjeje dhe një dokumenti tepër sekret mes qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe asaj të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike. Dokumenti i gjetur në arkivin e ministrisë së punëve të jashtme ka këtë përmbajtje :

"...Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeveria e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike me qëllim forcimin e mbrojtjes së Republikës Popullore të Shqipërisë , ndjejnë nevojën për të përfunduar në mes tyre këtë marrëveshje dhe për këtë qëllim caktojnë të plotfuqishmit e tyre: shefin e shtabit të përgjithshëm shqiptar major Arif Haskon dhe shefin e shtabit të përgjithshëm të flotës ushtarake detare sovjetike admiral Fokin V.A..." (1960, B.S. D.42/6, fl. 145, AMPJ) .

Marrëveshja perbëhej nga 7 nene.

Neni I

1. Përfaqësuesit e të dy anëve janë dakord që në periudhën 1957-1958 të kryhen një seri punimesh në gjirin e Vlorës për sigurimin e bazimit të nëndetësve dhe të anijeve luftarake mbiujëse që i jepen Republikës Popullore të Shqipërisë nga ana e Bashkimit Sovjetik (1960, B.S. D.42/6, fl. 145, AMPJ).

2. Punimet e radhës së parë për krjimin e bazës ushtarake detare do të kryhen në periudhën 1957-1958, në mënyrë që në tremujorin e parë të vitit 1958 të sigurohet bazimi i anijeve luftarake anijeve ndihmuese të treguara në lidhjen e nr.1(1960, B.S. D.42/6, fl. 145, AMPJ).

3. Në rast se do ta kërkojë situatë, me marrëveshje në mes të ministrave të mbrojtjes së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik , në bazë të vendimit të qeverive të tyre në bazën ushtarako - detare dhe në portet e Shqipërisë mund të dislokohej përkohësisht një pjesë e forcave të flotës ushtarako - detare të BRSS-së (1960, B.S. D.42/6, fl. 145, AMPJ). Gjithashtu në bazë të kësaj marrëveshjeje qeveria shqiptare zotohej të niste punën menjëherë për fortifikimin e ndërtesave të bazës. Një tjetër nen shumë i rëndësishëm i kësaj marrëveshjeje është edhe neni III në të cilin thuhet :

" 1. Mbrojtja e anijeve luftarake dhe anijeve ndihmuese të caktuara për dorëzim republikës popullore të Shqipërisë do të kryhet në tremujorin e parë të vitit 1958 menjëherë me gatishmërinë e objekteve të radhës së parë të bazës (1960, B.S. D. 42/6, fl. 146, AMPJ) .

2. Pas dorëzimit të anijeve luftarake Republikës Popullore të Shqipërisë, kryerja e shërbimit në anijet deri në fund të përgatitjes së ekuipazheve shqiptare do të bëhet nga efektivitë i Bashkimit Sovjetik. Efektivitë i Bashkimit Sovjetik në periudhën e përgatitjes së ekuipazheve shqiptarë do të qëndrojnë në Shqipëri si instruktorë. Në mbarim të përgatitjes së ekuipazheve shqiptare të anijeve në rast kërkesë nga Republika Popullore e Shqipërisë do të mbeten specialistët e nevojshëm si instruktorë në këto anije luftarake dhe ndihmuese. Pas marrjes dhe përvetësimit të anijeve të lehta të mbrojtjes kundër nëndetësve dhe të anijeve ndihmuese

nga ekuipazhet e Republikës Popullore të Shqipërisë, përdorimi i tyre do të bëhet nga Republika e Shqipërisë (1960, B.S. D.42/6, fl. 146, AMPJ).

3. Përdorimi operativ i nëndetëseve do të kryhet sipas planeve të akorduara në mes të komandës sovjetike dhe shqiptare. Kompletimi i nëndetëseve me efektiv deri në kohën e zëvendësimit të ekuipazheve sovjetike me ekuipazhet shqiptare do të kryhet nga Bashkimi Sovjetik (1960, B.S. D.42/6, fl. 146, AMPJ).

4. Furnizimi i anijeve, armatimi, pajisjet dhe dhënia e ndihmës teknike për krijimin e bazës ushtarake - detare në gjirin e Vlorës do të kryhen nga Bashkimi Sovjetik pa shpërblim. Sigurimi i anijeve të dorëzuara Republikës Popullore të Shqipërisë me llojet kryesore të furnizimit dhe me municione do të kryhet nga Bashkimi Sovjetik (1960, B.S. D.42/6, fl. 146, AMPJ).

Ne një tjetër nen të marrëveshjes atë me numrin 5 theksohet :

Për forcimin e mbrojtjes së gjirit të Vlorës në periudhën 1957-1958 ndjehet e nevojshme të vendoset në mënyrë plotësuese një grup artilerie kundër ajrore me përbërje tre bateri dhe dy bateri artilerie kunder katerave. Furnizimi në pjesë materiale do të bëhet nga Bashkimi Sovjetik (1960, B.S. D. 42/6, fl. 147, AMPJ)

Neni 7 i kësaj marrëveshjeje thotë se kjo e fundit është përfunduar për një periudhe prej dhjetë vjetësh dhe automatikisht zgjatet edhe për kaq kohë në qoftë se asnjëra nga palët nuk i paraqet kërkesë palës tjetër gjashtë muaj përpara skadimit të afatit 10 vjeçar mbi dëshirën për të ndërprerë këtë marrëveshje. Marrëveshja u përpilua më 12 shtator 1957 në Tiranë dhe hyri në fuqi menjëherë pasi u nënshkrua nga dy admiralët ai shqiptar Arif Hasko dhe ai rus V.Fokin (1960, B.S. D. 42/6,fl.148,AMPJ) .

Por baza e Pashalimanit kishte shumë probleme. Asnjëherë gjërat atje nuk shkuan ashtu siç duhej. Në një relacion të datës 9 nëntor 1960 mbi shkaqet e prapambetjes së stërvitjes luftarake të grupit N / D thuhet se prej datës 15 shtator 1958 deri më 31 dhjetor 1960 flitet për probleme nga më të ndryshmet që nga ato mbi mësimet për ndërtimin e nëndetëseve që

zhvilloheshin në gjuhën ruse dhe përkthimi i vononte gjërat e i bënte më pak të frytshme e deri tek çështje më të rëndësishme, konflikte mes ekspertëve etj (1960, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl.5,AQFA).

Me nëndetëset që duhet të përgatiteshin ekuipazhet shqiptare, përgatiteshin ekuipazhet sovjetike duke shfrytëzuar daljet në det me pjesëmarrje shumë të vogël të efektivit shqiptar nga katër deri në nëntë vetë thuhet ndër të tjera në këtë relacion duke nënkuptuar se ekuipazhi shqiptar lihej pas dore edhe në teori edhe në praktikë (1960, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl.5, AQFA).

Në një dokument tepër sekret që mban datën 2 dhjetor 1960, shkruhet se më datë 22 tetor komandanti i flotes lundruese detare me rastin e marrjes në dorezim të dy gjuajtësve të rinj nga flota e detit të zi, organizoi një mbremje, në të cilën u ftuan disa oficerë sovjetikë dhe shqiptarë ndër të cilët edhe kundër admiralët Kolesnikov, Jegorov dhe Sapozhnikov. Pas mbremjës së zhvilluar, kundëradmiralët u kthyen me makinë në Pashaliman, dhe në një moment kapiteni i parë Sapozhnikov iu drejtua kapitenit të dytë Mark Plani :

" Unë shoku Mark dua të flas me ty seriozisht për një çështje. Jam munduar të gjej rastin dhe vetëm tashti mu dha. Tek ti une kam besim të madh, ti ke studiuar kaq kohë tek ne, ke qënë tek ne në Sevastopol. Ne e kemi përgatitur efektivin në Sevastopol dhe gjate lundrimit në frymën e miqësisë dhe dashurisë ndaj popullit shqiptar, ndaj partisë së punës së Shqipërisë , komitetit qendror të saj e të tjera. Mirëpo ne po shohim një ndryshim që ju duhet të na e sqaroni në mënyrë që ne të dimë të orientojmë edhe efektivin tonë"(1960, Reparti ushtarak , F. 665, D. 1, fl. 2,AQFA)

Sapozhnikov i vazhdoi më tej me pyetjet. Ajo që e shqetësonte ishte se kishin marrë vesh që Liri Belishova ishte përjashtuar nga byroja politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, po ashtu ishte përjashtuar nga partia edhe kryetari i komisionit të kontrollit një farë Koço. Sovjetikët i kërkuan Mark Planit përse ndodhte kjo (1960, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl. 2. AQFA).

"Kjo është punë e brendshme e partisë sonë, prandaj ju lutem të mos më bëni të tilla pyetje. Për sa u përket këtyre çështjeve ju mund ti drejtoheni shefit të degës politike të flotës, kolonelit Xiqiri Meros dhe të sqaroheni me të", kjo ishte përgjigjia e menjëherëshme e Mark Planit (1960, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl. 2. AQFA).

Sipas dokumentit sekret duket se Sapozhnikovit dhe shokëve të tij nuk i pëlqeu përgjigjia e kundër admiralit shqiptar. Ata ishin të vendosur të kuptonin diçka mbi atë se çfarë po ndodhte në gjirin e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe vazhdonin këmbënguljen me pyetje në drejtim të Mark Planit.

"Po na thuaj të paktën çfarë ka shkruar shtypi juaj për Liri Belishovën " vazhduan sovjetikët (1960, Reparti ushtarak , F. 665, D.1, fl. 3, AQFA) .

Por Mark Plani dukej i vendosur të mos tregonte asgjë. Presionet ndaj tij në bazë të dokumentit vazhduan edhe në ditët e tjera por siç duket ai refuzoi sistematikisht gjë që solli edhe pakënaqësi tek sovjetikët. Në datën 23 shkurt 1960 komanda e flotës detare lundruese në bashkëpunim me komandën e brigadës së nëndetëseve pas marrjes në dorëzim të plotë të

nëndetëses nr.270 dhe nr. 290 planëzoi marrjen në dorëzim të bazës lundruese "Tomorri " dhe të nëndetëses nr. 296 prej datës 3 deri në 15 tetor 1960. Në datën 3 tetor komisioni i kryesuar nga shefi i shtabit të flotës lundruese detare filloi punën për marrjen në dorëzim të bazës lundruese " Tomorri" dhe punoi nëntë ditë (1960, Reparti ushtarak, F. 665, D.1, fl.4, AQFA) . Sipas dokumentit sekret kur puna kishte arritur thuajse në fund, në datën 11 tetor kundër admiral Jegorovi i thotë shefit të shtabit të flotës lundruese detare kapitenit të rangut të II Mark Planit :

"Sot mora urdhër nga kundër admiral Zagrebini të mos vazhdoj me dorëzimin e bazës lundruese " Tomorri.."

Preteksti ishte se komandanti dhe zv. komandanti i anijes ishin të papërgatitur. Pas kësaj komandanti i flotës lundruese detare u nis me shërbim në Bashkimin Sovjetik. Kjo situatë,

me pretekste, shtyrje e mungesa udhëzimesh të qarta vazhdoi për ca kohë (1960, Reparti ushtarak, F.665, D. 1. fl. 5-11, AQFA).

Marrëdhëniet e efektivit të përbashkët shqiptaro - sovjetik të bazës luftarake detare të Vlorës që nga nëntori i vitit 1960 sipas konstatimit nga ana e qeverisë sovjetike, pranuar kjo edhe nga autoritetet shqiptare, kishin qenë mjaft të ashpra. Gjithashtu në pjesën e dytë të nëntorit 1960, në ditët e fundit të marsit 1961 dhe në fillim të majit, tensioni kishte qenë më i lartë se zakonisht (1960, Reparti ushtarak, F. 465, D. 1, fl.108, AQFA).

Sipas dokumenteve të gjetura ne arkivin e Ministrisë shqiptare të Mbrojtjes këto kanë qenë periudhat kur qeveria sovjetike ka organizuar dhe ndërmarrë sulme kundër qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe udhëheqjes së Partisë së Punës së Shqipërisë. Në dokument veçohet periudha e konferencës së 81 partive komuniste dhe punëtore në Kremlin, mbledhja e komitetit politik konsultativ të vendeve anëtare të traktatit të Varshavës, etj (1960, Reparti ushtarak, F. 465, D. 1, fl.108, AQFA).

KAPITULLI VI: Ndarja e madhe me Bashkimin Sovjetik

Jugosllavia ngeli macja e zezë në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Në një rregjistrim të datës 16 janar 1960, Nikita Hrushov bisedonte me anëtarin e komitetit ekzekutiv të komitetit qëndror të Lëvizjes Komuniste Jugosllave Vukmanoviç Tempon. Edhe pse në nivel shtetëror ekzistonin marrëdhënie të mira tashmë, përsëri kishte edhe pikëpyetje dhe mospajtime. Sipas Hrushovit Jugosllavia kishte frikë të ngrinte zërin kundër SHBA-së në mbledhjet e OKB-së pasi merrte një ndihmë ekonomike jo të vogël nga Amerika (1960, MPKBS, F. 14, D. 3, fl.31, AQSH).

Në bisedën mes të dyve, Vukmanovic Tempo ndër të tjera këmbënguli të flasë për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe kishte porosi nga Tito për ta bërë këtë. Sipas tij gjatë një kohe të vazhdueshme shqiptarët po bënë një fushatë të ashpër anti-jugosllave. Ai shprehte habinë dhe nuk e kuptonte se si ishte e mundur kjo gjë. "...Shqipëria e vogël të ngrihet kundër Jugosllavisë e cila është shumë më e fuqishme se ajo"? Në këtë mënyrë Vukmanoviçi nënkuptonte se shqiptarët përkraheshin nga Bashkimi Sovjetik por kjo u hodh menjëherë poshtë nga Hrushovi. Ky i fundit kishte folur me Enver Hoxhën për çështjen jugosllave dhe lideri shqiptar i kishte thënë se zbulimi jugosllav dërgonte në Shqipëri vrasës dhe spiunë të cilët organizonin akte terroriste kundër qytetarëve shqiptarë dhe kjo nuk mund të mos shkaktonte reaksionet përkatëse nga ana e popullit shqiptar (1960, MPKBS, F. 14, D. 3, fl.40, AQSH).

Në bisedën me Vukmanoviçin, Hrushovi e mbron hapur Enver Hoxhën dhe shqiptarët.

"...Shokët shqiptarë thonë se jugosllavët kanë në Shqipëri agjencien e tyre, dhe unë e besoj Enver Hoxhën, sepse ju edhe në vende të tjera mbani agjentët tuaj..." (1960, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 42, AQSH)

Në librin e tij Shqipëria dhe prishja sovjeta - kineze, William E. Griffith ngre me të drejtë një pyetje:

" Përse i kushtohet kaq shumë vëmendje Shqipërisë ? Ky vend, më i vogli, më i varfri, më i izoluari, më ballkaniku, dhe më primitivi nga të gjithë vendet komuniste të Europës lindore ka luajtur ndonjë rol sinjifikativ dhe të pavarur në vazhdimin e betejës mes dy gjigandëve komunistë, pra mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës ? "(Griffith, E.W. 1963:1) 0

“...Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punetore që u mbajt në Bukuresht tregoi se midis partisë komuniste kineze dhe partive të tjera ka një domethënie të ndryshme të një varg çështjesh të rëndësishme të situatës ndërkombëtare dhe taktikës së partive komuniste. Ajo zbuloi mosmarrëveshje serioze mbi këto çështje...” Kështu nis letra e komitetit qëndror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik drejtuar anëtarëve të komitetit qëndror të partisë së punës së Shqipërisë më 13 gusht të vitit 1960 (1960, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 21, AQSH)

Ndër të tjera në Bukuresht u arrit marrëveshja mbi zhvillimin në Moskë, në nëntor, të mbledhjes së partive komuniste dhe punëtore të të gjitha vendeve dhe organizimi i kësaj mbledhjeje iu caktua pikërisht Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (1960, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 21, AQSH).

Në letrën e 13 gushtit 1960 drejtuar komitetit qëndror të partisë së punës së Shqipërisë nga pala sovjetike thuhet se ata e quajnë të rëndësishme që në mbledhjen e ardhshme të nëntorit partia e punës së Shqipërisë dhe partia komuniste e Bashkimit Sovjetik të shkojnë në unitet të plotë mendimesh. Do të ishte e drejtë thuhet në letër të shuhet në kohën e duhur shkëndija e keqkuptimit të lindur në mënyrë që ajo të mos ndizet (1960, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 22, AQSH).

Ndryshe nga polemikat publike midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, ato mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk nisën me gjithë forcën e tyre në ditëlindjen e Leninit, në prill 1960. Fjalimi i Ramiz Alisë me këtë rast, në atë kohë anëtar i byrosë politike, ishte kaq shumë armiqësor dhe i përqëndruar tek Jugosllavia, sa që me vështirësi mund të interpretohej si një sulm kundër Hrushovit (Griffith, E. W.1963 : 35-36). Në fund të fjalimit të tij, Ramiz Alia, ndoshta duke iu referuar Hrushovit konkludoi:

"Kur situata duket më e qetë... ata (revizionistët) mundohen të infiltrohen... si një kalë troje brenda vendeve të socializmit në mënyrë që ti minojnë ato nga brenda...dhe të rrëzojnë nga pushteti partitë marksiste - leniniste dhe rregjimet e popujve demokratikë. Mbi të gjitha në të tashmen, kur dikush mund të perceptojë simptomat e marrëdhënieve ndërkombëtare, rreziku i revizionizmit , i propagandimit të iluzioneve për çështjen e ndërtimit të socializmit, në luftën e klasave dhe në problemet e paqes, bëhet më i madh.." (1960, 5 maj, " Zëri i Popullit").

Përballja e parë ndërkombëtare e komunistëve ku grindja kinezo - sovjetike dhe mbështetja shqiptare për Kinën doli në pah publikisht, ishte në takimin e 5 dhe 6 qershorit në Pekin në këshillin e përgjithshëm të KNER-it, që ka qenë një nga organizatat më të rëndësishme të frontit komunist. Në këtë aktivitet duke tentuar të krijojë një grup opozitar, Kina sfidoi hapur supremacinë e Bashkimit Sovjetik në komunizmin ndërkombëtar, ndërkohë që në prill ata sfiduan hapur lidhshipin ideologjik të Bashkimit Sovjetik (Pollack, JD.1979: 320-325). Sovjetikët në këtë event u përkrarën nga francezët, polakët, çekët, gjermano - lindorët, italianët dhe indianët. Ndërsa kinezët patën në krah shqiptarët, japonezët, burmezët, vietnamezët veriorë, Ceilonin, sudanezët, somalezët, argjentinast, indonezianët dhe Zanzibarin..(Griffith, E.W. 1963: 37).

Kjo ishte edhe ndarja më e madhe në planin ndërkombëtar e cila rezultoi nga prishja kinezo - sovjetike duke u nisur nga kundërshtitë që ata kishin në planin ideologjik.

6.1. Roli I Shqipërisë në prishjen Sovjeto - Kineze

Kongresi i Bukureshtit i mbajtur në fund të qershorit u bë skena e parë e debateve të ashpra mes liderëve sovjetikë dhe kinezë dhe duket se i përkeqësoi edhe më shumë gjërat. Në këtë mbledhje Hrushovi pa asnjë paralajmerim, kërkoi që mbledhja të diskutonte mosmarrëveshjet sovjeto - kineze. Hysni Kapo zv. kryeministër dhe sekretar i komitetit qëndror të partisë së punës së Shqipërisë i cili edhe kryesonte delegacionin shqiptar në këtë mbledhje menjëherë njoftoi Enver Hoxhën për këtë zhvillim të orës së fundit (Hoxha, E. 1986: 21-22).Menjëherë Tirana zyrtare i dërgonte udhëzim Hysni Kapos të mos i bindej thirrjes së Hrushovit. Dhe ky i fundit kështu bëri. Kapo e cilësoi këtë mbledhje në kundërshtim me të gjithë normat organizative që rregullonin marrëdhëniet mes partive (

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1973: 274). Ky shpërthim i palës shqiptare nuk ishte i rastësishëm. Marrëdhëniet mes vendit tonë dhe Bashkimit Sovjetik nuk ishin marrëdhënie të thjeshta. Në vazhdimësi kishte patur komplikime, qejfmbetje, etj. Më parë udhëheqja shqiptare nuk guxoi të fliste hapur për mospajtimet. Edhe njëherë që e bëri, për rehabilitimin e Jugosllavisë, u detyrua të tërhiqej menjëherë mbrapsht.

Në këtë rast udhëheqja shqiptare shfrytëzoi mosmarrëveshjet sovjeto - kineze për të polemizuar me Hrushovin. Në një raport të mbajtur në pleniumin e XXI-të, Komitetit Qëndror të PPSH-së, në dhjetor 1960, Enver Hoxha duke diskutuar për mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore, mbajtur në Moskë në nëntor 1960, tha se ata dolën në krah të Kinës" në emër të mbrojtjes së parimeve të marksizëm - leninizmit (1960, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.10,AQSH).

Fjalimi publik i Hrushovit i mbajtur në këtë kongres në mënyrë të qartë shprehte opozitën e tij me Maon, e njëkohësisht edhe ndaj shqiptarëve. Ai madje i kërcënoi kinezët dhe shqiptarët se do të ndërpriste ndihmën ekonomike, duke ngadalësuar kështu tranzicionin e tyre në komunizëm. Ndër të tjera ai tha se për sa i përket çështjes së luftës termo - bërthamore, vetëm lunatikët dhe maniakët, pra Mao dhe Hoxha, mund të dilnin tani me thirrje për një rend të ri botëror. (1960, 23 qershor, " Zëri i Popullit). Madje ai denoncoi edhe interpretimet dogmatike të marksizëm - leninizmit nga kinezët dhe shqiptarët.

Shumë nga ato që tha Hrushovi u hoqën nga versioni i Tiranës zyrtare të fjalimit të tij.

Fjalimi i Hysni Kapos ashtu si ai i Ramiz Alisë në prill nuk e identifikoi Shqipërinë me të gjitha sulmet ideologjike kineze kundër Hrushovit, dhe në fakt ky fjalim kishte në përmbajtje të tij edhe disa pasazhe në mënyrë ekstravagante pro sovjetike, siç shprehet në librin e tij William Griffith (Griffith, E.W. 1963: 42) .

"Revizionistët jugosllavë, këta renegatë të urreyer të marksizëm - leninizmit dhe lakenj djallëzorë të imperializmit amerikan janë shndëruar në një agjensi të imperializmit.." tha ndër të tjera në fjalimin e tij Hysni Kapo(1960, 23 qershor, " Zëri i Popullit").

Fjalimet e mbledhjes së Bukureshtit krijuan një panoramë të mënyrës se si u ndanë partitë komuniste europiane. Te gjithë ishin në krah të Bashkimit Sovjetik, përveç Shqipërisë. Komiteti qëndror i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik i dërgoi një leter komitetit qëndror të partisë komuniste kineze që mban datën 26 qershor 1960. Sipas sovjetikëve, “..Kina në vend që të shikonte me vëmendje dhe në mënyrë objektive vërejtjet dhe kritikrat e partive motra, të cilat njëzëri u shprehën kundër pikëpamjeve të gabuara të shokëve kinezë mbi një varg çështjesh të rëndësishme të situatës ndërkombëtare dhe të politikës së partive komuniste, delegacioni kinez u vu në rrugën e ofendimeve dhe shpifjeve kundër udhëheqjes së PK të BS-së” (1960, MPKBS, F. 14, D. 22, fl. 8, AQSH).

Më tej në letër shkruhet : " Shkëmbimi i mendimeve në mbledhjen e partive motra në Bukuresht tregoi në mënyrë krejt të qartë se ekzistojnë largime në pikëpamjet e udhëheqjes së partisë komuniste kineze mbi një varg çështjesh të rëndësishme me lëvizjen komuniste ndërkombetare, tregoi largimin e shokëve kineze nga një varg parimesh kryesore të deklaratës dhe manifestit të paqes"(1960, MPKBS, F. 14, D. 22, fl.9, AQSH).

Për sovjetikët çështja nuk është se në mbledhjen e Bukureshtit delegacioni i PK-së së BS-së përdori metoda jo të drejta dhe ia imponoi vullnetin e tij të tjerëve, por çështja është se të gjitha partitë (edhe pse Shqipëria ishte kundër, ata nuk e përmendin) kundërshtuan njëzëri pikëpamjet jo të drejta dhe që nuk pajtoheshin me marksizëm - leninizmin e kinezëve mbi çështjet e përmendura më sipër çka e vërteton edhe protokoli i mbledhjes (1960, MPKBS, F. 14, D.22, fl.12, AQSH).

Në një takim të këshilltarit të ambasadës së Bashkimit Sovjetik në Tiranë Novikovit me Hysni Kapon në selinë e komitetit qëndror të PPSH-së në datën 16 korrik 1960, flitet pak a shumë për marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe rolin e Bashkimit Sovjetik. Hysniu i drejtoi disa pyetje diplomatit sovjetik. Ndër të tjera ai u tregua i rreptë në raport me jugosllavët. Sipas tij PPSH-ja nuk mendonte kurrë që Titoja dhe banda e tij të bëheshin të mirë, ata ishin tradhëtarë të marksizëm – leninizmit, armiq të socializmit, prandaj duheshin demaskuar pamëshirë, sepse kështu iu binte vlera. “Mos shpresohet se ata do të bëhen më të mirë”, i komunikonte me bindje Hysni Kapo, Novikovit (1960, MPKBS, F. 14, D. 8, fl. 7,

AQSH). Në përgjigje të letrës së palës sovjetike dërguar Tiranës zyrtare më 13 gusht 1960, në një letër dërguar komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik më 29 gusht 1960, shqiptarët nuk ndryshojnë qëndrim. Në letër theksohej se në mbledhjen e Bukureshtit qëndrimi shqiptar ishte i qartë, ai nuk u morr nga ata (shqiptarët) si rezultat i ndonjë keqkuptimi siç e quajnë sovjetikët në letrën e tyre, por u morr me ndërgjegjie të plotë për të cilin mbanin përgjegjësi përpara popullit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare për këtë qëndrim..(1960, MPKBS, F.14. D.2, fl.25, AQSH).

"Qëndrimi ynë në mbledhjen e Bukureshtit është zbatimi konsequent i vijës së përgjithshme ideologjike dhe politike të partisë sonë, e cila vijë, sikurse është njohur edhe nga ana juaj , ka qënë kurdoherë parimore, marksiste - leniniste dhe në përputhje të plotë me deklaratën e Moskës. Kundërshtimi që lindi në Bukuresht ishte rezultat i shkëmbimit të mendimeve mbi gabimet që i atribuohen partisë komuniste të Kinës nga partia komuniste e Bashkimit Sovjetik" (1960, MPKBS, F.14. D.2, fl.25, AQSH)

Mosmarrëveshjet që dolën hapur në mbledhjen e Bukureshtit u bënë evidente edhe në marrëdhëniet politike dhe ekonomike mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Bashkimi Sovjetik nisi presionet përmes ambasadës sovjetike në Tiranë. Filloi prerja e furnizimeve ushtarake, si dhe ndihmat ekonomike (1960. MPKBS, F.14, D.6, fl. 10. AQSH).

Shqipëria po gjendej çdo ditë e më shumë në një situatë mjaft të vështirë. Ne ishim plotësisht të varur nga ndihmat e sovjetikëve.

Ndërkohë në një intervistë me një gazetar amerikan në zyrën e tij kryeministri shqiptar Mehmet Shehu deklaronte : " Ne dëshirojmë që mes Republikës popullore të Shqipërisë dhe SHBA-së të vendosim marrëdhënie të rregullta diplomatike në bazë të barazisë, respektit reciprok dhe mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri - tjetrit." (Salisbury, E, H. " the New York Times" , 28 gusht 1957)

Më tej Shehu i pyetur rreth liberalizimit të pushtetit të brendshëm dhe praktikave policore, thotë se rolin e policisë dhe shërbimit sekret nuk e diskuton. " Insitucionet shtetërore janë të respektura në radhët e popullit tonë. Shqipëria është një shtet demokratik ku populli është

zot. Ne kemi një kushtetutë demokratike dhe ajo nuk është e mbyllur në një gotë qelqi". Në këtë intervistë, e para për një gazetar amerikan, Mehmet Shehu i fton amerikanët të vijnë turistë në Shqipëri edhe pse pasaportat amerikane ishin të pavlefshme për të udhëtuar drejt Shqipërisë. Pavarësisht kritikave, Shehu ishte i drejtpërdrejtë kur tha se do të dëshironte të jetonte në paqe me SHBA-të. " Ne duhet të jetojmë së bashku. Ka vetëm një tokë. Nëse ne nuk jetojmë bashkërisht, ne do të vdesim së bashku". (Salisbury, E. H. " the New York Times", 28 gusht 1957). Ishte kjo një tentativë për tu pajtuar me amerikanët, atëherë kur miku i madh i lindjes bënte dashuri me Jugosllavinë ? Dhe nëse po, flirti me SHBA-të nuk shkoi larg. Mosmarrëveshjet me sovjetikët do të thelloheshin edhe më tej në vjeshtën e vitit 1960. Enver Hoxha në krye të një delegacioni shqiptar do të merrte pjesë në konferencën e partive komuniste e punëtore mbajtur në Moskë në nëntor të vitit 1960. Siç thotë Spartak Ngjela në librin e tij "Përkulja dhe Rënia e Tiranisë shqiptare", të gjithë ata që e njihnin Enver Hoxhën e dinin se ai do ta çonte deri në fund aventuren e tij antisovjetike në " mbrojtje të marksizëm - leninizmit", sepse e dinin që nuk kishte çfarë të humbiste më. Humbja e tij përkundrazi vinte vetëm nga sovjetikët dhe nga kursi i ri i nisur në Moskë (Ngjela, S. 2011: 272).

Në këtë konferencë Enver Hoxha mbajti një fjalim të gjatë ku foli për situatën ndërkombëtare, mbi çështje të luftës e të paqes, mbi çarmatimin, mbi kolonializmin, mbi bashkëekzistencën paqësore, mbi format e kalimit në komunizëm, mbi kultin e individit, mbi çështjen jugosllave etj (1960, MPKBS, F. 14, D. 38, fl, 1, AQSH).

Enver Hoxha në praninë edhe të përfaqësuesve të 81 partive komuniste dhe punëtore denoncoi presionet sovjetike që i bëheshin PPSH-së për ta detyruar atë të pranonte kursin e kongresit të XX-të të PKBS-së. Në fjalimin e Hoxhës në pleniumin e komitetit qëndror të PPSH-së në dhjetor 1960 thuhej : " Ne do të ecim pa u lëkundur në rrugën marksiste leniniste dhe planin e kemi të siguruar. Shokët kinezë duke filluar që nga Mao Ce Duni, na kanë përsëritur shumë herë se me gjithë mundësitë e tyre do të na ndihmojnë, dhe do të bëjnë çmos që planin tonë ta realizojmë. Kjo është një ndihmë marksiste - leniniste shumë e nevojshme për ne, në këtë situatë kaq të vështirë e të jashtëzakonshme që po kalon vendi ynë. Ne duhet të kemi të qartë se partia komuniste e Kinës PKK, është në pozita revolucionare marksiste -

leniniste, dhe një nga shtyllat më të forta që mbron ideologjinë tonë "(1960, MPKBS, F. 14, D. 29, fl. 3, AQSH)

Në librin e tij " Enver Hoxha ", gazetari Blendi Fevziu duke cituar Ramiz Alinë i cili ishte pjesë e delegacionit që shkoi në Moskë në nëntor 1960 dhe përktheu gjatë gjithë kohës për udhëheqësin komunist batutat e Hrushovit, në një intervistë dhënë për emisionin "Opinion" në vitin 2004, shkruan : "... realisht në këto takime ne nuk ishim dakort me qëndrimin që mbanin rusët ndaj jugosllavisë , që filluan të flasin se jugosllavët nuk kanë gabuar. Gabimi ndaj jugosllavëve, për demaskimin e tyre në 1948-ën, ishte jo gabimi i tyre , por ishte gabimi i Stalinit dhe për pasojë , çdo gjë që është bërë më vonë është e gabuar. Bile shkuan deri atje sa kërkuan edhe rehabilitimin e Koçi Xoxes..."(Fevziu, B. 2011: 204).

Revista e famshme amerikane " Time " e ka paraqitur figurën e Enver Hoxhës në kohëra në mënyrë kontradiktore dhe kontrastuese, shkruan studiuesja Belina Budini në librin e saj "Tri kohë të Shqipërisë në Time , 1923-2013". Herë pas here revista i bën edhe ndonjë kompliment kur e quan " simpatiku Hoxha " ndërsa për aktin e daljes kundër Hrushovit në mbledhjen e partive të Moskës në vitin 1960 cilësohet si " pasues i guximshëm " (spunky fellow) (Budini, B. 2014: 77). Në artikullin me titull, "Albania the black sheep", "Time", ndërsa e cilëson Hoxhën si pasues i guximshëm boton pjesë nga fjalimi i tij në mbledhjen e Moskës. " Pavarësisht epiteteve të tjera që mund të meritojë Bosi i Kuq i Shqipërisë Enver Hoxha, ai e provoi veten se ishte pasues guximtar. Kush tjetër do të guxonte të shkonte në mbledhjen ndërkombëtare komuniste në Moskë dhe ta quante Nikita Hrushovin revizionist në fytyrë? Madje blasfemia e Hoxhës shkon edhe më tej , sipas një transkripti të fjalimit të mbajtur prej tij që u bë i njohur botërisht javën e shkuar " , shkruan "Time" në nje artikull të asaj kohe.

" Kulti i personalitetit nuk lidhet vetem me Stalinin " iu hakërrye 52 vjecari Hoxha delegatëve të 81 partive komuniste dhe punëtorë nga e gjithë bota." Hrushovi i ka shtrembëruar tezat e Stalinit."(Budini, B.2014:78)

Në të njëjtin artikull shkruhet se Hoxha zbuloi që Moska i kishte dërguar një letër shqiptarëve duke kërkuar mbështetje për fushatën anti Kinë. Hoxha gjithashtu zbuloi se Moska ishte përpjekur të kërkonte taktika brutale për të detyruar Shqipërinë të kthehej në linjën e saj. "

“...Ne kishim furnizim gruri vetëm për 15 ditë. Pas një vonese prej 45 ditësh , Bashkimi Sovjetik, na premtoi 10 mijë ton në vend të 50 mijë ton furnizim gruri për tu dorëzuar në muajt shtator dhe tetor. Ky, deklaroi ashpër Enver Hoxha ishte një presion i padurueshëm. Minjtë sovjetikë ishin në gjëndje të hanin, ndërsa populli shqiptar ishte duke vdekur nga uria”(Budini, B. 2014:81)

Delegacioni i PPSH-së që ndodhej në Moskë për mbledhjen e 81 partive komuniste dhe punëtore i dërgon një letër komitetit qendror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik e cila mban datën 21 nëntor 1960 si përgjigje të një letre që pala sovjetike i kishte nisur këtyre të fundit për të rinisur bashkëbisedimet midis përfaqësive të partive përkatëse të cilat u ndërpre në 12 nëntor 1960. Më hollësisht në këtë leter thuhet se Enver Hoxha e priti me kënaqësi ftesën për nisjen e bashkëbisedimeve me Hrushovin. Por pak kohë para se të nisej për në takim, delegacionit shqiptar, duke lexuar letrën dërguar nga pala sovjetike komitetit qendror të partisë komuniste kineze, i ra në sy se BS-ja e injoronte plotësisht ekzistencën e Shqipërisë si vend socialist dhe denigronte Partinë e Punës së Shqipërisë (1960, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 37, AQSH).

"më datë 12 nëntor për hir të përmirësimit të marrëdhënieve midis dy partive tona dhe të miqësisë midis dy vendeve tona, me qëllim që të gjendej rruga e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura midis nesh, delegacioni ynë shkoi në Kremlin për tu takuar me shokun Hrushov. Por ky i fundit papritur filloi të sulmonte në mënyrë ofenduese, të palejueshme, personalisht sekretarin e parë të komitetit qendror të partisë sonë, shokun Enver Hoxha, gjersa ta krahasonte atë me Makmillanin...."

Në këtë rast delegacioni ynë i kërkoi Hrushovit të tërhiqte mbrapsht ligjëratën, por ai refuzoi dhe në shenjë proteste delegacioni ynë, u largua pa përfunduar bisedimet.(1960, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 39, AQSH). Paranoja e Enver Hoxhës gjatë kohës që ndodhej në Moskë për mbledhjen e 81 e partive nuk ishte dhe aq e pabazuar në fakte. Në një intervistë për emisionin "Opinion " dhënë Blendi Fevziut në vitin 2004, Çlirim Balluku i biri i ministrit të mbrojtjes Beqir Balluku rrëfen se ambasadori sovjetik i propozoi Beqir Ballukut, autoritetit më të lartë të mbetur në Shqipëri, që me ndihmën e tyre të bënte grusht shteti. Të katër drejtuesit e tjerë

do të arrestoheshin në Moskë dhe do të ekstradoheshin sipas kërkesës shqiptare. Balluku me besnikëri refuzoi dhe pak a shume u përgjigj : "...nëse katër drejtuesve shqiptarë u ndodhte gjë, ambasadori sovjetik dhe gjithë specialistët që ishin në Shqipëri quheshin pengje dhe trajtoheshin si të tillë" (Fevziu, B. 2011:205)

Garancia që kinezët i kishin dhënë liderit Hoxha se do të ndihmonin me ç'të mundnin , e shpëtonte Shqipërinë nga varësia dhe presioni sovjetik për të ndjekur kursin e Hrushovit që kërcënonte drejtpërdrejt edhe pushtetin personal të Enver Hoxhës. Pas mbledhjes së Moskës marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik erdhën duke u rënduar. Ndërkohë mosmarrëveshjet mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës kishin marrë hov që në verën e më pas në vjeshtën e vitit 1959. Më 9 shtator TASS-i transmetoi një deklaratë të paprecedentë në lidhje me grindjen për kufirin kinezo-indian, dhe u bëri thirrje të dy palëve të zgjidhin çështjen (http://www.foia.cia.gov/sites/default/files/document_conversions/14/esau-19.pdf, fq. 39). Në një artikull që mban të njëjtën datë, 9 shtator 1959, "Zëri i Popullit" boton një editorial në të cilin sulmon hapur Jugosllavinë për përkrahje të Indisë në konfliktin e kësaj të fundit me Kinën (1959, 9 shtator, " Zëri i Popullit"). Disa lëvizje të fundit flisnin për një afrim të Shqipërisë me Kinën. Më 16 shtator të atij viti Mihal Prifti, ish ambasadori shqiptar në Bashkimin Sovjetik, emërohet ambasador në Kinë, dhe më 1 tetor një organizatë miqësie shqiptaro - kineze themelohet në Tiranë. Gjithashtu gjatë kësaj kohe Mehmet Shehu udhëheq një delegacion shqiptar i cili merr pjesë në festimet e dhjetë vjetorit të partisë komuniste kineze në Pekin. Pas kthimit të tij në atdhe përkrahja e Shqipërisë ndaj Kinës u bë mjaft evidente (Griffith, E. W. 1963: 34). Në librin e tij "Shqipëria dhe prishja sovjeta – kineze", William Griffith hedh tezën se vizita e Hrushovit në Tiranë në 1959-ën mund të shihet si një tentativë finale por e pasuksesshme për të paralajmeruar Hoxhën në aleancën e tij me Maon kundër Bashkimit Sovjetik.

Jo shumë kohë më parë në takimet e tyre me nëpunësit shqiptarë, sovjetikët dukeshin dashamirës. Në pritjen e ambasadës çeke në Moskë më 9 maj 1960, në një bisedë me ambasadorin suedez Hrushovi thotë : "..... Marrëdhëniet midis vendeve socialiste kanë qenë shumë të mira, kur ka patur ndonjë vend që ka dalë jashtë binarëve ne e kemi kritikuar hapur edhe në shtyp. Ju e dini si e kemi kritikuar rëndë Jugosllavinë, por sot nuk po i japim shumë

rëndësi atyre për të mos u ngritur vlerën dhe mos mendojnë se vlejnë më shumë se sa janë në të vërtetë..." Hrushovi duke iu drejtuar palës shqiptare vuri në dukje se këta të fundit vazhdonin të kritikonin jugosllavët duke qenë se kjo ishte punë e tyre dhe e drejtë e tyre të vepronin si të donin. "...Une mendimin tim e kam thënë....." (1960, B. S. D.66, fl. 9, AMPJ). Në këtë kohë ambasadori i Zvicrës i thotë Hrushovit : " Ju vitin e kaluar keni qenë në Shqipëri dhe shqiptarët duhet tu kenë dëgjuar juve mbi këtë ceshtje."

Hrushovi i përgjigjet: " Dije mirë zoti ambasador se edhe une jam shqiptar, jam shqiptar me të gjitha cilësitë e një qytetari shqiptar" dhe e mbylli këtë bisedë. Këto I përcjell për ministrine tonë të jashtme meanë të një telegrami, ambasadori I atëhershëm në Moskë Nesti Nase (1960, B. S. D.66, fl. 9, AMPJ). Në të tjera komunikime të zyrtarëve shqiptarë me ata sovjetikë duket ftohja por gjithashtu edhe përpjekjet e fundit për të mos e rrënuar marrëdhënien disa vjeçare. Në një telegram që mban datën 24 korrik 1960 dërguar ministrisë së jashtme nga Edip Çuçi, ambasador i Shqipërisë në Itali, thuhet se ambasadori i ri sovjetik ne Romë, Ustinov ishte shprehur vazhdimisht për miqësinë që ekziston midis popullit tonë sidomos u shpreh për popullin e Moskës ku ai kishte punuar vazhdimisht dhe tha se moskovitët ushqejnë simpati për popullin shqiptar. Gjatë bisedës ai kishte pyetur për shëndetin e Enver Hoxhës dhe ndër të tjera kishte lexuar një informacion të Tassit sikur në Shqipëri ishte bërë ato kohë nje plenium i Komitetit Qëndror të PPSH-së dhe dikush ishte përjashtuar. Ustinovi nuk kishte harruar të jepte porosi që të luftohej kundër elementëve anti parti (1960, B. S. D. 66, fl. 19, AMPJ).

Pas mbledhjes së Bukureshtit, duket se gjërat ndryshuan hapur. Filluan shmangiet e para. Në një telegram nga Pirro Koci, ambasadori i Shqipërisë në Bullgari (më vonë u bë ambasadori i Shqipërisë në Itali në vitet 1972 – 1977), drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme më datë 12 shtator 1960 tregon se të nesërmen e paraqitjes kredenciale kërkoi për ti bërë vizitë protokollare ambasadorit sovjetik në Sofje.. Por diplomati shqiptar kishte marrë një përgjigje negative me justifikimin se ambasadori ishte shumë i zënë. Ndërkohë që në pritjet e dhëna nuk shkembenin më shumë se sa një përshëndetje (1960, B.S. D. 68/1,fl. 13, AMPJ). Sovjetikët silleshin shumë ftohtë edhe me kinezët për shkak të ngjarjeve të fundit. Diplomatët shqiptarë raportonin vazhdimisht për lëvizjet e diplomatëve sovjetikë me vendet e

demokracive popullore. Në një nga telegramet rutinë që mban datën 20 shtator 1960 dhe i drejtohet Ministrisë së Jashtme, thuhet se ambasadori dhe personeli i ambasadës sovjetike mbanin një qëndrim të ftohtë edhe ndaj ambasadës kineze (1960, B.S. D. 68/1, fl.14, AMPJ). Ndërkohë një tjetër burim diplomatik në një telegram që mban datën 21 shtator 1960 shkruan se ambasadori sovjetik e kishte ftohur edhe më shumë qëndrimin e tij.

Ambasadori sovjetik takohet normalisht me përfaqësuesit e vendeve të tjera të bllokut si për shembull me të ngarkuarin me punë të Rumanisë dhe shmangte hapur shqiptarët. (1960, B.S. D. 68/1, fl.15, AMPJ).

Këshillat ndaj personelit shqiptar nëpër ambasada u shtuan, dhe gjithashtu edhe paranoja. Vasil Nathanaili tashmë zv. ministër i jashtëm i Shqipërisë, merrte vazhdimisht telegrame nga përfaqësitë tona diplomatike për marrëdhëniet e ftohta me sovjetikët. Në një telegram të datës 24 shtator 1960 shkruhet se për arsye vigjilence duhet që informacionet nga takimet e ndryshme të dërgonin vetëm me shifër, sepse dihet që postën diplomatike e dërgonin me anë të ambasadave sovjetike të vendosura nëpër botë. Kohët e fundit, ambasadat sovjetike tregonin interes për marrjen e postës shqiptare duke i kujtuar vazhdimisht. Më parë i kujtonin shqiptarët ... (1960, B. S. D. 68/1, fl. 20, AMPJ).

Një nga veprimet e Enver Hoxhës mbi të cilin u interesua rregullisht Moska (siç e kemi hasur edhe më sipër), me anë të të dërguarve të saj ishte edhe çështja e përjashtimit të Liri Belishovës nga byroja politike. Spartak Ngjela në librin e tij hedh një tezë rreth kësaj ngjarjeje. Sipas tij nuk dihet nëse do të merret vesh ndonjëherë se çfarë roli kishte luajtur Liri Belishova në atë kohë, sepse kishte tepër gjasë që ajo ka dashur jo të eliminojë Hoxhën, me anë të sovjetikëve , por ajo të bëhej figurë e dytë në Shqipëri, mundësisht edhe kryeministre duke eliminuar dy figura që i kishte pasur gjithmonë përpara: Hysni Kapon dhe Mehmet Shehun. Por edhe nëse nuk do të kishte qenë kështu, shkruan Ngjela, për Enver Hoxhën ka qenë po njëjloj, sepse ai e kishte vendosur që të shkëputej nga Moska, ngaqë nuk kishte më të ardhme politike me ta (Ngjela, S. 2011: 270).

Sovjetikët nuk rreshtën në asnjë moment së interesuari për përjashtimin e Liri Belishovës. Në një raportim që mban datën 3 tetor 1960 shkruhet se më 1 tetor në një takim me

ambasadorin sovjetik ky i fundit kishte pyetur për shkakun e përjashtimit të Liri Belishovës nga Komiteti Qëndror. "Po nëse Liri Belishova ka të drejtë?" pyeste ambasadori sovjetik(1960, B.S. D.68/1, fl. 21, AMPJ)

Sipas palës shqiptare ky ishte një provokacion ndërkohë që nuk kuptohej prej tyre, se përse ambasadori mbronte një element antiparti. Nderkohë që zyrtarët shqiptarë ishin të bindur se faktet e kishin treguar dhe po e tregonin se partia nuk kishte gabuar asnjëherë. Por sovjetikët kishin bindjen se fundi do ta tregonte kush kishte të drejtë. Ata po ndërhnin dhe po punonin kundër udhëheqjes së partisë së punës dhe qeverisë shqiptare si brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me miqtë e vendit të vogël ballkanik (1960, B.S. D.68/1,fl.22, AMPJ).

Më 25 nëntor 1960, Mehmet Shehu dhe Hysni Kapo u rikthyen në Moskë. Në një takim me Mikojanin, Kosiginin dhe Kozlovin (anëtarë te byrosë politike sovjetike), sipas Enver Hoxhës këta të fundit kërcënuan hapur udhëheqësit shqiptarë: "Ju nuk mund të rroni asnjë ditë pa ndihmën ekonomike tonën dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit." Por përgjigjia e shqiptarëve sipas Hoxhës ishte krenare. "Ne shtrëngojmë rripin, ushqehemi me bar, por juve nuk u nënshtrohemi" kishte deklaruar ne Moskë Mehmet Shehu. Enver Hoxha shkruan se revizionistët nuk i kishin vetëm fjalë këto kërcënime. "Ata vepruan. Sabotimi ekonomik nga Moska dhe nga specialistët e tyre shkoi kreshendo..".(Hoxha, E. 1980: 425).

Kundërshtimi i hapur i Shqipërisë ndaj Kremlinit, i cili daton që në 1956-ën dhe kulmoi në mesin e vitit 1960 nuk do të kishte vazhduar shumë gjatë, sipas vet Hrushovit, nëse Kina nuk do ti kishte dhënë vendit ballkanik një mbështetje të konsiderueshme si politike ashtu edhe ekonomike. Kështu shkruan në një artikull me titull "Sulmi i Hrushovit ndaj Shqipërisë, marrëdhëniet sovieto - kineze" Donald S. Zagoria (Zagoria,S.D.1961 : 1). Teksti i plotë I raportit të Hrushovit si sekretar i parë i komitetit qëndror të PK të BS-së mbajtur në kongresin e XXII-të të kësaj partie, u transmetua nga shërbimi i radio Moskës në 18 tetor 1961.

Menjëherë pas mbledhjes së Moskës, propaganda për Bashkimin Sovjetik filloi të zbehej e më qartë kjo u pa në nëntor të vitit 1960 kur në festat e nëntorit nuk u konsiderua më primar 7 nëntori, revolucionin sovjetik por 8 Nëntori, themelimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë, shkruan në librin e tij " Përkulja dhe Rënia e Tiranisë shqiptare" Spartak Ngjela si dëshmitar

i atyre ditëve (Ngjela, S. 2011: 273). Por përpara shpërthimit të Enver Hoxhës në mbledhjen e 81 partive në Moskë, më pak se një muaj më parë një tjetër incident mjaft i rëndësishëm kishte ndodhur mes një delegacioni të ushtarakëve shqiptarë në Moskë dhe komandantit të traktatit të Varshavës Gjeneral Greçkos. Delegacioni shqiptar i përbërë nga Gjeneral Leitnant Petrit Dume, Gjeneral Major Rrahman Parrllaku, Gjeneral Major Vaskë Gjino, dhe Gjeneral Major Halim Rramohito ndodhej në Moskë për një nga takimet rutinë të përvitshme që bëheshin në kuadër të traktatit të Varshavës në vjeshtë (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl. 4. AQSH).

Më datë 20 tetor në orën 13:00 deri në 15:00 në sallën e shtëpisë qendrore të ushtrisë sovjetike komandanti i forcave të bashkuara të traktatit të Varshavës dha një drekë ku morrën pjesë shefat e përgjithshëm të shteteve, zv.ministrat për përgatitjen luftarake komandantët e mbrojtjes kundërajrore të shtetit, komandantët e flotave detare, shefat e drejtorive operative, përfaqësuesit e komandës së bashkuar pranë ushtrive dhe pranë komandës së bashkuar, të gjithë gjeneralët e të gjitha vendeve të Traktatit të Varshavës (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.1, AQSH).

Nga pala sovjetike merrnin pjesë në këtë drekë, ministri i mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik, shefi i shtabit të përgjithshëm , komandanti i mbrojtjes kundër ajrore, komandanti i forcave ajrore, zv. komandanti i flotës, shefi i drejtorisë qendrore politike, zv. komandanti i forcave tokësore etj. Gjithashtu në këtë pritje merrnin pjesë mbi 100 vetë, marrëshallë, gjeneralë dhe admiralë (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.1, AQSH).

Sipas një dokumenti të arkivit qendror të shtetit me informacione rreth kësaj dreke, ka patur tentativa për të mos i dhënë fjalën përfaqësuesit shqiptar Petrit Dumes. Sipas dokumentit, Dumes i është dhënë fjala në fund. Në përmbyllje të drekës, gjeneral Malinovski tha : "Ne nuk i mbahemi etiketës formale që kanë disa shtete të tjerë por që në brendinë e saj është fallso prandaj dhe unë do të flas hapur..."(1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.1, AQSH). Malinovski në fjalën e tij kujton vizitën e Hrushovit në Shqipëri dhe mikpritjen e shkëlqyer të shqiptarëve me thirrjet Hrushov - Enver. "Por me hidhërim konstatojmë se kohët e fundit këto zëra nuk po dëgjohen më dhe populli shqiptar po largohet

nga kjo miqësi për arsye të disa zemërimeve personale të cilat çojnë në kultin e individit... "(1960, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 1, fl. 2, AQSH).

Halim Ramohito ishte i pari që reagoi pas thënieve të Malinovskit, i cili gjithësesi vazhdoi me kritikën ndaj udhëheqjes së PPSH-së. Malinovski ngriti një dollë për miqësinë por reagimi i delegacionit shqiptar ishte i menjëhershëm. Petrit Dume i kujtoi atij luftën që shqiptarët kishin bërë në favor të BS-së kur gjermanët ishin në dyert e kryeqytetit rus (1960, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 1, fl. 2, AQSH).

Pati një revoltë nga ana e delegacionit shqiptar. Të ngritur në këmbë të gjithë i jepnin të drejtë dhe mbështetje Petrit Dumes i cili iu drejtua Malinovskit me fjalët "... ju nuk keni të drejtë të ofendoni popullin, partinë dhe udhëheqjen tonë..." (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F.14, D. 1, fl.2, AQSH).

Delegacioni shqiptar ndërpreu drekën dhe u largua, e sipas dëshmitarëve nuk pranoi të takohej më me Gjeneral Malinkovskin me kërkesën e vazhdueshme të këtij të fundit (1960,MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl. 3, AQSH).

Më 21 tetor delegacioni shqiptar në orën 12 : 00 u takua me Marrëshall Greçkon, gjeneral Arante Antonov, gjeneral kolonel Vasiljev dhe gjeneral kolonel Andrejev (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.4, AQSH).

Çështjet që do të bisedoheshin në takim ishin dërguar paraprakisht dhe Greçko ishte i përgatitur. Nisi menjëherë nga sqarimi i çështjeve të ngritura nga shqiptarët. Pak a shumë asgjë nuk ishte përmbushur. Letra mbi kreditin ishte akoma në shqyrtim, raketat tokë ajër që pala shqiptare kërkonte dhe që duhet të vinin në muajin tetor sipas marrëveshjes kishin vështirësi në prodhim, për zëvendësimin e aeroplanëve Mig 15 me tipa të tjerë nuk kishte asnjë përgjigje të prerë, etj. Përgjigjet e Greçkos ishin evazive (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.4, AQSH). Gjatë takimit Petrit Dume i thotë Marrëshall Greçkos se delegacioni shqiptar, partia dhe udhëheqja ndiheshin të ofenduar nga qëndrimi që kishte mbajtur një ditë më parë gjeneral Malinovski, Dume mbrojti fort figurën e Enver Hoxhës, por Greçko i tha se nuk duhet të ofendohen nga fjalët e Malinovskit pasi ishte mendimi i tij

dhe ishte fakt I pakundërshtueshëm gjithashtu, se PPSH-ja ishte larguar nga PK-ja e BS-së (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl.5, AQSH).

" Partia jonë ka fakte të shumta që tregojnë se partia juaj po largohet nga Bashkimi Sovjetik dhe të mendoheni sa nuk është vonë" u përgjigj Greçko (1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl. 5, AQSH).

Dume nga ana e tij ngriti pretendimin se edhe shqiptarët kanë të drejtë të kritikojnë gabimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Bindjes së Petrit Dumes se PPSH-ja është në rrugën e drejtë të marksizëm - leninizmit, Greçko iu përgjigj: "Edhe jugosllavët thonë se janë me marksizëm - leninizmin por nuk është kështu si thonë ata"(1960, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 1, fl. 5, AQSH). Në një telegram nga Moska që mban datën 21 tetor 1960, Hysni Kapo i drejtohet Enver Hoxhës. Ai e informon udhëheqësin për çdo të re dhe lëvizje të delegacionit shqiptar.

"Thuhet se në orën 16:40 Petriti u njoftua se Malinovski do të takohet me të nesër në orën 11. Petriti më pyeti mua. I thashë të japë përgjigje se nuk mund të takohet pasi ka marrë urdhër nesër ora 8 të niset. Ju nxirrni vet konkluzionet përse kërkon takim. Une gjykova se kjo ishte përgjigjia më e mirë. Të mos takohet, kështu le ta mbajnë ata përgjegjësinë për provokacionin e poshtër që u bënë dje gjeneralëve tanë. Petriti si Malinovskit dhe Greçkos u ka dhënë përgjigjen që duhet" (1960, B.S. D.68/1, fl. 30, AMPJ)

Një nga dëshmitarët e ngjarjes dhe njëkohësisht pjesë delegacionit të asaj kohe, i pranishëm në Moskë ishte edhe Gjeneral Rrahman Parrllaku. Në një intervistë për emisionin "Exclusive" në Top Channel, Parrllaku e kujton kështu atë kohë :

"Ata atje deshën të provonin nëse ne do të lëkundeshim në qëndrimin tonë meqë të gjithë kishim mbaruar në Bashkimin Sovjetik dhe mund të bashkëpunonim me ta. Donin të na masnin puls. Kishin bërë dhe këtu pyetje provokuese të tipit : Me kë është ushtria?

Po shtrohej dreka e largimit dhe ne nuk po priteshim zyrtarisht. Petriti ka qënë implusiv dhe u ngrit pa u ulur Malinkovski. Atij i mbahej goja, por në atë moment me një rus ishte të rrjedhshme iu përgjigj atij. U prish mbledhja nuk u ulëm as ne dhe as ata. Pse do kishim frikë

ne... Erdhëm deri në Sofje me avionin e bullgarëve. Këtu përfunduan marrëdhëniet tona me traktatin . Por de jure kemi dalë nga traktati i Varshavës kur u sulmua Çekia."

Në një letër tepër sekret dërguar Tahmaz Beqarit, ambasadorit tonë në Beograd, nga ministri i jashtëm Behar Shtylla dhe që mban datën 10 dhjetor 1960 flitet për mbërritjen e ambasadorit të ri sovjetik në Jugosllavi, Epishev. Sipas letrës, prej gushtit të 1955-ës Epishevi ka qënë ambasadori i BS-së në Rumani. Pala shqiptare dyshonte se Epishevi e kishte hequr veten si mik i Shqipërisë por ishte tip oportunist dhe provokator.

"Gjatë kohëve të fundit ishte përpjekur dy herë të bisedonte me shokët e ambasadës sonë në Bukuresht", shkruan Behar Shtylla, "çështje të brendshme të PPSH-së, kishte mbrojtur elementët antiparti, të përjashtuarit apo të dënuarit nga PPSH-ja si dhe kishte bërë përpjekje të ngjallte pakënaqësi në gjirin e komunistëve shqiptarë kundër udhëheqjes së partisë dhe të nxiste ambiciet karrieriste" (1960, B.S. D. 68/1, fl. 51, AMPJ).

Ministri i Jashtëm Shtylla, i kujton ambasadorit Beqari se kur të mbërrinte në Beograd ambasadori i ri sovjetik, duhet të kishte kujdes në bisedimet me të duke pasur parasysh gjithmonë udhëzimet e PPSH-së dhe mbrojtjen e vijës së saj. Ai e porosiste se pasi të lexohej kjo letër menjëherë duhej asgjësuar duke e djegur (1960, B.S. D. 68/1, fl. 51, AMPJ). Ndërkohë lavdërimet e sovjetikëve për Liri Belishovën, sekretaren e PPSH-së, Enver Hoxha do t'i përjetonte si kundërvënie dhe sinjale për largimin e tij nga pushteti. Por pavarësisht se të gjitha rastet mbeten për t'u vlerësuar, dokumentet sugjerojnë se më e mundshme është që tek Hoxha, me kohë të ishte krijuar një bërthamë anti-Hrushov, që mezi priste të shpërthente diku. Kursi i destalinizimit i ndërmarrë nga Hrushovi, e kishte frikësuar e revoltuar Enver Hoxhën, por ai gjithnjë ishte zbrapsur duke qëndruar vigjilent (Lalaj, A. 2010, "Gazeta Panorama"). Dhe ishte pikërisht Liri Belishova njeriu për të cilin sipas deshmive dhe dokumenteve të kohës, pyesnin vazhdimisht sovjetikët dhe e mbronin hapur edhe përballë përfaqësuesve tanë diplomatike nëpër botë. Efekti zinxhir i situatës së krijuar që nga mbledhja e Bukureshtit e më tej, u ndje në ato pika strategjike të marrëdhënies sonë me sovjetikët që ishin edhe më të ndjeshme, atje ku gjërat nuk kishin shkuar asnjëherë vaj. "...Vlora dhe baza e Pashalimanit ishte molla e sherrit. Nuk kishte asnjë dyshim se baza ishte

e jona. Ne asnjëherë nuk do të pranonim që edhe për një pëllëmbë të tokës sonë të ishte nën të huajt."(Hoxha, E. 1980: 428) shkruante Enver Hoxha në librin e tij "Hrushovianët".

Specialistët, këshilltarët dhe ushtarakët që ndodheshin në bazën e Vlorës sipas dokumentave të arkivit të Ministrisë sonë të Mbrojtjes i shtuan acarimet, grindjet dhe incidentet. Për shembull një nga këshilltarët e shkollës, në datën 8 dhjetor 1960 u ka kërkuar llogari shqiptarëve përse u hoq Liri Belishova nga byroja politike madje ai vazhdonte më tej kur thoshte se kishin hequr edhe një komunist të vjetër, i cili kishte qenë qysh në 1936 në Bashkimin Sovjetik dhe ai ishte Sejfulla Malëshova (1960, F. 465, D. 1. fl. 67, AQFA).

Më datë 27 janar 1961 mjeku i nëndetësës 284 kur nëndetësja ndodhej në det shpërndau bukë të thatë në vend të bukës së freskët. Ai pretendonte se shqiptarët nuk i furnizonin me bukë(1960, F. 465, D. 1, fl. 58, AQFA).

Këto incidente në dukje banale, në atë kohë raportoheshin dhe shtonin tensionin. Në relacionet me shkrim që bëheshin për situatën në bazë këto incidente ishin të panumërta. Sipas këtyre përmbledhjeve sovjetikët i urdhëronin shqiptarët kryesisht për pastrim ndërsa komandën e mbanin për vete. Në shumë raste ka pasur edhe konfrontime fizike (1960, F. 465, D. 1, fl. 58, AQFA). Shpesh herë kapitenët dhe oficerët sovjetikë në bazë bënin pyetje që kishin lidhje me punët e PPSH-së. Si për shembull përse ia keni ndërruar emrin partisë nga Parti Komuniste në Parti e Punës, partinë tuaj e ka krijuar Koço Tashko sepse ai ka qenë edhe anëtar i vjetër i PK-së së BS-së, çfarë gjyqi po përgatitet të bëhet tek ju, çfarë origjine ka kryeministri juaj, ku ndodhet Liri Belishova, etj etj. Madje më datë 3 maj 1961 kapiteni i rangut III Varobjov thoshte se udhëheqësit shqiptarë ishin fajtorë, ata e kishin burgosur Liri Belishovën dhe sovjetikët dispononin të dhëna se ajo ndodhej në rrethin e Vlorës (1961, F. 465, D. 1, fl. 103-104, AQFA).

Në një telegram dërguar ministrit shqiptar të punëve të jashtme në një relacion mbi marrëdhëniet tona me përfaqësitë e vendeve të kampit socialist Skënder Konica ministër fuqiplotë shkruan ndër të tjera në datën 20 janar 1961 se vihej re një ftohje edhe më e madhe e marrëdhënieve në disa përfaqësi të vendeve socialiste me përfaqësinë tonë. Sipas Konicës ftohja kishte nisur që pas mbledhjes së Bukureshtit por ky qëndrim vazhdonte akoma edhe

më i theksuar. Bullgarët, polakët dhe sovjetikët në mënyrë demonstrative po afroheshin me jugosllavët (1961, B.S. D. 39, fl. 4, AMPJ).

Më herët në datën 5 janar të vitit 1961 Mehmet Shehu kryeministri shqiptar i dërgon një letër kryetarit të këshillit të ministrave të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike Nikita Hrushov. Ndër të tjera në letër pavarësisht tensioneve të krijuara çmohej ndihma e dhënë nga Bashkimi Sovjetik për sigurimin materialo - teknik të ushtrisë popullore shqiptare ndihmë që njëkohësisht u përgjigjej interesave të të dy vendeve vëllezër shkruan Shehu në letër. Me anën e kësaj letre qeveria shqiptare e pa të arësyeshme në atë kohë t'i parashtronte qeverisë së Bashkimit Sovjetik disa çështje që kishin lidhje me ndihmën e sipërpërmendur dhe që kishin lindur kohët e fundit.

Sipas kryeministrit shqiptar që në shtator 1949 midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik ishte përfunduar një marrëveshje mbi dhënien e ndihmës materiale ushtrisë popullore nga ana e Bashkimit Sovjetik.

Ashtu si çdo vit ministri i mbrojtjes Beqir Balluku më 7 prill 1960 dhe më 9 dhjetor 1960 i ishte drejtuar me letër ministrit të mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik Marrëshallit Malinovski për vazhdimin e zbatimit të marrëveshjes. Por në vend që të vazhdonte furnizimi, reagimi i marrëshallit Malinovski, ishte se zgjatja e kësaj marrëveshjeje për vitin 1960 - 61 duhet të vendosej në rang qeverish (1961, B.S. D. 40, fl.1, AMPJ) .

Në letër Shehu flet më tej për kredinë e akorduar nga sovjetikët për ushtrinë shqiptare e cila përfundoi në vitin 1960. Në bazë të marrëveshjes me komandën e bashkuar të forcave të armatosura të vendeve pjesëmarrëse në traktatin e Varshavës dhe me ministrinë e mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik , qeveria shqiptare qysh më datë 26 korrik 1960 i ishte drejtuar qeverisë sovjetike me lutje për të akorduar një kredi të re prej 125 milion rublash me anën e së cilës ti bëhej ballë nevojave të ushtrisë shqiptare. Por pati asnjë reagim edhe për këtë çështje (1961, B.S, D. 40, fl. 2, AMPJ). Mehmet Shehu ankohej se furnizimi i Shqipërisë me katër grupe luftarake raketash dhe një grup teknik skuadrilje helikopterësh dhe flotë ushtarake detare si dhe dy bateri artilerie bregdetare me tërheqje mekanike ishte ndërprerë. Deri në atë moment nuk ishte dërguar asgjë, vetëm një grup luftarak raketash dhe një grup teknik dhe për të tjerat

nuk kishte asnjë njoftim se kur do të vinin. Tek kërkesat e tij drejtuar kryeministrit sovjetik, pavarësisht gjëndjes së rënduar mes të dy vendeve zë një vend të rëndësishëm edhe baza e Vlorës e logjistika për të.

Sipas Shehut, ishte parashikuar se brenda vitit 1960 në bazen luftarake të Vlorës objekti 725 do të kryheshin një sërë ndërtimesh për të cilat do të furnizoheshin nga ana e Bashkimit Sovjetik, materiale të ndryshme ndërtimi të parashikuara në marrëveshjet përkatëse. Me keqardhje Shehu shprehej se për shkak të mos furnizimit të plotë nga pala sovjetike të materialeve të parashikuara në marrëveshje brenda vitit 1960 nuk përfundoi ndërtimi i mjaft objekteve të rëndësishme (1961, B. S. D. 40, fl. 2-3, AMPJ).

Pas mbledhjes së Bukureshtit emisionet shqip të radio Moskës injoruan ngjarjet më të rëndësishme të politikës shqiptare. Nuk ishte folur për vizitën e Beqir Ballukut në Azi, theksohej në relacionet e gjendura në arkivin e Ministrisë së Jashtme, as për vrasjen e rojeve shqiptare të kufirit nga jugosllavët, as për tezat shoviniste të Venizellosit për Vorio - Epirin etj. Madje as për aktivitetet e organizuara për muajin e miqësisë Shqipëri - Bashkimi Sovjetik. Pas mbledhjes së Bukureshtit dhe gjatë përgatitjeve për mbledhjen e Moskës, Radio Moska kishte transmetuar kryesisht komente dhe artikuj të shtypit sovjetik me karakter teorik në të cilat insistohej mbi rrezikun e dogmatizimit, flitej gjerë për rëndësinë e sesionit të OKB-së dhe rolin e Hrushovit në të. Në këto raportime të radios shtetërore të Bashkimit Sovjetik, theksohej ndihma që ka dhënë Bashkimi Sovjetik në arritjen e sukseseve të vendit tonë dhe nuk përmendej Partia e Punës e cila sipas propagandës së kohës ishte frymëzuesja kryesore. Ndërkohë pas acarimit të marrëdhënieve mes të dy vendeve, u bënë disa riorganizime në redaksinë e Radio Moskës. U bashkua redaksia shqiptare me atë jugosllave dhe përgjegjës për emisionet shqip u emërua shefi i redaksisë për emisionet drejtuar Jugosllavisë (1961, B. S. D. 42/2, fl.11-12-13- 14, AMPJ).

Më 14 korrik 1961, përgjegjësi i emisionit në gjuhën shqipe pranë Radio Moskës, Medvjedev thirri sekretarin e organizatës Kristo Zoga dhe i komunikoi se ishte i pushuar nga puna, sepse kishte refuzuar të përkthente materialet që i ishin dhënë nga redaksia. Gjithashtu punonjësi

shqiptar akuzohej për qëndrime jo miqësore kundrejt udhëheqjes së partisë dhe Bashkimit Sovjetik (1961, B.S. D. 42/2, fl. 32, AMPJ).

Incidente të tilla ishin shumë të shpeshta dhe reflektonin më së miri klimën e përgjithshme të marrëdhënieve mes të dy vendeve. Një tjetër punonjës i seksionit shqip të Radio Moskës kishte pasur probleme, në 17 tetor ai kishte refuzuar të lexonte një pjesë nga raporti i Hrushovit mbajtur në kongresin e PK-së të BS-së (1961, B. S. D. 42/2, fl.34, AMPJ).

Nesti Nase ambasadori yne në Moskë në një telegram që mban datën 31 mars 1961 drejtuar Hysni Kapos shkruante se Nikolai Firjubin zv, ministri i jashtëm i BS-së, i thirri ambasadorët e demokracive populllore për disa njoftime. Në këtë raportim Nase tregon ndër të tjera që pasi mbaroi me të tjerët, Firjubini e thirri në zyrën e tij dhe i bëri këtë njoftim verbal :

" Jam i autorizuar t'ju vë në dijeni se Ministria e Jashtme e Bashkimit Sovjetik ka të dhëna që ambasada e Republikës Popullore e Shqipërisë në Moskë, shpërndan broshura me fjalimin e Enver Hoxhes mbajtur në kongresin e katërt të organizatave të ndryshme dhe personave e individëve".

Lidhur me këtë ministria e jashtme i tërhiqte vëmendjen ambasadës shqiptare se veprime të tilla janë në kundërshtim me rregullat që ekzistojnë në BS mbi shpërndarjen e literaturës politike në bazë të së cilës gjithë literatura që botohej në vendet e tjera duhet të shpërndahej në Bashkimin Sovjetik me pëlqimin e palës sovjetike (1961, B. S. D. 42/3, fl.111, AMPJ).

Rapi Gjermani ambasadori shqiptar nga Bukureshti shkruan më datë 9 maj 1961 se këshilltari i ambasadës sovjetike atje Karpov i kishte thënë më herët se faji për prishjen e miqësisë midis të dy popujve ishte në anën e shqiptarëve.

Udhëheqësit shqiptarë kishin propozuar që të hiqnin bazën prej andej. "Ne", thoshte Karpovi, "po çuditemi se si po ndodhin këto gjëra dhe pse ju mbani këtë qëndrim". Diplomati sovjetik shprehej i habitur me argumentin sepse sipas tij Bashkimi Sovjetik i kishte bërë veç të mira Shqipërisë. Nuk donte të besonte se Hrushovi mund të arrinte deri këtu (1961, B. S. D. 42/4, fl. 8, AMPJ).

Shqipëria ishte rreshtuar krah Kinës komuniste tashmë, kurse Hrushovi kishte mbetur i habitur dhe i revoltuar me veten se përse e kishte toleruar aq gjatë Enver Hoxhën, kur ai e kishte në dorë që ta eliminonte që në vitin 1957. Kam qenë "durak" tha ai rasisht atëherë, që do të thotë budalla (Ngjela, S. 2011: 273).

"... Kujtohu se ti do ti lëpish të gjitha ato që më the në mbledhje..." i kishte thënë Hrushovi në një nga pushimet e mbledhjes së Moskës Enver Hoxhës. Ndërsa Hoxha me një indiferentizëm aktoriel ia kishte kthyer: "Ne nuk jemi më 2 milionë, por 602 milionë" duke i kujtuar Hrushovit se ai tani kishte mbrojtjen e Kinës (Ngjela, S. 2011: 273).

Por mosmarrëveshjet mes dy vendeve kishin një pikë mjaft të nxehtë e cila do të bëhej molla e sherrit dhe do të çonte punët deri në rrezikun e një sulmi nga ana e Bashkimit Sovjetik. Enver Hoxha në librin Hrushovianët shkruante se:

"Hrushovi dhe njerëzit e tij do ta shtrembëronin marrëveshjen zyrtare të arritur për dy qëllime, së pari për të na bërë presion që të nënshtroheshim dhe së dyti nëse ne sdo ta ulnim kokën do të përpiqeshin ta shtinin bazën në duart e tyre për ta pasur si një pikënisje që të pushtonin krejt Shqipërinë" (Hoxha, E. 1980:429).

Gjeneral Rrahman Parrllaku në intervistën për emisionin "Exclusive" në Top Channel arsyeton kështu mbi rrezikun e një sulmi sovjetik ndaj Shqipërisë: "..... Shqipëria nuk ka patur lidhje territoriale as me Bashkimin Sovjetik dhe as me shtetet e tjera të traktatit të Varshavës. Të ndërmerre një aksion kundër Shqipërisë do të krijoje një konflikt ndërkombëtar sepse do të shkelje mbi territore që nuk mund të ishin pjesë e konfliktit. A krijohej një konflikt me Shqipërinë kur ishte në rend të ditës përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë? Kjo te jepte sigurinë se nuk do të kishte ndërhyrje nga ana e Bashkimit Sovjetik, të jepte siguri për mosndërhyrjen sepse konflikt ndërkombëtar nuk mund të krijohej në këto kushte. Prandaj frika nga pikëpamja e ndërhyrjes nuk ekzistonte as në analizën tonë si ushtarakë dhe as në analizën e shtetit për konjunkturën politike...."

Diplomati Shaqir Vukaj shprehet kështu rreth kësaj çështjeje në të njëjtin emision: "...Për ta nuk ishte e thjeshtë, përkundrazi.. Kam diskutuar me shumë diplomatë e ushtarakë të huaj,

të cilët edhe më kanë folur për planet e pushtimit sovjetik kundër Jugosllavisë. Ne nuk shmangeshim. Sikur të sulmohej Jugosllavia patjetër do të pushtohej dhe Shqipëria. Plane konkrete nuk dimë dhe mbase nuk do merret vesh asnjëherë a ka pasur. Por kemi pasur të dhëna në atë periudhë se në ndonjë nga ushtritë e vendeve aleate kishte njësi speciale ku mësohej gjuha shqipe.. E për çfarë u duhej shqipja?! Këto dhe shumë fakte tregojnë që ka pasur plane....."

Nëse sovjetikët u larguan paqësisht nga baza e Vlorës dhe Perëndimi zbatoi politikën "Hands off" (e mospërzierjes) me Shqipërinë, kjo kryesisht ishte falë pozitës së saj strategjike, e cila rrezikonte shpërthimin e një konflikti me përmasa ballkanike dhe evropiane, i cili mund të dilte jashtë kontrollit të dy Superfuqive (Lalaj, A. 2010, gazeta "Panorama").

Më 28 mars 1961 ora 20: 00 e mbrëmjes, Enver Hoxha i shkruante Beqir Ballukut.

"Telegramin e marrëm dhe jemi plotësisht dakort me qëndrimin që mbajte kundrejt provokacionit të letrës së Greçkos. Mund të flasësh i pari po ta dhanë fjalën bazë alfabetit duke përdorur fjalimin normal. Pastaj shih e bëj po qe se ndokush do na sulmojë në mbledhje, kërko fjalën në fund fare dhe u jep përgjigjen e merituar për çdo gjë që do ngrihet, siç kemi biseduar e vendosur. Ne nuk pranojmë të hiqet baza dhe as të dalim nga traktati dhe kush shfaqet kundër në këtë drejtim i duhet të bëhet përgjegjës si armik i Shqipërisë dhe i kampit socialist, aq më tepër kur kjo bëhet në një kohë kur organizohen komplete për coptimin e Shqipërisë nga jugosllavët dhe imperialistët. Sa është i vërtetë dyshimi i Greçkos mbi kryeplanin jugosllavo - grek do ta marrë vesh së shpejti ai dhe gjithë bota kur të bëhet gjyqi i hapur. Mos u mërzisni, mbahuni në lartësinë e vijës së partisë sonë se ne jemi në rrugë të drejtë" 1961, B.S. D. 42/5, fl. 4, AMPJ).

Në po atë datë një tjetër letër nga Enver Hoxha i drejtohet Beqir Ballukut në Moske. Pak a shumë ai shkruan : "Letrën e Greçkos hidhe në shportë dhe përgjigju vetëm atyre çështjeve që ai dhe të tjerët do të shtrojnë në mbledhje. Prandaj fjalimi i tij duhet rishikuar në këtë dritë. Prandaj mos fol i pari" (1961, B.S. D. 42/5, fl. 5, AMPJ).

Përsa i përket bazës së Vlorës Hoxha shkruan :

"Qeveria shqiptare nuk pranon as ndryshimin më të vogël nga statuskuoja aktuale e përcaktuar nga marrëveshjet zyrtare në mes dy qeverive. Hidh poshtë shpifjet dhe arsyetimet e tyre, përmend dhe shpërnda promemorien e Mehmetit dhe të Andrejevit në lidhje me ngjarjet në bazë. Arsyeto çështjet nga ana politiko - ushtarake, trego përgatitjen shembullore të marinarëve tanë. Lidh kërcënimet dhe shantazhet e mëparshme të Hrushovit mbi heqjen e bazës dhe thuaj se qeveria shqiptare nuk pranon tezat e Greçkos se janë pa vend. Thuaj se çdo vendim që do të marrin në drejtim të heqjes së bazës dhe të mos armatimit të saj në bazë të marrëveshjeve dhe kontratave dobëson mbrojtjen e kampit dhe të Shqipërisë dhe i bëj ata përgjegjës. Si konkluzion u thuaj se në emër të partisë dhe qeverisë unë nuk pranoj dhe do të votoj kundër çdo vendimi që do të merret dhe ka për qëllim ndryshimin e strukturës së bazës dhe ndryshimin e marrëveshjeve ekzistuese mbi bazën midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Mos u nxeh nga poshtërsitë e tyre dhe mbaje veten në lartësinë e partisë sonë se e drejta është me ne." (1961 B.S. D. 42/5, f. 5-6, AMPJ)

Më 29 mars 1961, Beqir Balluku i raporton Enver Hoxhës për zhvillimet e fundit. Sipas tij takimi me Greçkon ishte parashikuar për ditën e premte në orën 3, pavarësisht se delegacioni shqiptar kishte kërkuar ta bënte të nesërmen. Ai i shpjegonte Hoxhës faktin se nuk kthehej dot në atdhe të premten pasi avioni i radhës ishte ditën e hënë. Ai i kërkonte Hoxhës udhëzime se si duhet të vepronte, nëse duhet të priste deri të premten apo jo. Dhe i shpjegonte se ky do të ishte vetëm një takim formal.

" Përsa i përket takimit tjetër që do të bënim mendoj të mos e bëjmë sepse Hrushovi hapur e tha në mbledhje se Shqipërisë nuk do t'i japim ndihma dhe kredi përderisa ekzistojnë këto marrëdhënie" (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 30 , AQSH)

Pavarësisht përkeqësimit të marrëdhënieve, përsëri Hrushovi si fillim nuk e përjashtoi Shqipërinë nga traktati i Varshavës. Dhe delegacionet shqiptare vazhdonin të shkonin në mbledhjet e traktatit. Në atë kohë ato drejtoheshin kryesisht nga Beqir Balluku, Ministër i Mbrojtjes.

Mbledhja e marsit 1961 ishte e tensionuar, kjo si pasojë edhe e letrës së marrëshallit Greçko e cila iu dorëzua në mbrëmje vonë përpara mbledhjes delegacionit shqiptar. Letër për të cilën

fliste edhe Hoxha më lart. Siç raportonte Balluku, në letër kishte një numër të madh shpifjesh, dredhira të vjetra të përsëritura më parë në bazën e Vlorës si dhe të reja të trilluara nga Andrejevi (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], d. 5. fl. 8, AQSH).

Në këtë letër thuhej ndër të tjera se nuk mund të mbylleshin sytë para faktit që ato kohë qëndrimi i Shqipërisë ndaj Bashkimit Sovjetik ishte i tillë që kishte lindur nevoja për të zgjidhur në një tjetër mënyrë çështjet e bashkëpunimit ushtarak me Shqipërinë në kuadrin e traktatit të Varshavës dhe dhënies së ndihmës ushtarake asaj duke përmendur ndihmat që BS i kishte dhënë kohë pas kohe Shqipërisë (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], d. 5. fl. 8, AQSH).

Sipas Greçkos ndihma ndaj Shqipërisë i kalonte 1 miliardë rublat. Më tej në letër ai vinte në dyshim delaratën e Enver Hoxhës në kongres në lidhje me komplotin greko - jugosllav. Përsa i përket bazës ushtarake të Vlorës në letër thuhej se në qoftë se qeveria shqiptare ishte e interesuar për qëndrimin e mëtejshëm në këtë bazë të nëndetëseve dhe të anijeve të tjera ushtarake sovjetike atëherë do të duhej që anijet ushtarake dhe nën repartet që u shërbenin atyre të kompletoheshin vetëm me efektivin sovjetik (1961, MPKBS, F. 14, Traktati i Varshavës, D. 5, fl. 8-9, AQSH).

"Nëse nuk jeni dakort me këtë masë krejtësisht të domosdoshme sipas mendimit tim, unë do të detyrohem ti drejtohem komitetit konsultativ mbi çështjen e bazës ushtarake të Vlorës, si dhe do të shtroj përpara qeverisë sovjetike çështjen për thirrjen e gjithë anijeve ushtarake dhe specialistëve sovjetik nga Shqipëria " me këtë fjali Marrëshalli Greçko e mbyll letrën e tij drejtuar delegacionit shqiptar (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 9-10, AQSH).

Të nesërmen në mëngjes delegacioni shqiptar i dorëzoi një letër përgjigje asaj të Marrëshallit Greçko. Të gjitha këto zhvillime ndodhën përpara fillimit të mbledhjes (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 11, AQSH). Duke i hapur kështu rrugë një tensioni edhe më të madh në vazhdim.

Siç thoshte Beqir Balluku në një nga telegramet e tij drejtuar Hoxhës me anë të letrës ai ia përplaste në fytyrë Greçkos gjithë trillimet e tij duke i vënë përpara përgjegjësisë nëse ata do të merrnin masat që shtrnin në të (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 11, AQSH).

Mbledhja u hap me një përshëndetje të Hrushovit i cili ia kaloi fjalën Ulbrihtit (Valter Ernst Paul Ulbriht, president i këshillit të shtetit të RDGJ-së dhe Komitetit Qëndror të partisë Komuniste gjermane, partisë shtet) i cili pas përcaktimit të rendit të ditës ia dha fjalën Greçkos që foli më shumë se një orë për gjëndjen ndërkombëtare si dhe detyrat për forcimin e mbrojtjes së vendeve të traktatit të Varshavës. Ndërkohë që Greçko pavarësisht letrës së një nate më parë, nuk iu drejtua në asnjë rast delegacionit shqiptar. Kjo ishte atmosfera e mbylljes së ditës së parë të punimeve (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 12, AQSH).

Letra dorëzuar delegacionit shqiptar u ishte dorëzuar njëkohësisht të gjitha përfaqësive mike. Balluku i rrëfen Hoxhës se po ruanin gjakftohtësinë dhe po prisnin për çdo veprim udhëzimet e udhëheqësit. Të nesërmen sipas radhës e kishin fjalën të parët (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 13, AQSH).

Në një telegram të datës 29 mars i cili flet për ditën e dytë të punimeve, Beqir Balluku thoshte se Hrushovi nisi sulmin ndaj shqiptarëve dhe atë e pasuan Zhivkovi (Todor Zhivkov, kreu i shtetit të republikës popullore bullgare), Gomulka (Vladislav Gomulka udhëheqësi komunist polak), dhe Ulbrihti. Balluku shkruante se ata ngritën për diskutim çështjen e komplotit greko - jugosllav dhe gjëndjen e bazës duke shpifur për qëndrimin e drejtë të palës shqiptare. Në vazhdim fjalën e mori ministri shqiptar i mbrojtjes duke mos prekuar asnjë nga çështjet delikate por vetëm çështjen e mosfurnizimit me ndihma ushtarake. Kjo shkaktoi reagimin e Malinovskit i cili e pyeti Ballukun përse nuk fliste për çështjet e paraqitura në letrën e marrëshallit Greçko. Edhe Hrushovi e sulmoi me fjalët se duhet të flisnin për gjëndjen në Vlorë. Por Balluku propozoi të fliste më vonë për këtë çështje (1961, MPKBS, F. 14, [Traktati i Varshavës], D. 5, fl. 16-17, AQSH).

Zhivkovi shprehej i indinjuar për qëndrimin e udhëheqjes shqiptare në bazën e Vlorës. Sipas tij këto ishin veprime provokuese dhe shkelje e detyrimeve. Ato nuk kishin asgjë të përbashkët me miqësinë dhe ndihmën që u jepte Bashkimi Sovjetik. Sipas tij udhëheqja shqiptare edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare po largohej nga politika leniniste dhe po binte në kundërshtim me bashkëekzistencën paqësore dhe se qeveria shqiptare shpesh kishte kërkuar hapur dhe kishte penguar zbatimin e kësaj politike. Këto veprime sipas Zhivkovit ndihmonin vetëm armiqët e socializmit (1961, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D.5.fl.17-18, AQSH).

Në mbledhje kryetari i delegacionit shqiptar reagoi menjëherë kundër këtyre deklaratave të cilat i quajti sulm ndaj Shqipërisë dhe tendencioze. Ndërkohë Kadari (udhëheqesi hungarez I dalë nga revolucion) dhe Gomulka propozuan dërgimin në Shqipëri të një komisioni për tu njohur me materialet rreth komplotit si dhe për të normalizuar gjëndjen në bazën e Vlorës. Madje Gomulka e quajti qëndrim pa përgjegjësi atë të udhëheqjes shqiptare i cili minonte unitetin e kampit. Ata gjithashtu kritikuan deklaratat e Enver Hoxhës në kongresin e IV-ët të PPSH-së të cilat ishin kundër mbledhjes së nëntorit (1961, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 5, fl. 20, AQSH) .

Gomulka ngriti në mbledhje çështjen e arrestimit të komunistëve Liri Belishova dhe Koço Tashko duke e quajtur gjyqin ndaj tyre jo vetëm një punë të brendshme të Shqipërisë, e cila influenconte shumë negativisht mbi gjithë gjëndjen e lëvizjes punëtore ndërkombëtare (1961, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 21, AQSH).

Mbledhja e marsit 1961 vazhdoi mjaft e tensionuar dhe dukej se të gjithë miqtë e traktatit të Varshavës nuk hezituan të ishin kundër Shqipërisë dhe të dënonin fort Enver Hoxhën në rrugën që kishte zgjedhur. Hrushovi në pasditen e datës 29 mars vazhdoi të sulmonte udhëheqjen shqiptare duke e quajtur të padurueshme gjëndjen në bazën e Vlorës. Ai nuk harroi të përmendte edhe keqtrajtimin që u bëhej grave sovjetike të cilave u kontrollohej edhe pasaporta nëpër autobuse. Madje Hrushovi kishte të dhëna se Pilo Peristeri (zyrtar komunist, kandidat per anëtar të byrosë politike të PPSH-së) kishte folur në aktivin e partisë së Vlorës kundër tij dhe udhëheqësve të partive të tjera. Gjithashtu lideri sovjetik foli për Liri

Belishovën dhe komunistët e tjerë që sipas tij në Shqipëri nuk ekzistonin më, dhe shkoi edhe më larg duke thënë se në Shqipëria ka njëzëz që veprojnë si Beria ish kreu i shërbimit sekret sovjetik i cili u shpall armik i Bashkimit Sovjetik (1961, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 5, fl. 25, AQSH). Mbledhja kishte arritur pikën më të lartë të tensionit kur Beqir Balluku u ngrit dhe hodhi poshtë ato që deri në atë moment kishte thënë Hrushovi duke i quajtur një lojë e rrezikshme që po bëhej kundër Shqipërisë dhe u tregoi përgjegjësinë që do të kishin karshi popullit shqiptar dhe kampit socialist (1961, MPKBS, [Traktati i Varshavës], F. 14, D. 5, fl. 26, AQSH).

Mbledhja e marsit 1961 e vuri palën shqiptare përballë përgjegjësisë për të pranuar ose jo projekt vendimin me propozimin sovjetik. Ose baza të kompletohej me personel plotësisht sovjetik ose baza do të hiqej nga Vlora. Nga votimi doli se vetëm shqiptarët votuan kundër ndërkohë që gjithë të tjerët ishin pro Bashkimit Sovjetik dhe propozimit të tij (1961, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 29, AQSH). Qeveria shqiptare i nisi një letër këshillit të ministrave të Bashkimit Sovjetik si dhe këshillave të Polonisë, Çekosllovakisë, Republikës Demokratike Gjermane, qeverisë revolucionare të punëtorëve fshatarëve të Republikës Popullore të Hungarisë, Këshillit të Ministrave të Rumanisë, Bullgarisë si dhe komandantit të përgjithshëm të forcave të armatosura të bashkuara të Traktatit të Varshavës, Marrëshallit të Bashkimit Sovjetik A.A. Greçko.

Si dhe për njoftim këshillit të shtetit të Republikës Popullore të Kinës, kabinetit të ministrave të Republikës Popullore të Koresë, qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit, këshillit të ministrave të Republikës Popullore të Mongolisë (1961, B. S. D. 42/5, fl. 21,AMPJ).

Në këtë letër flitej për zhvillimin e punimeve si dhe për vendimet e mbledhjes së komitetit politik konsultativ të traktatit të Varshavës që u mbajt në Moskë në 28 - 29 mars të vitit 1961. " Me keqardhje pala shqiptare konstaton se kjo mbledhje e përqëndroi vëmendjen e saj kryesore rreth akuzave të trilluara kundër Republikës Popullore të Shqipërisë me qëllim që në atë mbledhje të dënohej dhe të gjykohej kjo e fundit" (1961, B. S. D. 42/5, fl. 21,AMPJ).

Në këtë mbledhje u mor vendim dhe u kërkua që "luftanijet e flotës që ndodheshin në gjirin e Vlorës të përdoren vetëm nga ekuipazhet sovjetike dhe drejtimi i tyre të kryhej nga një komandë unike sovjetike e cila varet nga komandanti i përgjithshëm i forcave të armatosura të bashkuara të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe në rast se qeveria shqiptare nuk e pranonte këtë masë, atëherë pjesëtarët e traktatit të Varshavës do të detyroheshin të binin dakort me propozimin për tërheqjen e forcave ushtarake detare të lartpërmendura nga Shqipëria" (1961, B. S. D. 42/5, fl. 21, AMPJ). Përsa i përket vendimit të mbledhjes së Komitetit Politik Konsultativ mbi bazën ushtarake -detare të Vlorës, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë shprehet në letër se e konsideron atë të padrejtë.

“Ky vendim është marrë në bazë të informatave të njëanshme dhe të gabuara, në bazë të trillimeve të bëra me qëllim të keq, pa marrë aspak parasysh realitetin mbi bazën e Vlorës, të shprehur në promemorien e kryetarit të këshillit të ministrave të Shqipërisë. e cila i ishte dorëzuar prej tij përfaqësuesit të komandës së përgjithshme të forcave të armatosura të bashkuara të Traktatit të Varshavës pranë ushtrisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë më 22 mars të vitit 1961” (1961, B. S. D. 42/5, fl. 23, AMPJ).

Sipas qeverisë shqiptare ky vendim përbënte një shkelje të hapur të marrëveshjeve të përfunduara midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik më 12 shtator 1957 dhe më 3 maj 1959. Ajo nuk pranonte kurrësesi t'ua dorëzonte bazën ushtarake - detare të Vlorës ekuipazheve sovjetike dhe ripohonte qëndrimin e saj se e vetmja rrugë zgjidhjeje e çështjes së bazës së Vlorës ishte rruga e zbatimit të përpiktë të marrëveshjeve ekzistuese shqiptaro - sovjetike në bazë të cilave të gjitha mjetet luftarake detare të bazës së Vlorës duhet tu dorëzoheshin në një kohë sa më të shkurtër që të ishte e mundur ekuipazheve shqiptare të cilët sikurse e gjithë ushtria e Shqipërisë ishin treguar kurdoherë në lartësinë e detyrës së tyre dhe ishin sipas letrës besnikë të atdheut të tyre socialist. Qeveria shprehej e vendosur se tjetër rrugë nuk shihte. Çdo rrugë tjetër sipas saj do të çonte në prishjen e njëanshme të marrëveshjeve ekzistuese shqiptaro - sovjetike. Nëse qeveria sovjetike nuk pranonte të zbatonte marrëveshjet ekzistuese mbi bazën e Vlorës pala shqiptare shprehej se nuk do ti nxirrte pengesa dhe do të tregohej e gatshme për ti dhënë Bashkimit Sovjetik lehtësitë e rastit për evakuimin e forcave ushtarake - detare sovjetike nga baza e Vlorës. Letra

ishite firmosur nga kryeministri shqiptar i asaj kohe Mehmet Shehu dhe mbante datën 5 prill 1961 (1961, B. S. D. 42/5, fl. 24,AMPJ).

Më 20 prill 1961 zv. këshilltari për çështjet ekonomike, pranë ambasadës sovjetike në Tiranë, A.Pikalov, njoftoi zyrtarisht ministrin e minierave dhe gjeologjisë së RPSH-së, Adil Çarçanin, se Komiteti Shtetëror për marrëdhëniet ekonomike me botën e jashtme kishte vendosur që brenda një kohe të shkurtër prej 7 - 10 ditësh të tërhiqte specialistët sovjetikë që punonin në sistemin e naftës në Shqipëri (1961, MPKBS, F. 14, D. 31, fl.230, AQSH).

Më 25 prill 1961, pas disa orësh nga momenti i dorëzimit të kësaj note në ministrinë e punëve të jashtme të RPSH-së, rreth 50 specialistë sovjetikë lanë punën dhe morën urdhër të largohen nga Shqipëria. Brenda disa ditëve u tërhoqën pothuajse të gjithë specialistët madje dhe ata që nuk i kishte përfunduar mandati i qëndrimit në Shqipëri (1961, MPKBS, F. 14, D. 31, fl.109, AQSH). Më 26 prill qeveria sovjetike i dërgonte një letër qeverisë shqiptare. Si përgjigje ndaj letrës së 5 prillit që pala shqiptare i kishte dërguar udhëheqjes sovjetike. Në letër shkruhej se qeveria sovjetike ishte detyruar të konstatonte me ndjenjën e një keqardhje të thellë se qeveria shqiptare nuk bashkohej me përpjekjen e sinqertë të të gjithë pjesëtarëve të tjerë të komitetit politik konsultativ për të mënjanuar shfaqjet jo normale që kishin lindur kohët e fundit në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik dhe me vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës. Më tej në leter thuhej se siç duket qeveria e Shqipërisë kishte vendosur të shkonte dhe më tutje në rrugën e acarimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste. Duke vepruar në këtë mënyrë qeveria e Shqipërisë merrte përsipër një përgjegjësi të rëndë para gjithë popujve të vendeve të kampit socialist dhe popullit shqiptar (1961, B.S. D. 42/5, fl. 35-36, AMPJ).

Letra ishte shumë e gjatë dhe numëroheshin me detaje të mirat dhe ndihmat që Bashkimi Sovjetik i kishte dhënë Shqipërisë në këto vite miqësi. Për shembull me inisiativën e Bashkimit Sovjetik, Shqipëria u bë anëtare e organizatës së traktatit të Varshavës. Kjo ishte një garanci e tillë për sigurinë e Shqipërisë që nuk e kishte pasur kurrë gjatë gjithë historisë së saj. Një tjetër rast kur tregohej hapur mbështetja sovjetike ishte mitingu i Tiranës në maj të 1959-ës, kohë kur Shqipëria u vizitua nga Nikita Hrushovi. Ky i fundit në mitingun e

punonjësve të qytetit të Tiranës tha : "...Kush do të përpiqet të cënojë kufijtë e Shqipërisë ose të kujtëdo tjetër vendi të socializmit do të ketë të bëjë me të gjithë fuqinë e kampit të madh socialist. Populli shqiptar mund të jetë plotësisht i sigurtë se tragjedia e vitit 1939 nuk do të përsëritet më..."(1961, B.S. D. 42/5, fl. 40, AMPJ).

Sipas sovjetikëve për askënd nuk ishte më sekret se në Shqipëri lejoheshin hapur sulmet flagrante kundrejt Bashkimit Sovjetik, përhapeshin gjerësisht fjalë jo miqësore në lidhje me politikën e jashtme sovjetike dhe për marrëdhëniet sovjeto - shqiptare. "...Për këtë, ndër të tjera dëshmonte situata e sëmurë, e papajtueshme me parimet e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve miq që ishte krijuar nga autoritetet ushtarake shqiptare dhe qeveria e RPSH-së për ushtarakët dhe specialistët sovjetike që ndodheshin në bazën ushtarake të Vlorës" (1961, B.S. D. 42/5, fl.42, AMPJ).

"Është e kuptueshme që udhëheqja shqiptare nuk mund të shpresojë më tutje që Bashkimi Sovjetik do ta ndihmojë atë mbi bazën e mëparshme, ndihmë të cilën kanë të drejtë ta marrin vetëm miqtë dhe vëllezërit tanë. Bashkimi Sovjetik këtej e tutje e quan të nevojshme ti ndërtojë marrëdhëniet e veta me Shqipërinë mbi një bazë të re duke marrë parasysh politikën jo miqësore që ndjek udhëheqja e saj kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste"(1961, B.S. D. 42/5, fl. 49, AMPJ)

Sovjetikët sjellin në vëmendje se nga qëndrimi i saj i fundit qeveria shqiptare në fakt tregonte se ajo nuk ishte e interesuar për ruajtjen e bazës ushtarake - detare të Vlorës dhe në të vërtetë ajo po çonte punën drejt likuidimit të saj. "...Me keqardhje", thuhej në letër, "ne detyrohemi të tërheqim të gjitha nëndetëset, anijet mbiujëse, anijet ndihmuese dhe mjetet e tjera të vendosura në bazën ushtarake - detare të Vlorës..". Në lidhje me këtë, ata i luteshin qeverisë shqiptare tu jepte udhëzime autoriteteve ushtarake që deri në 20 maj 1961 të hiqnin ekuipazhet shqiptare nga të gjitha anijet nëndetëse dhe anijet ndihmuese të cilat në kohën e vet u dërguan nga Bashkimi Sovjetik në Shqipëri për organizimin e bazës ushtarake - detare të Vlorës (1961, B.S. D. 42/5, fl. 50, AMPJ). A. Kosigin zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave të BRSS-së e mbyll kështu letrën e tij:

"Përsa i përket marrëdhënieve të mëtejshme midis vendeve tona dhe ndihmës së BS-së për Shqipërinë kjo do të varet plotësisht nga fakti se çfarë qëndrimi do të mbajë pala shqiptare".

".....Kur marrëdhëniet midis vendeve tona të normalizohen qeveria sovjetike nga ana e saj do të jetë gati të kthehet tek parimet e mëparshme të lidhjeve tona reciproke, në të gjitha fushat e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe ushtarak ." (1961, B.S. D. 42/5, fl. 51, AMPJ). Përgjigjia e kësaj letre nga pala shqiptare erdhi në datën 8 maj 1961. Letra ishte me një përmbajtje jo miqësore dhe mbështetej mbi trillime, sipas palës shqiptare. Ishte sipas Hoxhës në kundërshtim me parimet më elementare të marrëdhënieve midis shteteve vëllezër socialiste, shkelte frymën internacionaliste etj. Në letër flitej vetëm për bazën e Vlorës pasi kjo konsiderohej si urgjente nga qeveria shqiptare :

"....Në bazë të marrëveshjeve të përfunduara midis qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Bashkimit Sovjetik mbi krijimin e bazës ushtarake - detare të Vlorës datë 12 shtator 1957 dhe datë 3 maj 1959, të gjitha mjetet detare që kanë ardhur në bazën e Vlorës në përputhje me këto marrëveshje kanë kaluar në pronësi të shtetit shqiptar dhe për këtë janë hartuar midis dy palëve dokumentet përkatëse të rregullta. Ndër të tjera qeveria shqiptare thekson se vendimi i qeverisë së Bashkimit Sovjetik për likuidimin e bazës së Vlorës për të cilën qeveria shqiptare ka bërë ndër të tjera shpenzime të konsiderueshme përbën një shkelje flagrante të marrëveshjeve në fuqi dhe ngarkon qeverinë sovjetike me një përgjegjësi të madhe historike përpara popullit shqiptar, sovjetik dhe popujve të gjithë vendeve të traktatit të Varshavës", shkruan Mehmet Shehu në letrën dërguar palës sovjetike (1961, B.S. D. 42/5, fl. 53-54, AMPJ).

Promemoria e datës 18 maj ishte urgjente dhe me një gjuhë të prerë e të ftohtë. Me anë të saj qeveria e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike hodhi poshtë menjëherë ato që ajo i quante sulme brutale që bëheshin kundrejt BS-së dhe tërhiqte vëmendjen rreth faktit që e tërë përgjegjësia për marrëdhëniet jo normale që ishin krijuar mes dy vendeve binte tërësisht dhe plotësisht mbi qeverinë e RPSH-së (1961, B.S. D. 42/5, fl. 66, AMPJ). Gjithashtu sovjetikët nuk hezituan të shprehnin refuzimin e tyre për t'u pajtuar me deklaratën e qeverisë shqiptare që gjasme sipas tyre të gjitha mjetet e forcave ushtarko - detare sovjetike që gjëndeshin në

Vlorë i përkisnin Shqipërisë dhe e shihte këtë si një interpretim arbitrar të marrëveshjeve përkatëse sovjeta - shqiptare mbi bashkëpunimin ushtarak (1961, B. S. D. 42/5, fl. 67, AMPJ). I ngarkuari me punë i Shqipërisë, ambasadori ynë në Beograd, Tahmaz Beqari, në një relacion mbi një takim të zhvilluar me këshilltarin e ambasadës sovjetike në Jugosllavi Djedushkin, shkruan se në takimin e zhvilluar në datën 15 prill 1961 ai e kishte pyetur zyrtarin sovjetik për një farë libri të bardhë të dërguar nga sekretariati i punëve të jashtme ku sipas palës shqiptare ishte një përmbledhje me shpifjet më të ulëta bërë për vendin tonë. Por Djedushikini ishte treguar indiferent rreth tij dhe ishte shprehur se libri ishte hedhur në një qoshe e nuk kishte njeri kohë të merrej me të (1961, B.S. D. 42/2, fl.7, AMPJ). Në një takim tjetër të datës 17 prill Tahmaz Beqari me ambasadorin sovjetik Epishev bënte sërish pyetje për librin e bardhë ashtu siç ishte udhëzuar nga eprorët. Edhe në këtë rast ambasadori sovjetik pretendonte se atë libër askush nuk e kishte lexuar. Ai mbronte tezën se përmbajtja e tij pa dyshim që ishte e trilluar për Shqipërinë. Sipas tij atje ishin përmbledhur materiale gazetash të shkruara për vendin tonë dhe asgjë më tepër. Epishevi shkonte më tej kur thoshte se habitej me shqetësimin e palës shqiptare nga ky libër (1961, B.S. D. 42/2, fl.8, AMPJ).

Ambasadori sovjetik në Beograd dukej se mbante një pozitë pro shqiptarëve pavarësisht ngjarjeve të fundit. Ai dukej ngushëllues ndaj diplomatit shqiptar kur thoshte se jugosllavët nuk donin të polemizonin. Madje këta të fundit e kishin pyetur përse sovjetikët nuk shkruajnë kundër tyre. Epishevi pretendonte se u ishte përgjigjur me fjalët "...me shpifjet tuaja është e kotë të humbasësh kohë". Epishevi e këshillonte Tahmaz Beqarin që shqiptarët të mos reagonin ndaj provokimeve. Qentë le të lehnin karvani duhet të shkonte përpara (1961, B. S. D.42/2, fl. 9-10, AMPJ).

Përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në botën socialiste ishin ato më vigjilentet. Ato që merrnin sinjalet e para të qejfmbetjes, përjashtimit, apo armiqësisë. Në një telegram të dërguar nga ambasada jonë në Poloni që mban datën 9 qershor 1961 thuhet se atje ishin hapur fjalë se Bashkimi Sovjetik do të tërhiqte nëndetëset e saj të cilat ishin të ankoruara në bazën e Vlorës (1961, B. S. D. 42/4, fl. 40, AMPJ).

Diplomati Mihal Prifti nga Kina shkruante ato kohë se njerëzit e ambasadës sovjetike i ishin afruar shumë shpesh Lilos (një punonjës i ambasadës shqiptare në Pekin) dhe e kishin pyetur në mënyrë të përsëritur çfarë të reja kishte nga shqiptarët. Në gjykimin e Mihal Priftit këto pyetje bëheshin me qëllim që të merrnin vesh qëndrimin e ambasadës atje. Ai rrëfen se me të njëjtat fjalë i ishin drejtuar edhe atij. P.sh. këshilltari i ambasadës sovjetike duke u treguar më intim i kishte thënë i shqetësuar se si do të shkonte halli i marrëdhënieve mes të dy vendeve (1961, B. S. D. 42/4, fl 115, AMPJ). Diplomatat sovjetikë në komunikimet e tyre me shqiptarët shpreheshin të gatshëm për përmirësimin e marrëdhënieve, dhe duket sikur kishin ngut për ti zhdukur sa më parë mosmarrëveshjet (1961, B. S. D. 42/4, fl 115, AMPJ).

Në darkën e dhënë nga ambasada koreane në datën 6 korrik të vitit 1961, këshilltari i ambasadës sovjetike në Bukuresht Antipov, në një bisedim me këshilltarin e ambasadës shqiptare atje Skënder Çuçin, I deklaroi këtij të fundit se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik në vend që të përmirësoheshin, ishin përkeqësuar për shkak të qëndrimit të pa drejtë të palës shqiptare. Nuk pritej dhe nuk mendohej kurrë që Shqipëria të mbante një qëndrim të tillë kundër Bashkimit Sovjetik, ishte shprehur zyrtari i ambasadës sovjetike. Ai ishte ankuar se ambasada e tyre në Tiranë jetonte në gjëndje alarmi. Sipas tij ambasadori sovjetik në Tiranë ndiqej me autoblanda të mbushura me ushtarë të armatosur me automatikë. Si pasojë e kësaj situate ai u detyrua madje edhe të largohej nga Tirana (1961, B. S. D. 42/4, fl. 95- 96, AMPJ).

"Specialistët tanë në Tiranë jane trajtuar shumë keq, prandaj ne i larguam. Atasheu ushtarak në Moskë ka shpifur duke thënë se oficerët shqiptarë trajtohen shumë keq, ju mungon ushqimi dhe veshmbathja. Udhëheqja e partisë suaj dënoi Liri Belishovën sepse donte Bashkimin Sovjetik dhe partinë komuniste të saj." Këshilltari shqiptar nuk pranoi asnjë nga pretendimet e palës sovjetike, duke i quajtur këto shpifje të ambasadorit sovjetik në Tiranë dhe shpifje të udhëheqësve sovjetikë (1961, B. S. D. 42/4, fl. 95- 96, AMPJ).

Me sa vihet re nga komunikimet e diplomatëve tanë në vendet e kampit socialist me ambasadorë apo zyrtarë të tjerë sovjetikë të vendosur në këto vende, edhe në rastet kur këta

të fundit përpiqen të tregohen më të mirë dhe më elastike përsa i përket marrëdhënieve me Shqipërinë përsëri reagimi nga pala shqiptare është disi agresiv dhe me përgjigje standarte.

Në një komunikim në ambasadën shqiptare në Kinë të datës 9 gusht 1961, i ngarkuari me punë i Bashkimit Sovjetik atje Sudarikovi përpiqet të jetë miqësor me ambasadorin shqiptar. Duke folur për ftohjen e krijuar në ambasadë ai i vinte në dukje ambasadorit shqiptar se ndonjë mosmarrëveshje e vogël që mund të ekzistonte lart nuk duhet të influenconte marrëdhëniet mes dy ambasadave. Por përgjigjia nga pala shqiptare ishte e qartë: "... ai që përpiqet të prishë miqësinë e popullit shqiptar me popujt sovjetikë është armiku ynë..." (1961, B.S. D. 42/4, fl. 125, AMPJ).

Në një radiogram nga Tirana për në Moskë dërguar Gac Mazit të dërguarit me punë të Shqipërisë në Bashkimin Sovjetik dhe që mban datën 15 gusht 1961 i këshillohet këtij të fundit të njoftojë urgjentisht Ho Shi Min-in sepse Komiteti Qëndror i PPSH-së e konsideronte të nevojshme dhe të ngutshme zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis udhëheqjeve të partive të vendeve socialiste të Evropës dhe Partisë së Punës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë i kërkohej Ho Shi Minut që përpara se të vijë në Tiranë për bashkëbisedime për këto çështje do të ishte mirë të bisedohej me të gjitha ato udhëheqje që kishin ndërmarrë veprimtarinë e jo miqësore dhe sipas palës shqiptare anti - marksiste kundër partisë, qeverisë dhe popullit shqiptar, citohet në radiogram.

"Siç janë udhëheqja e Bashkimit Sovjetik, Polonisë, Republikës Demokratike Gjermane, Çekosllovakisë, Hungarisë, Bullgarisë dhe Rumanisë. Vetem pasi të bëhet kjo do të mund të sillnin dobi bashkëbisedimet " Kjo letër ishte përpiluar nga Enver Hoxha dhe me anë të saj i kërkohej Gac Mazit që t'ia dorëzonte në çdo orë, qoftë edhe natën dhe ta lejonte Ho Shi Minin të fliste sa më gjatë e ta dëgjonte me kujdes (1961, B.S. D. 42/2, fl. 80- 81,AMPJ).

Situata në bazën e Vlorës që pas acarimit të deklaratave mes vendeve ishte përkeqësuar edhe më shumë. Incidente kishte pasur gjithmonë, por ato ishin mbyllur, anashkaluar dhe asnjëherë ngritur në nota proteste. Në datën 30 maj 1961 Ministria e jashtme e Shqipërisë protestoi duke i drejtuar një letër ambasadës sovjetike në Shqipëri për një incident të ndodhur në bazë. Sipas palës shqiptare më datë 29 maj shtetasi sovjetik, shoferi Vladimir Dermakov, pjesëtar

i personelit të instruktorëve që kishin shërbyer në flotën ushtarake detare shqiptare, duke ngarë autobusin në të cilin ndodhej edhe një kapiten i rangut të parë Pjotër Ivanoviç Diftjarenko shtypi duke e plagosur rëndë, marinarin shqiptar Refat Cervenaku përpara shkollës së instruksionit të flotës ushtarake - detare të bazës së Vlorës (1961, B.S. D. 42/7, fl.19-20, AMPJ).

Ministria e punëve të jashtme të Shqipërisë e quante këtë akt të qëllimshëm dhe aspak të rastësishëm dhe rezultat të punës aktive të kryer me ndërgjegje nga disa oficerë sovjetikë në Shqipëri me ndjenja aspak miqësore dhe urrejtje për shqiptarët (1961, B.S. D. 42/7, fl.19-20, AMPJ). Më herët më 30 prill të atij viti një tjetër incident i rëndë ndodhi në bazë. Ministri i jashtëm shqiptar për këtë shkak thirri madje edhe ambasadorin sovjetik në Shqipëri për ti komunikuar se sa e rëndë ishte ngjarja. Kryeinstruktori sovjetik, kapiteni i rangut të III-të Kllapunov kishte instruktuar rojen sovjetike të ndalonte ekuipazhin shqiptar të hynte në anije. Nga pala shqiptare ky u quajt një incident i rëndë dhe mjaft i rrezikshëm dhe për këtë u paralajmërua ambasadori sovjetik (1961, B.S. D.42/7, fl.1, AMPJ).

Në një promemorie që mban datën 8 maj 1961 pala sovjetike protestoi kundër veprimeve të personelit shqiptar në bazën ushtarake - detare të Vlorës. Ndër të tjera aty thuhej se komanda shqiptare kishte vënë në ato kohë në një gatishmëri të lartë luftarake të gjitha forcat dhe mjetet e flotës ushtarake - detare dhe të artilerisë bregdetare në rajonin e gjirit të Vlorës, u kishte ndaluar lejet efektivit si dhe kishte pajisur me armë të gjithë oficerët. Gjithashtu sipas sovjetikëve në Sazan ishte vendosur shërbimi i dezurnit të anijeve luftarake dhe katerëve silurues të ngarkuar me silurë luftarakë dhe të gatshëm për të dalë në det. Ata pretendonin se qëndrimi ndaj marinarëve ushtarakë sovjetikë ishte përkeqësuar edhe më shumë. Ata vinin re se qëndrimet e palës shqiptare kishin pasur për qëllim të përkeqësonin dhe të acararin edhe më tej gjëndjen në bazën e Vlorës (1961, MPKBS, F.14, D.3, fl. 64-65, AQSH).

" Qeveria sovjetike për shkak të kushteve të padurueshme që u krijuan në bazën ushtarake - detare të Vlorës për të evituar incidente të padëshirueshme që mund të shpinin në keqësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis vendeve, vendosi të tërheqë nëndetëset, anijet mbiujëse dhe vaporët nga Shqipëria drejt Bashkimit Sovjetik." (1961, MPKBS, F.14,D.3,fl.66-67,

AQSH). Në një dokument sekret ku pasqyrohej një bisedë e rregjistruar e ambasadorit të BS-së L.V. Shikin me zv.ministrin e punëve të jashtme të RPSH-së Halim Budo mbi gjëndjen në bazën ushtarake - detare në Vlorë mbi marrëdhëniet shqiptaro - sovjetike thuhej se ambasadori Shikin i kishte dorëzuar Budos një promemorie si përgjigje për letrën e datës 8 maj me autor kryeministrin shqiptar Mehmet Shehu mbi gjëndjen e punëve në bazën ushtarake - detare të Vlorës me kërkesën për t'ia bërë të ditur qeverisë shqiptare.

Pala shqiptare e konsideroi të papranueshëm qëndrimin e palës sovjetike. Halim Budo kishte ripërsëritur se shqiptarët udhëhiqeshin nga marrëveshjet ekzistuese në përputhje me të cilat të gjitha anijet nënujore dhe mbiujore dhe ndërtimet në bazën e Vlorës ishin pronë e tyre. Të gjitha përpjekjet për të kundërshtuar këtë dukeshin të kota (Kaba, H. Çeku, E. 2011: 231-232).

Si pasojë e këtyre mosmarrëveshjeve, vendin tonë mbërriti me urgjencë zv.ministri i punëve të jashtme sovjetike, Firjubin bashkë me zëvendësin e parë të shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë së flotës luftarake - detare sovjetike Antonov dhe zëvendësin e shefit të shtatmadhorisë së flotës ushtarake - detare sovjetike Sergejev (1961, B.S. D. 42/6, fl. 68, AMPJ).

Ky delegacion erdhi me misionin për të ulur gjakrat dhe për të qetësuar situatën sidomos përsa i përkiste bazës së Vlorës. Por Enver Hoxha në librin e tij Hrushovianët shprehej ndryshe për ta. Sipas Hoxhës, Firjubini i kishte kërcënuar me fjalët. "Ne do ti marrim anijet dhe ju do t'ju gëlltitin imperialistët" (Hoxha, E. 1980: 435).

Komunikimi për bazën ishte vërtetë i tensionuar. Megjithatë edhe pse pala shqiptare dukej hermetike dhe e vendosur, u bënë disa leshime. Në një letër konfidenciale që mban datën 25 maj 1961, Firjubini i drejtohej zv. ministrit të jashtëm shqiptar Halim Budo dhe shkruante se në përputhje me afatin e koordinuar me palën shqiptare, 8 nëndetëset dhe baza lundruese kotelnikov në orën 8:00 të 26 majit të vitit 1961 do të largohej nga Gjiri i Vlorës (1961, B.S. D. 42/6, fl. 129, AMPJ).

Për këtë të dy palët kishin rënë dakort në takimet e mëparshme kur delegacioni sovjetik me në krye Firjugin vizitoi Tiranën. Përgjigjia e Halim Budos ndaj letrës së zv. ministrit të jashtëm sovjetik ishte pak a shumë kështu : "...Qeveria shqiptare nuk ka asnjë kundërshtim që të largohen nga gjiri i Vlorës 8 nëndetëset dhe baza lundruese Kotelnikov në të cilat shërbejnë ekuipazhe sovjetike. Së bashku me këto mjete duhet të largohet edhe i gjithë personeli i forcave ushtarake - detare sovjetike që deri atë ditë kishte shërbyer në cilësinë e instruktorëve në repartet e flotës ushtarake - detare shqiptare për të cilët nuk keni më nevojë..." (1961, B. S. D. 42/6, fl.131, AMPJ).

Në një takim të datës 22 qershor të ambasadorit tonë në Moskë Nesti Nase me zv. ministrin e jashtëm sovjetik Firjugin, takim i tensionuar tepër duhet thënë, në një moment hasur në kundërshtimet e Nases, rreth mosmarrëveshjeve të fundit për bazën e Vlorës, Firjugin i thotë këtij të fundit me sarkazëm: "Çfarë do të bëjë qeveria juaj, mos vallë do të dërgojë desantë apo do të na invadojë" duke u përpjekur në këtë mënyrë të shprehë supremacinë e Bashkimit Sovjetik (1961, B. S. D. 42/6, fl. 157, AMPJ).

Delegacioni shqiptar për bisedime rreth bazës së Vlorës, kishte për kryetar Halim Budon zv. ministër i punëve të jashtme, anëtar k/admiral Hito Çakon, komandant i flotës lundruese detare të Shqipërisë, Gjeneral Todi Naçon komandant i artilerisë, etj (1961, B.S. D. 42/6, fl. 3, AMPJ).

Bisedimet mbi bazën reflektonin situatën e përgjithshme. Në një nga debatet e zhvilluara mes delegacioneve, Firjugin u shpreh mbi pronësinë e anijeve të bazës duke i thënë Halim Budos se ai ishte dakort me të. Kjo çështje ishte me të vërtetë e qartë sipas zyrtarit sovjetik. Të gjitha anijet dhe materialet e tyre ishin pronë e shenjtë dhe e padiskutueshme e shtetit dhe e popullit sovjetik (1961, B. S. D. 42/6, fl. 27, AMPJ).

Duhet thënë se pala shqiptare u tregua e vendosur gjatë gjithë ditëve të bisedimeve. Halim Budo sipas porosive që kishte marrë, përsëriste pa pushim se vendimi i qeverisë sovjetike për likuidimin e bazës cënonte rëndë sigurinë e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe e vendoste atë përpara rreziqesh të mëdha (1961, B.S. D. 42.6, fl. 63, AMPJ).

Një dokument konfidencial përmban listën e anijeve, vaporëve, pajisjeve dhe materialeve që ndodheshin në RPSH dhe duhet të ktheheshin në Bashkimin Sovjetik. Do të ktheheshin andej nga kishin ardhur 12 nëndetëse, 2 baza lundruese, 6 gjuajtësa kundër nëndetëseve, 6 dragamina, 1 tanker, 1 draga, 2 rimorkiatorë detarë, 1 dok lundrues, 3 anije polumbare, 1 anije hidrografike dhe 3 katera të radës, bateri artilerie, transportues të ndryshëm, pajisje dhe materiale të ndryshme ndihmëse, pajisje të aerodromit të Vlorës, mekanizma ndërtimi të lëvizshme etj (1961, B. S. D. 42/6, fl. 112-113-114, AMPJ).

Thyerja e marrëdhënieve mes dy vendeve pati pasoja në shumë fusha. Dy vjet më parë në janar të vitit 1959 qeveria sovjetike kishte vendosur të ndërtonte në Tiranë një pallat kulture si dhuratë nga Bashkimi Sovjetik për popullin shqiptar. Pak para vizitës së Hrushovit në Shqipëri, në prill 1959 arkitekti Butuzov mbërriti në Tiranë me një skicë projekti për pallatin e kulturës. Duke filluar nga janari 1961 pala sovjetike i ndërpreu furnizimet e ndërtimit të pallatit si në projekte dhe materiale (1961, S. D. 51, fl. 24-26, AMPJ). Në korrik pala sovjetike i dorëzoi palës shqiptare një promemorie për ndërprerjen e punimeve për pallatin e kulturës (1961, B. S. D. 51, fl. 28, AMPJ).

Nuk ishin të paktë në numër shqiptarët të cilët ishin vendosur në Moskë gjatë kohës së marrëdhënieve të shkëlqyera me këtë superfuqi. Por pas thyerjes së madhe, me urdhër të qeverisë shqiptare u nisën për në atdhe shumë studentë, oficerë etj. Por kishte dhe nga ata që refuzuan të ktheheshin dhe nga pala shqiptare ky veprim u interpretua si pengmarrje nga ana e sovjetikëve. Në një dokument sekret drejtuar ministrit shqiptar të mbrojtjes Beqir Balluku nga ana e gjeneral kolonelit sovjetik Gusjev, flitej për tre ushtarakë shqiptarë përkatësisht, Jani Lufi, Aristotel Poga, Ilia Kovaci të cilët kishin refuzuar në mënyrë kategorike të ktheheshin në Shqipëri dhe kishin kërkuar strehim politik në Bashkimin Sovjetik (1961, B.S. D. 42/19, fl. 31, AMPJ).

Ata ishin një grup dëgjuesish ushtarakë shqiptarë që studionin në akademinë ushtarake "Frunze" të Bashkimit Sovjetik të cilët sipas një letre dërguar më herët në drejtim të organeve sovjetike të mbrojtjes nga ministri jonë i mbrojtjes Beqir Balluku, nuk ishin lejuar të

ktheheshin në Shqipëri. Fakt që pala sovjetike e hodhi poshte si më lart me argumentin se ushtarakët shqiptarë kishin kërkuar azil politik (1961, B.S. D. 42/19, fl. 28, AMPJ).

Në një tjetër dokument konfidencial që mban datën 26 gusht 1961 thuhet se në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik vazhdonin të vinin informata se disa studentë dhe dëgjues shqiptarë që ndiqnin në atë kohë studimet në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik përhapnin trillime dhe shpifje të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet sovjeto - shqiptare si dhe përpiqeshin të tërhiqnin në bisedime provokuese studentët sovjetikë dhe të tjerët të huaj.

Sovjetikët pretendonin në këtë notë verbale drejtuar ambasadorit të RPSH-së në Moskë se studentët shqiptare thyenin hapur disiplinën dhe rregullat e bashkëjetesës socialiste, fyenin pedagogët dhe studentët sovjetikë, refuzonin të përgjigjeshin në provime dhe disa lëndë të parashikuara në planin mësimor. Me këtë pretendim pala sovjetike kërkonte largimin e këtyre studentëve nga Bashkimi Sovjetik (1961, B.S. D. 42/11, fl. 18, AMPJ).

Pala shqiptare nuk ishte dakort me ndërprerjen e marrëveshjes për studimin e shtetasve shqiptarë në institutet e larta të Bashkimit Sovjetik. Kështu në një relacion të datës 16 shtator 1961 thuhej se të ngarkuarit me punë të Bashkimit Sovjetik Krekotenj i është dorëzuar një notë kundër anulimit të marrëveshjes. Krekotenj e argumentoi këtë me faktin se kishte pasur raste të mungesës së disiplinës, dhe mosbindje ndaj komandantëve të shkollave sovjetike nga ana e ushtarakëve shqiptarë, si dhe ishte folur hapur kundër partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ndërkohë duhej kujtuar se studentët shqiptarë financiarisht mbështeteshin nga qeveria e Bashkimit Sovjetik (1961, B.S. D. 42/11, fl. 23-24, AMPJ).

Një tjetër sprovë për një tjetër delegacion shqiptar ishte ajo e 3 gushtit 1961. Ramiz Alia mbërriti në Moskë në datën 1 gusht dhe u prit ftohtë nga dy zyrtarë sovjetikë, përkatësisht Pisarjev dhe Lesakov. Delegacioni shqiptar u vendos në hotel Moska (1961, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.3, AQSH). Alia i shkruante Enver Hoxhës rregullisht për ti treguar çdo hap, çdo sjellje, çdo mëdyshje. Ai përmendte vazhdimisht se asnjë njeri nuk dukej tek shqiptarët, me përjashtim të një zyrtari të rëndomtë sovjetik Llaptievit për ndonjë komunikim rutinë, ndërkohë që ditën e kalonin me shokët e ambasadës (1961, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 5, AQSH). Mbledhja e gushtit në Moskë kishte si qëllim të miratonte planin e masave për përgatitjet

lidhur me përfundimin e traktatit të paqes me Gjermaninë demokratike si dhe mbi thirrjen e konferencës së paqes (1961, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.7, AQSH). Pas hapjes së mbledhjes së radhës së traktatit të Varshavës dhe hyrjes që bëri Hrushovi, Ulbrihti propozoi menjëherë që delegacioni shqiptar të mos pranohej në mbledhje, pasi nuk ishte i pranishëm sekretari i parë i partisë, në këtë rast Enver Hoxha. Ai pretendoi se shokët shqiptarë në këto kohë krize nuk po merrnin përgjegjësi dhe sipas tij kjo tregonte mungesë uniteti dhe përgjegjësie (1961, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.12, AQSH).

Situata në mbledhje u acarua pas fjalës së përfaqësuesit të Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë Ramiz Alia, i cili justifikoi mungesën e sekretarit të parë me argumentin se ky i fundit ishte sëmurë. Por reagimi i Hrushovit ishte i menjëhershëm. Ai thërriste ashpërsisht në drejtim të Alisë me fjalët : " Ke ardhur të na prishësh mbledhjen, të na sabotosh, se nuk ke të drejtë të flasësh, ti nuk je Komiteti Qëndror, por vetëm një përfaqësues i tij"(1961, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.12, AQSH).

Ulbrihti propozoi përpilimin e një letre të firmosur nga të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes dhe anëtarë të traktatit të Varshavës drejtuar Komitetit Qëndror të PPSH-së për sa i përket pakënaqësive që kishin kundërt Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj. Ramiz Alia u përpoq shumë të argumentonte se duhet të merrte pjesë në mbledhje si përfaqësues i Partisë së Punës por fjala e tij nuk u morr parasysh, përkundrazi e shtoi edhe më shumë tensionin. Propozimi i Ulbrihtit u miratua, ndërkohë që forcat e sigurisë tentuan të nxirrnin me forcë nga salla e mbledhjes delegacionin shqiptar (1961, MPKBS, F. 14, D. 6. fl. 3, AQSH).

Në një raportim të të dërguarve tanë në Moskë për mbledhjen e gushtit, thuhej se delegacioni kinez e mbrojti Shqipërinë me vendosmëri në këtë mbledhje.

Ndërkohë në mbledhjen e ministrave të mbrojtjes që u bë në Varshavë ku mori pjesë edhe Greçko, Shqipëria nuk u thirr. Shtypi sovjetik nuk shkruajti asgjë për muajin e miqësisë mes BS-së dhe Shqipërisë ndërkohë që specialistët ishin larguar të gjithë nga Shqipëria. Në këtë kohë Hrushovi në një nga daljet e tij e kishte quajtur Jugosllavinë vend socialist në sy të Popoviçit kur vizitoi Bashkimin Sovjetik. Duke folur në lidhje me manovrat e NATO-s në

Ballkan, Hrushovi tha se kërcënohet aleatja e tyre Bullgaria pa e përmendur Shqipërinë (1961, B. S. D. 39, fl. 1- 2- 3, AMPJ).

Fundi i verës së atij viti për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik ishte mjaft i nxehtë dhe i padurueshëm. Shtypi shqiptar shkruante për nevojën e Shqipërisë për ti siguruar me forcat e veta të mirat materiale dhe të ishte vetefektive në shumë fusha dhe kryesisht në jetën ekonomike të vendit (1961, 23 gusht, " Zeri i Popullit).

Në një mbledhje në nëntor të vitit 1961 zhvilluar në Moskë Komiteti Politik Konsultativ i Traktatit të Varshavës pa pjesëmarrjen e përfaqësuesit të qeverisë shqiptare e cila as që u njoftua për këtë mbledhje, vendosi në mënyrë të njëanshme përjashtimin e republikës popullore të Shqipërisë nga organizata e traktatit të Varshavës, thuhet në një dokument të atyre ditëve. Qeveria shqiptare e dënoi këtë akt të ri “antishqiptar” siç e quan ajo dhe “antisocialist” që i shtohet vargut të “sulmeve” dhe veprimeve “të padrejta” kundër RPSH-së dhe popullit shqiptar nga Nikita Hrushov dhe nga ata që e pasojnë. Ishte ky opinion i dokumentuar i palës shqiptare (1961, B. S. D. 42/5. fl. 82, AMPJ). Shqipëria ishte i vetmi vend komunist që nuk e përgëzoi dhe uroi Ulbrihtin në 13 gusht 1961 për ngritjen e murit mes përmes Berlinit duke e ndarë atë në dy pjesë, lindor dhe perëndimor (1961, 15-31 gusht, " Zeri i Popullit").

Më 19 gusht 1961 ambasadori i Bashkimit Sovjetik në Tiranë Shikin u largua nga vendi. Ai as nuk u kthye më në Shqipëri por as nuk u zëvendësua nga dikush tjetër (1961, MPKBS, F. 14, fl.16, AQSH).

Largimi i Shikinit nga Shqipëria siç tregon edhe një dokument i mëvonshëm i arkivave shqiptare tregonte dhe sinjalizonte kolapsin total të marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike. Më 24 gusht komiteti qendror i partisë komuniste të BS-së, në komunikimin e tij të fundit me Tiranën zyrtare në një dokument me një gjuhë mjaft të ashpër, deklaronte se udhëheqësit shqiptarë ishin bërë agjentë të shërbimeve sekrete të agjensive të huaja dhe dukej se çdo zhvillim ia faturonin Enver Hoxhës dhe shokëve të tij, mendime dhe opinione që Hrushovi do ti bënte publike në tetorin e ardhshëm (1962, 15 mars, 1962, 13 prill, 1961, 30 shjetor, "Zëri i Popullit").

Të dyja palët me propagandën e tyre gjatë muajit shtator shpallur edhe si muaji i miqësisë midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë e bënë mjaft të qartë së marrëdhëniet mes Moskës dhe Tiranës ishin tensionuar seriozisht (1961, 1 shtator " Zëri i Popullit"). Fjalimi i Hysni Kapos mbajtur në mbledhjen për muajin e miqësisë përmbante thënie të lavdishme nga Lenini dhe Stalini por nuk u përmend në asnjë çast Hrushovi (1961, 2 shtator, " Zëri i Popullit").

Më 5 shtator të po atij viti Hrushovi dha një intervistë për gazetarin dhe editorialistin e njohur të New York Times Cyrus L. Sulzberger. Në këtë intervistë ndër të tjera Hrushovi deklaroi : " Natyrisht që ne e konsiderojmë Jugosllavinë një shtet socialist" (New York Times, 1961: 11). Dhe sigurisht kjo ishte një deklaratë e fortë. Në këtë intervistë Hrushovi foli publikisht për një çështje ideologjike të pa prekur që prej prishjes së marrëdhënieve me Kinën komuniste e cila ishte edhe molla e sherrit mes tyre. Kjo ishte gjithashtu një shenjë se marrëdhëniet mes Tiranës dhe Moskës ishin thyer në atë formë që nuk do të kishin kthim mbrapa në kohërat e muajit të mjalitit mes dy vendeve. Dhe si për ti nevrikosur edhe më tej shqiptarët, Hrushovi deklaroi në intervistë : " ...dhe nëse Jugosllavia do të sulmohej nga një shtet imperialist, dhe do të na kërkonte ndihmë ne, unë mendoj se ne nuk do ta refuzonim kërkesën dhe do ta ndihmonim atë..." (New York Times, 1961: 11).

Presioni në rritje i sovjetikëve i dha efektet e tij në fund të shtatorit. Enver Hoxha në një fjalim të tij të datës 30 shtator, mes rreshtash donte ti bënte të ditur botës, se Shqipëria nuk do ti dorëzohej presionit sovjetik. " Imperialistët, revizionistët e Beogradit dhe të gjithë armiqtë e partisë sonë që kanë tentuar me çdo kusht me anë të kompleteve e bllokazheve, ta thyejnë apo ta zhdukin partinë tonë dhe të vënë nën kontroll popullin tonë, këta armiq mendojnë se lehtësisht mund të likujdojnë Shqipërinë sepse është një vend i vogël. Por ata i kanë bërë llogaritë gabim, kanë dështuar, dhe do të dështojnë me turp sepse ata i janë kundërvënë dhe do ti kundërvihen gjithmonë një fortese shkëmbore, e cila mbrohet heroikisht dhe nga një popull i guximshëm dhe partia e tij. Ata që kërkojnë ti hapin gropën Shqipërisë do të bien vet brenda..." (1961, 1 tetor, " Zëri i Popullit").

Të njëjtën linjë me Bashkimin Sovjetik në drejtim të marrëdhënieve me Shqipërinë po mbanin edhe vendet e tjera socialiste të Europës lindore satelitë të superfuqisë sovjetike. Më

datë 23 tetor 1961 me rastin e festës së ushtrisë rumune u mbajt një koktejl në Beograd ku ishte thirrur edhe Tahmaz Beqari, ambasadori ynë atje i cili u takua gjatë koktejlit me Djedushkinin këshilltarin e ambasadës sovjetike në Beograd. Biseda mes tyre u përqëndrua kryesisht tek mosmarrëveshjet mes BS-së dhe Shqipërisë. U fol madje edhe për faktin se delegacioni shqiptar nuk u ftua në punimet e kongresit të partisë komuniste të BS-së organizuar nga Hrushovi. Beqari ndër të tjera nuk hezitoi ti thote Djedushikinit se Hrushovi prej kohësh kishte deklaruar dhe vepruar kundër Shqipërisë, dhe në atë kohë veçse i deklaroi qëllimet e tij hapur (1961, B. S. D. 42/2, fl. 62, AMPJ).

Përveç Djedushkinit përfaqësuesit tonë diplomatik, iu afrua edhe ambasadori bullgar dhe ai i Rumanisë. Bullgari Atanasov i tha Tahmaz Beqarit se në Shqipëri nuk ishte bërë analizë dhe nuk ishte dënua siç duhet kulti i individit. "Ju keni vrarë Liri Gegën në një mënyrë të tillë që nuk bën vaki në asnjë vend në botë dhe komiteti juaj qëndror përbëhet nga njerëz farë e fis. Ndërkohë Teme Sejko nuk dihet si është dënua nga ana juaj. Enver Hoxha nuk ka shkua në mbledhjet e organizuara në Moskë ku ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste, por ai qenka njeri i madh dhe nuk mund të bisedojë me ta..." ironizonte Atanasovi me udhëheqjen shqiptare (1961, B. S. D. 42/2, fl. 62, AMPJ). Shandron, i dërguari me punë i Rumanisë në Beograd gjithashtu nuk ngelet mbrapa në akuzat ndaj homologut shqiptar.

" Përse i mbani akoma bustet e Stalinit dhe fotografitë e tij? Përse i mbani në burg komunistët? Pse e përjashtuat nga partia Liri Belishovën? Me çfarë mendje shkoni kur thoni se komunistët sovjetikë dhe populli sovjetik është me ju, kur rruga e filluar nga ju i ngjan asaj të nisur nga jugosllavët në vitin 1948..." (1961, B. S. D. 42/2, fl. 63, AMPJ). Më datë 6 nëntor 1961, Gac Mazi i dërguari ynë në Moskë, largohet në shenjë proteste nga mbremja akademike ku u fol kundër Shqipërisë (1961, B. S. D. 42/2, fl. 83, AMPJ). Gazetari Xhafer Bagllamaja shkruante nga Pekini në tetor të atij viti se në hotelin ku flinte gjatë udhëtimit të tij në Kinë kishte takuar rastësisht një sovjetik të cilin e pati njohur në krahinën e Krasnodarit kur shoqëronte një delegacion shqiptar për bujqësinë në vitin 1958 të cilin e quanin Usenko. Në takimin e parë, thotë Bagllamaja, u tregua shumë i çuditshëm, më vonë e kishte marrë në telefon dhe i kishte kërkuar takim duke i kërkuar të falur që ishte larguar aq shpejt. Sovjetiku

sipas gazetarit shqiptar kishte rrëfyer më vonë se kishte qenë në Jugollavi i dërguar nga ministria e bujqësisë.

Ai gjithashtu i kishte treguar se nuk i kishte shkruar letra pasi nga ana e shtetit ju thuhet vazhdimisht shumë gjëra, si për shembull që shqiptarët duan luftë, që kanë rënë në pozitë nacionaliste antisovjetike etj. Gjithashtu i kishin porositur te mos u shkruanin më shqiptarëve se mund ti merrnin në qafë dhe mund ti akuzonin si miq të Bashkimit Sovjetik dhe do ta pësonin si Liri Belishova.

Usenko I kishte thënë Bagllamasë se nuk i besonte këto, duke qenë me parrullën e parë : "Dy miqtë tanë më të ngushtë janë populli shqiptar dhe ai kinez" (1961, B. S. D. 42/4, fl. 70, AMPJ).

“ Më 8 Nëntor ambasadori sovjetik shtroi një drekë ku ishin të ftuar të gjithë titullarët e vendeve socialiste përveç atij shqiptar. Ishte i ftuar edhe shoku Cen....” shkruan ambasadori shqiptar në Pekin. Ky i fundit i kishte thënë se pasi mori dijeni që Shqipëria nuk ishte ftuar e refuzoi ftesën (1961, B. S. D. 42/4, fl. 130, AMPJ). Dukej se perfaqësitë shqiptare në të gjithë botën sipas raportimeve të të dërguarve tanë në selitë diplomatike, ishin pre e provokimeve nga Bashkimi Sovjetik. Në ambasadën tonë në Paris kishte ndodhur provokimi i radhës. Vinogradovi , ambasadori sovjetik atje, kishte thënë se shqiptarët e konsideronin Bashkimin Sovjetik si armik, shqiptarët kishin ndryshuar, shqiptarët e kishin vënë veten jashtë traktatit të Varshavës dhe në këtë mënyrë po shkëputeshin edhe nga kampi. Sipas zyrtarit sovjetik, ishin shqiptarët ata që trajtonin keq oficerët e bazës së Vlorës, ishin shqiptarët ata që ishin izoluar dhe si rrjedhojë kishin mbetur vetëm se edhe Kina i braktisi. Biseda u zhvillua në pritjen e Etiopisë në Paris ndërkohë që ambasadori ynë atje po bisedonte me hungarezin, rumunin dhe bullgarin për veprimtarinë armiqësore të titistëve (1961, B. S. D. 42/4, fl.144, AMPJ). Më dt. 16 nëntor ambasadori shqiptar në Moskë u thirr nga zv.shefi i protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të BS-së, Koliçev dhe iu komunikua sa më poshtë : "Jam i ngarkuar të dakloroj se në të ardhmen ambasada e RPSH-së në Moskë, kontaktet e saj me institutet dhe dikasteret sovjetike duhet ti bëjë vetëm nëpërmjet degës së protokollit të ministrisë së punëve të jashtme të BS-së. Duhet cilësuar se pala shqiptare disa

muaj më parë ka vënë një rregull të tillë për përfaqësinë sovjetike në Shqipëri. Pala sovjetike është e detyruar të marrë masa të tilla sepse e përsëris një masë e tillë është marrë nga pala juaj kundër njerëzve tanë në Tiranë" (1961, B. S. D.37, fl.1-2, AMPJ).

Më 22 nëntor zv. ministri i jashtëm shqiptar Vasil Nathanaili thirri të ngarkuarin me punë të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri, Krekotenj dhe i bëri deklaratat e mëposhtme:

" Bashkimi Sovjetik ka anuluar gjithë marrëveshjet e kredive, ekonomike dhe ushtarake me Shqipërinë, keni tërhequr specialistët dhe në këto kushte është e pamundur që ambasada sovjetike të mbajë një staf kaq të madh sa ky që ka sot, pasi ky personel nuk ka çfarë të bëjë më në Shqipëri" (1961, B. S. D. 37, fl. 3-4, AMPJ).

Diplomati sovjetik Krekotenj e quajti një akt të ri armiqësor këtë që i propozoi Nathanaili për ambasadën sovjetike në Tiranë.

Ndërkohë Nathanaili nuk e pranoi që masa e ndërmarrë nga pala shqiptare ishte veprim armiqësor, por të gjitha masat që kanë marrë deri në atë çast sovjetikët për anulimin e marrëveshjeve me Shqipërinë ishin të tilla (1961, B. S. D. 37, fl. 3-4, AMPJ). Në një relacion të përpiluar nga ambasadori shqiptar në Berlin Gaqo Paze më datë 27 nëntor 1961 shkruhet se disa familje të nëpunësve të ambasadës kanë patur mjaft të njohur sovjetikë sepse ambasada jonë ndodhej në rajonin ku banonin edhe sovjetikët. Marrëdhëniet midis familjeve kanë qenë shumë të mira. Por si rezultat i qëndrimit të ftohtë të sovjetikëve këto marrëdhënie kohët e fundit ishin keqësuar shumë. "...Mundohen të mos i takojnë dhe të mos u flasin fare. Madje disa fëmijë sovjetikë u kanë thënë fëmijëve shqiptarë se shqiptarët janë fashistë, janë armiq të BS-së dhe prandaj ata nuk duan të takohen me shqiptarët...." (1961, B. S. D.42/4, fl. 22, AMPJ).

Ndërkohë që marrëdhëniet shqiptaro - sovjetike tashmë po shkonin drejt fundit, Enver Hoxha po forconte miqësinë me Kinën komuniste. Kongresi i katërt i Partisë së Punës së Shqipërisë mbajtur në Tiranë në muajin shkurt të 1961-it, ishte shtyrë dy herë (1961, 14-21 shkurt, " Zëri i Popullit") .

Në hapje të tij spikeri, në këtë rast Abdyl Këllezi, deklaroi: " Miqësia mes shqiptarëve dhe popullit kinez është e madhe dhe e pathyeshme" (1961, 14 shkurt. " Zëri i Popullit").

Kongresi i katërt i PPSH-së ishte i mbushur me fjalime mbi ideologjinë dhe vijën politike të partisë. Një nga pjesët më të rëndësishme të fjalimit të Enver Hoxhës ishte i ashtuquajti komplot kriminal i ndërmarrë nga ana e jugosllavëve dhe grekëve kundër vendit tonë me bekimin e amerikanëve siç deklaronte në atë kohë Hoxha publikisht. " Jugosllavia dhe Greqia në bashkëpunim me disa tradhëtarë shqiptarë, të cilët janë ende në vendin tonë apo kanë dezertuar për në Jugosllavi dhe në lidhje me flotën e gjashtë amerikane në Mesdhe..." (1961, 20-22 shkurt, " Zëri i Popullit") .

Enver Hoxha e kishte fjalën për një komplot të verës së vitit 1960 me shumë mundësi me mbështetjen e Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik për të rrëzuar Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun si rezultat i të cilit Belishova, Tashko dhe disa të tjerë u përjashtuan dhe arrestuan. Pavarësisht kësaj, Hoxha publikisht i qëndronte besnik versionit të një komploti jugosllavo - greko - amerikan (1961, 20-22 shkurt, " Zëri i Popullit").

Sulmi që i bëri Hrushovi Shqipërisë në kongresin e XXII-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik bëri që çështja shqiptare papritur të shpërthejë në arenën ndërkombëtare. Ashtu siç ai e kishte nënkuptuar në fjalim, sulmi i tij i drejtohej çdo partie komuniste që ndërmernte një qëndrim publik ndaj çështjes shqiptare ose më saktë që të bëheshin publike qëndrimet që ata vet i kishin mbajtur në mbledhjen e 81 partive një vit më parë. Sulmi i Hrushovit ndaj Shqipërisë ishte i ndarë në dy plane, në atë organizativ dhe politik (1961, 31 tetor, " Pravda"). Në fjalën e tij ndër të tjera Hrushovi e akuzoi lidërshtpin shqiptar si njerëz që vranë një grua shtatzënë:

"Pak vite më parë komiteti qëndror i partisë komuniste të BS-së, ndërhyri për ndërmjetësim me liderët shqiptarë për fatin e Liri Gegës një ish anëtare e byrosë politike të komitetit qëndror të PPSH-së e cila u dënua me vdekje bashkë me burrin e saj... Ne u udhëhoqëm nga njerzillëku dhe nga ankthi i të qëlluarit kundrejt një gruaje shtatzënë ose qoftë edhe një gruaje. Ne e ndjemë dhe ende e ndjejmë që si një parti motër e kishim dhe e kemi të drejtën e një opinionit për këtë çështje... ata u treguan mizorë.." (1961, 31 tetor " Pravda")

Bashkë me Tuk Jakovën, Liri Gega ishte ndoshta e përfshirë në tentativën e vitit 1956 për të rrëzuar Hoxhën dhe Shehun nga pushteti. Mbrojtja e Hrushovit ndaj saj me siguri i zemëroi keqazi liderët shqiptarë të kohës por në fjalimin e tij në kongres Hrushovi shkoi edhe më tej kur tha se Liri Belishova dhe Koço Tashko, figura të famshme të PPSH-së jo vetëm që u përjashtuan nga partia por u quajtën edhe armiq të partisë dhe popullit. Dhe e gjitha kjo sipas liderit sovjetik sepse Liri Belishova dhe Koço Tashko ishin kurajozë dhe të ndershëm dhe dolën hapur pro Bashkimit Sovjetik (Fischer, G. George, R. Graham, L. Levine, H. 2012:27).

Ashtu si politika edhe fjalimet e Hrushovit kundër udhëheqjes shqiptare ishin të ndara në dy plane. "Dogmatizmin dhe sektarizmin" dhe "nacionalizmin e ngushtë dhe revizionizmin". Sipas Hrushovit tërheqja e Tiranës zyrtare nga tezat e kongresit të XX-të të PK-së së BS-së, çoi në rritjen e kultit të individit, abuzimin me autoritetin e liderit, dhe si rrjedhim edhe fraksionim të normave të leninizmit (1961, 23 tetor, " Pravda") .

Duke folur në 26 tetor 1961 Otto Kuusinen, më i vjetri në moshë dhe anëtar i lartë i presidiumit, i vetmi që e kishte njohur Leninin dhe kishte qënë gjithashtu një anëtar i lartë i

kominternit deklaroi se Hoxha kishte arrestuar shqiptarë të cilët ishin avokatë të miqësisë me Bashkimin Sovjetik (Belishova dhe Tashko), dëbuan nga vendi gjithë specialistët sovjetikë dhe përhapën llafe të rreme sikur Moska kishte ndërprerë furnizimin me grurë për Shqipërinë. Kuusinen publikisht mbrojti pretendimet e Greqisë për Epirin e veriut (1961, 27 tetor, " Pravda") Dhe në fakt sipas dokumenteve, sovjetikët i ndërprejnë vërtetë furnizimet me grurë për Shqipërinë në verën e 1960-ës, dhe intervista e Hrushovit me Venizellosin dha sigurisht përshtypjen, të cilën sovjetikët në atë kohë nuk e mohuan, që Moska nuk ishte plotësisht kundër pretendimeve të Greqisë (Griffith, E. W. 1963: 95).

Kongresi i PK-së të BS-së ishte i mbushur me fjalime e deklarata të gjitha kundër grupit anti parti dhe kundër Shqipërisë. Në fjalimin e tij të dytë Hrushovi deklaroi për herë të parë si një lider sovjetik se Hoxha dhe Shehu nuk kishin publikuar draft programin e partisë komuniste të BS-së dhe gjithashtu kishin hequr dhe i kishin nënshtruar me dhunë Belishovën dhe burrin e saj, ministrin Maqo Çomo, kishin hequr Tashkon, kishin shtypur studentët shqiptarë dhe marinarët që po ktheheshin nga Bashkimi Sovjetik dhe po ngrinin në nivele mjaft të larta

kultin e individit të Stalinit. Gjithashtu ai deklaroi se në shkurt të vitit 1961 në kongresin e PPSH-së Mehmet Shehu kishte thënë se të gjithë ata që nuk janë dakort me lidershipin do të merrnin " ..një pështymë në fytyrë, një grusht në nofull, dhe nëse do të jetë e nevojshme dhe një plumb ballit.." (1961, 18 shkurt, " Zëri i Popullit").

Reagimi i shqiptarëve kundër kongresit të XXII-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik erdhi në periudhën e fundit të tetorit, fillimi i nëntorit. Si fillim u botua një editorial në gazetën " Zëri i Popullit" ku një ditë më vonë u botua i plotë gjithë sulmi i Hrushovit kundër Shqipërisë (1961, 18-19 nëntor, " Zëri i Popullit").

Dokumentet e arkivuara të asaj kohe janë të mbushura me një gjuhë të ashpër, mjaft agresive e cila nuk ishte vënë re më parë në asnjë nga konfliktet verbale që mund të kishin ekzistuar mes vendeve komuniste madje as në momentet më të akullta të Kinës me Bashkimin Sovjetik. Shqiptarët e quajtën Hrushovin një njeri të ulët, pa themel dhe një anti marksist, një komplotist dhe një puçist, një juda i vërtetë, fjalët e tij u quajtën demagogji dhe hipokrizi njëloj si ato të imperialistit Tito (Brown, J.F. 1962: 29-30)

Komiteti Qëndror i PPSH-së formuloi menjëherë një notë proteste ku ndër të tjera thuhej :

"Nikita Hrushov, duke iu treguar armiqve divergjencat që në kohëra kishin ekzistuar mes udhëheqjes së partisë komuniste të BS-së dhe PPSH-së dhunoi në mënyrë brutale deklaratën e Moskës të vitit 1960 e cila e vë theksin tek diferencat të cilat ishin në rritje mes partive motra dhe duheshin zgjidhur me qetësi, me shpirtin e internacionalizmit proletar dhe në bazën e principeve të barazisë dhe këshillimeve." (1961, 1 nëntor, " Zëri i Popullit"). Qëndrimi i plotë i Shqipërisë i cili u bë publik përciptazi në dy editorialet e "Zërit të Popullit", nuk u shfaq plotësisht deri në ligjëratën e 7-të publike për këtë çështje të liderit komunist Enver Hoxha. Ky fjalim ishte edhe një burim shumë i mirë dokumentar jo vetëm për të kaluarën dhe të tashmen e marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike por edhe për grindjen mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës.

Në librin e tij " Hrushovianët " Enver Hoxha shkruan se Hrushovi menjëherë mori jo vetëm përgjigjen tonë por të mbarë popullit shqiptar : "... me mijëra telegrame dhe letra që erdhën

ato ditë në adresë të komitetit tonë qendror nga të gjitha anët e vendit , nga shtresat më të ndryshme të popullsisë, komunistët dhe populli yne duke shprehur indinjatën e thellë e legjitime ndaj veprimeve tradhëtare të Hrushovit mbështetnin me gjithë forcat vijën e partisë " (Hoxha, E. 1980:447).

Sidomos të mërzhitur ishin studentët që ishin kthyer nga vendet e lindjes e midis tyre ata që ende nuk kishin mbaruar, por u ishte ndërprerë e drejta për të vijuar. Ata rrinin të mërzhitur dhe përgjonin gjithë ditën radiot. Flisnin hapur kundër udhëheqjes shqiptare por në të vërtetë diçka prisnin... (Ngjela, S. 2011: 278).

Te hënën, mëngjesin e datës 20 Nëntor, ambasada shqiptare në Moskë ndërmorri një veprim sigurisht nën urdhërat dhe udhëzimet e Tiranës, dhe ndoshta e planifikuar më herët. Sipas agjensisë së lajmeve franceze të asaj kohe AFP, ambasada shqiptare në Moskë u dorëzoi gjithë përfaqësive diplomatike të vendeve me të cilat kishte marrëdhënie diplomatike një dokument të zgjeruar që kishte të bënte me historinë, gjeografinë, jetën kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë.

Gjithashtu këtu përfshiheshin edhe tre dokumente që flisnin për marrëdhëniet shqiptaro - sovjetike, deklaratën e 20 tetorit të PPSH-së, fjalimin e 8 nëntorit të liderit komunist Enver Hoxha (përkatësisht fjalimi i tij i shtatë) dhe një deklaratë nga komiteti qendror i partisë që kishte lidhje me debatet e zhvilluara në gusht të atij viti në Moskë nga përfaqësuesit e traktatit të Varshavës në lidhje me traktatin e paqes me Gjermaninë. Dy dokumentet e para ishin botuar në Tiranë ndërsa në të tretin shqiptarët akuzonin Hrushovin se kishte dëmtuar lëvizjen komuniste botërore duke e shtyrë nënshkrimin e traktatit të paqes për Gjermaninë në kundërshtim me marrëveshjet e Gushtit (1961, 24 nëntor, " Neue Zurcher Zeitung").

Sovjetikët këtë veprim e cilësuan si një përpjekje të qeverisë shqiptare për të informuar perëndimorët kapitalistë për pikëpamjet e saj antisovjetike (1961, 12 dhjetor " Pravda").

Pas kongresit të XXII-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik në tetor të vitit 1961 kur Nikita Hrushov e sulmoi shumë ashpër dhe hapur Enver Hoxhën, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik morrën goditjen përfundimtare. Më 3 dhjetor 1961

Bashkimi Sovjetik ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë (1961, B. S. D. 37, fl. 6, AMPJ). Në një dokument sekret mbi takimin me zv. ministrin e punëve të jashtme të BS-së Firjubin, i dërguari me punë, Gac Mazi shkruan se Firjubini me porosi të qeverisë sovjetike i komunikoi se qeveria shqiptare duke ndjekur kursin e keqësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik veçanërisht pas kongresit të XXII-të të PK-së të BS-së, kishte krijuar një situatë të padurueshme për veprimtarinë normale të ambasadorit sovjetik në Tiranë dhe të diplomatëve të tjerë sovjetikë, ambasadori sovjetik sipas Firjubinit ishte vënë në kushte të tilla që nuk mund të zbatonte normalisht porositë e qeverisë së tij. Ambasada e Bashkimit Sovjetik në fakt gjëndej në një situatë izolimi me pretekstin se zhvillonte aktivitet armiqësor në Shqipëri. Në këto kushte qeveria sovjetike mori vendimin për të tërhequr përfundimisht nga Shqipëria ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të BS-së Shikin J.V (1961, B. S. D. 37, fl. 6, AMPJ).

Gjithashtu ministria e punëve të jashtme të Bashkimit Sovjetik i drejtoi ambasadës shqiptare në Moskë një notë proteste energjike dhe duke e konsideruar të pamundur më tej qëndrimin BS të ambasadorit të RPSH-së Nesti Nase. Gjithashtu sovjetikët kërkuan menjëherë pushimin e shpërndarjes së materialeve antisovjetike dhe përhapjen e propagandës armiqësore ndaj PK-së të BS-së dhe qeverisë sovjetike (1961, B.S. D. 37, fl. 10, AMPJ).

Në një letër dërguar Gac Mazit të dërguarit me punë në Moskë nga ministri i jashtëm Behar Shtylla thuhej: "...ti e kupton që për një periudhë ne nuk do të kemi ambasador atje. Dhe telashe patjetër do t'ju nxjerrin. Prandaj duhet të jeni kurdoherë të përgatitur. Të forconi bashkëpunimin me shokët Petro Godeshi dhe Kiço Kasapi në mënyrë që gjithçka të kryhet sa më mirë. Kujdes nga provokimet, mos u provokoni, dhe po ju provokuan jepuni përgjigjen e duhur..." (1961, B. S. D. 38, fl. 1/1, AMPJ).

Nga Amerika, Halim Budo përfaqësues i përhershëm në New York më 20 janar 1962 shkruante se në fjalimin që mbajti më 11 dhjetor 1961 në klubin kombëtar të shtypit në Washington ish ambasadori sovjetik në SHBA, Manshikov përse i përket Shqipërisë kishte thënë fjalë për fjalë "... të tjerët tregojnë interes të veçantë në dënimin që i bëri partia komuniste e Bashkimit Sovjetik si dhe përfaqësuesit e partive të tjera komuniste qëndrimit

të mbrapshtë të udhëheqësve shqiptarë që kanë rënë pas kultit të individit dhe bëjnë veprime egërsie të turpshme....." Fjalimi i tij u transmetua edhe nga televizionet amerikane. Teksti i fjalimit ra në duart e shqiptarëve nga ambasada sovjetike në Washington (1962, B. S. D. 42/4, fl. 73, AMPJ).

Pak pas vendimit të marrë nga qeveria sovjetike për të ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë në 3 dhjetor 1961, Vasil Nathanaili thirri për sqarime të ngarkuarin me punë të BS-së në Shqipëri, Krekotenj. Komunikimi i ndërprerjes së marrëdhënieve iu bë Gac Mazit në Moskë nga zv. ministri i jashtëm i BS-së Firjubin verbalisht. Në të njëjtën kohë biseda me Krekotenj ishte pa rezultat. Ai premtoi t'ia përcillte Moskës zyrtare ankesat e palës shqiptare për vendimin e 3 dhjetorit (1961, B. S. D. 42/14, fl. 68-69-73, AMPJ). Paralajmërim i ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike ishte një vendim i pak ditëve më parë. Bashkimi Sovjetik dhe Hungaria e kishin shfuqizuar marrëveshjen me Shqipërinë sipas së cilës lejohej udhëtimi pa viza i shqiptarëve në këto vende, e nevojshme për të shkuar në Kinë me anë të transportit ajror. Shqiptarët iu përgjigjën këtyre veprimeve menjëherë në 4 dhe 9 dhjetor, përgjigje këto të bëra publike në faqet e "Zërit të Popullit" të datës 10 dhjetor. Pala shqiptare në mënyrë shumë të hidhur dhe të dhunshme dha opinionet e saj për qëllimet, siç i quante, diabolike të Nikita Hrushovit dhe grupit të tij (1961, 10 dhjetor, " Zëri i Popullit"). Shpërthimet e shqiptarëve të cilat i bënë shpesh jehonë miqësisë dhe mirënjohjes së popullit dhe Partisë Komuniste shqiptare për popullin dhe Partinë Komuniste sovjetike nuk ishin shumë më të dhunshme dhe as më të veçanta se sa shpërthimet anti sovjetike të Pekinit. Ishte koha kur Abduzhei intervistonte presidentin amerikan Kennedy dhe koha e debateve në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për pranimin e Kinës komuniste në këtë organizatë (1961, 8 dhjetor, "Observer").

Në një tjetër artikull të "Pravdës" së 14 dhjetorit 1961, thuhej se devijimi i Enver Hoxhës nga bashkëjetesa paqësore ishte një divergjencë direkte nga principet e deklaratës së Moskës 1960 (1961, 14 dhjetor, " Pravda").

Artikulli i gjatë i "Pravdës" i cili sulmonte me fjalët më të egra liderët komunistë shqiptarë , si mizorë, përfundonte me një konkluzion që shqiptarët ishin duke i shërbyer imperialistëve

duke cituar kështu një pjesë të një artikulli të gazetës imperialistë siç e quanin ata New York Times :

"Nën perden e tymit të fjalëve të mprehta rreth besnikërisë së tyre për marksizëm - leninizmin dhe deklaratave e pakteve të partive simotra, liderët shqiptarë të PPSH-së në realitet zhvilluan një betejë të hapur kundër vijës së parë të lëvizjes komuniste. Nuk është dhe aq e papritur, prandaj imperialistët e kishin mirëpritur kursin e ndarjes së atëhershme të udhëheqjes komuniste shqiptare, me një aprovim të hapur..."(Zagoria, D. 1969:346-347)

Në një tjetër telegram Gaqo Paze nga Berlioni më datën 21 dhjetor 1961 njofton se Kristaq Misha ambasadori ynë në Francë i cili ishte takuar me të, njoftonte se Liu Ning anëtar i byrosë politike të Kinës u kishte komunikuar se nga shokët kinezë që kishin ardhur nga Egjipti ishte mësuar se në Kajro kishte shkuar një marrëshall sovjetik i cili i kishte propozuar Naserit udhëheqësit komunist të këtij vendi ti jepte një nëndetëse atomike me kusht që Naseri ti priste rrugën delegacionit shqiptar për në Kinë (1961, B.S. D. 42/4, fl.3, AMPJ).

Në një raportim të radio Moskës që mban datën 21 dhjetor 1961 pasqyrohen përshtypjet e një specialisti sovjetik në Shqipëri. Emri i tij ishte Igor Ponomarev një specialist materialesh ndërtimi. Sipas Ponomarevit gjatë periudhës së fundit të qëndrimit të tij në Shqipëri sjellja e qeverisë dhe e zyrtarëve në veçanti ata të ministrisë së ndërtimit kishte ndryshuar dukshëm ndaj tyre (1961, 21 dhjetor, " Radio Moska" 1500GMT). Ishte e dukshme që presioni, sipas specialistit sovjetik, kishte bërë punën e tij tek ata që shprehnin hapur simpatinë ndaj Bashkimit Sovjetik. " Kohët e fundit ne ishim të detyruar", tregon ai, "që edhe çështjet më banale teknike t'ua tregonim liderëve shqiptarë. Madje edhe kontaktet me punonjës të tjerë shqiptarë ishin bërë mjaft të vështira. Madje zyrtarët e ministrisë", tregon specialisti, "nuk bënë përparim për ta fshehur armiqësinë ndaj nesh" (1961, 21 dhjetor, " Radio Moska" 1500GMT) .

Në një artikull të "Zërit të Popullit" botuar vazhdimisht gjatë muajit dhjetor përkatësisht në datat 19, 20 dhe 30 dhjetor me titullin "Shpifjet dhe trillimet nuk qëndrojnë" tregohet e vërteta e palës shqiptare për sa i përket çështjes së specialistëve.

Sipas artikullit në fjalë sulmet anti marksiste dhe anti shqiptare të lëshuara nga Nikita Hrushovi dhe grupi i tij nga podiumi i kongresit të XXII-të të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik kundër partisë së punës përfshinin shpifje dhe trillime që kishin lidhje me specialistët sovjetikë të vendosur në Tiranë. Sipas Kuusinenit anëtarit të komitetit qëndror të partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, specialistët sovjetikë që po punonin në Shqipëri ishin larguar nga vendi me dëshirën e palës shqiptare. Ata pretendonin se specialistët sovjetikë fyheshin dhe trajtoheshin shumë keq në Shqipëri, por kjo gjë nuk pranohet kurrësesi nga pala shqiptare e cila kujton në këtë artikull momentet kur sovjetikët me kërkesën e tyre tërhoqën gradualisht specialistët e tyre nga Shqipëria (19,20,30 dhjetor, " Zëri i Popullit").

Dhjetori ishte një muaj kur tonet u ashpërsuan së tepërmi dhe situata mes të dy vendeve ishte më e zjarrtë se kurrë. Në shënimet e zv. ministrit të punëve të jashtme të Bashkimit Sovjetik V.V.Kuznjeçov dërguar komitetit qëndror të PK-së së BS-së ndër të tjera shkruhej se dokumentet karakterizoheshin nga një ton brutal krejtësisht i palejueshëm në praktikën ndërkombëtare dhe që përmbanin trillime e shpifje të zakonshme të udhëheqësve shqiptarë ndaj qeverisë sovjetikë (Kaba, H. Çeku, R. 2011: 262).

Në faqet e fundit të librit Hrushovianët, Enver Hoxha shkruan ndër të tjera se Hrushovi ndërmorri ndaj Shqipërisë edhe aktin final, të vetmen gjë që i kishte mbetur pa bërë. Ndërpreu në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet diplomatike me RPSH-në. Ky ishte gjesti i fundit i hakmarrjes së tij të dëshpëruar. **"Por gaboi tmerrësisht rëndë siç kishte gabuar gjithë jetën"** (Hoxha, E. 1980: 445).

Më 29 Maj të vitit 1962 "The Guardian" shkruante se Beogradi kishte lajmëruar se qeveria sovjetike kishte ftuar Titon të kalonte pushimet në Bashkimin Sovjetik, një delegacion parlamentar nga Jugosllavia vizitoi Moskën, dhe tregëtia mes të dy vendeve mori një hov të ri edhe me nënshkrimin e një marrëveshje tregëtare shumë planëshe (1962, 29 maj, " The Guardian").

Reagimi i shqiptarëve ndaj gjithë kësaj ishte mjaft i ashpër por gjithësesi liderët nuk iu kundërvunë Hrushovit në vetë të parë edhe për shkak se kinezët nuk i lejonin ta bënin këtë. Në një shkrim të gjatë të botuar tek " Zëri i Popullit " në 30 qershor Tirana zyrtare hodhi një

tjetër tezë : “ Klika e Titos është ura midis revizionistëve dhe imperialistëve, për aq kohë sa kjo lidhje nuk mund të dalë publikisht.. i frytshëm dhe mjaft gjithëpërfshirës, bashkëpunimi ka filluar me qëllimin për të konsoliduar forcat e revizionizmit modern në luftën e tij kundër Marksizëm - Leninizmit. Ky proces është për momentin në zgjerim të plotë dhe do të bëhet më konkret në të ardhmen" (1962, 23 qershor, " Zëri i Popullit").Ky ishte çasti, pas një përgjumjeje të lehtë, kur konflikti sovjeta - shqiptar u intensifikua.

Sulmet ndaj Hrushovit vazhduan, në fjalimin e Mehmet Shehut në 16 korrik i cili denoncoi lidhshkrimin sovjetik me në krye Nikita Hrushov (1962, 17 korrik, " Zëri i Popullit") dhe pak ditë më vonë një rezolutë e Komitetit Qëndror të PPSH-së iu referua aktivitetit armiqësor të Nikita Hrushovit dhe ndjekësve të tij (1962, 22 korrik, " Zëri i Popullit).

Pranvera e vitit 1962 u duk se do të sillte edhe një përmirësim të marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës për shkak të uljes së intensitetit të deklaratave polemizuese kineze apo shqiptare ndaj Bashkimit Sovjetik. Është e vërtetë që gjatë kësaj periudhe pati disa shenja sipërfaqësore që marrëdhëniet mes dy superfuqive komuniste po përmirësoheshin. Kjo për shkak se shtypi sovjetik rregullisht publikonte raporte, edhe pse të shkurtra dhe sipërfaqësore, për zhvillimin ekonomik të Kinës. Gjithashtu edhe shtypi kinez i dha një vëmendje të konsiderueshme fjalimit të Hrushovit në radio dhe televizion të datës 2 Korrik " (1962, 3 korrik. " Pravda").

Por gjithësesi Moska nuk u kursye gjatë kësaj periudhe në deklaratat e saj kundër pozicionit ideologjik të Tiranës zyrtare (1962, 19 korrik, 30 gusht , 5 shtator, " Radio Moska").

Në këtë kohë kur Kina intensifikoi sulmet kundër Jugosllavisë në krah të saj dolën edhe koreano - veriorët ndërkohë që kinezët filluan sërish të ribotonin sulmet e Shqipërisë së vogël kundër Bashkimit Sovjetik ashtu siç kishin bërë deri në Janar 1962 duke e sulmuar me emër Nikita Hrushovin (" South China Morning Post", 14 gusht 1962 : 30).

Pavarësisht piruetave diplomatike të bëra në arenën ndërkombëtare nga Enver Hoxha situata e brendshme në Shqipëri ishte e qëndrueshme, nuk kishte shenja për mungesë uniteti në lidhshkrimin shqiptar që nga koha e dënimit të Belishovës dhe Tashkos në 1960-ën. Edhe

situata ekonomike e vendit dukej e qëndrueshme dhe shteti po e mbante atë nën kontroll këtë herë me ndihmën e një tjetër superfuqie, Kinës (1962, 5-15 qershor, " The daily telegraph "). Kështu shkruante David Floyd, një korrespondent britanik i cili vizitoi Shqipërinë në pranverën e vitit 1962.

Për Kinën, Shqipëria ishte një vend i vogël, rregjimi i saj dukej i qëndrueshëm, besnikëria e saj ndaj komunizmit ekstremist e padiskutueshme dhe shanset për tu pajtuar me Moskën minimale. Nevoja për një protektor të fuqishëm ishte shumë e madhe dhe mundësia për të gjetur një tjetër të tillë përveç Kinës ishte po aq e vogël sa nevoja për të ishte e madhe.

Në 5 shtator 1968, në pleniumin V-të të KQ-së së PPSH-së, Enver Hoxha do të deklaronte "Ekzistenca e traktatit të Varshavës nuk luante asnjë rol pozitiv për mbrojtjen e vendit tonë, përkundrazi ishte një rrezik që vazhdon të mbetet edhe pasi ta revokojmë këtë traktat... kur ne të revokojmë traktatin e Varshavës, vendet e Natos mund të arsyetojnë me fjalët se e sulmojmë Shqipërinë pse është anëtare e traktatit të Varshavës....kështu e heqim atë argument nga dora e tyre." (1968. 6 shtator, " Zëri i Popullit")

Tërheqja përfundimtare edhe de jure, nga traktati i Varshavës ishte dhe prishja përfundimtare e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik.

Kapitulli VII Konkluzione

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik nuk dolën ndonjëherë nga tutela e varësisë dhe e preferencave. Edhe pse brenda të njëjtit kontekst ideologjik marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik reflektonin raportet e fuqive dhe për këtë arsye ato përherë u dominuan nga presioni, nga shantazhi nga njëra anë, dhe perkulja e bindja nga ana tjetër.

Ngjarjet në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit patën ndikim direkt në kursin e marrëdhënieve dypalëshe. Udhëheqja shqiptare nuk ishte në gjendje dhe nuk dëshironte të reflektonte ndaj ndryshimeve ndërkombëtare duke përfunduar drejt vet-izolimit.

Zhvillimet rajonale (marrëdhëniet midis BS-së dhe Jugosllavisë) patën efekte direkte negative në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Ngjarjet në Hungari dhe roli I BS-së dhe Traktatit të Varshavës në këtë vend trembën udhëheqjen shqiptare duke i dhënë goditjen përfundimtare marrëdhënieve dy palëshe. Ideologjia komuniste dhe mungesa e demokracisë në vendin tonë i jepte dorë të lirë udhëheqjes komuniste për të ruajtur monopolin e diplomacisë duke u fokusuar në interesat e kastës dhe në interesat komuniste. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën, edhe pse nën moton e interesit të përbashkët erdhën si konjunkturë për tju shmangur pasojave të rënda që solli prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Në vështirimin gjeopolitik ato lidheshin me interesat e Kinës për të krijuar praninë e vet në Europën Juglindore duke i veshur me interesa të përbashkëta ideologjike por duke qenë mbi bazën e balancave jo të barabarta, jo partnere dhe ato nuk e patën jetën e gjatë.

Rasti I analizës së ndikimit jugosllav në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik do të vazhdojë të mbetet një rast studimi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në raport me jugosllavët, Shqipëria asnjëherë nuk ka qenë prioritare, për Bashkimin Sovjetik. Në çdo rast ajo do të duhet të trajtohej në varësi të ulje - ngritjeve të marrëdhënieve BS - Jugosllavi. Kjo nuk ndryshoi si në kohën e Stalinit edhe në atë të Hrushovit.

Shqipëria nuk arriti asnjëherë të luante në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare midis dy të mëdhenjve. Ndërkohë interesi i udhëheqjes komuniste dhe paaftësia e pamundësia për tu kthyer në aktorë nuk arrinte të jepte rezultat në interesat kombetare. Unifikimi I interesave me ato ideologjike dhe personale krijoi një kornizë të hekurt për përdorimin e diplomacisë në marrëdhëniet ndërkombëtare për interesat e vendit. Unifikimi I interesave kombëtare me ato ideologjike dhe personale krijoi një kornizë të hekurt për përdorimin e diplomacisë në marrëdhëniet ndërkombëtare për interesat e vendit. Interesat e Bashkimit Sovjetik në Shqipëri dominuan gjithë hapësirën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare me vendin tonë. Interesi I vetëm I pandryshueshëm I BS-së në vendin tonë mbeti përdorimi i Shqipërisë si avan-post ndaj kundërshtarit tjetër. Gjeopolitika dominoi përfundimisht marrëdhëniet midis dy vendeve. Shqipëria për shkak të kufizimeve ideologjike dhe potencialeve të pakta, shoqëruar edhe me kultin e udhëheqjes komuniste nuk mundi ta kthejë politikën e jashtme në një instrument për interesat e vendit.

Në vlerësimin ideologjik, ndërsa Bashkimi Sovjetik hyri në rrugën e destalinizimit dhe liberalizimit të vendit pas kongresit të XX-të të Partisë Komuniste të BS-së, rrugë e cila iu diktua Hoxhës nga lideri sovjetik, historia ka treguar se Hoxha ruajti me çdo çmim pushtetin personal.

Arsyet e ndarjes janë të shumëfishta. Nga njëra anë Jugosllavia , rikthimi I marrëdhënieve sovjet - jugosllave , që luajti një rol shumë të rëndësishëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Por nuk mund të themi me bindje se Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik do ta kishin ruajtur miqësinë nëse këto marrëdhënie nuk do të ishin recuperuar. Apo nëse Shqipëria nuk do të ishte rreshtuar krah Kinës. Por edhe këtë rreshtim në këtë punim unë e kam parë në dritën e rikthimit të marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë. Sepse pikërisht kur u ndje e rrezikuar nga ky rikthim, Shqipëria I hodhi sytë nga Kina dhe anasjelltas, Kina konstatoi se mund të kishte një mbështetje të vogël në lindje të Europës.

Pra mund të themi se marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik lindën në një periudhë të vështirë ndërkombëtare dhe ato patën rolin e tyre të rëndësishëm në planin e

brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Ato nuk mund të gjykohen e vlerësohen bardhë e zi . Marrëdhëniet me BS-në patën ndikim në njohjen në arenën ndërkombëtare dhe në zhvillimin e brendshëm ekonomik. Efektet e këtyre marrëdhënieve patën peshë shumë të rëndësishme për kohën.

Edhe pse te propaganduara nga ideologjia si vëllazërore e të barabarta, marrëdhëniet dy palëshe mbetën deri në fund marrëdhënie vasaliteti. Marrëdhënie midis te fuqishmëve dhe të vegjëlve. Interesat gjeopolitike dhe interesat e partisë, dominuan mbi interesat kombëtare. Roli I Enver Hoxhës në zotërimin me grusht te hekurt të çdo fushe, dominoi për palën shqiptare edhe interesat në marrëdhënie me Bashkimin Sovjetik.

Mosmarrëveshjet brenda bllokut komunist, si ato mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, apo Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik treguan që mund të ketë divergjenca të mëdha edhe kur vendet ndjekin të njëjtën linjë dhe ideologji. Shkaku i divergjencave në disa raste ka qënë sovraniteti dhe çështje të rëndësishme me karakter kombëtar. Përsa i përket Shqipërisë faktet tregojnë se interesi kombëtar në dukje ushqente moton e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Por më tej, dokumentat e shumtë tregojnë se kjo mund të ishte “mbulesa më e mirë” për të ruajtur interesat dhe pushtetin personal të udhëheqjes. Studimi pavarësisht nga çështjet që trajton, nuk ka për qëllim të ezaurojë tematikën e punimit, por të japë një kontribut në analizën objektive dhe të ndikojë sadopak në vazhdimin dhe thellimin e trajtimit të kësaj tematike. Jetojmë në një kohë tjetër, por dukuritë janë të njëjtat, fenomenet dhe sfidat që vendi ndeshej edhe në periudhën 1953-1961 janë të ngjashme.

Bibliografia

Literaturë

Aliljeva, S. *Vajza e Stalinit për Stalinin*. (2006), Tiranë, Mësonjëtorja)

Belishova, L. (2010) *Kujtime dhe reflektime* .Gazeta Shqiptare

Brown, J. F. *Albania : Mirror of conflict* (1962). *Survey: A journal of Soviet and East-European studies*

Budini, B. *Tri kohët e Shqipërisë në Time 1923-2013*. (2014). UET press

Dougherty E. J, Robert L, PFALTZGRAFF Jr : *Contending Theories of International Relations. A Comprehensive Survey. Third Edition* (1993) Harper Collins Publishers

Duroselle. J. Kaspi. A. *Historia e Marrëdhënieve ndërkombetare*. V. II.(2011) Tirane. Lira

Duka.V. *Histori e Shqipërisë 1912-2000"* (2007) Tiranë . Kristalina-kh

Dymishi, D. *Lufta politike në udhëheqjen e PPSH-së 1944-1960*. (2011) Tiranë. Toena

Fevziu, B. *Enver Hoxha* (2011) Tiranë. UET press

Fischer, G. George, R. Graham, L. Levine, H. *Science and ideology in soviet society: 1917-1967*. (2012)

Griffith, E. G. *Albania and the Sino - Soviet rift*. (1963) Cambridge, Massachusetts. The M.I.T. Press

Gjilas, M. *Conversations with Stalin* (1962) New York

Historia III.(2003) Tiranë. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor

Historia e popullit shqiptar, Vol. IV, 1939-1944 (2009) Tiranë. Toena

Historia e Shqipërisë IV. (1983) Tiranë. Akademia e Shkencave

Historia e Shqipërisë (1973) Tiranë. *Akademia e Shkencave*

Hoxha, E. *Me Stalinin*. (1979) Tiranë. *8 Nëntori*

Hoxha, E. *Hrushovianët* (1980) , Tiranë, *8 Nëntori*

Hoxha, E. *Titistët* , (*kujtime dhe shënime historike*). (1982) Tiranë. *8 Nëntori*

Hoxha, E. (1956, prill 14.) *Marksizëm – Leninizmi mëson se populli është krijues i historisë*”.
Zëri i Popullit

Hoxha, E. *Mbi ngjarjet në Hungari. Vepra IV*. (1980) Tiranë .*8 Nëntori*

Hoxha, E. *Superfuqitë, Ditar politik 1959-1984*(1986) Tiranë, *8 Nëntori*

Hysaj, Q. (2010, korrik 29) *Udhëtim tre ditë me nëndetëse Kaliningrad - Vlorë. ATSH*

Kaba, H, Celiku, E. *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*. (2011) Prishtinë.
Brezi 81

Lalaj, A. (2010, maj 16) *Arkivat kineze dhe sovjetike, si e shiti Andropovi Liri Belishovën tek Enver Hoxha* . *Gazeta Panorama*

Lalaj, A. *Shqipëria dhe Informbyroja, studime historike nr. 3-4*. (2009) Tiranë. *Qendra e Studimeve Albanologjike*

Lalaj,A. 1956 - Pranvera e dështuar shqiptare, artikull, *Revista Historike*, nr.4, v. 2007

Milo, P. (1996. janar 21) *Dialog Sekret shqiptaro-amerikan. Koha Jonë*

Ngjela, S. *Përkulja dhe Rënia e Tiranisë shqiptare* . (2011) Tiranë. *UET press*

Ohri, D. (2010). *Une komandanti i Pasha Limanit ju tregoj të vërtetat e përplasjeve me sovjetikët* . *Gazeta Standard*

Olson W.C. *"The Theori and practice of international relations"*, Eighth Edition, New Jersey

Pearson, O. *Albania in the twentieth century , a history*, vol.III.(2006) *The centre for albanian studies*

Pollack, JD. *The sino-soviet conflict*. (1979) *Rand.org*

Ponomarev, I. (1961, dhjetor 21) *Interviste. Radio Moska 1500 GMT*

Salisbury, E. H. (1957, gusht 28) " the New York Times"

Smith. S, Hadfield. A, Dunne. T, *"Politika e Jashtme, teori-aktorë-raste"* (2012), UET Press

Vukaj, Sh. (2015, qershor 18), Batalioni shqiptar që luftoi për Rusinë, *Gazeta Dita*

www. britannica.com/event/Twentieth-Congress-of-the-Communist-Party-of-the-Soviet-Union

www.foia.cia.gov/sites/default/files/document_conversions/14/esau-19.pdf

Zagoria, S.D. *The sino-soviet rift 1956-1961*.(1969) Princeton. P. press

Zagoria, S. D. *Khrushchev's attack on Albania and Sino-Soviet Relations*. (1961). *Jstor.org*

Zagoria, S. D. *The sino-soviet rift 1956-1961*.(1969) Princeton. P. press

Zorza, V. (1962, maj 29) *The Guardian* (Manchester)

1956, *Marksizëm-Leninizmi na mëson se populli është krijues i historisë . Zëri i Popullit*

1953, mars 7. *Vendim mbi shpalljen e zisë në Bashkimin Sovjetik. Zëri i Popullit*

1953, mars 8. *Me 9 Mars do të bëhen mitingje zije në Tiranë dhe në qytete kryesore. Zëri i Popullit*

1953, mars 6. *Zëri I Popullit*

1953, mars 7. *Zëri I Popullit*

1953, mars 8. *Zëri I Popullit*

2011, *Kujtimet e Agim Popës. Gazeta Panorama*

1956, nëntor 5. *Zëri i Popullit*

1960, maj 5. *Zëri i popullit*

1960, 23 qershor. *Zëri i Popullit*

1959, shtator 9. *Fushatë shpifëse kundër Kinës. Zëri i Popullit*

1961, gusht 23. *Zëri i Popullit*

1961, gusht 15-31, *Zëri i Popullit*

1961, dhjetor 10. *Zëri i Popullit*

1962, mars 15. *Zëri i Popullit* 30 dhjetor 1961

1962, mars 13 prill. *Zëri i Popullit*

1961, dhjetor 30. *Zëri i Popullit*

1961, shtator 1. *Zëri i popullit*

1961, shtator 2. *Zëri i Popullit*

1961, shtator 8. *New York Times*

1961, tetor 1. *Zëri i Popullit*

1961, shkurt 14-21. *Vija e përgjithshme e partisë ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e drejtë.*

Zëri i popullit

1961. shkurt 14 . *Zëri i popullit*

1961. shkurt 20 - 22 shkurt . *Zëri i Popullit*

1961, tetor 31. *Pravda*

1961, tetor 23. *Pravda*

1961, tetor 27. *Pravda*

1961, tetor 26. *Pravda*

1961, shkurt 18. *Zëri i popullit*

1961, tetor 18-19. *Zëri i popullit*

1961, nëntor 1. *Marksizëm - Leninizmi do të triumfojë. Zëri i Popullit*

1961, nëntor 24. *Neue Zürcher Zeitung*

1961, dhjetor 12. *Pravda*

1961, dhjetor 10. *Zëri i Popullit*

1961, dhjetor 8. *Kennedy's wishful thinking. Observer*

1961, dhjetor 14. *Pravda*

1961, dhjetor 19,20,30. *Shpifjet dhe Trillimet nuk qëndrojnë. Zëri i Popullit*

1962, qershor 30. *Shamata mbi "ndryshimin" e Titos dhe e vërteta e pamohueshme. Zëri i Popullit*

1962, korrik 17. *Zëri i Popullit*

1962, korrik 22. *Zëri i Popullit*

1962, korrik 3. *Pravda*

1962, korrik 19, gusht 30, shtator 5. *Radio Moska në shqip*

1962, gusht 14. *South China Morning Post*

1962, qershor 5-15. *The daily telegraph (Londer)*

1968, shtator 6. *Zëri i Popullit*

Burime Parësore

AQSH, MPKBS, F.14, D 1/s , fl. 4, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 5, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl.11, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl.15, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 20,v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 21,v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 28,v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 29, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D.1/s, fl. 36, v. 1953

AQSH, MPKBS. F.14, D.9, fl. 34, v. 1953

AQSH, MPKBS. F. 14, D.9, fl.3, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 10, fl. 1, v. 1953

AQSH, MPKBS, F.14, D. 9, fl. 38, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 39, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 40, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 43, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 43, v. 1953

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 1, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 1, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 2, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 3, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 5 , v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 7, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 8, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 7, 8, 9,10,11, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 15, v. 1954

AQSH, MPKBS, f. 14, D. 6, fl. 20, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.21, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 51, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 52, v. 1954

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 5, fl. 2, v. 1955

AQSH, MPKBS, F.14, D. 10, fl. 13, v. 1955

AQSH, MPKBS, F.14, D. 10, fl.15, v. 1955

AQSH, MPKBS, F.14, D. 10, fl. 17, v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D.10, fl.18, v. 1955

AQSH, MPKBS, F.14, D. 10, fl. 18, v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 10, fl. 21, v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 10, fl. 22, v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 10, fl. 37 , v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 10, fl. 37 , v. 1955

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl.1, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl.48, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 50, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 53, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 57, v. 1956

AQSH, MPKBS, F.14, D. 3, fl. 61, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 64, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 53, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 56, v. 1956

AQSH, MPKBS, F.14, D. 19, fl. 57, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 57, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 57, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 57,v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 58, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 58, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 59, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 60, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 61, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fq. 64, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 23, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 24, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 26, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 29, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 31, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 3, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 105, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 107, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 111, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 16, fq. 112, v. 1956

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 1, fl. 50, v. 1957

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 1, v. 1957

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 2, v. 1957

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 3, v. 1957

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 19, fl. 4, v. 1957

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.1, v.1958

AQSH, MPKBS, F.14, D.6, fl.2, v.1958

AQSH, MPKBS, F.14, D.6, fl.6, v. 1958

AQSH, MPKBS, F.14, D.6, fl.7, v. 1958

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 9, fl. 3, v. 195

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 8, v. 1959

AQSH, MPKBS, F.14, D.2, fl. 12, v. 1959

AQSH, MPKBS, D. 14, D. 12, fl. 2, v. 1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D.23, fl. 1, v. 1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 2, v. 19

AQSH, MPKBS, F.14, D. 23, fl. 8, v.1959

AQSH, MPKBS, F.14, D. 23, fl.9, v.1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 23, fl.10, v.1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 11, v. 1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 12, v. 1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 23, fl. 13, v. 1959

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl.31, v. 1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl.40, v. 1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 3, fl. 42, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 21, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 22, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.10, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 22, fl.9, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D.22, fl.12, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 8, fl. 7, v.1960

AQSH, MPKBS, F.14. D.2, fl. 25, v.1960

AQSH, MPKBS, F.14. D.2, fl. 25, v. 1960

AQSH. MPKBS, F.14, D.6, fl.10. v. 1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 38, fl. 1, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 29, fl. 3, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 37, v.1960

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 2, fl. 39, v.1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl. 4. v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl.1, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl. 2, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F.14, D. 1, fl.2, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl. 3, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl.4, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl.5, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 1, fl. 5, v. 1960

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14. D. 5, fl. 30 , v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5. fl. 8, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 8-9, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 9-10, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 11, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 12, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F.14, D. 5, fl. 13, v.1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 16-17, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5. fl. 17-18, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 20, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 21,v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 25, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 26, v. 1961

AQSH, MPKBS, Traktati i Varshavës, F. 14, D. 5, fl. 29, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 31, fl.230, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 31, fl. 109, v. 1961

AQSH, MPKBS, F.14, D.3, fl. 64-65, v. 1961

AQSH, MPKBS, F.14, D. 3,fl. 66-67, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.3, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl. 5, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.7, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.12, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6, fl.12, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, D. 6. fl. 3, v. 1961

AQSH, MPKBS, F. 14, fl.16, v. 1961

AQFA, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl.5, v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak , F. 665, D. 1, fl. 2, v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak, F. 665, D. 1, fl. 2, v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak , F. 665, D.1, fl. 3 , v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak, F. 665, D.1, fl.4 , v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak, F.665, D. 1. fl. 5-11, v. 1960

AQFA, Reparti ushtarak, F. 465, D. 1, fl. 108, v. 1960

AQFA, F. 465, D. 1. fl. 67, v. 1960

AQFA, F. 465, D. 1, fl. 58, v. 1960

AQFA, F. 465, D. 1, fl. 103-104, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.40, fl. 1, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 40, fl.2 , v. 1957

AMPJ,Drejtoria e parë, B.S, D. 41, fl. 3, 4 viti 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 41, fl. 5, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 41, fl. 7, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 41, fl. 10, 11,v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 41, fl.12, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 43, fl 48, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 43, fl. 69, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 43, fl. 72, 73, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 43, fl.135,136, v. 1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 46, fl. 49, 50 ,v.1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S. D. 43, fl. 9, v.1957

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 50, fl. 1, v.1958

127/2 AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 50, fl 3, v. 1958

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 49, fl.5, 6,v. 1958

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 50, fl. 23, v. 1958

AMPJ, Drejtoria e parë. B.S, D. 45, fl. 87- 88, v. 1958

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.92, fl.40, v. 1959

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, dosja nr. 92, fl.83, v.1959

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 92, fl.51, 52, v. 1959

AMPJ, D. 342, fl. 26, v. 1959 (vendim i kolegjiut të MPJ dt. 1.8.1959)

AMPJ, D. 339,fl. 22, v. 1959, (telegram i zv. ministrit të punëve të jashtme V.Nathanaili dërguar përfaqësive diplomatike 19.8.1959)

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.42/6, fl.145, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/6, fl. 146, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/6, fl. 147, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/6, fl. 148, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.66, fl. 1, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 19, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.66, fl. 9, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 66, fl. 19, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 13, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 14, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 15, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 68/1, fl. 20, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 21, 22, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 30, v. 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 68/1, fl. 51, viti 1960

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 39, fl. 4, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 40, fl. 1, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 40, fl. 2, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 40, fl. 2-3, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/2, fl. 11-12-13- 14, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/2, fl. 32, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/2, fl.34, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/3, fl.111, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 8, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 4, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5,fl. 5, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, f. 5-6, v.1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/5, fl. 21. v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/5, fl. 23, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/5, fl. 24, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 35-36, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 40, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl.42, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 49, v.1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 50, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 51, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 53-54, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 66, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/5, fl. 67, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/2, fl.7, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/2, fl.8, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D.42/2, fl. 9-10, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 40. v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl 115. v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 95- 96, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/4, fl. 125, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/2, fl. 80- 81, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/7, fl.19-20, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/7, fl.19-20, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D.42/7, fl.1, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë. B.S, D. 42/6, fl. 68, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/6, fl. 129, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/6, fl.131, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S. D. 42/6, fl. 157, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S. D. 42/6, fl. 3, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/6, fl. 27, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42.6, fl. 63, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/6, fl. 112-113-114, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 51, fl. 24-26, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 51, fl. 28, v.1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/19, fl. 31, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/19, fl. 28, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/11, fl. 18, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 42/11, fl. 23-24, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 39, fl. 1- 2- 3, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/5. fl. 82, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/2, fl. 62, v.1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/2, fl. 63, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/2, fl. 83, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 70, v. 1961

AMPJ. Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 130, v. 1961

AMPJ, Drejtroria e parë, B. S, D. 42/4, fl.144, v. 1961

AMPJ. Drejtoria e parë, B. S, D.37, fl.1-2, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 37, fl. 3-4, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D.42/4, fl. 22, v. 1961

AMPJ. Drejtoria e parë, B. S, D. 37, fl. 6, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 37, fl. 10, v. 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B.S, D. 38, fl. 1/1, v, 1961

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/4, fl. 73, v. 1962

AMPJ, Drejtoria e parë, B. S, D. 42/14, fl. 68-69-73, v. 1961

